

■ Ali Pajaziti

■ In veritas
■ /traktat sociologjik/





© L O G O S - A

2 0 0 5



S H K U P

P R I S H T I N Ë

T I R A N Ë



■ Dr. Ali Pajaziti

■ In veritas

■ /traktat sociologjik/





■ Dr. Ali Pajaziti

■ In veritas

■ /traktat sociologjik/



Përbajtja:

KREU I PARË: PASQYRIME.....	9
Utilitarizmi politik dhe shoqëria e sëmurë	11
Fitorja e 'simbolit të atdhetarisë' kundër kombëtarizmit populist	16
Fokusimi i librit	21
E ardhmja dhe bashkëpunimi rajonal në Ballkan	25
Mbresa nga realiteti social flamano-valonas.....	33
Gjuha si sfidë e kombtarizmës	37
Shoqëria pa filozof(i)	42
Tranzicioni dhe psikologjia e shqiptarit	46
Të jetojmë së bashku	55
In medias res: mediumet	63
Tjetri në masmedia	129
KREU I DYTË: LEKSIONE.....	135
Shteti.....	137
Origjina e shtetit dhe teoritë e tij.....	139
Tipologjia, elementet kryesore dhe funksionet e shtetit	142
Përmbyllje	145
Format e qeverisjes me shtetin	146
a. Sistemi parlamentar	146
1. Sistemi parlamentar anglez.....	146
2. Sistemi parlamentar në vendet e tjera	151
b. Sistemi presidencial	153
Demokracia.....	158
a. Zhvillimi historik i demokracisë.....	159
b. Demokracia moderne	161
c. Problemi i demokracisë	163
Përfundim	166
Teoritë sociale bashkëkohore.....	167

a. Funksionalizmi	167
1. Talcott Parsons.....	170
2. Robert Merton.....	171
b. Interaksionizmi simbolik.....	172
1. G. Herbert Mead	173
2. Herbert Blumer	175
c. Etnometodologja.....	176
Don H. Zimmerman	177
KREU I TRETË: SHTOJCA	180
Bazat ideore të sociologjisë politike, fusha dhë përfshirja*	182
a. Bazat ideore të sociologjisë politike: Evropa	185
b. Bazat ideore të sociologjisë së politikës: ShBA-të	189
c. Përfshirja e sociologjisë politike dhe kufiri i saj me politikologjinë	192
Kultura politike	199
a. Koncepti “kultura politike” në literaturën e politikës	199
b. Kultura politike si një sistem simbolesh	202
1. Themeli psikologjik	202
2. Kulmi simbolik	205
Raportet mes kulturës politike, ideologjisë dhe bindjes politike	207
Kultura politike e elitës dhe e masës	211
Kultura politike dhe gjuha.....	215
Bibliografia	219
Indeksi	222

KREU I PARË:

Pasqyrime

Utilitarizmi politik dhe shoqëria e sëmurë¹

“Politika është punë e qytetarëve të dorës së dytë”

C. Alltan

1.

Me të vërtetë është shumë interesante çështja se si politika si një institucion shoqëror ka arritur të fuqizohet dhe të dominojë kaq shumë në çdo kënd të jetës shoqërore, saqë mund të thuhet se në kohën tonë, sidomos këto ditë, të gjitha rrugët shpien në politikë, mediumet më së tepërm janë të preokupuara me të, muhabetet e rrugës dhe të lokaleve me të, madje edhe fëmijët janë përfshirë në këtë sferë duke reklamuar rekuizite të “albumit politik” aktual. Do të ishte e kuptueshme që ajo, si një zanat i udhëheqjes me shoqërinë, të ketë vendin që e meriton, mirëpo s’të lë rehat shndërrimi i saj në një akrep ose gjarpër férshëllues që vigilon vazhdimisht mbi njerëzit, qoftë drejtpërsëdrejti ose duke e preokupuar mendjen e qytetarit të rëndomtë, i cili, për shkak të halleve të veta, në fakt s’ka kohë të mendojë për parakalimet e politikanëve të sojit të ndryshëm, por do s’do futet në rrjetin e procesit ireversibil ku trallëherë realizon diç nga ajo që pret prej tajfës së ”idealistëve” që meren me pu-

¹ Lobi, 9 shtator 2002, nr. 82, fq. 35.

nët e qytetarisë e cila është tërësisht e anonimizuar një periudhë të tërë prej zgjedhjeve në zgjedhje. Në katër vjet qytetaria vetëm një muaj është *in* kurse pjesën tjetër është *out*. Një pjesë e politikanëve, si njerëz të inspiruar nga vetvetja dhe të pajisur me artin demostenian (ndonjëherë vetëm shtiren si të tillë edhe pse s’ë njohin as Demostenin e as Ciceronin), punojnë vazhdimisht përritjen e rejtingut të “çerdheve të veta” dhe, siç flasin kulloret, dhe hulumtimet e organizatave të ndryshme të vendit dhe të huaja ”i mbushin xhepat e vet” e, nga ana tjetër, pohojnë se do t’u sjellin qytetarëve ditë më të ndritshme dhe me më pak brenga, premtojnë agime të treme, eldorado deri te të cilat s’arrihet dot.

Si grupe sociale që, në esencë duhet të janë organizata përmes të cilave do të realizohet vullneti i qytetarëve, partitë politike janë shndërruar në *grupe të interesit*, që duke e shfrytëzuar zonën e lirë të veprimit dhe njëren nga mangësitë më të mëdha të demokracisë - mosmundësinë për t’ia marrë votën atij që vepron kundër interesit të përgjithshëm, asaj që ka propaguar dhe premtuar, nëpër mitingjet dhe nëpër konferencat e shtypit herë tregohen si cezarë, herë si altruistë e bamirës, ndonëse një pjesë e tyre në fakt janë persona(litete) që “interesin e kanë princip jetësor të gjithmbarshëm” (George Washington).² Para do kohe një miku tetovar iu drejtova me këtë pyetje: Ç’thotë Tetova? M’u përgjigj: “Në qytetin tonë çdokush merret me politikë, kurse politikanët me ekonomi!”

Një aspekt tjetër i dehumanizimit të politikës është edhe përjashtimi i tjetrit, i konkurrentit, i atij që ka ngjyrime të tjera politike. Psikologja egocentrike i mbërthen lojtarët e valles politike aq shumë sa që tjetrin s’ngurronë ta nxijnë tërësisht, madje edhe ta satanizojnë. Ndo-

² Ukshin Hoti, *Filosofia politike e çështjes shqiptare*, Rozafa, Tiranë, 1995, fq. 32.

njëherë dinë të përgatisin edhe gracka nga më të shëmtuarat, vetëm e vetëm që tjetri të mos mund të përzihet në *mare nostrum* (detin tonë), pra në “meranë” e quajtur popull, shtet dhe pasuritë e tij të ndryshme.

Këto veçori nuk mund t'i përgjithësojmë dhe t'ia atribuojmë çdo politikani. Me siguri se të ndershmit janë prezentë në mesin e gamës së korpusit politik, por përfat të keq më tepër bien në sy ata me kulturë autoritare dhe individualiste, ata që bëjnë pjesë në kategoritë e gjysmëpolitikanëve, çerekpolitikanëve dhe hiçpolitikanëve!

2.

Në shkencën e sociologjisë ekziston një grup shkençtarësh, të udhëhequr nga Herbert Spencer, që e kanë zhvilluar teorinë biologiste lidhur me shoqërinë. Sipas kësaj teorie, shoqëria u pëngjan organizmave të gjallë. Pra, në të shfaqet gjendja normale, por edhe ajo e sëmundjes. Me sa duket, shoqëria në të cilën jetojmë ne është kapluar nga një sëmundje e rëndë, për shërimin e së cilës duhej të bëhej një “ndërhyrje kirurgjike”, pas të cilës shumica menduan se gjendja do të fillonte të normalizohej. Mirëpo, ç'e do që i sëmuri lëngon vazhdimisht nga dhembje të cilat i kanosen me spitalin, madje edhe me vdekjen. Mikrobë të shumtë mundohen pareshetur t'i hapin varrat duke treguar “trimëri të lartë e të rrallë”, duke folur me ton heronjsh legjendarë, duke luajtur teatër me llojet e shtazëve mishngrënëse që s'i gjen në tokën e këtushme, duke përsëritur refrenin “kurrë më...”, edhe pse është thënë për mrekulli: “Kurrë mos thuaj kurrë më!”

Vallë kush mund t'i ndihmojë këtij të sëmuri? Të gjithë qytetarët, e në veçanti *globi intellectualis*, elita urtare, e

cila si grup reference do t'i marrë penjtë në duart e veta dhe do të tregojë se s'arrihet gjë me mbyllje të rrugëve, por me hapjen e tyre, se nuk vlen formula njeriu + arma = trimëria = bota është imja, se mendësia e ngurtë, se punët pa vënë në peshore çojnë në gjendje kaotike.

Se ç'shoqëri jemi flet edhe ambienti parazgjedhor. Vetëm në një shoqëri të sëmurë në të njëjtën ditë, në të njëjtën gazetë mund të paraqiten dy të vërteta lidhur me rezultatet e katër vjetëve të kaluara të subjektit politik në pushtet. Shtangesh kur sheh dy të vërteta për gjëra konkrete dhe thua: ç'punë kjo? Dy të vërteta! E dimë se e vërteta është një dhe s'duron dualizëm! Dhe me të shpejtë i mbyll faqet, në të cilat domosdo njëra palë është gënjeshtare, që të kalosh në gjëra më shpresëdhënëse, që do ta heqin hidhësirën e matrapazllëqeve të makinerisë së marketingut shkurajues.

Por, sindromi të ndjek në çdo hap: pano e stenda afishimi me shumë ngjyra e me porosi tërheqëse që flasin se kolltukofagët tanë e tutje do të punojnë për popull, se do të shndërrohen në lule së cilës të gjithë do t'i marrim erë dhe në bletë punëtore, se gjendjen do ta ndryshojnë me një të rënë të shkopit magjik, se do ta shpien anijen në limanin që është destinacion edhe pse kabinën e shturmanit e kanë pasur boll gjatë dhe e kanë dëmtuar shumë mjetin që është para fundosjes. Ndonjëherë themi se ndoshta e meritojmë gjithë këtë, sepse, siç thotë një fjalë e urtë popullore, “Zoti sipas malit e jep borën!”

Sidoqoftë, edhe nëse jemi mal që e meritojmë këtë borë, s'duhet humbur shpresat, me të keqen s'duhet pajtuar, së paku s'duhet harruar, sepse “njerëzit e mençur, nëse falin, s'harrojnë!” (Th. S. Szasz) Më kanë lënë shumë përshtypje fjalët e shkruara në një pankartë të lirisë, të shfaqur menjëherë pas okupimit të ish-Çekoslovakisë në vitin 1968 nga Armata e Kuqe ruse:

*Asgjë nuk mësuam,
asgjë nuk dimë,
asgjë nuk kuptojmë,
asgjë nuk shesim,
nuk tradhtojmë,
dhe, nuk do të harrojmë!*

Dhe një gjë: ç'thoni për fjalët e Alltan-it, të cilat, sipas meje, janë tepër kategorike, por në vete ngërthejnë edhe pjesë të madhe të vërtetësisë, në veçanti kur kemi të bëjmë me një sërë të lumpenpolitikanëve të ditëve tona?

Fitorja e ‘simbolit të atdhetarisë’ kundër kombëtarizmit populist³

Njeri me arsyé të shëndoshë është ai që di të drejt-peshojë fjalët, interpretimet dhe kritikat e tij, që dhjetë minuta mendon dhe thotë një fjalë, që e mat mirë çdo gjë dhe bën një vijë të vogël ose shkruan disa shkronja në letër. Duke u nisur nga ky parim jetik, themi se nuk kemi për qëllim të bëjmë elozhe për fituesit e as t'i sulmojmë ata që pësuan disfatë në zgedhjet e pagëzuara “më demokratiket prej pavarësimit të këtij vendi”, por të bëjmë një analizë konstruktive lidhur me ngjarjen që na mbërtheu ditëve të kaluara të gjithë neve si qytetarë që presim që të na ngrohë më tepër dielli i së nesërmes.

Zgjedhjet parlamentare 2002; një kapitull i ri në historinë e shoqërisë sonë tranzicionale të përblytur me probleme të ndryshme dhe të etnive që jetojnë në të, skenë e re, sfida të reja, kërkesa të reja, mundësi që fituesit të marrin mësime nga gabimet e tjekrit, nga shkarjet e pararendësve, kurse humbësit “t'i skenojnë” lajthitet e veta që të kenë mundësi edhe më tutje të jenë lojtarë të fushës politike të kësaj shoqërie. “Periudha e re” është një hapësirë e dhënë për ta përdorur urtësinë, për ta përdorur potencën intelektuale që të krijohet atmosferë e përshkuar me më tepër optimizëm për të gjithë qytetarët

³ *Lobi*, 30 shtator 2002, nr. 85, fq. 31.

që janë të lodhur dhe rënkojnë nga problemet me të cilat përballen në këtë periudhë të mjegullt të historisë.

Në këto zgjedhje, me dallim nga përbërja politike maqedonase, ku dymbëdhjetë vjet, bëhet fjalë për një duel ndërmjet dy partive më të mëdha, kurse peshqit e vegjël mbijetojnë vetëm nëse u bashkohen atyre të mëdhenjve, skena politike shqiptare mori në sy *mezikun e vërtetë* dhe fitoi një opcion i ri, politikisht i paqenë në këto troje deri para një kohe të shkurtër, por me bagazh dhe pikë të fituara në fushëbetejë. Themi rrezik, sepse në zgjedhjet 2002 u investua fama dhe autoriteti i subjektit që zhvilloi me nam luftën për të drejtat shqiptare në këto anë. Po qe se BDI-ja, pavarësisht nga polemikat nëse e përfaqëson vetëm ajo ish-UÇK-në është *de facto* vazhdimësi e tri shkronjave simbol i rezistencës dhe pamposhtjes shqiptare - t'i humbte zgjedhjet, kjo do ishte një bum i madh në skenën politike të RM-së dhe huti e madhe dhe shpresëthyerje në opinionin shqiptar. Nëse partia politike që fitoi numrin më të madh të votave të shqiptarëve i humbte zgjedhjet, do t'u hapeshin gojët qëllimkëqinjve, albanofobëve të përbetuar dhe “strategëve të luftës” për të pohuar se “ja, dolën fjalët tona: me të vërtetë populli shqiptar nuk paska qenë me këta ‘banditë, mafiozë dhe terroristë’”, “nuk ua dha votën, sepse s’ishte me ta, shqiptarët e Maqedonisë nuk janë për militarizmin ahmetian, pra luftën e vitit 2001 e zhvilloi faktori i jashtëm, pra kosovarët”. Një gjë tjetër, që mund të ndodhë nëse BDI-ja i humbte zgjedhjet e që do të kishte pasoja shumë më të mëdha do të ishte humbja e kauzës shqiptare. Si do të humbte kauza shqiptare? Ja si: Do të humbte gjithë optimizmi, shpresa, legjenda e trimërisë rimore dhe atmosfera e krijuar nga grushti i parë që pas dekadash iu dha atij që i mëshonte shqiptarit vazhdimisht dhe pa mëshirë kur ia donte qejfi. Thënë

shkurt, rrëziku i daljes në skenë i partisë së re është zgjedhja e alternativës së hyrjes në fushën e minuar të politikës kundrejt mbetjes në faqet e historisë me shkronja të arta, edhe pse sukseen e rezistencës shqiptare 2001 s'do të mund ta fshijë kurrfarë debakli i mundshëm i veprimtarisë politike i ngadhënjesve të zgjedhjeve të këtij viti.

Është populli ai që partinë ngadhënijmtare të korpusit politik shqiptar e shpëtoi nga rrëziku i disfatës në zgjedhje dhe ia dha mundësinë të tregohet edhe në politikë. Ky udhëtar i ri në kompartimentin politik, fenomen ky të cilin, me fjalorin e mendimtarit amerikan Noam Chomsky do të kishim mundur ta quanim *nrymë e popullarizuar*, puhizë e re nga e cila masat e gjera presin shumë, duhet të zhvillojë një koncept dhe strategji të mirëpërpunderuar nëse do që të të korrë sukses të vërtetë aty ku i ka përveshur krahët.

Nëse do të ndaleshim pak të mendonim rreth shkaqeve që partinë e re e prunë deri te fitorja, si më të rëndësishmet do të mund t'i numëronim këto:

1. Figura e Ali Ahmetit, i cili në vetëdijen kolektive të shqiptarëve është personifikim i trimërisë dhe fitores në luftën e vitit 2001.

2. Populizmi kombëtarist i lirë i PDSH-së, që në kampanjën zgjedhore thuajse deshi të vë monopol mbi simbolet kombëtare dhe me këtë ta kthejë rejtingun e humbur, gjë që nuk kaloi te populli.

3. Marketingu politik jokorrekt i partisë në pushtet, bontoni politik i ulët, përpjekjet për ta deklasuar konkurrentin me fjalë me peshë (“struktura”, “përvoja”) të përdorura në kontekst të gabuar, kundërthëniet në strategjinë parazgjedhore. Është paradoks që t'i kërkosh votat me sloganin “synojmë Perëndimin” dhe ta quash flamurin e kaltër me yje, “flamur lara-lara”, të tregohesh

për integrim evropian dhe të mbyllesh në bahçen kom-bëtare, për të mos thënë partiake.

4. Dëshira e popullit për t'iu revanshuar antiuçëkëiz-mit maqedonas i cili, pasi nuk mundi ta ekskomunikonte, me të gjitha mjetet me të cilat dispononte përpinqej ta marginalizonte subjektin e ri politik shqiptar. Pra bëhet fjalë për faktin e quajtur “aksiuni-reaksioni”.

5. Dëshira e popullit për të parë dhe për të shijuar diç të re në skenën politike, mendësia popullore “t'i provojmë edhe këta”.

Është me rëndësi që partia ose lëvizja e re, e cila krijoi një atmosferë që t'i përkujton fillimet e viteve nën-tëdhjetë, gjendet para një sprove të madhe, ose do të bëjë *punë* ose do të përfundojë siç përfunduan paraardhësit ose oponentët politikë të këtyre zgjedhjeve. Aktorët e rinj të politikës duhet të dinë se, nëse i shmangen vijës në të cilën duhet ecur, nuk do t'u ndihmojë as bagazi i luftës e as karizma e personave dhe heronjve të luftës që janë gjallë (s'është fjalë për dëshmorët, sepse ata flijuan veten dhe u bënë të pavdekshëm), nëse nisen nga qëllimet e lehta dhe prirja egoiste e formës “o Metë secili për vete”, si përfundim i ligjit të natyrës do të marrin shpejt tezoshtëzën dhe do të treten, për më tepër do të komprometohen.

Është mirë që grupimi politik ngadhënjimtar, ndoshta duke u nisur nga largpamësia dhe vizionariteti, nuk ka dhënë premtime tëndërrash, nuk ka thënë fjalë të mëdha, nuk ka rrahu rujën në havan. Në udhën plot gropë në të cilën duhet të ecë subjekti i ri politik, jetësimi i Marrëveshjes Kornizë, pa bërë kompromise me pishman-hinxjtë maqedonas dhe zgjidhja e problemit të Universitetit të Tetovës, i cili është problem i mijëra të rinjve dhe familjeve shqiptare të cilat e ndajnë kafshatën e gojës për shkollim, duhet të jenë çështje primare. Në këtë drejtim

bashkëpunimi me partitë e tjera shqiptare është i pashmangshëm. Politika shqiptare do të ishte shumë destruktive po të krijonte hendek që do t'i ndante partitë simotra që synojnë destinacionin e njëjtë, por me metodologji të ndryshme. Rrugë më e mirë për ta avancuar kauzën shqiptare tek ne dhe atë panshqiptare në përgjithësi është ajo që Michael Kinsley e quan *politikë e menduar, politikë e ekuilibruar* si me faktorin vendor ashtu edhe me atë ndërkombëtar. Tani që çështja shqiptare është në një pozitë shumë më të volitshme se dekadave të kaluara nën zgjedhën e monizmit, nga njëra anë, dhe të sllavizmit, nga ana tjetër, duhet t'i jepet më tepër shtytje politikës racionale që të mund të fitojmë më tepër pikë në opininin ndërkombëtar dhe në skenën e kompcionit në mes popujve.

Vox populi e bëri të vetën, tash mbetet të tregohet *vox politica*. Është thënë: *Vox populi vox Dei est* (Zëri i popullit është zëri i Zotit). Populli dhe Zoti nuk harrojnë, kurse vepërmirin veprat e tij e mbrojnë.

Fokusimi i librit⁴

“Dhe vetëm dritë e diturisë përpara do të na shpjjerë!”

Naimi

Ditëve të kaluara në qytetin buzë Sharrit, në Tetovën e universiteteve shqiptare ndodhi diç për t'u shënuar dhe për t'u gjuar. Panairi i gjësë më të shtrenjtë - librit, vendtakimi i rrëzëllimit të diturisë dhe *fjalës shqipe*. Kjo e fundit është gjë pér t'u theksuar. Ditëve të kësaj ngjarjeje, një nga dojenët tonë të fjalës së shkruar, me dhembje dhe trishtim fliste pér kohën kur librat shqip njerëzia i lexonin fshehurazi se mos u binin në sy kolegëve servilë e puthadorë ose agjentëve shtetërorë të cilët kishin pér detyrë ta robëronin mendjen e njeriut, ta mbanin në pranga farën e diturisë, t'ia kufizonin njeriut një nga të drejtat dhe liritë elementare jetike: të lexojë, të informohet dhe të ushqehet nga burimet e diturisë të cilat ia ka ënda. Ai rrëfente se këta libra, të paktë pér nga numri, qarkullonin dorë më dorë, sepse ishte privilegji të kishe një libër shqip në kohën kur mbretëronte serbokroatishja e cila nga sistemi në fuqi shfrytëzohej si mjet indoktrinimi. E sot? Sot kemi libra shqip sa të duash, duhen vetëm lexues pasionantë që do ta konsumojnë frytin e mundit të dhënë nga autorët, përkthyeshit, botuesit si dhe nga të gjithë ata që nxjerrin në dritë publikimet diturore.

⁴ *Lobi*, 14 tetor 2002, nr. 87, fq. 31.

Nga sa pashë ditën kur e vizitova këtë festë të librit, lexuesi i këtyre trojeve dalëngadalë po sensibilizohet edhe në aspekt të leximit. Gëzohesha sidomos kur shihja fëmijë e të rinj që me gojën plot i thoshin emrat e autorëve ose titujt e veprave të kolosëve së fjalës së shkruar. Gumi zhima e njerëzve në kërkim të dritës ma shuajti aty për aty pesimizmin që na ka kapluar duke i dëgjuar sondazhet joformale të prindërve, mësimdhënësve dhe të profileve të tjera për faktin sa lexon shqiptari i këtyre trojeve. Thashë me vete, s'është gjithçka aq e zezë, kemi dhe ne gjasa për të formuar breza të edukuar në të gjitha sferat e jetës.

Pse e theksoj kaq librin. Për shumë arsyе. Së pari në “pazarin” e botës së qytetëruar mund të konkurrohet vetëm me vlera diturore. Popujt që nuk dinë të kafen pas vlerave të mirëfillta të diturisë s'mund të konkurrojnë në mejdanin ku fillon gara ndërmjet kulturave. Në një tribunë shkencore në të cilën pjesëmarrës ishte edhe autori i këtyre rreshtave, filozofi (pa hamendje) i vetëm i Maqedonisë, miku ynë i respektuar, Ferid Muhiq, duke folur për rrëthanat dhe kushtet në të cilat rrojmë tha se punën që do ta bënin dhjetë veta me studimet universitare ose ato pasuniversitare në universitetet më të mëdha në botë si Oksfordi, Kembrixhi ose Harvard-i s'mund ta bëjë as pasuria më e madhe materiale e një populli. Fjalë me vend. S'i luan topi. E për të arritur të kemi njerëz që të studiojnë dhe të marrin diploma në këto qendra ku kultivohen “mendjet e mëdha” duhet të mëkojmë fëmijë dhe të rinj me bagazh. Kjo është punë e rëndë që varet nga shumë faktorë.

Një aspekt tjetër i rëndësisë së librit është edhe ai i shoqërizimit (socializimit) të individit ose qytetarit, pra i krijimit të qytetarit të dobishëm, gjë kjo të cilën e synon çdo shoqëri racionale. Libri është një agjens që ndikon

në synimet e njeriut, në veçanti në orientimin e të rinxve të cilët në atë moshë delikate i fokusojnë dhe dalëngadalë i gjejnë shtigjet jetike nëpër të cilat do të ecin gjatë jetës. Pra, përveç familjes, grupit të shoqërimit, personave të referencës, mjedisit shoqëror, mediumeve etj., në formimin e njeriut ndikon edhe “faqja e shkruar”. Megjithëse libri nuk bën foni, ai krijon në mënyrë magjike personalitetet, krijon njerëz në kuptimin e plotë të fjalës, jo vetëm *homo ecco* (njeri që flet), por edhe *homo sapiens* (njeri që mendon), jo vetëm bukëngrënës por edhe dituribërës. Libri është faktori që familjeve dhe organeve përkatëse mund t'u sigurojë gjumë të rehatshëm: ta pakësojë ose ta zhdukë virusin e delikuencës rimore, narkomanisë, shitjes së trupit, anomisë si dhe të shumë sëmundjeve nga të cilat lëngon e tërë shoqëria. Prandaj nënvizojmë: më mirë është t'ua bëjmë shok librin fëmijëve tanë, para se t'u bëhet shok ndonjë ves i ditëve tonë, para se të fillojmë ta kruajmë kokën e të mos mundet askush të na dalë në ndihmë. Përgjegjësia është e të gjithëve, duke filluar nga prindërit deri te instancat më të larta shoqërore. Dikush do të thotë: i mirë gjithë ky idealizëm, po paratë për të blerë libra? Le të ndajmë vetëm nga 20 % të asaj që e harxhojmë për gjëra të qejfeve të rrejshme (p.sh. cigaret) dhe do të shohim se në fund të vtitit çdo shtëpi do të ketë një qoshe të librit ndonjë raft me libra që do ta ndriçojë atë vatër, që do t'i bie në sy fëmijës, mikut... Mua më brengos fakti se kemi shumë mburravecë që rrabin gjoks me orënditë shtëpiake, me autoveturat, me verimet e kaluara atje e këtu e pak të tillë që përpiken t'ia heqin telashet nga qafa si vetes ashtu edhe shoqërisë duke e avancuar dijen dhe diturinë. Mendimtari i shquar turk I. Ozel, në njërin nga librat e vet, *Shkrime të padobishme*, ka vënë një titull mjaft simbolik:

“Duke pritur diturinë”. Ky titull sikur treh edhe mjedisin tonë. Jemi në pritje të diturisë.

Në fund, duke kërkuar ndjesë nga autor i rrështave në vijim, sepse për fat të keq në fletoren prej nga i përcjell nuk e kam të shënuar burimin, do t'i kisha cituar këto fjalë kuptimplota:

Libri,

është i pashpirt, të emocionon.

Është i ftobtë, ta dashurosh të çon.

Nuk zë peshk për ty, të peshkosh të mëson.

Nuk flet, bërtitje të dhuron.

Është vetmi, kallaballëqe formon.

Është një, shumëson.

Është i fshehtë, publikon.

Është i pafajshëm, gjuajtësit e fajeve i motivon.

Është botëror, shenjtëron.

Është i shkruar, të pashkruarën ta mëson.

Është tabelë, rrugë tregon.

Është “i egër”, miq krijon.

Është i qetë, nxit e të lëvizësh të çon!

E ç'gjë mund të ketë ndikim më të madh se fjala e bukur? Mendoj se s'duhet kurrfarë komenti, apo jo, lexues të dashur?

E ardhmja dhe bashkëpunimi rajonal në Ballkan⁵

Se “fuçia e barotit” është tepër e rrezikshme jo vetëm për banorët e Gadishullit Ballkanik, por edhe për tërë Evropën më së miri flet interesimi i formacioneve të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare të Kontinentit të Vjetër lidhur me këtë zonë traumatike, përpjekja për ta kuptuar dhe hulumtuar “Evropën Juglindore” apo Ballkanin nga këndvështrime të ndryshme. Në këtë kontekst Instituti i Sindikatave Evropiane me seli në Bruksel dhe fondacionet “Hans Böckler” dhe “Friedrich-Ebert”, prej 2 deri më 4 nëntor në Knokke-Heist, një qytezë kjo afro 150 km. larg kryeqendrës evropiane, e organizuan “Simpoziumin e Dytë të Revistës së Evropës Juglindore” (SEER) në të cilin u diskutua edhe një herë për Ballkanin, por këtë herë kryesisht nga vetë ballkanasit. Të ftuar ishin afro 40 veta nga vendet të ndryshme (për fat të keq mungonin përfaqësuesit e dy vendeve më të përvuajtura dhe më të dëmtuara nga konfliktet në trojet e ish-Jugosllavisë: Bosnja dhe Kosova), midis të cilëve edhe autori i këtij vështrimi, që të referojnë dhe të diskutojnë hapur lidhur me problemet që i mundojnë vendet e tyre dhe më gjerë.

⁵ *Lobi*, 18 nëntor 2002, nr. 92, fq. 31-32.

Në sesionin e së dielës, pas hapjes solemne, i pari foli përfaqësuesi i Qendrës Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Beograd, Florian Bieber, i cili e elaboroi temën “Kooperimi rajonal si një instrument i mbrojtjes prej konflikteve”. Në mes tjerave, ai vuri theks të veçantë mbi kooperimin rajonal, i cili, sipas tij, nënkupton bashkëpunimin ndërmjet fqinjëve, mbi rëndësinë e mbrojtjes prej konflikteve, të cilat i ndau në dy grupe (ndërshtetërore dhe brendashtetërore-qytetare). Ai po-hoi se është shumë rëndë të bëhet përkufizimi i konflikteve dhe cilësimi i tyre. Si shembull e mori luftën e Bosnjës, e cila sot e kësaj dite ndonjëherë cilësohet si agresion i Serbisë kundër BH-së e ndonjëherë si luftë qytetare. Bieber-i u ndal edhe në mbrojtjen post-konfliktuale, në kthimin e refugjatëve si një çështje me peshë, në nacionalizmin etnik dhe polarizimet në këtë sferë dhe në shkaqet dhe mungesën e mundësisë për t'i evituar përpbrasjet ndëretnike (mungesa e mekanizmave rajonalë, ngecja në sferën ekonomike, mungesa e mekanizmave për mbrojtjen e lirive dhe të të drejtave të minoriteteve...). Sipas Bieber-it Bashkësia Evropiane ka zgjedhur dy modele lidhur me konfliktet: *modelin e krizës*, pra të zgjidhjes së problemit pas ndodhjes së krizës ose përleshjes (Bosnja, Maqedonia) dhe *modelin e integrimit*, të pengimit të konfliktit në saje të bisedimeve për të gjetur gjuhë të përbashkët (përpjekjet për të krijuar një union ndërmjet Serbisë dhe Malit të Zi). Referuesi i parë u ndal edhe në pretendimin e kandidatit për kryetar të Jugosllavisë së cunguar, M. Labus se “vendi i tij për 7-8 vjet do të bëhet pjesë përbërëse e BE-së” dhe tha se nuk pret që një gjë e tillë të ndodhë për dhjetë e më shumë vjet. Bieber ka konstatuar se integrimi evropian nuk është duke shkuar nga e mira dhe se marrëveshjet bilaterale për minoritetet janë problematike. Në fund potencoi rëndë-

sinë e *pajtimit rajonal* midis etnoseve të ndryshme që jetojnë në trojet ballkanike.

Diskutuesi i dytë, Dragan Gjuriq, nga Konfederata e Sindikatave të Pavarura të Malit të Zi, e zbërtheu temën “E ardhmja e Malit të Zi si një partner për bashkëpunim rajonal”. Ai tha se politika millosheviqiane i dha fund ndjenjës së “jugosllavizmit” të krijuar për 45 vjet dhe shkaktoi një mori problemesh. Në këtë kontekst ai u ndal edhe në pozicionin e vendit të tij në raportet e krijuara me zhbërjen e ish-Jugosllavisë dhe insistoi në domosdoshmërinë e pavarësimit të Malit të Zi si kërkësë e forcave proevropiane të këtij vendi të vogël i cili i vetmi deri më tanë kaloi pa konflikte. Mbetjen e këtij shteti jashtë konfliktit ai e lidhi me përvojën historike e cila çdo qytetar të këtij vendi e shtyn të bëhet pjesë e identitetit të përbashkët malazias, pa marrë parasysh nënidentitetet si shqiptar, boshnjak etj. Ai rrëfeu se në luftërat e zhvilluara në trojet ish-jugosllave janë ngatërruar edhe malazez, por veprimet e tyre nuk kanë arritur t'i prishin marrëdhëniet e Malit të Zi me fqinjët. Sipas Gjuriq-it kontraktimet për mbetjen brendapërbenda shtetit të ri artificial jugosllav dhe Harta Kushtetuese janë të gjykuara të dështojnë, ndërsa përfaqësuesit malazez në instancat federale janë jo legalë dhe nuk e përfaqësojnë vullnetin e popullit të Malit të Zi. Ai shprehu edhe dyshimin lidhur me konceptin që ka shteti i ri, i cili, sipas tij s'mund të përkufizohet as si federatë e as si konfederatë. Përfaqësuesve evropianë iu drejtua me pyetjen pse Mali i Zi dënohet të mbetet në Jugosllavi, “mos do të thotë kjo se Serbisë i falet vendi i fundit që i ka mbetur pas humbjes së tokave në të cilat ajo kishte pretendime territoriale si Sllovenia, Kroacia, Bosnja dhe Kosova”. Malaziasi insistoi në presionin e bashkësisë ndërkombëtare mbi këtë vend, e në këtë drejtim e përmendi cilësimin e M. All-

bright-it lidhur me rrëzimin e Milosheviq-it prej pushtetit “Serbian Democratic Revolution”, ndryshim ky që gjoja se i ka hapur shtigjet për mbetje në “shtetin e ri”. Ai u shpreh se Mali i Zi ndoshta nuk pavarësohet për arsyen se ndërkombëtarët e dinë se pas këtij akti do të pasonte pavarësimi i Kosovës, e pavarësimi i kësaj të fundit do të hapte problemin e bashkimit të R. Sërpëska me Serbinë, gjëra këto që do t'i shkaktonin shumë telashe bashkësisë ndërkombëtare.

Aleksandar Fatiq nga Qendra për Menaxhim nga Beograd i trajtoi temën “Korrupsioni si një barrierë e bashkëpunimit rajonal”, ku midis të tjera shka se Evropa Juglindore është laboratori metodologjisë dhe projekteve të anti-korrupsionit që mund t'i shërbejnë tërë Evropës në drejtim të zgjidhjes së problemeve të kësaj natyre. Ai theksoi se në disa vende të kësaj hapësire të Evropës pjesë e problemit të korruptionit janë edhe burokracitë e ngatërruara në të.

Ljiljana Viduçiç nga Universiteti i Splitit i trajtoi çështjen e rrjedhave ekonomike në Kroaci, kurse Snježhana Vasiljeviq nga Universiteti i Zagrebit foli për “minoritetet etnike dhe çështjen e kooperimit rajonal në kuadër të Procesit për Stabilizim dhe Asocim”.

Bruno S. Sergi nga Universiteti i Messina-s dhe ai i Melburn-it i pa me sy kritik kushtëzimet të cilat organizatat ekonomike ndërkombëtare ua bëjnë vendeve në tranzicion që përpilen ta implementojnë ekonominë e tregut. Ai foli edhe për politikën e tutorit të cilën FMNja (IMF) dhe Banka Botërore e zbatojnë mbi këto vende, për nevojën e ndihmave monetare të cilat kontribuojnë në pengimin e krizave, në stabilizimin e sistemeve dhe në integrimin e ekonomive vendore në ekonominë botërore ku do të jenë më të hapura ndaj biznesit të huaj.

Kumtesa e Carl Bethke-s nga Universiteti Freie i Berlinit kishte të bënte me “vështirësinë e procesit të ngritjes së kombeve në Ballkan”. Autori pohoi se gjatë dekadës së shkuar Ballkani ka qenë shembull klasik i nacionalizmit bashkëkohor evropian. Ai u ndal mbi elementet kyç të shoqërive paramoderne të Ballkanit, mbi domethënien dhe zhvillimin e nacionalizmit në Evropën Perëndimore dhe Qendrore, mbi procesin e zhvillimit të nacionalizmave në Ballkan përgjatë shekujve XIX dhe XX. Sipas tij Ballkani premodern, edhe pse i lidhur me pjesën tjeter të Evropës në aspektin gjeografik, gjuhësor, të përvojës greko-romake dhe kristiane, ka dy tipare që bien në sy: tradita ortodokse dhe trashëgimia osmane. Në traditën ortodokse, Kisha ka qenë, në aspektin shpirtëror dhe institucional, më pak se në Perëndim e ndarë prej shtetit, gjendje kjo të cilën Eusebio e përshkruan si *symponia* ose *cezaropapizëm*. Në trashëgiminë osmane, ku ka qenë në fuqi sistemi i *milet*-it popullata është ndarë në bazë të feve ose konfesioneve. Sipas Bethke-s, idetë bashkëkohore për themelimin e kombeve në Ballkan janë adoptuar së pari nga shtresat e vogla të intelektualëve dhe të tregtarëve, për të cilët nacionalizmi ka qenë koncept funksional në luftën kundër Perandorisë Osmane. Te sllavët e jugut të gjitha përpjekjet për integrim shekullar kanë dështuar dhe kanë shkaktuar gjakderdhje (Kroacia e Madhe, Serbia e Madhe, jugosllavizmi). Në Ballkan, sipas tij, gjejnë vend si modeli i nacionalizmit shtetëror francez ashtu edhe ai gjerman i bashkësisë kulturore, por në vend të gjetjes së “përcaktimi pozitiv” ku kombinohen orientimi qytetar me të drejtat e pakicave, zakonisht bëhet “përcaktimi negativ” i nacionalizmit. Me rëndësi, sipas shkencëtarit të ri gjerman, është gjetja e një kornize që do ta garantojë de-

mokracinë, që do ta shmangë dhunën, që do t'i mbrojë të drejtat e njeriut dhe ku do të mbisundojë e drejta.

Lajos Hethy, sekretar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale të administratës ndërkombëtare të Kosovës foli për “politikën sociale dhe të punës në Kosovën multietnike”. Ai theksoi se është shënuar një progres i madh në zhvillimin e politikës sociale në këtë vend (vënia në binarë e sistemit të ndihmave sociale dhe të pensionimit). Ai përmendi edhe shkaqet pse Kosova nuk është zonë atraktive për investime të huaja (pasiguria, shtrenjtësia e punës, nebulzoza politike etj). Hethy, mes tjera shpesh pohoi se “Kosova *de facto* është shtet i pavarur”.

Dushan Janiq, nga Institutit i Shkencave Sociale i Universitetit të Beogradit, i cili temë diskutimi e pati “të ardhmen e Kosovës shqiptare/serbe”, shtroi pyetje nëse Kosova është në gjendje më të mirë sesa në kohën e Millosheviqit. Në këtë drejtim ai përmendi rritjen e madhe të numrit të policëve me të cilët Kosova “qeverisej” në periudhën e sundimit të Millosheviq-it (20 000) dhe atij të formacioneve të rendit me të cilat menaxhohet sot (60 000), rritjen e numrit të banorëve të Prishtinës nga 250 000 në 500 000 edhe pse infrastruktura ka mbetur e njëjtë. Me sa duket Janiq-i sikur harron se nuk është me rëndësi numri por veprimet e policëve dhe se Serbia s’ka pse të kujdeset për kualitetin e jetës së kosovarëve sot kur nuk është kujdesur me dekada të tëra! Ai kërkoi që të mbahet një konferencë paqësore ndërkombëtare për Kosovën, e ngjashme me atë të Dayton-it dhe shprehu “brengosjen” e tij për problemet e kosovarëve për të dalë jashtë vendit dhe si zgjidhje propozoi që në vend të pasaportave të UNMIK-ut qytetarëve kosovarë t’u jepen të tilla me shënimin “European Community”. Në një bisedë të zhvilluar me ne ai e “volli” tërë pesimizmin lidhur me të ardhmen e Kosovës si pjesë e Ser-

bisë dhe rrëfeu rastin kur ai kish pohuar se Sllobo-s kosovarët duhet t'i ngrenë një bust të madh, sepse me hapat e tij të pamatur e shkëputi këtë “krahinë” nga Serbia.

Kumtesën e vet me titull “Maqedonia dhe shqiptarët – perspektivat për një të ardhme të përbashkët” e shpalosi në fund autor i këtyre tresshtave. Ai e përmendi “koincidencën” e marrjes së autonomisë së Kosovës në të njëjtin vit me ndryshimin e preambulës së Maqedonisë si nismë e problemeve me të cilat u përballi ky vend kohëve të fundit. Ai foli për nacionalizimin e shtetit nga kombi shumicë dhe ndërtimin e jetës shoqërore në trajtë përjashtuese, *kujtesën e shkurtër* të udhëheqësisë shtetërore e cila s'mori shembull nga konfliktet që ndodhën më në veri. Pajaziti pohoi se tranzicioni i parë i pasuksesshëm (1990-2001) duhet të jetë mësim i mirë për të gjitha strukturat shtetërore. Shoqëria stabile mund të krijohet vetëm nëse në epikendër vihet qytetari e jo kolektivitetet nationale, nëse avancohen të drejtat dhe liritë e njeriut, normat për barazinë, inkluzioni social etj. Paqja konstante mund të sigurohet vetëm nëse krijohet komunikim ndëretnik i cili do t'i eliminojë ekstremizmat kundërshtues, vetëm nëse *etnokracia zëvendësohet me vlerat e vërteta demokratike*. Në vazhdim vuri theks në rëndësinë e jetësimit të plotë të Marrëveshjes Kornizë dhe në bindjen se shoqëria që ka hyrë në periudhën e tranzacionit të dytë gjendet përballë dy orientimeve me rëndësi: multikulturalizmit në spektrin socio-kulturor dhe modelit të shoqërisë postetnike si matricë formale bashkëkohore e kombit politik.

P.S. *Dallimin ndërmjet mendësise ballkanase dhe asaj evropërendimore e shpreh më së miri ndodhia në vijim. Pas përfundimit të simpoziumit udhëtonim me veturë për në stacionin e trenit për t'u kthyer në Bruksel. Zonja Vidiçiq e pyet shoferin për*

pronarin e hotelit ku u mbajt ky tubim dhe ai përgjigjet se “pronarë jemi të gjithë, unë dhe 25 punëtorët, nëse njëri nuk punon si duhet, të gjithë humbim”. Pra zotëria që na shpinte në stacion ishte pronari që veten e konsideronte të barabartë edhe me punëtorët e thjeshtë të këtij objekti turistik.

Mbresa nga realiteti social flamano-valonas⁶

Pak më sipër theksuam një ndodhi që të bën të ndalesh dhe të mendosh lidhur me diskrepancat që ekzistojnë midis realitetit tonë tipik ballkanas, për të cilin nuk mendojmë se është i paracaktuar ose i predeterminuar, dhe atij perëndimor i cili jo gjithmonë ka qenë në nivelin e sotëm të mendësisë dhe të zhvillimit socio-ekonomik. Pra varet prej nesh nëse do të mbetemi bisht i botës apo do të garojmë me më të mirët. Vetëm para disa shekujsh i tërë Perëndimi përjetonte periudhën e errët (mesjetën), kurse një pjesë tjeter e botës ishte simbol i përparimit dhe i qytetërimit. Këtë e di gjithkush që ka sadopak njoħuri nga historia objektive.

Në pauzën midis dy sesioneve të simpoziumit dolëm të shëtisnim rrugëve të qytezës së formuar nga dy fshatra të dikurshme, ku çdo vjet mbahej një manifestim përkujtimor nga kanadezët, popull ky që kishte dhënë dy mijë viktima në mbrotjen e asaj zone bregdetare në Luftën e Dytë Botërore. E pyes vetveten: Ç'idealizëm ky që njerëzit i ka sjellë nga një qoshe e botës në tjetrën që ta sakrifikojnë veten për një vend të huaj? Dhe, përnjëherë më shkuan ndër mend shqiptarët të rënë dëshmorë në Jemen si ushtarë osmanë, disa mijë turq që kanë dhënë jetën e tyre në fillimin e pjesës së dytë të shekullit XX në luftën e Koresë, vullnetarët nga vendet e ndry-

⁶ *Lobi*, nr. 95, 9 dhjetor 2002, fq. 31.

shme që janë vrarë në luftën qytetare në Spanjë etj. Të gjithë këta, për qëllime dhe ideale të ndryshme, kanë dhënë më të shtrenjtën: jetën. Dhe atë shumë larg truallit të vendlindjes.

Gjatë qëndrimit tonë disaditësh në Belgjikë vërejtëm disa gjëra të cilat shumëkush tashmë i ka parë dhe nuk janë sekuenca të reja, por përsëritja e gjërave të mira dhe pozitive është dobipurëse dhe do të ishim të kënaqur sikur ato ta ndryshonin pak duzinën e negativiteteve që po na përcjellin si shoqëri dhe si komb.

Rrugëve të këtij vendbanimi që të përkujton përshkrimet e parajsës, me bahçe e parqe fantastike, me drurë e kullosë të kositur me kujdes, me lule të llojlojshme, me shtëpi të radhitura me rend e me sistem, boll të vjetra, por të mirëmbajtura me pedanteri, thuajse çdo shtëpi është pallat përrallor. Syri të kërkonte ndonjë shtëpi të re apo në ndërtim e sipër, por s'e gjeje dot. Zötërim i plotë i klasikës. I tillë ishte edhe hoteli në të cilin qëndruam, me të gjitha komoditetet por i vjetër. Qerimi, një student prishtinas me prejardhje nga Presheva, që studionte drejtësinë në Universitetin e Utrechtit në Hollandë, më rrëfen se ndërtimi i shtëpive të reja është i rregulluar me norma dhe kushte të veçanta dhe se madje ka edhe fabrika që prodhojnë tulla të cilat jepin përshtypje se janë të vjetra, se janë pjesë e një historie. Ç'konservatorizëm ky - i them vetvetes- ç'dashuri dhe respekt për të kaluarën, në kundërshtim me ne që ëndërrojmë vetëm të renë, modernen, bashkëkohoren,, ç'popull nostalgjik këta belgët? I riu kosovar vazhdon dhe më thotë se shtëpitë e vjetra i kanë çmimet shumë më të majme sesa të rejat. Te ne edhe monumentet kulturore zëvendësohen me ngrehina të reja të ndërtuara pa shije. Përkujtoni vetëm çarshinë e vjetër të Shkupit ku është përdho-

sur sa s'bëhet kultura e trashëguar e këtij qyteti me histori të bujshme.

Rrugëve të Knokke-s vërejmë njerëz që shëtisin me kuaj. Biçikletat sikur e kanë zaptuar çdo kënd të qytezës në fjalë. Biçikletat, prej të cilave ne turpërohem sepse mendojmë se tani është koha e makinave të autosalloneve! Ç'kontrast ky, të pasurit me biçikleta, shqiptarët (dhe ballkanasit) me Benz-a, pa kulm mbi kokë e me "qerren e fortë". Qerimi e vazhdon sagën e vet dhe thotë se në Holandë edhe profesorët universitarë vijnë në vendet e tyre të punës me biçikletë. Me të vërtetë njerëz pa kompleks! Tek ne edhe më i pashkolluari madje del të blejë deri edhe bukën veturën që "vezullon", duke gënjer vreten se kështu e shpreh "statusin e lartë social". Mos t'i përmendim burokratët të cilët pa veturën zyrtare me zerot si shenjë dalluese s'lëvizin këmbën prej pragut të zyrës të veta. S'e di çdo të kishte thënë Max Weber-i, i cili burokratin e shihte si tip ideal, për burokracinë e sodit të "batisur" në zdërhallje, luks e pispilosje?

Edhe një nuancë me rëndësi. Ujin të cilin e konsumonim ishte i ambalazhuar në shishe të xhamit, që janë shumë më higjenike. Plastikë-shishet tona që na i kanë mbuluar përrenjtë, lumenjtë dhe çdo kënd bosh s'arritëm t'i shihnim me sy. Duke darkuar më hip pak tensioni dhe i them kroates së moshuar që e kisha afër: Po këta ne s'i arrijmë "asnijëherë". Ne ëndërrojmë vetura, këta ecin me biçikleta, ne i zumë fushat duke bërë shtëpi të reja, te këta paha të lartë kanë shtëpitë "e moshuara", te ne lëngjet i gjejmë në pet-shishe, te këta në ato të qelqit. E vërtetë - më drejtohet ajo me buzëqeshje.

Natën që po udhëtoja me tren nga Brukseli për në Knokke, më ra në sy se gjëja e parë që po nxirrnin nga çantat e tyre e shumta e udhëtarëve ishte libri. Me të shoqëroheshin madje edhe nëse udhëtonin shumë shk-

urt, nuk e humbnin kohën kot. Më kujtohet thënia e një kolosi të historisë njerëzore: “Koha është si shpata, nëse s’ë pret atë, të pret ajo ty”. Mendoja mos është rastësi ky aktivitet i leximit kaq pasionant. Por të njëjtën gjë e pamë edhe gjatë kthimit për në kryeqytet. U mundova t’numëroja disa prej vleravë të një shoqërie që na ranë në sy. Me siguri se këto shoqëri kanë edhe antivlera të shumta, të cilat s’patëm rast t’i shohim, por për të cilat flasin me bollëk mediat, udhëpërshkruesit, hulumtimet e ndryshme shkencore, veçse njeriun me energji pozitive duhet ta interesojnë aspektet mbresëlënëse dhe prej tyre duhet të marrë shembuj për ta përmirësuar së pari mendësinë e vet e më pas të tjegrit. Të vërtetë, të mirën dhe të dobishmen njeriu i mençur e merr pa marrë parasysh ku e gjen atë.

Mbetemi me shpresë se shumë gjëra të realitetit tonë do të marrin nga e mira. Është thënë se shpresa është gjëja e fundit që shuhet te njeriu.

Gjuha si sfidë e kombtarizmës⁷

Para do kohe pata rastin të lexoja për vdekjen e një dijetari lindor (pakistanez), që kish ligjëruar nëpër universitetet më të mëdha botërore, që një periudhë të konsiderueshme të jetës e kish kaluar në Perëndim dhe që pjesën e fundit të jetës kish vendosur ta kalonte në Paris, por që sëmundja e kishte shpurë në një spital të Floridës ku e dha edhe fryshtë e fundit. Fija që e bën interesant rrëfimin për këtë dijetar, që njihte, lexonte dhe shkruante në mbi dhjetë gjuhë të ndryshme, duke filluar nga ajo amtare urdu, anglishtja, arabishtja, frëngjishtja, rusishtja, spanjishtja etj. është fakti, se me t'u kapluar nga një sëmundje e rëndë, i kishte harruar të gjitha gjuhët me përjashtim të amtares, pra s'mund të vinte kontakt me njerëzit pos në gjuhën amtare dhe me atë të shenjave. Me të vërtetë një rast që të lë gojëhapur dhe të bën të mendosh. Si mund të harrojë njeriu gjithçka të futur në trurin e vet, me përjashtim të gjuhës amtare, si mund të abstraktohet një tërësi zërash dhe shkronjash të një morie gjuhësh?

Sociolinguistët pohojnë se fenomeni i quajtur gjuhë amtare është një kod “i mbjellë” te njeriu që nga ninanana në djep dhe ajo shndërrrohet në “pjesë të pashlyeshme” të personalitetit të çdo njeriu, se jeton në ndjenjat e tij. Shikuar në aspektin sociologjik mund të thuhet se

⁷ *Lobi*, 13 janar 2003, nr. 100, fq. 43.

çdo etnos ose komb ka sistemin e vet të simboleve në saje të të cilit pjesëtarët e tij komunikojnë ndërmjet tyre, e kuqtojnë njëri-tjetrin dhe me të e *ndërtojnë identitetin* që dallon nga identitetet e grupeve të tjera sociale që kanë sendërtuar gjuhën e vet. Edhe ne shqiptarët e kemi bërë kodifikimin, të cilit disa i thonë konsolidim i gjuhës sonë me qëllim të sigurimit të nivelist më të lartë të homogjenitetit brendashqiptar dhe kulturës së përbashkët që do të mund të konsumohet nga çdo shqipfolës.

Kohëve të fundit për *homo albanicus*-in temë mjaft aktuale është edhe ajo e dy dialekteve të gjuhës shqipe, gegë dhe toskë, edhe pse, siç shprehet një gjuhëtar i njo-hur i këtyre trevave, dallimet qëndrojnë vetëm në tri pika fonetike. Kjo temë ka shkaktuar rihapjen e bisedës për “padrejtësitë që i janë bërë gegërishtres në Kongresin e drejtshkrimit të gjuhës shqipe, të mbajtur më 1972 në Tiranë”, ndikimin enverist për t'i dhënë përparësi toskë-rishtes... Edhe më parë gjuhëtarë të shquar si Eqrem Çabej, Shaban Demiraj, Mahir Domi, letrarë, publicistë, analistë e mendimtarë janë prononcuar rreth “unitetit të gjuhës”, por, nga ana tjetër, ekziston edhe grupi i atyre që luftojnë për “t’ia kthyer hakun dialektit të anashkalur e të nëpërkëmbur”, madje para do kohe më ra në dorë edhe një gazetë kosovare (Java) për të cilën shoku që më dha tha se “në të shkruhet gegërisht, se është e një mqedisi që e avancon gegërishten”. Se çështja e dualitetit dialektor nuk është aq minore tregon edhe fakti se dalgadalë po krijohet një atmosferë për mbajtjen e një kongresi të dytë të drejtshkrimit të shqipes, se ndër pyetjet e para që u shtrohen personaliteteve të mëdha shqiptare është edhe ajo që e prek këtë çështje (Kadare për VOA-n, në RTK). Më 11-12 nëntor 2002 në kryeqytetin e Shqipërisë u mbajt një konference shkencore ndërkombejtare në temën “Shqipja standarde dhe shoqëria shqi-

ptare sot” ku u prek tërthorazi problemi në fjalë, por iu tha qartë “jo” minimit të shqipes dhe trungut kombëtar.

Pasojat e ecejakeve gojore dhe të shkruara në sferën e kësaj problematike mund të jenë shumë të rënda, duke filluar nga “përçarja gjuhësore”, hapja e ngadalshme e jazit ndërmjet gjeografisë alabanofone jugore dhe veriore... Skenarët po gatuhen djallëzisht në kuzhinat e ndryshme antishqiptare që ëndërrojnë një luftë të imagjinuar brendashqiptare, si barrierë e unitetit kulturor gjithëshqiptar. Tentativat përçarëse nisen nga e famshmja thënie latine “Divide et impera!” (Përçaj e sundo!) Ndarja dialektore e shqipes do ta zbehte, madje do ta përdhoste vetëdijen kolektive shqiptare, të leckosur për 45 vite të monizmit, vetëdije kjo që sapo ka filluar “t’i marrë këmbët”, në vend të letërnjoftimit gjithëkombëtar - “ne shqiptarët” do të krijonte ndarje të llojit “ne” dhe “ata”, veriu-jugu, do të ndahej hapësira e fjalëve të ëmbala shqipe në dy zona, do të përcaheshin lexuesit, shtëpitë botuese, hir e pa hir do të botonim në dy variante, secili me publikun e vet lexues, mediumet do të kultivonin dy shqipe...

Kujtojmë se është me rëndësi të kuptohet ligji sociologjik i Kontit, sipas të cilit, *gjendja e një fenomeni të vëçantë shoqëror nuk mund të kuptohet nëse nuk e vendosim atë në raporte me tërësinë sociale*, pra, ashtu sikundër nuk mund të kuptohet një element i tërësisë sociale pa e marrë në konsideratë këtë tërësi, nuk mund të kuptohet edhe një moment i evolucionit historik pa i hyrë seriozisht vetë këtij evolucioni. Domethënë, është me rëndësi që të sqarohet mirë racionaliteti i mbizotërimit të njërit dialekt dhe përparësitë nga unifikimi, të bëhen ilustrime me taste të ngjashme në realitetin botëror. Me të vërtetë çasti dhe rrrethanat janë tepër kritike në këtë kohë të krizës, e cila besojmë se është episodike dhe sipërfaqëso-

re, kohë kjo kur njerëzit duan që diqysh të zbrazen nga stresi dhe problemet e shumta ekonomike-sociale me të cilat përballen. Edhe pse jemi të sigurt se sondazhet sociometrike do të kishin treguar se ballafaqohemi me probleme më të mëdha sesa ky që e trajtojmë, çështjen në fjalë e shqyrtojmë për shkak të rrezikut të moskokëçarjes për problemet e mëdha dhe kalimit te më të voglat ku do të kërkohej një satisfaksion i rrejshëm.

Është mjaft simptomatik rasti i ShBA-ve të cilat kanë arritur të ndërtojnë kombin amerikan të bazuar në gjuhën e përbashkët si përfaqësues kolektiv (*common representatives*), megjithëse gjeneza, historia dhe kultura e qytetarëve të këtij vendi është e karakterit difuziv. Elementi i gjuhës angleze si *supraidentitet*, me gjithë diversitet e shumta në këtë shoqëri multietnike dhe multikulturore, e ka luajtur rolin e vet konstruktiv. Tani neve si shqiptarë na hapen shtigjet e optimizmit dhe themi se kur mund të gjejnë gjuhë të përbashkët afro-amerikani me skocezin, arabo-amerikani me latino-amerikanin, russo-amerikani me tajlandezin e kinezin, nuk duhet të kemi kurrfarë problemesh për të gjetur pikën e përbashkët, pikën e takimit, pika të cilat, në rastin tonë, ndryshe nga ai i amerikanëve, janë të shumta. Ne kemi histori të njëjtë, gjuhë të njëjtë, jetojmë në territor të njëjtë gjeografik, kemi tradita e doke të njëjta, mendësi dhe ndërtim ndijor përafërsisht të njëjtë...

Mendojmë se problemiit në fjalë duhet që t'i hyjmë si me metodën veberiane të të kuptuarit (*verstehen*) dhe me të të shpjeguarit (*erklären*), e këtë mund ta bëjnë intelektualët e mirëfilltë, duke mos u lënë vend atyre që duan të luajnë me kartat e dallimeve dialektore, të cilat askush nuk i mohon. Nuk duhet t'i lëmë vend asaj që Kont e quan *anarki intelektuale*, e cila mund të pjellë krizë politike dhe morale. Le të mbetemi me shpresë se do të

mbizotërojë motoja e Konsultës së Prishtinës e vitit 1966 “një komb-një gjuhë”, qoftë edhe e modifikuar pak a shumë në korniza të racionales. Me rëndësi është të mbetet unike, ombrellë e kombëtares.

Shoqëria pa filozof(i)⁸

Mendimtari është njeri që e vë në lëvizje shoqërinë, që e mban atë brenda një dinamizmi të pandërprerë, që mundohet ta shohë edhe të padukshmen, atë pas perdes, që mundohet ta kapë edhe të pakapshpmen, të flasë në mënyrë kuptimplotë edhe kur hesht, që përmes dy fjalëve e thotë atë që thuhet në një vëllim të tërë, që nuk është snob por zë i kohës... Një kategori e njerëzve të ambientit të lartë shoqëror (sipas Platonit kategori e pri-jësve shoqërorë), një kategori e ithtarëve të idealizmit janë filozofët, personalitete që duke e kërkuar *të vërtetën*, i japid vulën epokës në të cilën jetojnë, që *mendimin e lidbin me jetën dbe ekzistencën*. I famshmi Descartes është shprehur kështu: *Cogito, ergo sum!* (Mendoj, pra ekzistoj!) Ky urtar i shquar në mënyrë implicitë ka pohuar se ai që nuk mendon, që nuk përpinqet t'i njohë gjërat, që nuk mundohet të hyjë në botën e ideve, ai s'ekziston fare, është i vdekur për së gjalli, madje qoftë fizikisht edhe njeriu më i fortë e më i shëndoshë në botë.

Për fat të keq, mund të themi se në mjedisin shqiptar është bërë normale *gjendja pa filozof e pa filozofi të mirëfilëtë*. Është rëndë për t'u thënë, por është realitet, se nuk njohim asnjë filozof shqiptar që merret në mënyrë sistematike me urtësinë, që bën filozofi, që merret me çësh-tjet sublime të harkut filozofik. Ta themi të drejtën, në

⁸ *Lobi*, 3 shkurt 2003, nr. 103, fq. 31.

këtë kategori (pra të filozofëve) s'mund t'i fusim as njerëzit tanë të letrave, autorët e prozës dhe të poezisë - për të cilët kemi respekt të veçantë dhe i lexojmë me ëndje - që në aureolën e tyre krijuese shfaqin një imagjinatë të bujshme, por jo filozofi në plotkuptimin e fjalës.

Më kaplon një ndjenjë e pezmit për fatin tonë gjithëshqiptar kur mendoj rrëth faktit se jemi ngushtuar tepër dhe jemi bërë shoqëri pothuajse vetëm e hulumtuesve të gjuhës, kulturës dhe historisë sonë kombëtare. Dikush do të thotës se “kush s'e njeh vetveten s'mund të ecë përpara, ai që s'e respekton vetevetn s'është askushi”. Po, e pranoj, por vërtitja vetëm në oborrin e kombëtarës, kufizimi vetëm në gjeografinë tonë është nonsens dhe absurd, është një *circulum vitiosus* (qark i mbyllur). Duhet qenë më i hapur ndaj botës. S'është thënë kot “vetëm uji që lëviz është i pijshëm”. Para do ditësh, duke lexuar një revistë kroate prestigjioze (*Globus*) rastisësa në një kolumnë të saj për botimet e reja dhe në të mëra në sy titulli “Kontributi kroat për egjiptologjinë”. Bëhej fjalë për veprën *Egjipti i vjetër* të Igor Uraniq-it, drejtëtor i departamentit për egjiptologji në Muzeumin Arkeologjik të Zagrebit. Ç'ka interesante në këtë të dhënë - do të pyes dikush? Është me rëndësi puna e shpërndarë në fusha të ndryshme të jetës, degëzimi i veprimit tarisë intelektuale në shumësi lëmenjsh diturorë, është me rëndësi fakti se drita e njerëzve të urtë ka bërë që një shoqëri të dijë të ballafaqohet me diversitetin e vlerave.

Ndonjëherë e arsyetoj veten duke thënë se “filozofët lindin”, ata vijnë nga bota e numenit, nuk janë të botës së fenomeneve, por mbifenomenë, nuk kultivohen. Po prapë, seç më ngacmon dhe them, vallë mos jemi të predeterminuar të mos kemi filozof(ë)? S'është e vërtetë – them - filozofët janë gatim i talentit të dhënë nga Perëndia dhe stërhollimit të mendimeve e të

ndjenjave në hapësirë dhe kohë, janë aliazh i dhuntisë dhe i përpjekjes.

Gjithherë e kam pëlqyer idenë e Th. Carlyle-it se historinë e bëjnë njerëzit e mëdhenj, heronjtë e kohës, ata që e kapërcejmë vijën e anemisë jetësore, që gjenerojnë vlera të cilat i regjistrojnë shekujt. Në këtë kategori bëjnë pjesë edhe filozofët, që krijojnë e thyejnë legjenda e mite, që e mësojnë popullin të mos bishtërojë e as të kapërdijë gjëra të gatshme, që dinë të gjykojnë edhe për gjërat më delikate *sine ira et studio* (pa urrejtje e anim), që dinë t'i zgjidhin problemet e kohës sipas një logjike briliante, që dinë t'i jasin mend popullatës edhe në çastet më kritike, që kanë guximin t'i thonë ndal vëllavrasjeve për hiçgjë, që me urtësi i bëhen barrierë pazarit të trupave femërorë që rrënojnë familje të tëra, që kataklizmën nuk e vërejnë vetëm nga prizmi i sipërfaqësores, që haptazi shprehin largpamësinë se shoqëria e korruptuar s'ka të ardhme, që me ëndje e pinë kupën e hidhur të ekskomunikimit për hir të të qenët *in veritas...*

Njeriu i madh-filozof di të krijojë një korelacion të shëndoshë ndërmjet politikës, ekonomisë, religionit, psikologjisë, sociologjisë, historisë, antropologjisë, nuk është i skajshëm në bindjet e veta, s'i mbyll sytë para së vërtetës, i përgatit “asistentët e së ardhmes së kombit” të përvëluar nga ëndrrat pasojë e premtimeve të Elbasanit të fillimeve të demokracisë për “ngrënje me lugë floriri”, di t'i hapë shtigje popullit që përballet me probleme të identitetit të vet kulturor, të së ardhmes politike, të konvertimit masiv në grekëri, të çështjes së universit të diturisë, të arsyes funksionale... Ç'tragjedi është për një etnos në të cilin s'nihet hermeneutika e Hermesit, s'diskutohet për postulatet e filozofisë etike kantiane, për *Prologomena-n*, për Averroes-in, për Heidegger-in, fenomenologjinë huserliane, për shkollën e Frankfurtit... për e për...

Sa i kënaqur do të isha sikur dikush të më përgënjeshtonte dhe të më tregonte se prapseprapë kemi filozof(ë)!

Ndoshta ky shkrim bën pjesë në kategorinë e shkrimeve të padobishme, por i fortrespektuar Ismet Ozel më ka pushtuar me vargjet në vijim dhe më ka mësuar përi eliksirin e dobisë në padobishmëri:

*Sa një dru që s'jep fruta
të padobishme le t'jenë këto shkrime të mia.
Askush duke synuar frutat e tij
le t'mos ketë shkas të gjuajë gurë degëre.
Këto shkrime le të jenë të padobishme
sa një dru shumëdegësh, shumë i shtrembër.
Atëherë marangozët
s'do ta shohin të vlefshëm që ta presin e gdhendin.
Sa një dru trungbosh, vrimëgojerë, i parrëshirë
le të jenë të padobishme këto shkrime të mia.
"Nuk vlen përi djegie ky dru," -le të thonë,
le të mos e djegin.
Prapë të padobishme le të jenë!
Si një dru, le të jenë këto shkrime të mia:
Që rrënjet i ka në tokë,
degët drejt qiellit.
Mbase askush s'e mbjell në bahçë,
e s'e vë në bullevardin e qytetit.
Por, nëse në një vend të largët e të thatë
një udhëtar i trullosur
gëzohet e freskohet
ngase gjeti një dru
ku do ta mbështesë shpinën e do të çlodhet,
më mjaftron kjo!*

Tranzicioni dhe psikologja e shqiptarit⁹

(Hamit Beqja, *Tranzicioni demokratik dhe psikologja e shqiptarëve të sotëm*, Mësonjtorja e parë, Tiranë, 2000, fq. 203)

Periudha e tranzacionit të shoqërive të Evropës Juglindore, pra e atyre të sistemit real-socialist, me tiparet e veta specifike është bërë objekt studimi i shumë dijetarëve të profileve të ndryshme, të cilët merren me këtë fazë të transformimit apo “të ndërrimit të lëkurës” për shkak të ndryshme - strategjike, pragmatiste, shkencore etj.

Në librin e tij të titulluar *Tranzicioni demokratik dhe psikologja e shqiptarëve të sotëm*, që ka karakter vrojtues e mediativ, akademik Hamit Beqja, flet për tranzicionin si për një kapercell historik të kalimit nga një sistem shoqëror, i bazuar në një monizëm të gjithanshëm, politikisht njëpartiak dhe i vetëquajtur komunist, nga një sistem ekonomikisht i centralizuar në një sistem të ri shoqëror me natyrë të theksuar demokratike. Sipas tij, zhvillimet e reja i kapin të gjitha sferat e jetës shoqërore, materiale e shpirtërore, politike, sociale dhe ekonomike, kulturore, etike e zakonore, madje edhe psikologjike. Këto zhvillime janë mjaft të vrullshme e kontradiktore, të shoqëruara me retushime të totalitarizmit të vjetër dhe të neotalitarizmit. Për *demokracinë*, në Shqipëri si një

⁹ Lobi, 15 korrik, 2002, nr. 74, fq. 35; 29 korrik, 2002, nr. 76/77, fq. 33.

ndër konceptet më të konsumuara të tranzpcionit, thotë se ende është e brishtë dhe se duhet të bëhet stabilizmi dhe konsolidimi i institucioneve demokratike në të gjitha nivelet qeveritare e jashtëqeveritare, qendrore e lokale, duhet të kultivohet një mendësi e re demokratike, çështje kjo që ka të bëjë me *psikologjinë e njerëzve*. (f. 6-7) Sa më i varfër të jetë vendi që hyn në rrugën e tranzpcionit, aq më e vështirë, më e gjatë dhe më e ndërlikuar është hyrja në demokraci, në saje të së cilës duhet të bëhet liri-mi nga indoktrinimi i njëanshëm monist, nga vargonjtë e censurës e të autocensurës. Mbi flatrat e demokracisë njerëzit do ta ndiejnë veten të lirë mendërisht duke e afirmuar në vetvete lirinë e mendimit e të fjalës, personalitetin dhe identitetin e vet.

Autori, i cili subjektin në fjalë e kap nga prizmi i psikologjisë së personalitetit, i psikologjisë sociale, etnike dhe socioetnike, na jep një tablo shumë interesante për krizën e identitetit, depersonalizimin, psikologjinë skllavëruese të individëve, për emancipimin shpirtëror të njeriut si qenie sociale dhe ekonomike, si subjekt politik, pronar, konsumator, subjekt i jetës arsimore e kulturore etj. (f. 24) Ai “ëndërron” formimin e *personalitetit të lirë*, që do të mendojë me kokën e vet, jo në mënyrë mekanike, sidomos jo qorrazi, një personalitet antipod i atij që ishte brumosje psikologjike, mendore dhe emocionale e indoktrinimit marksist-leninist dhe e vijës ideologjike të partisë-shtet, që nuk do të frikësohet nga akuzat për “agitacion e propagandë”, që do ta arrijë maturitetin mendor, që gjërat nuk do t'i shohë vetëm bardhë e zi, që nuk do të niset nga pozicione aprioristike... Për gjithë këtë ai sugjeron mësimin e gjërave në baza të vërteta shkencore, larg trajtimeve të njëanshme e tendencioze, politizuese e ideologjizuese.

Prof. Beqja e kundërshton ashpër *figurën e të stërdituarës* dhe *të stërkompetentëve*, të cilët janë refleksion i sëmundjes karakteristike të kohës, pasqyrim i atmosferës së lirë demokratike e pluraliste, i mundësisë së shprehjes së lirë e të pakufizuar të mendimit. I stërdituri i ditëve tona është subjektiv dhe intolerant dhe duke i zbrazur bateritë e diturisë e të kompetencës, mendon se e afirmon personalitetin e vet. (f. 45) Prirja për të qenë i stërditur dhe stërkompetent shoqërohet edhe me llafazanëri që është e bezdissħme për të tjerët, ndërsa satisfaksionuese për atë që flet. Duke e kritikuar këtë tip të përsonalitetit, autori i përmend fjalët kuptimplotë të një frëngu: “Ruajna Zot nga gjysmëdijetarët!”

Në veprën në të cilën artikulohen segmente shumë të rëndësishme të përditshmërisë shqiptare trajtohet edhe subjekti i *kalimit nga ekonomia e centralizuar* në atë të *tregut të lirë*, ku krijohet mundësia për shpërthimin e iniciativës së lirë, të cilën Beqja duke u mbështetur në të folurit e popullit, e quan *çalltisje*. Thonë çalltis shumë, është i çalltisur, që do të thotë është i shkathët dhe me iniciativë. Sipas tij, sistemi i ekonomisë së tregut të lirë sikur thotë: punoni, fitoni, pasurohuni. Pasurohuni, por duke zbatuar ligjet dhe rregullat e lojës së lirë të tregut, jo pa parë se ku po shkel, jo duke shkelur mbi të tjerët. Duke punuar, qoftë edhe duke shpejtuar e vrapuar, por ndershmërisht. Në formimin e psikologjisë së re të punës mund të ndihmojë edhe tradita shqiptare që flet për njeriun që “e ka punën në gjak”, traditë kjo në të cilën nëma më e rëndë është “Të daltë puna qejfit!” (f. 63) Por edhe këtu duhet bërë një nivinizim, nuk duhet kaluar në pozitën e “qenit të lekut”, i cili do të shqyejë për vete sa më shumë, duke shkelur mbi të tjerët, duke i nëpërkëmbur interesat e të tjerëve. Pra, duhet pasur

kujdes nga psikologjia grabitqare, me kahje të theksuar antishoqërore. (f. 66)

Autori, i cili bën një analizë mjeshtërore të tranzicionit, flet më tutje për dekonstruktivizmin dhe destabilizimin, të shfaqura në mënyrë më eklatante në vitet 1991-92 dhe 1997, për *psikologjinë rrënimtare e shkatërrimtare*, dukuri këto që arsyes së shëndoshë i duken krejtësisht absurdë. “Janë shkatërruar e djegur rrugë e ura, rezervuare e kanale vuditjeje, shtëpi banimi, objekte të ndryshme administrative e sociale, spitale, shkolla, çerdhe e kopshët fëmijësh, ferma pemësh frutore, deri edhe monumente kulture e biblioteka”. Si shkaqe të kësaj psikologjie dijetari në fjalë e përmend antikomunizmin e zi patologjik, psikologjinë ose orgjinë e rrugës që priret nga *instiktet destruktive*.

Profesor Beqja “rrëfen” edhe për shumë plagë të tjera të rënda sociale si korrupzioni, kontrabanda, mafioziteti, kriminaliteti etj. Ai ndalet sidomos te korrupzioni dhe thotë se kjo dukuri ka depërtuar gjithandej, në zyra, institucionale, madje edhe në drejtësi. (f. 76-77) Korruptohen, marrin ryshfete jo vetëm nëpunësit e niveleve të ndryshme, deri te pushtetarët, bile edhe të lartët, por edhe ata që për nga natyra e punës duhet të janë të pastër e të shenjtë si gjykatesit, mjekët, mësuesit etj. Shqipërinë e ditëve tona nuk e ka kapluar vetëm kriza ekonomike, por një krizë e përgjithshme, krizë morale, psikike, shpirtërore. Kjo krizë përshkohet nga anomali të shumta si narkomania, prostitucioni, dhuna seksuale, pedofilia, incesti etj. Patologjia sociale ka arritur deri në atë nivel saqë çdo ditë lexojmë për ndonjë baba që përdhunon të bijën! (f. 78)

Një dukuri tjetër e shëmtuar janë edhe vrasjet “për pesë para gjë”, vrasjet e bëra nga bandat e organizuara, vrasjet e hakmarrjes/gjakmarrjes e cila si një dukuri ata-

vike kanunore ka qenë e struktur dekada me radhë, kurse në demokracinë ka gjetur truall që përsëri të shpërthejë.

Autori vë theks edhe mbi psikologjinë e zhgënjin, nihilizmin dhe pesimizmin që mbretëron te shqiptari i ditëve tona, mbi *përçarjet* si një dhembje e rëndë kancero-gjene që e prish trupin dhe shtetin kombëtar. Lidhur me këtë të fundit (përçarjet) ai e citon Gjergj Fishtën: “Më kollaj është të mbushësh një thes me pleshta se sa t’i bësh bashkë dy shqiptarë!” dhe Konicën i cili thotë se “Shqipëria nuk bëhet, pasi për këtë janë pengesë vetë shqiptarët, pasi nuk bëhen dot ata vetë”. (f. 81)

Profesor Beqja pohon me bindje se, rilindësit, me gjithë këto fjalë, nuk kanë qenë as nihilistë e as bukëshkalë. Ata qenë patriotë të mëdhenj dhe ky zemërim i tyre me shqiptarët është zemërim i patriotëve të dëshpëruar prej të cilëve buron thirrja për zgjim, për kthjellim dhe bashkim.

Dijetari i shquar, prapseprapë përpinqet të na tregojë se gjithçka nuk është kaq tragjike. Në një kohë kur pretendohej se Shqipëria është shpërbërë keqas, se shqiptarët janë degraduar rëndë, kjo Shqipëri “e shpërbërë” dhe këta shqiptarë “të degraduar” i priten dhe i trajtuan vellezërit e vet kosovarë me një bujari të rrallë, në mënyrë madhëshe-tore, aq sa shumë të huaj objektivë kanë thënë se në kohët e sotme vetëm shqiptarët mund ta bënin këtë. (f. 82)

Autori, i cili e ka eksploruar shumë mirë shoqërinë shqiptare me të gjitha veçoritë e saj, bën një retrospektivë të psikologjisë pozitive të shqiptarit që shfaqet në mendësinë, traditat, zakonet, ritet etj. Sipas tij, në këtë trafsh të psikikës kombëtare mund të hasim shumë virtyte që e reflektojnë shpirtin e potencialitetit e të via-litetit shqiptar. Midis këtyre virtyteve ai e veçon *burrërinë*, që shprehet në maturi, në të qenët i përbajtur, jo i nxituar dhe jo i rrëmbyeshëm, *bujarinë*, *mikpritjen*, *besën*,

nderin, ndjenjën e solidarësisë fqinjësore dhe *miqësore* etj. Duke folur për këto cilësi, autori jep shembuj konkretë. Lidhur me bujarinë përmend aforizmin “shtëpia është e Zotit dhe e mikut” dhe rastin kur e kanë pyetur malësorin që duhej të ekzekutohej me varje se a e kishte ndier veten ndonjëherë më ngushtë e ai është përgjigjur: “Po besa, kur më ka ardhur miku në derë e nuk kam pasur çfarë t’i shtroj në sofër”. (f. 109) Shqiptari anekënd botës njihet edhe si njeri i besës, dukuri kjo zakonore e karakterit psikologjik, por që ka edhe kuptim politik. Me besa-besën janë lidhur shqiptarët edhe fis me fis, edhe krahinë me krahinë për ta mbrojtur vendin, lirinë, zakonet dhe të drejtat. Kush e ka shkelur besën është mallkuar, është damkosur si tradhtar. Për shqiptarin mbajtja e fjalës ka qenë imperativ kategorik. Nuk ka lindur kot aforizmi: “Shqiptari kur e jep fjalën e therr djalën!” Një virtyt tjetër tradicional i shqiptarëve është ai i nderit. Të veprosh e të jetosh me nder. Jo vetëm ta kalosh, por edhe ta mbyllësh jetën me nder. Nderi shoqërohet edhe me ndjenjën e turpit dhe të koritjes. Koritja, turpërimi të vrasin para opinionit publik. Nderi trajtohet edhe si një virtyt i femrës, që nënkupton ruajtjen e saj në kuptimin seksual, pastërtinë dhe besnikërinë seksuale. Malësorët me zakone e me kanun, kur e kanë nisur femrën nuse, i kanë dhënë edhe atë që është quajtur “fishku në pajë”. Nëse e ka shkelur dëlirësinë seksuale, për të ka qenë gati fishku në pajë. (f. 115)

Duke folur për vlerat e psikologjisë tradicionale shqiptare prof. Beqja e përmend edhe solidaritetin fqinjësor, miqësor dhe përgjithësisht njerëzor. Mikun shqiptari e respekton aq shumë sa është thënë se “më mirë një mik se një çiflig”. Solidariteti shqiptar është shënuar edhe ndaj të huajve. Është bërë proverbial trajtimi që

shqiptarët ua kanë bërë ushtarëve italianë pas kapitullimit të Italisë fashiste.

Por, ç’ë do që, me gjithë këto cilësi shembullore tradicionale të shqiptarit, ditëve tona shfaqen shumë dukuri negative, “sikur janë grumbulluar nëntëdhjetë e nëntë të zezat”. Nga këto plagë shquhet *bajraktarizmi*, një psikologji e tipit njerëzor që do t’i dëgjohet fjala me çdo kusht, ta bëjë të veten patjetër (f. 126), hajdutëria e puna e kaçakut,, format e të cilave tashmë janë shumë të njoitura si p.sh. vjedhja e shtëpive, dyqaneve, vjedhja e institucioneve, plaçkitja e bankave. Vjedhja natën, por edhe në mes të ditës. Vjedhja e kalimtarëve, vjedhja e makinave, objekteve industriale...

Duke bërë një përshkrim të anëve negativite të shqiptarit në periudhën e tranzicionit, shkencëtari e cek edhe neglizhimin e detyrave ndaj shtetit, si paguarja e taksave, paguarja e energjisë elektrike etj. Këto veprime janë arsyё shtesë për formimin e opinionit se shteti është i dobët, se nuk ka shtet. “Kjo është e lidhur me një *psikologji indiferente* përgjithësisht ndaj shoqërisë civile, ndaj rolit të shtetit në vendosjen e konsolidimin e saj”. (f. 85) Në në-përkëmbjen e shtetit rol luan edhe tradita, trashëgimia dhe prirja për ta zhvatur shtetin dhe për të shqyer prej tij, prej pronës shtetërore e cila konsiderohet “mall belik”.

Në komunikimet ndërnjerëzore, shqiptari i ditëve tona është i kapluar nga *psikologjia e inatçit* e cila e dëmtion ecurinë e mbarë të punës, bashkëpunimin e pronarëve dhe të të punësuarve, raportet ndërmjet fqinjëve dhe të të afërmve, madje edhe ndërmjet anëtarëve të familjes, marrëdhëniet në politikë etj. Gazetarë, publicistë, njerëz të letrave, bile edhe studiues, të ndikuar nga klima e mllefeve politike, i trajtojnë shpesh problemet me ngjyrimë të veçanta inati. Me sa duket kjo sëmundje ëshë recidiv i inatit klasor që zhvillohej në emër të luftës së

klasave e që, në “periudhën e kuqe”, kishte marrë forma të përcudnuara e makabre. Inati klasor, në një regjim totalitar, është punë e shpjegueshme, por është i huaj për një regjim që synon të jetë demokratik. Ky inat, duke depërtuar në partitë politike dhe në qarqe të caktuara të opinionit shoqërор, prodhon acarime, mëri e urejtje passionante, kështu që personalitetet e shquara politike, përgjatë fushatave elektorale dhe paraelektorale, në vend që t'i shpalosin alternativat e veta, flasin me një inat të papërbajtur, kundër rivalëve politikë përdorin etiketat më të vrazhda e më të habitshme. (f. 89-90) Pjellë e kësaj atmosferë është intoleranca inatçore e cila është shenjë e mungesës së kodeve të qytetërimit, të kulturës demokratike, jo vetëm politike, por edhe etike.

Një dukuri tjeter shqetësuese është *gjakmanja*, e cila po bën kërdi dhe për nga pesha në jetën e kombit shqiptar është shndërruar në vëllavrasje të vërtetë. Në gjysmën e dytë të shekullit XX u duk sikur kjo plagë u shërua, por në krizën e gjithanshme tranziotore që e kapllosi Shqipërinë u gjallëraun recidivet e saj. S'bën pa e përmendur as përhapjen e krimit, vagabondizmin rinor, konfliktin ndërmjet brezave, gjinive etj.

Analizat e bëra në shoqërinë shqiptare flasin për shtimin e depresionit, për problematikat shqetësuese si zhgënjimi, ankthi, zbrazëtia shpirtërore, stresi, vetëvrasja etj. Të dhënët rrëfejnë përritje të numrit të vetëvrasjeve në Shqipërinë e ditëve tona, akt ky trishtues të cilin shqiptarët, me gjithë vështirësitë e mëdha, hera-herës të jashëzakonshme, e kanë praktikuar tepër rrallë. Numërohen me gishta, deri edhe të burgosurit e regjimit totalitar që i kanë dhënë fund jetës me dorën e vet. Ç'fatkeqësi që sot edhe shoqëria shqiptare është kapluar nga kjo plagë e rëndë sociale dhe shpirtërore e qytetërimit modern!

Prof. Beqja flet edhe për përshtypjen e gabuar gjoja se *inteligjencia* ose *intelektualët* janë kapluar nga një piskologji e shkujdesjes, se gjoja qëndrojnë larg shqetësimeve të jetës së vendit, të popullit, të kombit. Ai pohon se problemi do parë realisht, me tërë kompleksitetin e vet. Në këtë kontekst ai e cek dukurinë e quajtur *hemoragjia e trurit*, ikjen e shumë intelektualëve dhe të specialistëve jashtë Shqipërisë, në vendet evropiane dhe në ShBA e Kanada. Përveç kësaj, gjatë dhjetëvjeçarit të fundit shumë intelektualë, pedagogë të shkollave të larta, punonjës të institucioneve shkencore me përvojë e me kontributë të njoitura për shkaqe të njëanshme politike nuk janë përfshirë në jetën intelektuale të vendit, janë mënjanuar dhe përashtuar prej saj. Ky fenomen ka çuar deri te paralizimi i veprimtarisë së këtyre intelektualëve, gjë kjo e cila shpesh është trajtuar si një farë indiferenziimi. (f. 93-94).

Prof. Beqja vë në dukje edhe shumë plagë të tjera sociale, sidomos shpirtërore, sociale-psikologjike që janë ruajtur, madje që janë zhvilluar edhe më tej në shtratin e proceseve kontraverse e destabilizuese që kanë ndodhur e gjallojnë ende.

Megjithatë, autori këshillon dhe thotë se shqiptarët nuk duhen të tremben nga këto sëmundje të cilat duhet shëruar e pastruar. “Ndoshta kjo nuk arrihet menjëherë. Por, është një rrugë në të cilën duhet ecur vendosmërisht”. (f. 132) Në këtë drejtim ai vë theks në rolin e *edukatës fetare* e cila i kultivon virtytet morale mbarënjerezore e mbarëshekullore si ndershmëria, mbijatja e fjalës, shmanangia e gënjeshtrës, shpirti i vetësakrififikimit, thjeshtësia, respekti për të tjerët, sidomos për nevojtarët e ata që vuajnë, për të moshuarit dhe për të vegjëlit, me një fjalë kultivon “shumë vlera të vetë karakterit njerëzor, që puqen edhe me shumë tradita tona kombëtare”. (f. 202)

Të jetojmë së bashku¹⁰

Kur njeriu zbulon të vërtetën është e pamundur të mos ngadhënjejë mbi të shëmtuarën. Në vendin tonë është me rëndësi bindja se ndryshimet mbi të cilat ngrihet çështja e identifikimit dhe përkatësia jonë nuk duhet t'u shërbejë paragjykimeve se kush është i mirë dhe kush nuk është i mirë. Sepse, përkatësia e identifikimit nuk duhet shikuar vetëm si çështje gjeografike, por edhe kulturore, në të cilën shprehen si veçoritë ashtu edhe të përbashkëtat. Secili komb ka filozofinë e tij të identitetit. Kjo filozofi është vetë procesi ndërveprues i frysës dhe natyrës etnike të cilat gjenden në veprime të vështira të vërtetimit. Po pushoi ky proces i etnikumeve, atëherë do të pushojë edhe fryma dhe natyra e bashkëjetesës.

Për bashkëjetesën morëm edhe mendimin e Ali Pajazitit, magjistër i sociologjisë dhe kolumnist në javoren Lobi. Le ta ndjekim në vazhdim!

Radio Vat: Si i vlerësoni marrëdhëniet ndëretnike në vendin tonë në kohën në të cilën jemi duke jetuar?

Kur kemi të bëjmë me konceptin e marrëdhënieve ndëretnike përnjëherë na bie ndër mend përplasja që në

¹⁰ Intervistë dhënë Radio Vat-it, më 15 janar 2002, si pjesë integrale e projektit “Të jetojmë së bashku”, finançuar nga Këshilli për Radiodifuzion i Republikës së Maqedonisë.

trojet tona ndodhi gjatë pesë gjashtë muajve të fundit. Evidente është se në këtë periudhë po ballafaqohemi me një ndasi ndërnacionale, gjegjësisht nuk mund të flitet në asnjë mënyrë për një interferencë ndërkulturore ose ndëretnikë mes grupimeve sociale që jetojnë në Maqedoni. Ndasia, largësia apo distanca ndërtenike është rritur aq sa mund të themi lirisht se është hapur një hendek mjaft i madh ndërmjet grupimeve sociale si në aspektin etnik ashtu edhe në atë kulturor. Po ashtu mund të themi se në nënqiellin tonë janë krijuar mikrokozmose apo enkлава të botëkuptimeve, janë krijuar ca botë më vete të cilat kanë shumë pak vullnet që të bashkëpunojnë, madje edhe të jetojnë pranë tjebrit.

Për fat të keq, kjo është një pasqyrë mjaft e zyrtë e realitetit tonë, por kjo është e vërteta dhe ne të gjithë duhet të përpinqemi që të japim kontributin tonë për ndryshimin e gjendjes që na rrrethon.

Radio Vat: Cilat janë shkaqet që kanë ndikuar në ftohjen e marrëdhënieve ndërtenike?

Mund të numërojmë një mori shkaqesh dhe nuk mund të flitet për një shkak kryesor madhor apo të vetëm që ka ndikuar në drejtim të keqësimit të marrëdhënieve ndërmjet korpusit etnik shqiptar dhe maqedonas. Pikë së pari, më duket se këtu kanë fryrë erërat asaj që sociologu anglez me prejardhje gjermane, Ernest Gellner, e quan nacionalizëm *sui generis* i Ballkanit, i përzier me romantizëm të faktorit religioz. Ky nacionalizëm është një dukuri e rëndësishme sepse popujt i konsideron si tufa apo grumbuj të cilët duhet të sillen rrëth mëmës dhe ta përjashtojnë tjetrin, ta anatemojnë atë që ka ngjyrime të tjera, që dallon nga ata të komunitetit gjegjës. Këto tendenca të nacionalizmit destruktiv mundojnë ta zhdukin larminë e jetës shoqërore. Një trajtësia

apo monolitizmi shoqëror janë një gjë e paarritshme, një absurd, një pamundësi. Është ligj hyjnor dhe natyror që në këtë botë të gjejmë forma, ngjyra, gjuhë, kultura dhe elemente të tjera shoqërore, të cilat e përshkojnë jetën tonë. Pra larmia e ngjyrave dhe e elementeve të tjera është një kategori që s'mund të mohohet e të përjashton. Askund në botë nuk mund të gjeni shoqëri që është e pastër plotësisht në aspektin etnik apo kulturor. Multikulturaliteti dhe multietniciteti janë fenomene të cilat e shquajnë çdo shoqëri. Ata që mundohen të sendërtojnë një monolitizëm kulturor dhe etnik bëjnë punën e Sizifit.

Shkaqe të tjera që mund t'i kenë keqësuar marrëdhëniet ndëretnike janë hapat e pamatur të elitës politike dhe intelektuale të kolektivitetit maqedonas, i cili veten e ka pagëzuar si padron të këtyre trojeve, si dhe politika e diskriminimit institucional. Një faktor tjetër gjendjekeqësues janë edhe paragjykimet, pra idetë e skalitura apo të ngulitura te një pjesë e qytetarëve të këtij vendi karshi grupit etnik shqipfolës. Në këtë drejtim s'duhet harruar edhe kuazidemokracinë e instaluar në dekadën e fundit të shekullit XX në RM. Këtë demokraci do të ishte më mirë ta quanim demokraturë, pra demokraci e përzier me diktaturë shtetërore. Demokracia e vërtetë viente vetëm për një pjesë të qytetarëve të Maqedonisë, për ata që gjëzonin të drejta shumë më mëdha sesa pjesëtarët e tjerë të shoqërisë. Kjo demokraci krijonte qytetarë të privilegjuar, qytetarë të dorës së parë, në njërin tabor dhe qytetarë të dorës së dytë e të tretë, në taborin tjetër, të cilët vetëm prej së largu mund ta shikonin majën e piramidës shoqërore dhe për ta nuk punonte ashensori social që do t'i ngrinte në katet e larta dhe në kulmin shoqëror. S'duhet harruar as faktorin urejtje ndaj atij që nuk duket dhe që nuk mendon si unë, atij që nuk luan ashtu siç dua unë, përbuzjen e atij që këtë vend e imagjinon ndryshe

sa e imagjinoj unë. Mund të themi se këta janë faktorët kryesorë që kanë ndikuar në hapjen dhe zgjerimin e h-endekut social ndërmjet shqiptarëve dhe maqedonasve.

Radio Vat: Mendoni se do të duhet të kalojë shumë kohë për ta kthyer bashkëjetesën të cilën e kishim më parë e të mos flasim për diçka më të mirë? Ç'duhet bërë në këtë drejtim?

Po. Me siguri se për t'u përmirësuar gjendja duhet të kalojë një kohë, duhet të kalojë një periudhë kohore, e shkurtër ose e gjatë. Vetë realiteti do të tregojë sa do të zgjasë ajo. Duhet të kalojë një kohë që në mbamendjen kolektive të ndryshojë bindja, hija apo imazhi i shëmtuar për tjetrin si përbindësh që mundohet t'ia bëjë varrin tjetrit dhe shoqërisë në përgjithësi. Pra, njerëzit duhet të çlironen nga stereotipet dhe klishetë e krijuara në kokën e tyre. Duhet të përjetojnë katharsis shpirtëror dhe tjetrin ta konsiderojnë dhe shikojnë në një pamje tjeterfare, në një formë të ndryshme nga ajo siç e kanë perceptuar deri tani. Duhet të bëhet një reformë që Edmund Husserl e quan vetëperceptim (*selbverstandis*). Pra, një herë duhet ta perceptojmë ndryshe veten e pastaj ta perceptojmë ndryshe edhe tjetrin. Njerëzit duhet të çlironen nga konceptet e Luigjit të tipit “shteti jam unë!” Mendimtari i shquar anglez Bertrand Russel thotë se një i krishterë i vetëm s'mund të jetë krishter i mirë. Në lidhje me këtë mund të bëhet një krahasim i këtillë: Maqedoninë s'mund ta përbëjë vetëm një etnitet. Të gjithë qytetarët që jetojnë brenda kufijve politikë të këtij vendi, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre konfesionale, etnike, profesionale, janë pjesë përbërëse e kësaj shoqërie politike. Në botëkuptimin e qytetarit të Maqedonisë duhet të mbretërojë ideja se Maqedoni jemi ne të gjithë.

Me gjithë konfliktin nëpër të cilin kaluam muajve të kaluar, mendoj se ka gjasa për bashkëjetesë, sepse bile edhe shoqëritë të cilat sot merren si shembull par excellence i bashkëjetesës dhe vlerave demokratike kanë shënuar konflikte në historinë e tyre, ndojëherë edhe shumë të ashpra. Ja, për shembull ShBA-të, të cilat sot merren si shembull i demokracisë funksionale, në të kaluarën kanë përjetuar një luftë të ashpër qytetare ndërmjet Veriut dhe Jugut, pastaj një përvojë të hidhur të racizmit denigrues. Por, sot kemi një pamje dhe një faqe tjetër të këtij shteti të madh, njerëzit bashkëjetojnë në kuadër të normave të normales dhe të së natyrshimes pa marrë para-sysh tiparet e ndryshme dhe larminë e qytetarëve.

Për t'u kthyer në gjendjen e marrëdhënieve të relaksuara dhe të shëndosha ndëretnike duhet të kalojë një periudhë kohore, sepse ne jemi një shoqëri rekonvalescente, pra duhet të përjetojmë procesin e rehabilitimit, duhet të përpinqemi të krijojmë dalngadalë, hap pas hapi, kushte për mbylljen e varrave të shkaktuara nga konflikti. Pra nuk duhet të presim që gjendja të ndryshojë hë për hë. I sëmuri s'mund të shëndoshet aty për aty; shpe-shherë pacientët që përjetojnë ndryshim radikal vdesin. Pra duhet shoshitur gjërat mirë, duhet nënvizuar gabinet me qëllim që të mos përsëriten. Nuk duhet të gënje-hemi dhe t'i presim ditët e Armagedonit, kur pas apokalipsës të gjitha gjallesat, që kanë qenë në kundërshtim, do ta përqafojnë njëri-tjetrin, si ujku qengjin, dhelpra pulën etj. Kthimi i paqës s'mund të ndodhë përnjëherë. Koha duhet t'i marrë me vete dhe t'i lajë pikat e ndyta të jetës shoqërore të nënqiellit tonë.

Radio Vat: Sa kanë ndikuar mediumet pozitivisht apo negativisht në marrëdhëniet ndërnacionale?

Mediumet si institucion mjaft i rëndësishëm shoqëror, si fuqia e shtatë shoqërore, kanë qenë mjaft aktive gjatë krizës sonë. Kur themi aktive, duhet nënkuptuar edhe veprimtarinë kreative edhe atë dëmprurëse. Disa prej tyre e kanë kryer misionin e vet si medium, gjegjësisht si ndërmjetës mes ngjarjeve dhe masës apo popullit, pra kanë informuar sipas kodeksit të gazetarisë së mirëfilltë. Janë përpjekur që të jenë bartës dhe përcues autentik të ndodhive në kohën e konfliktit.

Në kohën tonë mediumet kanë ndikim të madh në jetën sociale. Ato mund të gjenerojnë mega-ndodhi siç është grusht shteti, të rrëzojnë qeveri. Ato dinë, ta bëjnë qimen tra, t'i hiperbolizojnë gjërat, po bile edhe të krijojnë gjëra të paqena. Ato dinë, siç thotë populli, “ta bëjnë mizën buall”. Gjatë periudhës që e lamë pas disa prej mediave kanë kryer një mision të shëmtuar, kanë bërë thjesht propagandë dhe agitacion, i kanë ndjekur në mënyrë joreale ndodhitë. Ato janë marrë me spekulime, kanë krijuar një imazh jo të vërtetë dhe jo të drejtë përpërfaqësuesit e kombit tjetër në mendjen e njerëzve. Kanë etiketuar me cilësi antihumane tërë një komb. Shkencëtari gjerman Hegel thotë se nëse njeriu kalon pranë një qeni pa e ditur se qeni është i sëmurë, kalon atypari pa kurrfarë mendimi të keq për të dhe vazhdon të ecë në mënyrë normale. Por, nëse dikush i tregon se bëhet fjalë për një qen të sëmurë, pra nëse ia servon idenë se ai është i çartur, te ai krijohet përnjëherë një bindje tjetër për qenin në fjalë dhe ndryshon edhe sjellja ndaj kësaj krijese. Një pjesë e mediave tona, përfat të keq, janë përpjekur me mish e me shpirt ta shtrembrëojnë të vërtetën dhe të krijojnë një realitet apo një të vërtetë të tyren, që s'ka të bëjë fare me realitetin.

Radio Vat: Si ka ndikuar faktori ndërkombëtar në marrëdhëniet ndërnacionale?

Deri në fillimin e viteve '90 të shekullit të kaluar Maqedonia si pjesë e ish Jugosllavisë për faktorin ndërkombëtar ka qenë një *terra incognita* (tokë e panjohur). Me shpërthimin e konfliktit në Slloveni, Kroaci, Bosnjë e Hercegovinë, interesimi i bashkësisë ndërkombëtare u përqendrua në këto hapësira, sidomos në ndërprerjen e gjakderdhjeve së pari në Kroaci e pastaj edhe në Bosnjë. Më vonë, me kalimin e konfliktit në Kosovë, filluan të ndizen dritat e alarmit edhe për Maqedoninë, sepse epidemja e quajtur luftë po përhapej në drejtim të këtij shteti të ri. Dhe, meqë njëra prej palëve të konfliktit kosovar i përkiste trungut kombëtar shqiptar e edhe këtej kufirit jetojnë shqiptarë filluan të përgatiten strategji për t'i thënë ndal zgjerimit të kancerit të quajtur luftë. Në vitin 2001 kur u paraqitën xixat e para të konfliktit shqiptaro-maqedonas apo anasjellas, bashkësia ndërkombëtare e kuatoi seriozitetin e gjendjes dhe menjëherë i përveshi krahët për ta zgjidhur këtë galimatias të vërtetë ballkanik. Dhe në fund arriti që ta pengonte luftën qytetare me pasoja të paparashikueshme. Mendoj se me pengimin e përhapjes së konfliktit në Maqedoni faktori ndërkombëtar ka bërë një punë të madhe. Tashmë ai kishte përvojë mjaft të hidhur, posaçërisht me Bosnjë-Hercegovinën dhe Kosovën. Reagimi i politikës ndërkombëtare ka ardhur në kohë të duhur dhe ka qenë më efektiv sesa në dy vendet e përmendura, ku u shënua gjenocid i paparë në analet e historisë. Bashkësia ndërkombëtare, e pa që herët realitetin në Maqedoni dhe e trajtoi atë me një besim dhe vendosmëri më të madhe, duke e kërkuar rrugëzgjidhjen pa ndodhur më e keqja, pa ndodhur gjakderdhja masovike, pa u përballur me rrëke lotësh e gjaku. Shkurt, në konfliktin e vitit 2001

bashkësia ndërkombejtare ka luajtur një rol mjaft konstruktiv, pavarësisht se faktori maqedonas mundohet me të gjitha mjetet që ta paraqesë atë si një skenar të komplotit antimaqedonas dhe ta mohojë kontributin e zënë ngoje. Sidoqoftë, politika ndërkombejtare, në rastin e konfliktit në Maqedoni, ka marrë notë pozitive.

Radio Vat: Porosia juaj drejtar qytetarëve?

Porosia ime drejtar qytetarëve është që para çdo veprimi të ndalen njëherë dhe ta masin hapin që do ta bëjnë, të mendojnë mirë e thellë rrëth gjérave me të cilat përballen, të jenë qytetarë të dobishëm e konstruktivë. Çdo vepër e mirë që e bëjnë është një hap drejt ardhmërisë më të mirë, kurse çdo vepër e shëmtuar është një hap më afër ditëve të zymta. Duhet të dinë se edhe e mira, edhe veprimet joracionale kthehen domosdoshmërisht si bumerang. Qyetarët e këtij vendi duhet ta japin kontributin e tyre maksimal për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike, ndërkulturore dhe ndërfetare, ta duan për tjetrin atë që e duan për veten dhe të mos i dëshirojnë tjetrit atë që nuk ia dëshirojnë vetvetes. Nëse vihen në praktikë të gjitha këto aspekte etike-kulturore mund të arrijmë deri në shoqërinë të cilën Habermas e quan “racionale”, ku do të sundojë diskursi paqësor dhe i mirëqenies.

In medias res: mediumet¹¹

“Masat e gjera popullore janë konsumatorë robër të
mediumeve.”

Baudrillard¹²

I.

Ndër dukuritë më të mistikuara dhe me ndikim më të madh në kohën tonë, në shoqërinë moderne dhe postmoderne është masmedia. *Leksikoni i fjalëve dhe shprehjeve të huaja* konceptin medium e shpjegon kështu: (lat.) ajo që gjendet në mes, që paraqet mesin, rruga e mesme; ndërmjetësues, gjëja përmes së cilës përcillet veprimi.¹³

Si një element ndërmjetësues mediumet ndahen në ato të shtypit (gazetat, revistat) dhe elektronike (TV dhe radio). Mediumet përkufizohen edhe si mjete të komunikimit masiv dhe si organizacione përmasash të mëdha, që në saje të teknologjisë së sofistikuar mund të kontaktojnë me numër shumë të madh njerëzish.¹⁴ Mediumet paraqesin teknika ose institucionë përmes së cilave provajderët e ndryshëm i përcjellin ose i distribuojnë informacionet ose format e tjera të komunikimit simbo-

¹¹ *Lobi*, nr. 98-99, 30 dhjetor 2002, fq. 31.

¹² R. Appignanesi & Ch. Garrat, *Herkes İçin Postmodernizm*, fq. 103.

¹³ Милан Вујаклија, *Лексикон страних речи и израза*, Просвета, Београд, 1954, fq. 554.

¹⁴ Gordon Marshall, *Sosyoloji Sözlüğü*, fq. 484.

lik deri te audiencat e mëdha, heterogjene dhe gjeografi-kisht të shpërndara.¹⁵

Mediumi i parë i komunikimit masiv është paraqitur në shek. XV me zbulimin e shtypshkronjës, por shtrenjtësia, restriksionet pushtetare dhe niveli i ulët i arsimimit e kanë mbajtur publikun tepër të kufizuar deri në pjesën e dytë të shek. XIX, kur teknologja arriti të prodhonte dhe të shiste mjete për marketing, zbavitje dhe për shpërndarjen e informacioneve. Faza e formimit të mediumeve është ajo ndërmjet viteve 1860-1930 kur u bënë zbulime të rëndësishme në sferën e elektronikës dhe industrisë kimike. Ato vite kanë qenë dëshmitare të zhvillimit të fotografisë, të fotografisë së lëvizshme (kinemaja), telegrafit me kabllo dhe pa të, të fonografit, telefonit, radios dhe televizionit. Këto teknologji të reja, në periudhën e zënë ngoje, kanë luajtur rol madhor në transformimin e kulturës së popullarizuar dhe janë shndërruar në shembull tipik të kapitalizimit në një masë më të madhe të industrisë së zbavitjes dhe të drejtimit publikut masiv. C. Wright Mills në veprën e tij *The Power Elite* pohon se mediumet kanë dy veçori sociologjike:

1. Në saje të një numri të vogël personash mundësojnë informimin e një numri shumë të madh njerëzish.
2. Publiku shikues, lexues apo dëgjues s'ka asnë mënyrë për ta përcjellë reagimin e vet drejtar mediumeve.

Pra, komunikimi masiv është një proces që zhvillohet në një drejtim. Organizmi medial është burokratik dhe i shpërndarë në firma e kompani të mëdha të cilat, në saje të informatave dhe të dhënavë të çastit, të dhënavë ditore, javore e kështu me radhë, e orientojnë opini-onin në këtë apo në atë drejtim. Sipas Marshall-it mediumet janë instrument i dominimit mbi jetën mendore të

¹⁵ David Jary & Julia Jary, *Unwin Hyman Dictionary of Sociology*, second edition, Harper Collins Publishers, Glasgow, 1995, fq. 397.

njerëzve. Shembull konkret lidhur me këtë kemi në rastin e viteve '30 të shekullit XX kur famëkeqi Adolf Hitler e përdori radion në mënyrë "të suksesshme" për qëllime propaganduese antinjerëzore. Linja indoktrinuese e mediumeve, në trajta të ndryshme, vazhdon deri në kohën tonë. Një mangësi e këtij komponenti të rëndësishëm shoqëror është edhe ndikimi negativ mbi edukatën tradicionale. Neil Postman në veprën e tij *Amusing Ourselves to Death* pohon se mediumet elektronike e sidomos ato vizuele e kanë kthyer nga e prapa ritmin e shtimit të shkrim leximit dhe të të kuptuarit. Dëmin që e shkakton amullia e "industrisë kulturore" më së miri e përshkruan Umberto Eco, i cili pohon se "brezi i ri nuk do të jetë më i orientuar nga imazhet (*not image oriented*)", pra ai nuk do të dijë të abstraktojë, nuk do të dijë ta vë në lëvizje potencën e vet imaginatyive, bota e imazheve, e cila është mjaft e rëndësishme në jetën e çdo individi dhe më gjërë do të plastifikohet.

II.

Observimi i hapësirës mediale në Republikën e Maqedonisë na shpie në konkluzionin se këtu funksionojnë mbi njëqind gazeta dhe revista ditore, javore dhe periodike dhe mbi katërmëdhjetë radio dhe TV stacione. Është ky një fenomen specifik medial-sociologjik, sidomos nga këndvështrimi i madhësisë së territorit dhe numrit të popullsisë. Vështruar nga prizmi i numrave: një mjedis i vërtetë plural në të cilin mediumet luajnë rol mjaft të rëndësishëm në ndërtimin dhe zhvillimin e proceseve demokratike. Nga fokusi i gjendjes aktuale në sférën e mediumeve: shkallë e lartë e dallimit, specializim, garim i ndërsjellë, autonomi "e kufizuar", politikë redaktuese e përkufizuar në mënyrë interesante.

Në një mjedis të këtillë të komunikimit, krijimi i “pasqyrës” së realitetit, të vendosur në një kornizë konkrete mediale, nuk varet vetëm nga konteksti shoqëror-kulturor, por edhe nga aftësia për të aplikuar gazetari që do të bazohet në standardet profesionale, në etikën dhe përgjegjësinë shoqërore.

Shënim i aktiviteteve, lëvizjeve, ndryshimeve dhe tendencave në këtë sferë në saje të një veprimtarie hulumtuese - monitoring i mediumeve - ka rëndësi të veçantë, sepse në këtë mënyrë provohet edhe niveli i arritur i demokratizimit të sistemit në tërësi dhe i mediumeve si një pjesë funksionale dhe përbërëse”.¹⁶

Hulumtimet e bëra kohëve të fundit flasin për (ri)ishullizim të mediumeve, apo për një proces të diferençimit të qartë ndërmjet tyre në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe. Këto dy bloqe të mediumeve krijojnë dhe flasin për dy realitete, disa herë krejtësisht të kundërtta, ato nuk ofrojnë rrugë që shpien drejt mirëkuptimit, por shndërrohen në “mësonjëtore nacionaliste”, “në pentagram urrejtjeje” pasojat e së cilës mund të jenë apokaliptike. Në sferën informative dhe atë interpretative ato flasin për “teza që mund të bëhen realitet i hidhur”, për komplate, e presin hapur degën mbi të cilën qëndrojnë ata vetë dhe qytetarët e rëndomtë.

Është shumë i çuditshëm fakti se ky kurs i një-anshmërisë dhe i i subjektivitetit të mediumeve vazhdon edhe pas trazirave të vitit 2001, kur mendohej se do të ndërronin qëndrim, se do të ndryshonte vokabulari agresiv me atë paqendjellës, se nuk do të ishte aq atraktive prekja e sedrës kombëtare të tjegrit, se do të binte në minimum informimi pa burime (në formën “siç marrim vesh nga qarqe të mirinformuara”, “thuhet se”, “flitet

¹⁶ Raport nga monitorimi i mediave në Republikën e Maqedonisë në periudhën 15-28 shkurt 2002.

se”), se do të ndryshonte politika redaktuese e përshkuar me fyerje të paskrupullta, me përcmime, por ç’ e do që hapat për shpëtim nga kthetrat e joprofesionalizmit gazetaresk janë shumë të ngadalshëm. Meqë bëhet fjalë pér një shoqëri postkonfliktuze, e gjithë kjo mund të jetë deri diku normale, por është e qartë se vazhdimi i këtij avazi të këtillë të “ndërtimit” nuk prenton ditë të bardha pér shoqërinë dhe pér banorët e saj. Tablo më të kthjellët dhe më ekzakte lidhur me mënyrën e informimit në vend do të japë një projekt i cili është në realizim e sipër. Bëhet fjalë pér monitoringun e mediumeve të vendit tonë, projekt ky që, me mbështetjen e disa fondeacioneve të huaja nën kujdesin e Institutit të Hulumtimeve Sociologjike dhe Juridike-Politike nga Shkupi, që prej shkurtit të këtij viti vazhdon t’i tubojë dhe t’i interpretojë të dhënat që kanë të bëjnë me këtë çështje në një varg mediumesh nga zona të ndryshme të Maqedonisë. Hulumtimi në fjalë së pari bën zgjedhjen e mediumeve të cilat kanë (ose mund të kenë) ndikim në opinionin e përgjithshëm në RM, si dhe të mediumeve që, në aspektin përmrbajtësor dhe programor, i plotësojnë interesat, kulturën, gjuhën e komuniteteve të caktuara etnike. Janë bërë përpjekje pér përfitimin e të dhënavë të rëndësishme krahasimtare sipas profilit të mediumeve, karakterit të tyre dhe publikut të synuar. Të dhëna më konkrete rrëth rezultateve dhe konkluzioneve të monitoringut në fjalë, në të cilin jemi të përfshirë që nga fillimi i realizimit të tij, po japim duke botuar në mënyrë integrale tekstin e dy raporteve të tij.

Raport nga monitoringu i mediumeve për periudhën 1-31 dhjetor 2002

Konstatime të përgjithshme

Ngjarje kryesore shoqërore që i dhanë vulën skenës politike të Maqedonisë gjatë muajit dhjetor kanë qenë burgosjet spektakulare të një pjese të funksionarëve të ish-garniturës në pushtet si pasojë e përzierjes së tyre në skandale të korupsionit. Ngjarje me rëndësi ka qenë edhe vazhdimi i protestave dhe grevave sociale të punëtorëve, të shoqëruara me shqyrtimin e privatizimit të një duzine firmash. Funksionimi i koalicionit ndëretnik u vu në sprovë disa herë, si p.sh. në rastin e ashtuquajtur të Shemshovës, përdorimin e gjuhës shqipe në punën e Kuvendit, zgjedhjen e nënkytarit të Kuvendit nga radhët e BDI-së. Jehonë të madhe pati paraqitja spektakulare e Ali Ahmetit në mbledhjen e Kuvendit me rastin e fjalimit tradicional vjetor të shefit të shtetit para deputetëve.

Proceset bazore që u zhvilluan në sferën mediale mund t'i përbledhim kështu: vazhdoi agonia e NGB "Nova Makedonija", me të gjitha pasojat negative për mediumet në kuadër të saj; shumica e gazetarëve u bënë zëdhënës në institucionet qeveritare, gjë të cilën opozita e komentoj si provë për subjektivitetin dhe anshmërinë e tyre (në veçanti në fushatën parazgjedhore). Thuajse të gjitha mediumet u inkadruan në mënyrë aktive në kampanjën e qeverisë kundër korupsionit, duke i publikuar jo vetëm emrat e të dyshuarve por edhe detajet nga "dosjet e tyre kriminale", që nga opozita u vlerësua si sulm ndaj prezumcionit të pafajësisë.

Të gjitha këto ngjarje, të vështruara ndryshe-ndryshe shumë kanë ndikuar në strukturën tematike të kontributave të mediumeve. Çdo medium i ka dhënë ngjyrën e vet ndërtimit të realitetit medial.

Për çka shkruajnë mediumet?

Nëse e neglizhojmë ndikimin e atmosferës së Vtit të Ri si dhe kushtet jo të përshtatshme të shkaktuara me grevën në NGB “Nova Makedonija”, të cilat kanë ndikuar në zvogëlimin e kohëzgjatjes së disa emisioneve informative, respektivisht të hapësirës së kontributave të analizuara, mund të përfundojmë se mediumet kanë treguar interesim të madh për të gjitha ndodhitë aktuale të cilat e kanë shënuar skenën politike të Maqedonisë gjatë muajit dhjetor. Dy lëmenjtë dominantë drejt të cilëve e kanë orientuar interesimin e tyre janë lëmenjtë sho-qëror-politik dhe socio-ekonomik. Këtë strukturë e hasim thuajse edhe te të gjitha mediumet të përzgjedhjes sonë. Duhet shënuar se dallime shënohen në shkallëzimin e informacioneve. Tradicionalisht, Kapital-i interesin e vet e fokuson në çështjet socio-ekonomike, kurse mediumet e shtypit në gjuhën shqipe në ato politike duke i marginalizuar të tjerat. Sa u përket mediumeve elektronike - Sitel, A1, RM/m, RM/shq, këto janë të orientuar nga lëmi i gjashtë (ekonomia), kurse TVM/m, TVM/shq si dhe TV Era dhe Kanal 77 nga ato politike. Çështjet lidhur me pasojat e konflikteve luftarake janë përfaqësuar shumë në disa mediume (p.sh. në Lobi, Fakti dhe Radio Vat). Sa u përket temave të veçanta, ato kanë të bëjnë, në të shumtën, me gjendjen ekonomike, funksionimin e pushtetit dhe aktivitetet e partive politike. Por, kësaj radhe, në këtë “skemë” të njohur janë përfshirë edhe çështjet e privatizimit dhe reformat, korrupzioni, zbatimi i Marrëveshjes Kornizë, çështje këto që disa mediume i trajtojnë veças, kurse disa, duke u hyrë interpretimeve, i vënë ato në kontekst më të gjerë, duke i vështruar si aspekte të veçanta të (mos)funksionimit të sistemit tonë politik. Shumica e mediumeve janë përpjekur

që rëndësinë e temave mbizotëruese ta theksojnë nëpërmjet paralajmërimit në faqen e parë, gjegjësisht në fillim të lajmeve, përmes përdorimit të formave më të komplikuara (analitike) të zhanrit, duke shfrytëzuar ilustrime etj.

Për kë shkruajnë mediumet?

Aktorët kryesorë përmes të cilëve mediumet i kanë realizuar temat dominante, gjegjësisht e kanë ndërtuar realitetin medial, zakonisht janë zyrtarët e lartë shtetërorë dhe ekspertët/intelektualët. Me fjalë të tjera, vazhdon edhe më tutje dominimi absolut i aktorëve individualë vendës, me çka ata zënë vend qendror në ndërtimin e realitetit (medial). Si pasojë e këtij mbizotërimi, publiku më tepër dëgjon për qëndrimet, mendimet, aktivitetet e tyre etj. Me gjithë dallimet e theksuara që kanë, analiza e aktorëve individualë flet ende për parapëlqimin e lartë të zyrtarëve shtetërorë në nivel nacional, ndërkohë që te disa nga mediumet vërehet afinitet edhe për aktorët kolektivë (p.sh. TV Telma, RM/shq dhe Fakti). Këtë herë më prezentë janë Boris Trajkovski, qeveria e RM-së, Ilinka Mitreva, Ali Ahmeti... Në aspekt të vlerësimit të aktorëve, mediumet elektronike zakonisht (me përjashtim të Sitel-it) janë shumë më të përbajtura, duke ia lënë publikut kënaqësinë për të dhënë kualifikime rrëth aktorëve që ato ua prezentojnë. Te mediumet e shtypit gjendja ndryshon, sidomos kur bëhet fjalë për Utrinski Vesnik-un dhe Dnevnik-un, te të cilët dominojnë vlerësimet negative për aktorët. Te gazeta e parë këtë punë e bëjnë “me mjaft guxim” vetë gazetarët, kurse te e dyta si aktorë dominojnë politikanët, respektivisht grupei i ekspertëve/intelektualëve.

Kur bëhet fjalë për profesionalizmin gazetaresk edhe këtë herë konstatojmë një gjendje pak a shumë tanimë të njojur. Analiza e kontributave dominante flet për trajtimin joprofesional të shumë mediumeve elektronike gjë që shihet edhe në emetimin e fotografive filmike të pashënuara ndërsa te ato të shtypit ku hasim shumë tekste në të cilat autori nuk mund të identifikohet për të vetmen arsyse se nuk është nënshkruar. Te të gjitha mediumet, pa marrë parasysh llojin, është e përhapur praktika e shfrytëzimit të burimeve të padefinuara të llojit "... nga burimet tona mësojmë", "në qarqe të korit diplomatik dëgjohet se...", "zyrtar i lartë qeveritar pohon se..." etj., fraza këto mjaft provokative për ta tërhequr vëmendjen e opinionit, por edhe mjaft të papërcaktuara me qëllim që gazetari të krijojë alibi për (pa)përgjegjësinë e vet eventale për lajmin, qëndrimin ose vlerësimin e shfaqur. Mediumet e kanë pikë të dobët edhe shfrytëzimin e burimeve të palëve të ndryshme kur bëhet fjalë për konfliktet ndëretnike ose ato politike/të interesit. Në këtë mënyrë krijohen kushte për informimm të pjesërishëm dhe të njëanshëm lidhur me ngjarjet dhe mundësi për ndërtimin e realitetit medial mbi spekulime. Nëse kësaj ia shtojmë edhe fjalorin diskualifikues, përplot me emocione dhe metafora (rregullisht negative) të disa gazetarëve, në pikëpytje vihet jo vetëm profesionalizmi i shtëpisë mediale, por edhe roli i mediumit në krijimin e atmosferës demokratike dhe tolerante në shoqërinë tonë kaq të ndarë.

Stacionet televizive

Janë analizuar ditaret e 10 TV stacioneve: TMV, TVM-programi informativ në gjuhën shqipe, A1, Sitel,

Telma, Kanal 5, Shutel, TV Era, TV Nova dhe TV Hana nga Kumanova.

1. Mënyra e prezantimit të informatave: Si kriterë për verifikimin e mënyrës së prezantimit të informatave në emisionet qendrore informative të TV stacioneve janë marrë të dhënat për kohëzgjatjen e tyre (pa blloqet e reklamave) si dhe të dhënat për kohëzgjatjen e kontributeve të analizuara.

Tabela 1. Kohëzgjatja e përgjithshme e lajmeve, numri i kontributeve të analizuara dhe përfaqësimi i kontributeve në raport me kohëzgjatjen e përgjithshme të lajmeve.

TV stacioni	kohëzgjatja e përgjithshme e lajmeve	numri i kontributeve të analizuara	kohëzgjatja e përgjithshme e kontributeve të analizuara	% e kontributeve në raport me kohëzgjatjen e lajmeve
TVM/m	5:32:47	114	3:47:25	68,3
TVM/shq	4:17:29	61	2:06:45	49,2
TV A1	5:35:27	99	3:47:25	67,8
TV SITEL	4:54:25	70	2:49:39	57,6
TV TELMA	4:39:25	80	2:54:53	62,6
TV KANAL 5	5:01:00	84	2:50:10	56,5
TV SHUTEL	2:18:23	47	1:26:47	67,6
TV ERA	3:30:15	43	1:05:02	30,9
TV HANA	1:56:22	28	1:08:04	58,5
TV NOVA	2:07:08	20	0:49:17	38,8

Shënim: Te të gjitha TV stacionet janë analizuar nga tetë emisione lajmësh, në TV Hana shtatë, në TV Nova gjashtë (nuk emetojnë lajme të shtunare dhe të dielave, kurse TV Nova nuk jep lajme edhe ditën e fundit të viti).

Kohëzgjatja e lajmeve dhe numri i kontributeve të analizuara tregojnë se muaji i fundit nuk mbetet mbrapa me ngjarje për të cilat publiku duhet të jetë i informuar. Madje, (me përjashtime të vogla) mund të thuhet se

është mbajtur dinamika e muajit të kaluar. Përjashtim bën dita e fundit e monitoringut (31 dhjetor), kur, kuptohet, për shkak të kremitimit të Vtit të Ri, në mënyrë rapide ka rënë numri i kontributeve të analizuara te pjesa më e madhe e TV stacioneve. Vetëm A1 në këtë ditë të fundit nuk heq dorë nga informimi i vëllimshëm, sidomos për problemet socio-ekonomike të vendit. Bile, ditari i fundit i vitit 2002 është më i gjati në krahasim me ditaret e tjera të analizuara. Nga ana tjetër, TV Era ndonjë ka dhënë lajme dhe më 31 dhjetor, nuk ka emetuar asnjë kontribut që ka të bëjë me temat nga përzgjedhja jonë, kurse TV Nova, atë ditë nuk ka emetuar lajme fare.

Është një gjë karakteristike e këtij muaji se primatin për nga gjatësia e lajmeve e mban A1, i cili e lë prapa për disa minuta i “ik” TVM-së, e afër tyre është edhe Kanal 5, por TVM/m prin edhe më tutje në numrin e kontributeve të analizuara. Nga ana tjetër, në TVM/shq dhe Telma shënohet një rritje e vogël, kurse në Sitel rënje e vogël e kohëzgjatjes së lajmeve dhe e numrit të kontributeve të analizuara. TV stacionet lokale si Shutel dhe Era, pak a shumë, i përbahen sasisë standarde prej 40-50 kontributesh dhe kohëzgjatje të lajmeve mesatarisht 15-20 minuta (Shutel), respektivisht 20-25 minuta (Era). E njëjtë gjë mund të thuhet edhe për TV stacionet kumanovare Nova dhe Hana.

2. Struktura tematike e kontributeve në lajme: Si ka qenë përbajtja e lajmeve në këtë muaj? Ato kanë ndjekur ritmin e trazimeve socio-ekonomike (grevat), të cilat nuk kanë pushuar, ndërsa gjithnjë e më të shpeshta kanë qenë raportet rrëth privatizimeve kriminale të shumë firmave dhe më të zëshme kërkesat për rishqyrtime e tyre. Opinion i ka qenë i bombarduar me lajme për burgosje dhe arrestime të personave të njojur nga politika për shkak të keqpërdorimit të posteve zyrtare. Por,

interesimi ka qenë i përqendruar edhe në punën e Parlamentit, sidomos në ardhjen spektakulare të Ali Ahmetit, liderit të BDI-së në mbledhjen e Kuvendit, si dhe zvarritjen e zgjedhjes së nënkyrytarit të Kuvendit nga radhët e BDI-së, kontestet në komisionet parlamentare për përdorimin e gjuhës shqipe dhe “shkundjen” e arkave të zbrazura ministrorë.

Së këtejmi është i kuptueshëm fakti që interesimin e vet në aspektin tematik mediumet e kanë orientuar në dy lëmenj kyç: shoqëroro-politik (më i përfaqësuar në TVM/m, TVM/shq, Telma dhe Era) dhe socio-ekonomik (Sitel, A1 dhe Nova). Veças, më së tepërmë janë dhënë informata lidhur me funksionimin e pushtetit ekzekutiv dhe ligjvénës dhe për gjendjen ekonomike të vendit. Të parat kanë pasur përparësi në TVM/m, TVM/shq, A1, Telma, Kanal 5, kurse të dytat në TV Sitel, Shutel, Hana dhe Nova. Në vendin e tretë vijnë kontributet rrëth partive politike (sidomos në TVM/m, Telma, Kanal 5, Shutel dhe Era). Konkretnisht, nga të dhënat për çdo TV stacion, mund të nxirren këto njohuri:

TVM/m, edhe këtë muaj, pikërsisht si në të kaluarin, është e përqendruar në *funkcionimin e pushtetit ekzekutiv dbe ligjvénës* (24.6 %) dhe *gjendjen ekonomike në vend* (18.4 %). Çështjet e tjera që dominojnë kanë të bëjnë me aktivitetin e partive politike dhe bashkëpunimin bilateral dhe multilateral me fqinjët (të dyja të përfaqësuara me 7.9 %). Edhe pse mundohet ta ruajë trajtimin informativ në prezantimin e ngjarjeve, prapseprapë, kur bëhet fjalë për çështjet e funksionimit të pushtetit, ato më shpesh i lidh me kriminalitetin në vend, Marrëveshjen Kornizë dhe implementimin e saj si dhe me jetën dhe problemet në zonat ku ishin konfliktet e vitit të kaluar (2001). Mukëto çështje i paralajmëron rregullisht në fillim të lajmeve, dhe këto, si edhe ato që janë dominante, përveç janë

të mbuluara me raporte edhe me disa lajme (por, këtë herë numri i tyre është më i vogël se zakonisht) dhe deklarata. Nga ana tjeter, zhanret analitike (më tepër bëhet fjalë për analiza) janë rezervuar për temat jodominante (reformat në vend, kriminaliteti, Marrëveshja Kornizë dhe implementimi i saj). Vizuelisht, thua se të gjitha temat dominante janë të mbuluara me fotografi filmike dhe vetëm disa me sllajde. Sekuencat filmike më së shpeshi janë aktuale, të produksionit vetjak dhe janë të shënuara. Ky profesionalizëm në këtë segment të prezantimit është standard për TVM/m, gjë që nuk mund të thuhet edhe për TV stacionet e tjera. Sa i përket kohëzgjatjes së kontributeve, vetëm dy janë më të gjatë. Njëri prej 7:17 minutash është analizë e ligjit për vetaadministrimin lokal dhe implementimin e tij, kurse tjetri është raport për fjalimin vjetor të kryetarit Trajkovski në Kuvin e RM-së.

TVM/shq, po ashtu, merret më tepër me *funkcionimin e pushtetit ekzekutiv dhe ligjvënës* (18 %), e më pas me çështjet socio-ekonomike (13. 1 %), Marrëveshjen Kornizë dhe implementimin e saj (11.5 %), kurse nga çështjet tjera dallohen ato për aktivitetet e partive politike dhe për integrimin e RM-së në strukturat ndërkombëtare (të dyja të përfaqësuara me 6.6 %). TVM/shq nuk largohet nga trajtimi interpretativ (62.3 % të kontributeve janë me temë referente). Kjo ka të bëjë sidomos me çështjet e integrimit të RM-së në strukturat ndërkombëtare, të cilat më së tepërm i lidh me bashkëpunimin bilateral dhe multilateral me fqinjët, dhe me funksionimin e pushtetit dhe aktivitetet e partive politike, të cilat i lidh me Marrëveshjen Kornizë dhe implementimin e saj. Në lajmet e TVM/shq nuk ka paralajmërim, kurse si zhanr, përvèç me lajme/lajme të zgjeruara, që janë më të shpeshta, tema e funksionimit të pushtetit është përpunuar edhe me

dy analiza, një intervistë, dy deklarata, Marrëveshja Kornizë me një analizë dhe një intervistë, gjendja socio-ekonomike me tri raporte dhe një analizë, kurse aktivitetet e partive politike me një raport dhe me një intervistë. Në aspektin vizuel, 2/3 e temave dominante janë të mbuluara me sekuenca filmike (kurse të tjerat me sllajde), por më tepër se gjysma janë përpunuar në mënyrë joprofessionale sepse fotografia nuk është shënuar. Si më të gjata dallohen tri kontribute. Në të parin (6:28 min.) bëhet fjalë për kontestin lidhur me emrin e shkollës së fshatit Shemshovë dhe helmimin e nxënësve në Kumanovë përmes deklaratave të deputetëve shqiptarë dhe qëndrimeve të tyre në këto çështje, i dyti (5:18 min.) ka të bëjë me qëndrimet e deputetëve shqiptarë (Thaçi, Vejseli) rrëth diskutimit vjetor të Kryetarit në Parlament, kurse i treti (5:25 min.) flet për konferencën e shtypit të PDSH-së dhe moskënaqësinë e përfaqësuesve të saj lidhur me proceset e implementimit të Marrëveshjes Kornizë dhe përfaqësimin e shqiptarëve në administratën shtetërore.

A1 rëndësi të njëjtë u kushton çështjeve të funksionimit të pushtetit dhe gjendjes ekonomike në vend (të dy temat të përfaqësuara me 19.2 %), pastaj kriminalitetit në vend (10.1 %). Edhe pse në prezantimin e ngjarjeve dominon dimensioni informativ, temat rrëth funksionimit të pushtetit ekzekutiv dhe ligjvënës i lidh me ndonjë çështje tjeter (më shpesh me gjendjen ekonomike në vend dhe kriminalitetin). Në paralajmërim shpesh i veçon çështjet rrëth funksionimit të pushtetit, por edhe ato në sferën e shoqërisë qytetare. Si zhanr, temat dominante thuajse përpunohen vetëm përmes raporteve, gjë që nuk befason, sepse ato dominojnë në lajmet e A1, gjegjësisht, 76.8 % të kontributeve të analizuara janë raporte. Vizuelisht, të gjitha kontributet janë të mbuluara me fotografi (dy prej kontributeve rrëth funksionimit të

pushtetit janë shoqëruar me film të vizatuar), por vetëm gjysma janë shënuar, mangësi profesionale kjo e hasur edhe në muajt e mëparshëm. Sa i përket kohëzgjatjes së kontributeve, si më të gjatë vcohen tri prej tyre. Njëri (6:17 min.) është raport rrëth vizitës së delegacionit maqedonas në kampet ushtarake në Kabul, i dyti (6:57 min.) është filmi i vizatuar i Darko Markoviç-it, i titulluar si “zbavitje”, në të cilin janë përfaqësuar Lubço Georgievski, Branko Cërvenkovski dhe pjesëtarët tjerë të pushtetit (të tanishëm dhe të shkuar) në Maqedoni dhe gënjeshtrat e tyre, kurse i treti (6:40 min.) flet për “personalitetin e vitit-Dosta Magevska”, zgjedhje kjo e A1, nënë e një fëmije të sëmurë nga paraliza cerebrale e cila ka treguar trimëri të përballet me varfërinë dhe të gjitha problemet që i sjelljeta.

TV Sitel më tepër hapësirë në lajmet e veta ka ndarë për *gjendjen ekonomike në vend* (21.4 %), pastaj për aktivitetet e partive politike (12.9 %), për funksionimin e pushtetit ekzekutiv dhe ligjvënës (11.4 %) dhe kriminalitetin në vend (9.6 %). Si zakonisht, të gjitha çështjet e trajtuara në lajme janë përpunuar në mënyrë interpretative. Sa u përket temave dominante, ato vazhdimisht janë të ndërthurura. Gjegjësisht, gjendjen ekonomike më së tepërm i lidh me reformat, me privatizmin, kriminalitetin dhe cilësinë e jetës së përditshme; funksionimin e pushtetit me gjendjen ekonomike, kurse aktivitetet e partive politike me kriminalitetin dhe aktivitetet në kuadër të shoqërisë qytetare. Paralajmërimet u jepin më shumë hapësirë partive politike dhe organeve të pushtetit ekzekutiv dhe ligjvënës, kurse si zhanr dominojnë raportet, sidomos ato në lidhje me funksionimin e pushtetit, kurse temat rrëth gjendjes ekonomike dhe kriminalitetit janë përpunuar me disa komente. Vizuelisht, të gjitha çështjet, si ato dominante ashtu edhe të tjerat janë mbuluar

me fotografi, por profesionalisht janë përpunuuar vetëm 42.1 % (në të cilat është shënuar burimi i fotografisë). Këtë muaj, për çudi, janë shënuar vetëm dy kontributë të gjata në lajmet e Sitel-it. Njëri (5:51 min.) është raport që shfaq qëndrimet e ekspertëve për reformat në ARM, kurse i dyti (5:28 min.) është analizë që ka të bëjë me problemet rrëth drogës dhe rritjes së numrit të narkomanëve në Maqedoni.

TV Telma, si TVM/m, TVM/shq dhe A1, u jep përparësi çështjeve të *funkcionimit të pushtetit ekzekutiv dhe ligjënës* (23.8 %), pastaj ngjarjeve shoqërore-politike (21.3 %), gjendjes ekonomike (13.8 %) dhe aktiviteteve të partive politike (11.3 %). Por, me dallim nga TV stacionet e tjera, Telma ngulmon më shumë në trajtimin interpretativ të prezentimit të ngjarjeve (vetëm 6.2 % të kontributëve janë me temë referente). Sa i përket paralajmërimi, pikërisht kontributet për pushtetin dhe funksionimin e tij janë veçuar si ngjarje të ditës. Si zhanr, përvëç kontributëve më të shumta (73.2 % prej temave dominante janë raporte), të tjerat janë lajme, deklarata, kurse prej kontributëve analitike tri janë analiza (ky është numri i përgjithshëm i analizave në tërë periudhën e analizuar), një koment dhe një sondazh, të gjitha rrëth ndodhive shoqërore-politike në vend. Vizuelisht, 85.7 % të kontributëve janë mbuluar me fotografi (disa me sllajde), por prej tyre 65.5 % janë aktuale dhe të produksionit vetjak, kurse 31.3 % janë përpunuuar në mënyrë joprofesionale, respektivisht nuk është shënuar burimi i fotografisë. TV Telma zakonisht nuk ka kontribute të gjata. Vetëm një është mbi 4 minuta (4:15 min.) dhe ka të bëjë me hidrosistemin për mbushjen e liqenit të Dojranit.

Në lidhje me temat dominante, gjendja nuk dallon edhe në **Kanal 5**. Për të, po ashtu, më të rëndësishme janë ngjarjet që kanë të bëjnë me *funkcionimin e pushtetit*

ekzekutiv dhe *ligjvénës* (20.2 %), pastaj vijojnë ato rrith gjenjes ekonomike (16.7 %) dhe aktivitetet e partive politike (11.9 %). Prej tyre, si ngjarje të ditës së pari i veçon çështjet e aktiviteteve të partive politike, e më pas ato për funksionimin e pushtetit. Asnjë nga temat ekonomike s'është paralajmëruar në fillim të lajmeve. Si zhanr, numri më i madh i tyre janë përpunuuar në formë të raporteve, disa prej tyre janë dhënë si lajme, kurse vetëm një kontribut rrith funksionimit të pushtetit është koment. Prej tyre, 90.2 % janë mbuluar me fotografi, kurse të tjerat me sllajde dhe grafikone/tabela/tekst. Të gjitha sekuencat filmike, përveç njërisë, janë aktuale, të produksionit të këtij TV stacioni, dhe ç'është më e rëndësishmja, të gjitha janë të shënuara, gjë kjo që flet për një trajtim profesional serioz. Kanal 5, zakonisht nuk ka kontribuite të gjata, me përjashtim të një reportazhi prej 6:11 min. lidhur me ndihmën humanitare që vetë televizioni e kish organizuar me rastin e festave të Vtitit të Ri përfëmijët pa prindëri si dhe për të sëmurët.

Nga ana tjeter, për **TV Shutel**-in kryesore janë çështjet nga *sfera socio-ekonomike*. Respektivisht, çdo kontribut i katërt kontribut ka të bëjë me këto çështje (25.5 %), kurse nga temat e tjera interesimi është i orientuar nga funksionimi i pushtetit ekzekutiv dhe ligjvénës (12.8 %) dhe aktivitetet e partive politike (10.6 %). TV Shutel, ashtu si TV Telma, mund të lavdërohet se i përbahet parimit të rapportimit lidhur me ngjarjet, e jo të interpretimit të tyre (vetëm 6.4 % të kontributeve të analizuara janë me temë referente). Paralajmërimë në fillim të lajmeve nuk ka, kurse nga këndvështrimi i zhanrit, përveç një interviste, një komenti dhe një ankete për çështjet socio-ekonomike, të gjitha temat e tjera janë përpunuar përmes raporteve (ka edhe disa lajme/lajme të zgjeruara). Por, dobësi e këtij TV stacioni është prezantimi vizuel. 76.5 % e të

gjitha kontributeve të analizuara janë shoqëruar me fotografi filmike, por vetëm te disa syresh është shënuar burimi prej nga është huazuar ajo. Gjendja është edhe më e keqe kur kemi të bëjmë me temat dominante. Prej tyre, 62.5 % kanë fotografi, por asnjë nga këto kontribuite nuk është shënuar. Shtrohet pyetja nëse bëhet fjalë për mosnjohje të standardeve gazetareske ose për mungesë të burimeve teknike ose kadrovike? Me sa duket në pyetje janë edhe njëri faktor edhe tjetri. Pa marrë parasysh shkakun, kjo mënyrë e prezantimit të lajmeve s'mund të arsyetohet. Ç'është ineteresante TV Shutel, edhe pse ka numër të vogël të kontributeve, ka shfaqur tri kontribute të gjata. Njëri (6:15 min.) ka të bëjë me temën e njëjtë, gjegjësisht informon lidhur me formimin e një shtabi të krizës në komunë për t'u dhënë ndihmë disa familjeve të prekura nga vërvshimi, kurse i treti (5:40 min) është koment për sulmet e taksistëve shqiptarë mbi taksistët romë, me deklarata të vetë qytetarëve.

Ndryshe nga sa thamë më sipër, **TV Era** fokusohet më tepër *në çështjet shoqërore-politike* (37.2 %), e më pas vijojnë ato për funksionimin e pushtetit dhe për aktivitetet e partive politike (të dyja të përfaqësuara me 14.0 %). Një numër i vogël i tyre janë paralajmëruar në fillim të lajmeve (28.5 %), kurse si zhanr, përveç lajmeve/lajmeve të zgjeruara, që janë më të përfaqësuara, hasim edhe disa deklarata dhe analiza si dhe komente (para së gjithash për gjendjen shoqërore-politike). Vizuelisht, më tepër se gjysma e kontributeve janë të mbuluara me fotografi, e disa edhe me sllajde. Por, edhe TV Era është joprofessionale në këtë segment. Në të vërtetë, prej të gjitha temave dominante të cilat kanë sekuenca filmike vetëm njëra është e shënuar (si produksion i saj). Vallë, edhe TV Era nuk i njeh standardet profesionale gazetareske ose nuk disponon me burime teknike dhe kadrovike për një gjë

të tillë? Përveç kësaj, edhe ky TV stacion, si TV Shutel-i, edhe pse me numër të vogël të kontributeve, kohë pas kohe lajmëron gjerë e gjatë për ngjarjet. Këtë herë, me gjatësinë e vet dallohen dy kontribute: njëri është raport (5:15 min.) nga konferenca e shtypit e Agron Buxhakut, nëkryetar i BDI-së, me gazetarët, kurse tjetri (5:30 min.) është koment rrëth destruktivitetit të TV Sitel-it në informimin e opinionit.

Dy TV stacionet kumanovare, **TV Hana** dhe **TV Nova**, kryesisht janë të orientuara nga çështjet dhe problemet lokale, kurse nga ato me rëndësi shoqërore-politike TV Hana i preferon *çështjet socio-ekonomike* (32.1 %) dhe ato rrëth funksionimit të pushtetit ekzekutiv dhe ligjvënës (25 %), TV Nova, gjendjen ekonomike në vend (50 %) dhe problemet e vëtëqeverisjes lokale (20 %). Përderisa TV Nova këmbëngul në regjistrimin e ngjarjeve, në TV Hana gjysma e kontributeve të analizuara kanë karakter interpretativ. Kjo ka të bëjë sidomos me kontributet për funksionimin e pushtetit. Këtë çështje ajo e lidh më së shumti me aktivitetet e partive politike dhe me Marrëveshjen Kornizë dhe implemtimin e saj. Të dy TV stacionet, në paralajmërimet, përveç temave dominante i vendosin edhe të tjerat, kurse si zhanr, përveç shumëlojshmërisë së formave gazetareske (sidomos për dy temat më frekuente) në TV Hana dhe në TV Nova thuajse të gjitha temat dominante (si edhe të tjerat) janë të mbuluara vetëm me raporte (me përjashtim të një reportazhi). Vizuelisht, të gjitha temat dominante të TV Nova-s janë të shoqëruara me fotografi filmike, prej tyre më tepër se 70 % janë shënuar si aktuale dhe të produktionit vetjak, kurse vetëm disa janë përpunuar në mënyrë joprofessionale (nuk është shënuar burimi prej të cilët janë huazuar). Ndryshe nga kjo, në TV Hana, 68.4 % të temave dominante kanë fotografi (njëra është me sllajd),

e vetëm 47.3 % janë shënuar si aktuale. Edhe pse me numër të vogël kontributesh, të dy TV stacionet kanë nga disa syresh të gjata. Në TV Hana dallohet kontributi prej 7:00 min. lidhur me helmimin e nxënësve në Kumanovë si dhe kontributi (5:25 min.) për vlerësimet e deputetëve shqiptarë (Ahmeti, Thaçi, Vejseli) për fjalimin vjetor të kryetarit Trajkovski para Parlamentit, kurse në TV Nova kontributi që flet për pasojat që i shkaktuan shirat e mëdha në Kumanovë.

3. Struktura e aktorëve të kontributeve të analizuara. Cilat kategori subjektesh janë në fokusin e interesimit medial? Edhe këtë muaj, si zakonisht, thuajse asnjë informatë, ngjarje ose rrëfim gazetaresk nuk ka kaluar pa zyrtarët e lartë shtetërorë në nivel nacional dhe intelektualët; kohë pas kohe janë paraqitur edhe politikanët dhe organet shtetërore në nivel nacional. Për subjektet e tjera është lënë hapësirë shumë më e vogël. Konkretisht, të dhënat na flasin për një fotografi të këtillë:

Në **TVM/m**, **Kanal 5** dhe **TV Hana** kategorinë më të madhe e përbëjnë zyrtarët e lartë shtetërorë në nivel nacional (TVM/m – 41.9%, Kanal 5 – 39.3% dhe Hana – 22.9%), e pas tyre ekspertët/intelektualët (TVM/m 32.3%, Kanal 5 – 33.9% dhe Hana – 14.7%), kurse në **A1** dhe **Shutel** dy kategoritë e njëjtë, me dallim që ekspertët/intelektualët (A1- 31.7%, Shutel – 35%) kanë pasur përparësi të vogël para zyrtarëve shtetërorë në nivel nacional (A1- 25.3%, kurse Shutel – 20%). TVM/m dhe Kanal 5 i citojnë më tepër fjalët e aktorëve, A1 dhe Shutel-i thuajse në mënyrë të barabartë citatet, parafrazimin e fjalëve të tyre dhe përmendien në kontekst të temës; TV Hana preferon t'i citojë ekspertët, kurse për zyrtarët e lartë shtetërorë të flasë në kontekst të temës. **MTV/shq** në kontekst të temës të cilën e përpunon i përmend zyrtarët e lartë shtetërorë (22.2%) dhe

organet shtetërore në nivel nacional (13.5%), kurse **Telma**, ekspertët/intelektualët (25.6%) dhe organet shtetërore në nivel nacional (14.8%), por të parët zakonisht i citon, kurse për të dytët flet në kontekst të temës. **Në TV Sitel**, kategori më e madhe janë ekspertët/intelektualët (36.6%), e më pas, me përfaqësim të njëjtë, zyrtarët e lartë shtetërorë dhe politikanët (14.5%). Politikanët (17.3%), krahas zyrtarëve të lartë shtetërorë (26.5%), janë përfaqësuar edhe në **TV Era**, dytët më së shumti të parafrazuar, kurse në **TV Nova** kategori e vetme më e madhe janë ekspertët/intelektualët, thuajse në mënyrë të barabartë të parafrazuar dhe të përmendur në kontekst të temës.

Cilat subjekte, personalitete ose institucione kanë vend dominant në TV stacionet?

TVM/m – Kryeministri është personi më i përfaqësuar në lajmet e TVM/së, kurse më së tepërm i cituar është zëdhënësi i Qeverisë, Çollakovski.

Aktorë më të përfaqësuar	kohëzgjatja e kontributave në të cilat aktori është prezent		kohëzgjatja e përgjithshme e prezentimit direkt të aktorit	
	në sekonda	%	në sekonda	%
1. Branko Cërvenkovski	785	5,7	224	28,5
2. Ilinka Mitreva	544	4,0	50	9,2
3. Boris Trajkovski	536	3,9	223	41,6
4. Vllado Buçkovski	428	3,1	106	24,8
5. Sasho Çollakovski	395	2,9	176	44,5

Shënim: % e kontributave me aktorin prezent është llogaritur në raport me kohëzgjatjen e përgjithshme të kontributave të analizuara, kurse për prezantimin direkt të aktorit, në raport me kohëzgjatjen e kontributave në të cilat ai (aktori) është prezent.

MTV/shq – Në ditarin e këtij TV stacioni më prezente është BDI-ja, kurse më i cituari është Agron Buxaku, nënkyetari partisë së njëjtë.

Aktorë më të përfaqësuar	kohëzgjatja e kontributeve në të cilat aktori është prezent	kohëzgjatja e përgjithshme e prezantimit direkt të aktorit		
	në sekonda	%	në sekonda	%
1. BDI	2346	30,8	00	0,0
2. Qeveria	1467	19,3	00	0,0
3. Boris Trajkovski	1408	18,5	00	0,0
4. Agron Buxhaku	773	10,2	314	40,6
5. Branko Cërvenkovski	317	4,2	00	0,0

A1 – Hapësirë më e madhe është ndarë për kryetarin Trajkovski, i cili ndërkohe është edhe personi më i cituar.

Aktorë më të përfaqësuar	kohëzgjatja e kontributeve në të cilat aktori është prezent	kohëzgjatja e përgjithshme e prezantimit direkt të aktorit		
	në sekonda	%	në sekonda	%
1. Boris Trajkovski	1024	7,5	542	52,9
2. Qeveria e RM-së	1014	7,4	00	0,0
3. Branko Cërvenkovski	961	7,0	46	4,8
4. MPB	780	5,7	00	0,0
5. Lubço Georgievski	708	5,2	27	3,8

TV Sitel – Hapësirë më e madhe në lajmet e këtij TV stacioni është ndarë për MPB-në, kurse më i cituar është Vlladimir Gjorçev-i, zëdhënës i VMRO-DPMNE-së.

Aktorë më të përfaqësuar	kohëzgjatja e kontributeve në të cilat aktori është prezent	kohëzgjatja e përgjithshme e prezantimit direkt të aktorit		
	në sekonda	%	në sekonda	%
1. MPB	1121	11,0	00	0,0

2. Zoran Vitanov	382	3,7	175	45,8
3. Vllatko Gjorçev	289	2,8	221	76,5
4. Sasho Çollakovski	279	2,7	60	21,5
5. Ilinka Mitreva	231	2,3	107	46,3

TV Telma – Në Telma dominojnë aktorët kolektivë. Më e përfaqësuar është Qeveria e RM-së, kurse më i cituar është Makraduli, zëdhënës i LSDM-së.

Aktorë më të përfaqësuar	kohëzgjatja e kontributeve në të cilat aktori është prezent		kohëzgjatja e përgjithshme e prezantimit direkt të aktorit	
	në sekonda	%	në sekonda	%
1. Qeveria e RM-së	2748	26,2	00	0,0
2. Qytetarë të RM-së	1417	13,5	115	8,1
3. MPB	941	8,9	00	0,0
4. BDI	851	8,1	00	0,0
5. Jani Makraduli	703	6,7	138	19,6

TV Kanal 5 – Për zëdhënësin e qeverisë, Sasho Çollakovski, është ndarë hapësirë më e madhe në lajmet, kurse më i cituar është ministri i ekonomisë, Ilija Filipovski.

Aktorë më të përfaqësuar	kohëzgjatja e kontributeve në të cilat aktori është prezent		kohëzgjatja e përgjithshme e prezantimit direkt të aktorit	
	në sekonda	%	në sekonda	%
1. Sasho Çollakovski	655	6,4	35	5,3
2. Boris Trajkovski	525	5,1	116	22,1
3. Ilinka Mitreva	302	2,9	44	15,6
4. Ilija Filipovski	278	2,7	162	58,3
5. Tito Petkovski	241	2,4	50	20,6

TV Shutel – Hapësirë më e madhe në ditarin e kësaj TV shtëpie është ndarë për ministren e punëve të jashtme, Ilinka Mitreva, por askush nuk është cituar.

Aktorë më të përfaqësuar	kohëzgjatja e kontributeve në të cilat aktori është prezent	e prezantimit direkt të aktorit		
	në sekonda	%	në sekonda	%
1. Ilinka Mitreva	195	3,7	00	0,0
2. Branko Cërvenkovski	147	2,8	00	0,0
3. Risto Penov	146	2,8	00	0,0

TV Era – Ky TV stacion përparësi i jep kryetarit Trajkovski, kurse më tepër e citon Ali Ahmetin, kryetarin e BDI-së.

Aktorë më të përfaqësuar	kohëzgjatja e kontributeve në të cilat aktori është prezent	kohëzgjatja e përgjithshme e prezantimit direkt të aktorit		
	në sekonda	%	në sekonda	%
1. Boris Trajkovski	843	21,6	00	0,0
2. Ali Ahmeti	577	14,8	49	8,5
3. Branko Cërvenkovski	331	8,5	00	0,0
4. Ilinka Mitreva	249	6,4	00	0,0

TV Hana – Hapësirë më të madhe ka ndarë për Ali Ahmetin, i cili ndërkohë është edhe personi më i cituar.

Aktorë më të përfaqësuar	kohëzgjatja e kontributeve në të cilat aktori është prezent	kohëzgjatja e përgjithshme e prezantimit direkt të aktorit		
	në sekonda	%	në sekonda	%
1. Ali Ahmeti	1014	24,8	432	42,6
2. nxënësit e shkollave të mesme	731	17,9	00	0,0
3. Boris Trajkovski	522	12,8	00	0,0
4. Hysni Shaqiri	348	8,5	00	0,0

TV Nova – Subjekt i vetëm që e ka tërhequr më tepër vëmendjen në lajmet është njësia rajonale e MPB-së në Kumanovë.

Aktorë më të përfaqësuar	kohëzgjatja e kontributeve në të cilat aktori është prezent		kohëzgjatja e përgjithshme e prezantimit direkt të aktorit	
	në sekonda	%	në sekonda	%
1. MPB Kumanovë	486	16,4	000	0,0

Kush është personaliteti i muajit? Me sa duket, këtë muaj nuk e ka zënë vendin e parë asnje peson, por është e qartë se në lajme më prezent ka qenë “treshja” Trajkovski-Cërvenkovski-Mitreva, gjë që nuk habit për shkak të aktiviteteve të shumta që ata i kanë pasur si në planin e politikës së brendshme ashtu edhe në atë të asaj të jashtme. Nga ana tjeter, bie në sy që Telma, me dallim nga TV stacionet e tjera, u jep përparësi aktorëve kolektivë – qeverisë, qytetarëve, MPB-së, BDI-së. Vetëm TV stacionet shqiptare TV Era dhe TV Hana, ndër subjektet dominante, i kanë dhënë vend liderit të BDI-së, Ali Ahmetit (vendin e parë), kurse TVM/shq “i ka bërë hatë” partisë së Ahmetit, Bashkimit Demokratik për Integrin.

Aspak më spektakulare nuk janë as vlerësimet lidhur me aktorët dominantë. Të gjitha TV stacionet, kuptohet, përveç, TV Sitel-it, janë shumë të kujdeshme kur bëjnë komplimente ose kritikë, e kur vendosin, “të sulmojnë” dikë, atëherë huazojnë e citojnë fjalë të huaja, duke dashur të mos merren nëpër gojë për të (pa)vërtetat e thëna. E megjithatë, kjo nuk i pengon TV Sitel-it, që të japë kualifikime për të gjithë aktorët. Nga ato nuk janë të kursyer as subjektet dominante. Kështu, vlerësime më negative ka marrë MPB-ja për burgosjen e ish-pushteta-

rëve për shkak të “keqpërdorimeve të pozitave zyrtare” dhe për shkak të përpjekjeve (jo) të suksesshme për ndriçimin e aktit terrorist në Kumanovë (shpërthim i një bombe para shkollës së mesme), kurse zëdhënësi i Qeverisë, Collakovski, për paralajmërimin e anulimit të konkursit për ndarje të të ashtuquajturave banesa sociale. Sitel-i i thekson edhe kritikat e zëdhënësit të PS-së, Zoran Vitanov dhe ato të zëdhënësit të VMRO-DPMNE-së, Vllatko Gjorçev për aktin terrorist në Kumanovë (shpërthimi i një bombe para shkollës së mesme), të cilët e sulmojnë Qeverinë për bashkëpunim me pjesëtarët e UÇK-së.

A1 dhe TV stacionet kumanovare TV Hana dhe TV Nova tregojnë kujdes të veçantë për të qenë “neutralë” si ndaj aktorëve dominantë ashtu edhe ndaj të tjerëve, ndaj në lajme nuk ka as vlerësimi pozitive e as negative për asnjë subjekt. Disa mediume të tjera, paraqesin si me turp ndonjë vlerësim, kryesisht negativ. Mund të thuhet se duke e marrë parasysh numrin e kontributeve të analizuara, më të guximshme janë TV stacionet më të vogla, si p.sh. TV Era. Përndryshe, në lidhje me aktorët dominantë, në TVM/shq vetëm BDI-ja ka marrë një notë negative nga gazetari, që ka të bëjë me koalicionimin me LSDM-në dhe (pa)përgjegjësitë e deritanishme si parti politike; kurse në TV Era, Ali Ahmeti ka marrë një notë pozitive për paraqitjen në parlamentin e Maqedonisë.

4. Burime të informatave: Në çfarë burimesh të informatave mbështeten TV stacionet për prezantimin e lajmeve? A kanë përparësi burimet e provuara apo ato spekulative? Në bazë të kontributeve me burime të sakta të informatave, numrit më të madh të TV stacioneve mund t'u besohet për informatat që ia ofrojnë opinionit.

Tabela 2. Burime të informatave sipas llojit

TV stacioni	të paqarta/të pasakta		të sakta		gazetari nga vendngjarja		burimi nuk është cekur	
	N	%	N	%	N	%	N	%
TMV/m	9	7,9	101	88,6	2	1,8	7	6,1
TVM/shq	8	13,1	52	85,2	-	-	5	8,2
TV A1	29	29,3	77	77,8	-	-	13	13,1
TV SITEL	9	12,9	70	100,0	-	-	-	-
TV TELMA	28	35,0	67	83,8	3	3,8	3	3,8
TV KANAL 5	11	13,1	76	90,5	3	3,6	2	2,4
TV SHUTEL	-	-	44	93,9	-	-	3	6,4
TV ERA	3	7,0	9	20,9	-	-	31	72,1
TV HANA	7	25,0	21	75,0	-	-	2	7,1
TV NOVA	6	30,0	12	60,0	-	-	3	15,0

Shënim: Përqindja e përgjithshme e të dhënave është mbi 100 % sepse në disa kontributet ka edhe burime të paqarta/të pasakta dhe të sakta të informatave.

TV Sitel-i është TV stacioni i vetëm i cili, si edhe deri tani, në të gjitha kontributet e veta e thekson burimin e informatave. Ndryshe nga ky qëndrim profesional, brengos joprofesionalizmi i TV Era-s ku numri i kontributeve pa burime të cituara të informatave i minimizon të gjitha argumentet në kuptim të çfarëdo arsyetimi për gjendjen e këtillë. Prej këtu lind pyetja, nëse popullata shqiptare e Shkupit (sepse ky TV stacion emeton program për zonën e kryeqytetit) mund të mbështetet në atë që e dëgjon dhe e sheh në lajmet ë këtij TV stacioni? Me siguri se jo! Nga ana tjeter, burime të paqarta/të pasakta kanë më shumë Telma, A1, Hana dhe Nova. Mbështetje kritika duhet të jetë më e ashpër ndaj A1 për shkak të faktit se emeton program për tërë hapësirën e Maqedonisë, por kjo nuk do të thotë se të tjerët mund të “amnistrohen”, p.sh. Hana dhe Nova që i drejtohen opinionit kumanovar. Sa i përket TVM/m-së, mund të vërehet se ajo

qëndron shumë dobët sidomos sa u përket burimeve të sakta si në krahasim me Kanal 5, ashtu edhe me Shutelin, i cili nuk mund t'i konkurrojë as me potencialin teknik as me atë të kuadrit. Kjo vlen edhe për TVM/shq si pjesë përbërëse e shërbimit publik radiodifuziv.

Duke e marrë parasysh faktin se disa TV stacione kanë numër të konsiderueshëm të kontributeve me burime të paqarta/të pasakta si dhe kontribute pa burime të cekura, ato i janë nënshtuar një analize. Të dhënët na jepin këtë tablo: A1 burime të paqarta/të pasakta ofron më tepër në lidhje me temat dominante (funkcionimi i pushtetit, gjendja ekonomike, kriminaliteti), por edhe në fushën e kriminalitetit në vend dhe të privatizimit. E njëjtë është gjendja edhe në TV Telma, ku me burime të paqarta/të pasakta përveç temave dominante, janë edhe ato lidhur me kriminalitetin dhe veprimtaritë në kuadër të shoqërisë qytetare. Në TV Hana, burimet janë të paqarta për temën më frekuente - çështjet socio-ekonomike, kurse në TV Nova - për gjendjen ekonomike në vend. Prej TV stacioneve të tjera me numër më të vogël kontribuetesh me burime të paqarta/të pasakta është më i vogël dallohet TVM/shq, në lidhje me çështjet socio-ekonomike, Sitel-i, në lidhje me kriminalitetin dhe Kanal 5, rrëth gjendjes ekonomike. Tashmë kemi thënë se TV Era është “kampion” i prezantimit të informatave pa cekur burimin e tyre. Për fat të keq, burimi i informatave mungon pikërisht te temat dominante, gjegjësisht 71.4 % të këtyre çështjeve janë pa burim. Prej të tjerave dallohen A1 me më tepër kontribute pa burime informatash për gjendjen ekonomike dhe funksionimin e pushtetit, TVM/shq për integrimin e RM-së në strukturat ndërkombëtare, TV Telma për çështjet shoqërore-politike, TV Hana për vetëqeverisjen lokale dhe TV Nova për gjendjen ekonomike.

Sa i përket statusit të burimeve të informatave, s'ka ndonjë ndryshim në krahasim me muajt e kaluar. Gjegjësisht, të gjitha TV stacionet u japid përparësi burimeve vendëse. Prej tyre TVM/m, TVM/shq, Shutel dhe Hana mbështeten më tepër në burimet zyrtare, A1, Sitel (te e cila 77.1 % të burimeve janë alternative) dhe Telma, në burimet alternative, Kanal 5 edhe pse përparësi u jep burimeve zyrtare (59.5 %) nuk i lë anash as ato alternative (42.9 %), kurse TV Nova përvëç burimeve alternative (35 %), u kushton rëndësi edhe atyre zyrtare (25 %). Burime ndërkombëtare më tepër ka shfrytëzuar TV Sitel-i, e pastaj TVM/shq dhe TVM/m.

Në lidhje me karakterin e kontributave të analizuara, TV stacionet kanë qëndrim shpeshherë diametralisht të ndryshëm, shpeshherë diametal. Shumica prej tyre, si p.sh. televizionet nationale TVM/shq dhe TVM/m dhe ato lokale TV Hana, TV Era dhe TV Telma, konsiderojnë se është duke u pakësuar numri i ngjarjeve me karakter konfliktuoz. Nga ana tjeter, A1 dhe TV Nova kanë qëndrim krejtësisht të ndryshëm. Ato theksojnë se të gjitha ngjarjet për të cilat e kanë informuar publikun janë para së gjithash të karakterit politik dhe të interesit, kurse TV Telma pajtohet me to, por disa ndodhi i konsideron jokonfliktuze. Dhe në fund vijnë TV Sitel-i dhe TV Shutel-i për të cilat 2/3 e ngjarjeve janë të karakterit konfliktuoz. Këtë e vërtetojnë edhe të dhënrat nga tabela e mëposhtme:

TV stacioni	ndëretnik		politik/i interesit		nuk është i karakterit konfliktuoz	
	N	%	N	%	N	%
TVM/m	4	3,5	12	10,5	98	86,0
TVM/shq	-	-	1	1,6	60	98,4
TV A1	4	4,0	95	96,0	-	-
TV SITEL	7	10,0	36	51,4	27	38,6

TV TELMA	13	16,3	63	78,8	4	5,0
TV KANAL 5	3	3,6	17	20,2	64	76,2
TV SHUTEL	12	25,5	18	38,3	17	36,2
TV ERA	7	16,3	-	-	36	83,7
TV HANA	-	-	1	3,6	27	96,4
TV NOVA	-	-	20	100,0	-	-

Por, kur duhet të sigurohen burime informatash përkëto çështje, të gjitha TV stacionet (si ato me numër të madh ashtu edhe ato me numër të vogël të kontributeve që kanë të bëjnë me konfliktin) ngecin në aspektin profesional. Probleme më serioze ka TV Shutel-i, tek i cili për të gjitha çështjet konfliktuoze dhe të karakterit ndërëtnik dhe politik, burimet e informacioneve janë pa përjashtim nga njëra anë e konfliktit. Gjendja është pak më e mirë te A1 dhe TV Nova për çështjet konfliktuoze e sidomos te ato politike,, në veçanti në A1 i cili ka arritur të sigurojë informata nga dy burime për numër të njëjtë të kontributeve me ato të një burimi. Te TV stacionet e tjera (Era, TVM/m, Telma, Kanal 5) është burimi më shpesh vetëm nga njëra anë e shumë më rallë nga të dyja anët e konfliktit. Madje edhe TV Sitel-i, i cili “ia doli” edhe këtë muaj t’i sigurojë të dy burimet e informatave, si në muajin e kaluar, mbështetet shumë më tepër në burime vetëm nga njëra anë e konfliktit. Është e qartë se të gjitha TV stacionet duhet të punojnë në mënyrë më serioze në këtë çështje, përderisa mëtojnë profesionalizmin në informim.

Radio stacionet

Janë analizuar emisionet informative qendrore të pësë radio stacioneve: Radioja maqedonase – programi i

parë, Radioja maqedonase – programi informativ në gjuhën shqipe, Kanal 77, Radio Vat dhe Radio Plus Forte nga Tetova.

1. Mënyra e prezantimit të informatave: Si tregues lidhur me mënyrën e prezantimit të informatave janë marrë të dhënat për kohëzgjatjen e përgjithshme të radio lajmeve (pa blloqet e reklamave) dhe në raport me kohëzgjatjen e kontributeve të analizuara.

Tabela 1. Kohëzgjatja e përgjithshme e lajmeve, numri i kontributeve të analizuara dhe përfaqësimi i kontributeve në raport me kohëzgjatjen e përgjithshme të lajmeve

radio stacioni	kohëzgjatja e përgjithshme e lajmeve	numri i kontributeve të analizuara	kohëzgjatja e përgjithshme e kontributeve të analizuara	% e kontributeve në raport me kohëzgjatjen e lajmeve
RM/m	5:10:30	101	2:51:58	55,4
RM/shq	3:14:56	48	1:20:13	41,2
Kanal 77	4:27:20	98	3:03:12	68,5
Radio Vat	2:46:00	57	1:30:16	54,4
Kanal Plus Forte	1:48:34	39	1:02:56	58

Shënim: Në RM/m, RM/shq dhe Radio Vat janë analizuar tetë emisione të lajmeve, në Kanal 77 shtatë (të dielave nuk emeton lajme), kurse në Radio Plus Forte pesë (të shtunave dbe të dielave nuk emeton lajme; në këtë radio stacion lajme nuk janë emetuar edhe më 31 dhjetor).

Këtë muaj lajme më të gjata ka pasur RM/m, pastaj Kanal 77, i cili për kontributet e analizuara ka ndarë më tepër hapësirë dhe kohë. Kohëzgjatja e përgjithshme e lajmeve të Kanal 77 është për 40 minuta më e shkurtër sesa ajo e lajmeve të RM/m, kurse numri i kontributeve të analizuara thuajse është i njëjtë. Pastaj, sipas kohëzgjatjes së lajmeve, pasojnë RM/shq dhe Radio Vat-i dhe në fund të rang-listës është Kanal Plus Forte. Kra-

hasuar me muajin e kaluar, rritje të kohëzgjatjes është shënuar te RM/m (gjysmë ore në korelacion me kohëzgjatjen e përgjithshme), kurse zvogëlim te Kanal Plus Forte. Radio stacionet e tjera, krahasuar me muajin e kaluar kanë kohëzgjatje përafërsisht të njëjtë të lajmeve qendrore.

2. Tematika strukturore e kontributeve në lajme: Cilat kanë qenë ngjarjet të cilat radio stacionet i kanë shënuar si të rëndësishme dhe të njëjtat janë munduar “t'i mbulojnë”. Si temë më e rëndësishme te të gjitha radiot dallohet *funkcionimi i pushtetit ekzekutiv dhe ligjërës*, temë kjo që dy herë është gjetur në vendin e parë të listës së temave më të trajtuara, e tri herë në të dytin. Çështjet për *gjendjen ekonomike* në vend dhe në përgjithësi temat *socio-ekonomike* janë shfaqur si aspekte të rëndësishme të jetës. RM/m dhe Radio Vat-i, në zgjedhjen e tyre të temave të ofruara e kanë inkuadruar edhe *bashkëpunimin bilateral dhe multilateral të RM-së me fqinjët*.

Për **RM/m**-në si tema më të rëndësishme kanë qenë: *gjendja ekonomike* (25.7 %, respektivisht në çdo të katërtin kontribut theksi është vënë mbi këtë çështje) dhe tema për *funkcionimin e pushtetit* (14.9 %). Pothuajse gjysma e tyre e plotësojnë pjesën e parë të lajmeve, kurse si zhantur, dy temat dominante të veçuara, gjegjësisht 2/3 e tyre janë “paketuar” si raporte, kurse 1/3 si lajme/lajme të zgjeruara. Kontributet analitike edhe këtë herë mungojnë, kurse përsëritet edhe trajtimi informativ i përpunimit të tyre. Për gjysmën e kontributeve që kanë të bëjnë me funksionimin e pushtetit dhe përmë tepër se 1/3 e atyre tretë gjendjes ekonomike është siguruar besueshmëri, janë mbuluar me audio incizim nga vendi i ngjarjes dhe me citim direkt të aktorëve. Në RM/m nuk ka kontribute të gjata, përvèç nëse si të tillë konsiderohen dy kontribute që zgjasin nga katër minuta, të cilat janë dë-

gjuar në fund të vtitit. Njëri (4:53 min.) ndërlidhet me diskutimin vjetor të rregullt të kryetarit Trajkovski para Parlamentit në vigilje të Vtitit të Ri, kurse tjetri (4:09 min.) flet për përgatitjet për pritjen e Vtitit të Ri në she-shin “Maqedonia”.

Në muajin e fundit të vtitit, **RM/shq**, është fokusuar në katër çështje apo tema: e para, sipas shpeshtësisë është ajo që i trajton çështjet/*problemet socio-ekonomike* (18.8 %), pastaj *funkcionimi i pushtetit ekzekutiv dhe ligjvënës* (14.6 %), *integrimi i RM-së në strukturat ndërkombëtare* dhe *bashkëpunimi bilateral dhe multilateral me fqinjët* (të dyja me nga 10.4 %). Më pak se 1/4 e këtyre temave të përfaqësuara në mënyrë dominante janë përpunuuar në pikëpamje interpretative, respektivisht në kontekst të ndonjë teme tjeter. Shënohet një ritëm i rënies së trajtimit interpretativ, edhe pse në përgjithësi ende është i lartë numri i interpretimit të temës kryesore – thuajse 44 % të kontributive të analizuara janë përpunuar në atë mënyrë – me sqarimin e temës kryesore në saje të një tjetre, pra në saje të një teme referente. Nëse objekt analize e kemi paralajmërimin, atëherë përsëri duhet ta shënojmë numrin e madh të kontributeve të paralajmëruara. Ç'është e vërteta, 71 % (në tetor 65 %, kurse në nëntor 67 %) e të gjitha kontributeve të analizuara janë paralajmëruar për të térhequr kështu vëmendjen e dëgjuesve, kurse gjysma e tyre janë të dalluara me tema dominante. Vështruar nga një kënd tjeter – 2/3 e temave dominante janë gjetur në paralajmërimin e përgjithshëm të lajmeve. Struktura e zhanrit të kontributeve: dominojnë lajmet/lajmet e zgjeruara dhe një numër më i vogël raportesh. Si RM/m ashtu edhe RM/shq nuk kanë kontribute të gjata, me përjashtim të dy prej tyre. Njëri, me kohëzgjatje prej 4:53 min., ka të bëjë me paraqitjen e parë të Ali Ahmetit në punën e Kuvendit të RM-së (ditën e diskutimit vjetor të

Kryetarit para deputetëve), kurse i dyti, edhe ky me kohëzgjatje 4:53 min. ka të bëjë me reagimet e partive politike shqiptare rrëth paralajmërimeve të VMRO-DPMNE-së për tërheqjen e nënshkrimit të tyre nga Marrëveshja Kornizë.

Kanal 77 i përbahet në mënyrë standarde trajtimit informativ të prezantimit të ngjarjeve (vetëm 12.2 % të kontributeve janë me temë referente). Në fokusin e interesimit të tij janë *funkcionimi i pushtetit* (thuajse $\frac{1}{4}$ e kontributeve), *çështjet shoqërore-politike* (17.3 %), e më pas vijojnë *gjendja ekonomike* dhe *aktivitetet e partive politike* (të dyja me 13.3 %). E dhëna rrëth numrit të kontributeve të paralajmëruara vlen edhe për kontributet që trajtojnë tema më interesante – gjysma e tyre janë paralajmëruar si tema interesante që e shënojnë përditshmërinë tonë. Në aspekt të zhanrit, situata është dinamike dhe nuk “vlen” për të gjitha temat e cekura. Në fakt, funksionimi i pushtetit dhe gjendja ekonomike janë tema të përpunuara më shpesh në formë të raporteve dhe të lajmeve/lajmeve të zgjeruara. Kjo pasqyrë përputhet deri diku edhe me aktivitetet e partive politike. Por, për temën që ka të bëjë me çështjet e rëndësishme shoqërore-politike, përveç numrit më të madh të kontributeve, paraqiten edhe 4 analiza (prej gjithsej 5 nga kontributet e analizuara) dhe dy komente (prej gjithsej 3 nga të gjitha kontributet e analizuara). Domethënë, nga gjithsej 8 zhanret e analizuara – 6 janë shfrytëzuar për përpunimin e temës së dytë për nga shpeshtësia në Kanal 77 – çështjet e rëndësishme shoqërore-politike. Këtë muaj, Kanal 77 ka vetëm një kontribut më të gjatë, me kohëzgjatje prej 5:10 min., që ndërlidhet me qëndrimet e Kongresit Maqedonas Botëror, i cili konsideron se rezultatet nga regjistrimi i popullatës së RM-së do të jenë nën parashikimet e shqiptarëve.

Radio Vat-i këtë muaj shfrytëzon si trajtimin informativ ashtu edhe atë interpretativ (46 % të kontributeve kanë, kurse 54 % nuk kanë temë referente). Temat deri diku janë të “shpërndara” në fushat e përcaktuara që më parë. Dallohet *funkcionimi i pushtetit ekzekutiv dhe ligjërës* (19.3 %), e më pas (me përfaqësim të njëjtë me nga 8.8 %) vijojnë *bashkëpunimi bilateral dhe multilateral me fqinjët*, *Marrëveshja Kornizë dhe implementimi i saj* si dhe temat që trajtojnë *probleme të rëndësishme socio-ekonomike*. Gjysma e të gjitha kontributeve të analizuara paralajmërohen në fillim të lajmeve, e gjysma e atyre që janë paralajmëruar kanë të bëjnë me temat dominante të përmendura. Marrëveshja Kornizë është temë e cila pa përjashtim është karakterizuar si “temë e ditës”. Në aspekt të zhanrit, temat dominante më shpesh “paketohen” në formë të lajmeve/lajmeve të zgjeruara, ndërsa më rrallë, por në mënyrë të barabartë janë përfaqësuar raportet dhe deklaratat e dhëna nga protagonistët kryesorë. Por, Radio Vat-i ka vetëm një kontribut të gjatë, 5:46 min., që ka të bëjë me kritikat e PDSH-së drejtuar kopcionit qeveritar për mosimplementimin e Marrëveshjes Kornizë si dhe për përpjekjet dhe meritat e PDSH-së lidhur me të. Ka disa kontribute prej 4 minutash. Njëri (4:48 min.) ka të bëjë me reagimet në lidhje me helmimin e nxënëseve shqiptare; i dyti (4:53 min.) i përcjell reagimet e përfaqësuesve të partive politike shqiptare rrëth një skandali kur ministrat Mitreva dhe Buçkovski u larguan nga ceremoniali i NATO-s, për tërheqjen e saj nga Maqedonia për shkak të përdorimit të gjuhës shqipe; kontributi i tretë (4:59 min.) i përcjell deklaratat e Ali Ahmetit rrëth pjesëmarrjes së tij në Parlament.

Për **Kanal Plus Forte**-n, *problemët socio-ekonomike* janë tema që do ta tërheqin vëmendjen e qytetarëve (23 % i kontributeve kanë të bëjnë me këtë temë). Më tutje,

rëndësi të njëjtë u kushton temave në lidhje me *gjendjen ekonomike në vend*. Siç mund të pritet, ai flet edhe *për jetën dhe problemet e popullatës*, e cila vitin e kaluar ishte dëshmitare e konfliktit të armatosur, por s'e harron as *pushtetin dhe funksionimin e tij*. Në punën e vet e shfrytëzon trajtimin informativ,^{3/4} e kontributeve me tema dominante i paralajmëron në fillim të emetimit të lajmeve qendrore, kurse si zhanr, thuajse i shfaq kryekëput në formë të raporteve (ka vetëm dy lajme/lajme të zgjeruara). Kanal Plus Forte këtë herë, përveç një kontributi prej 4:20 min., që ka të bëjë me ngjarjet e 3 dhjetorit, ditën ndërkombëtare të personave me handikap, nuk ka kontribute të gjata.

3. Struktura e aktorëve në kontributet e analizuar ose kategori të aktorëve që dominojnë në lajmet e radiostacioneve. Si edhe deri tanë, në të gjitha radio-stacionet *kanë përparesi aktorët vendës*. Në Kanal 77, 94 % të të gjithë aktorëve të përmendur janë me “prejardhje vendëse”. Aktorët e huaj më të përfaqësuar janë në RM/shq dhe Radio Vat, sidomos në RM/shq, ku raporti “vendas-të huaj” është 71 % - 29 %. Edhe këtë herë, RM/m, Kanal 77 dhe Kanal Plus Forte i favorizojnë aktorët individualë, kurse RM/shq dhe Radio Vat-i ata kolektivë. Raporti “individualë-kolektivë” te mediumet e para është 66 % - 34 % në dobi të atyre individualë, kurse te të dytë 54 % - 46 % në dobi të atyre kolektivë. Nëse kategoritë e aktorëve hulumtohen veç e veç, mund të konstatohet se radhitja është e njëjtë si edhe dy muajve të mëparshëm, pra dominojnë *zyrtarët e lartë shtetërorë në nivel nacional* dhe *ekspertët/intelektualët*. **RM/m** prap i parapëlqen zyrtarët e lartë shtetërorë në nivel nacional dhe ekspertët/intelektualët (të parët me 26.3 %, kurse të dytët me 18.6 %). E njëjta gjë mund të thuhet edhe për **Kanal 77** (me dallim se në këtë frekuencë të parët janë përfaqë-

suar me 30.4 %, kurse të dytët me 17.9 %). RM/shq vë theks mbi zyrtarët e lartë shtetërorë (21.1 %) dhe organet shtetërore në nivel nacional (17.1 %). E njëjtë gjë vërehet edhe te Radio Vat-i, me të vetmin dallim se te ky radiostacion raporti midis përqindjeve është më drastik (23.8 % zyrtarët e lartë shtetërorë dhe 12.8 % organet shtetërorë në nivel nacional). Te **Kanal Plus Forte**, si zakonisht mbizotërojnë ekspertët/intelektualët (këtë herë me 58.3 %).

C'qëndrim kanë radiostacionet e analizuara lidhur me aktorët dominantë? “Nuk kanë qëndrim të njëjtë”. Për aktorët RM/m dhe Kanal 77 flasin më tepër në kontekst të temës, po jo rrallëherë i citojnë, sidomos kur bëhet fjalë për zyrtarët e lartë shtetërorë, dhe i parafrazonë. RM/shq e jep shumë rrallë në eter zërin e aktorit. Për shembull, prej 172 bartësve të veprimit, në 48 kontributë të analizuara, vetëm gjashtë janë cituar. Ky radiostacion, për aktorët dominantë flet më shpesh në kontekst të temës. Të njëjtën gjë e praktikon edhe Radio Vat-i. Kanal Plus Forte i citon dhe i parafrazon aktorët dominantë.

Cilat janë subjektet konkrete që janë përfaqësuar në mënyrë dominante në lajme?

RM/m - Personi më i përfaqësuar dhe më i cituar në lajme është **Boris Trajkovski**.

aktorë më të përfaqësuar	kohëzgjatja e kontributeve në të cilat aktori është prezent		kohëzgjatja e përgjithshme e prezantimit direkt të aktorit	
	në sekonda	%	në sekonda	%
1. Boris Trajkovski	838	8,1	319	38,1
2. Ilinka Mitreva	608	6	38	6,3
3. Qeveria e RM-së	470	4,6	00	0,0
4. Vllado Buçkovski	463	4,5	246	53,1
5. Branko Cërvenkovski	242	2,3	76	31,4

Shënim: % e kontributere me aktorin prezent është llogaritur në raport me kohëzgjatjen e përgjithshme të kontributere të analizuara, kurse % për prezantimin e drejtperdrejtë të aktorit, në raport me kohëzgjatjen e kontributere në të cilat aktori është prezent.

RM/shq – Në lajmet RM/shq më prezente është **Qeveria e Maqedonisë**, por asnjë prej aktorëve dominantë nuk është cituar.

aktorë më të përfaqësuar	kohëzgjatja e kontributeve në të cilat aktori është prezent		kohëzgjatja e përgjithshme e prezantimit direkt të aktorit	
	në sekonda	%	në sekonda	%
1. Qeveria e RM-së	882	18,3	00	0,0
2. Boris Trajkovski	745	15,5	00	0,0
3. MPB	700	14,5	00	0,0
4. NATO	444	9,2	00	0,0
5. BE	441	9,2	00	0,0

Kanal 77 - Më e përmendur në lajme është **Qeveria e Maqedonisë**, kurse më i cituar, **Boris Trajkovski**.

aktorë më të përfaqësuar	kohëzgjatja e kontributeve në të cilat aktori është prezent		kohëzgjatja e përgjithshme e prezantimit direkt të aktorit	
	në sekonda	%	në sekonda	%
1. Qeveria e RM-së	1637	14,9	00	0,0
2. Lubço Georgievski	1164	10,6	18	1,5
3. Branko Cërvakovski	1120	10,2	84	7,5
4. Ali Ahmeti	739	6,7	49	6,6
5. Boris Trajkovski	701	6,4	240	34,2

Në këtë radiostacion dëgjuesve u është përcjellë një vlerësim negativ i Lube Boshkovskit për Ali Ahmetin, momenti kur Boshkovski ka thënë se nuk dëshiron të ulet në parlament me “kriminelin Ahmeti”.

Radio Vat – Për NATO-n është ndarë më tepër kohë në lajme, kurse më tepër të cituar janë **nxënësit shqiptarë**.

aktorë më të përfaqësuar	kohëzgjatja e kontributeve në të cilat aktori është prezent		kohëzgjatja e përgjithshme e prezantimit direkt të aktorit	
	në sekonda	%	në sekonda	%
1. NATO	1362	25,1	00	0,0
2. Boris Trajkovski	1113	20,6	40	3,6
3. nxënësit shqiptarë	972	17,9	143	14,7
4. BE	896	16,5	00	0,0
5. Qeveria e RM-së	260	4,8	00	0,0

Mund të vërehet se te të gjitha radiostacionet kryetari **Trajkovski** dhe **Qeveria e RM-së** bëjnë pjesë në grupin e aktorëve më të përmendur. Në këtë grup, RM/shq dhe Radio Vat-i, përveç zyrtarët e lartë shtetërorë, e pozicionojnë edhe NATO-n dhe BE-në. Janë po ato radiostacione që si temë të rëndësishme e kanë trajtuar integrimin e RM-së në strukturat ndërkombëtare. Radio stacionet janë mjaft të kujdeshme – *të paanshme* gjatë përcjelljes së vlerësimeve negative për aktorët e sferave të tjera. Të theksojmë se te Kanal Plus Forte, për shkak të numrit të vogël të kontributeve të analizuara nuk mund të veçohet asnjë aktor dominant. Përndryshe, në këtë frekuencë më tepër është dëgjuar zëri i Arbër Xhaferit (190 sekonda), kurse një aktor është vlerësuar negativisht.

3. Burimet e informatave – Së pari le të themi diç lidhur me profesionalitetin e radiostacioneve, më saktë, lidhur me burimet e informatave që i kanë shfrytëzuar ato:

Tabela 2. Burime të informatave sipas llojit

radiostacioni	të paqarta/të pasakta		të sakta		gazetari nga vendi i ngjarjes		burimi nuk është theksuar	
	N	%	N	%	N	%	N	%
RM/m	26	25,7	72	71,3	0	0,0	13	12,9
RM/shq	8	16,7	32	66,7	0	0,0	8	16,7
Kanal 77	59	60,2	54	55,1	2	2,0	3	3,1
Radio Vat	5	8,8	46	80,7	0	0,0	6	10,5
Kanal Plus Forte	1	2,6	38	97,4	0	0,0	0	0,0

Shënim: Përqindja e përgjithshme e të dhënave është më e madhe se 100 % për arsyе se në disa kontributet ka edhe burime të paqarta/të pasakta dhe burime të sakta të informatave.

Nëse lidhur me profesionalitetin gjykojmë në bazë të përqindjes së burimeve të paqarta/të pasakta dhe të kontributet që nuk e përmendin burimin, atëherë si radiostacion më profesional do ta kishim cilësuar Kanal Plus Forte-n (të gjitha kontributet i ka me burime të sakta të informatave), kurse si më joprofesional Kanal 77 (në 60.2 % të kontributet janë theksuar burime të paqarta/të pasakta). Brengos edhe numri i madh i kontributet me burime të paqarta/të pasakta të informatave te RM/m, por edhe te RM/shq. Mediumi i fundit është radio stacioni me numër më të madh të kontributet në të cilat nuk është theksuar asnjë burim i informatave (16.7 %). Kështu është rasti edhe me RM/m dhe Radio Vatin. Serioziteti i kësaj të mete shpie në kërkim dhe identifikim të temave me burime të paqarta/të pasakta, gjegjësisht pa burime të theksuara të informatave, duke mbetur të vetëdijshëm se nuk i kemi zbuluar shkaqet e një dukurie të këtillë. Kanal 77 është radio stacion i cili në kontributet e veta përmend përqindje më të madhe të burimeve ta paqarta/të pasakta. Këtë e bën lidhur me tema që kanë të bëjnë me funksionimin e pushtetit dhe

ndodhitë shoqërore-politike relevante, apo, më saktë, lidhur me gjithë atë fushë që i përfshin ngjarjet e brendshme dhe ato të politikës. RM/m dhe RM/shq janë të ngjashme në këtë drejtim, respektivisht përqindjen më të madhe të burimeve të paqarta/të pasakta e përmendin në kontributet që kanë të bëjnë me problemet shoqërore-ekonomike. Tema e fundit është ajo që nuk është mbuluar nga RM/shq me kurrfarë burimi. Ndërkaq, RM/m dhe Radio Vat-i nuk i theksojnë burimet për rapsortin e bashkësisë ndërkombëtare në lidhje me Maqedoninë.

Në aspekt të statusit të burimit, të gjitha radiostacionet shfrytëzojnë më së tepërmë burimet zyrtare të informave, përvèç Kanalit 77, ku përqindja më e madhe e burimeve të përmendura është alternative. Kanal Plus Forte i shfrytëzon në mënyrë të barabartë burimet alternative dhe zyrtare, por në valët e veta nuk ka asnjë burim ndërkombëtar të informimit. Te RM/m dhe te Radio Vat-i, në vend të dytë janë ranguar burimet alternative, kurse te RM/shq ato ndërkombëtare. Marrë në përgjithësi, mediumet në gjuhën shqipe, për “mbulimin” e ngjarjeve shfrytëzojnë numër të madh burimesh ndërkombëtare, gjë që mund të pritet nëse merret parasysh fakti se temat e tyre “të interesit” kanë qenë edhe marrëdhëni me fqinjët dhe integrimi i RM-së në strukturat ndërkombëtare.

Radiostacionet në fjalë, karakteri i kontributeve të cilave është në qendër të vëmendjes sonë, kanë qëndrimë skajshmërisht të kundërtatë në lidhje me temat aktuale. Në njërin skaj gjenden RM/shq dhe Radio Vat-i, ku asnjë kontribut nuk trajton çështje konfliktuoze, pasojnë RM/m me 21.8 % të kontributeve të karakterit konfliktuz, Kanal Plus Forte me 38 % të kontributeve të tillë, kurse në skajin tjetër gjendet Kanal 77 me thuaqse 96 %

të kontributeve të identikuara dhe të analizuara të karakterit konfliktuoz, pra medium ky që gjendet në eks-tremin “konfliktuoz”.

Tabela 3. Karakteri i kontributit

Radiostacioni	ndëretenik		politik/i interesit		nuk është i karakterit konfliktuoz	
	N	%	N	%	N	%
RM/m	3	3,0	19	18,8	79	78,2
RM/shq	0	0,0	0	0,0	48	100
Kanal 77	15	15,3	79	80,6	4	4,1
Radio Vat	0	0,0	0	0,0	57	100
Kanal Plus Forte	7	17,9	8	20,5	24	61,5

Domethënë, te të gjitha radio stacionet, përveç te Kanal 77, dominojnë kontributet që nuk janë të karakterit konfliktuoz. Te Kanal 77 dominojnë kontributet e konfliktit politik dhe të interesit (80.6 %). Nga ana tjeter, konfliktet ndërtenike i hasim te Kanal Plus Forte. Është i pritur interesimi dhe prezentimi i çështjeve të konfliktit ndëretenik të Kanal Plus Forte, sepse mu në rajonin nga ky medium e emeton programin e vet ka më tepër trazira të natyrës ndërtenike. Edhe temat me të cilat ndërlidhen çështjet e konfliktit ndëretenik kanë të bëjnë me jetën dhe problemet e popullatës së zonës tetovare të kri-zës, por jo rrallë, edhe me aktivitetet e partive politike. Kanal 77 i trajton të gjitha kontributet që kanë të bëjnë me funksionimin e pushtetit si konfliktuze, duke e theksuar para së gjithash aspektin politik dhe konfliktin e interesave. Ky konflikt u jep ngjyrim edhe të gjitha temave që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike në vend dhe që kanë qenë në fokusin e interesimit të Kanal 77. Te numri më i madh i kontributeve të karakterit konfliktuoz të këtij radiostacioni janë theksuar burime të paqarta/joprecize. Me fjalë të tjera, vetëm te 15 % e kontribu-

teve që ndërlidhen me konfliktin politik/të interesit ka theksuar burime të sakta, kurse te 15 % është dhënë vetëm njëra anë e konfliktit. Gjysma e kontributave konfliktuoze janë gjetur në pjesën e parë të lajmeve të Kanal 77, kurse tetë zhanret analitike, prezentë në analizën e zhanrit të Kanal 77, kanë të bëjnë pikërisht me kontributet e konfliktit politik/të interesit. Te RM/m, 2/3 e kontributave me karakter konfliktuoz si temë e trajtojnë gjendjen ekonomike, kontributet që “merren” me aktivitetet e partive politike shpesh ngërthejnë në vete përbërje konfliktuoze (67%). Te ky radiostacion, thuajse te 80 % e kontributave të konfliktit politik ose të ndonjë konflikti tjetër të interesit janë theksuar burime të paqarta/të pasakta. Përveç asaj që çështjet konfliktuoze mbulohen më shpesh me burime të paqarta/të pasakta, problem i përbashkët, si duket, është edhe sigurimi i burimeve të informatave nga dy ose më tepër anë të përfshira në konflikt. Pa marrë parasysh nëse konflikti është politik ose ndëretnik, opinionit më së shumti i ofrohet vetëm “njëra anë”. Dhe tanimë pushon të jetë me rëndësi fakti nëse radiostacionet janë profesionale ose jo, tani të rëndësishme janë pasojat që mund t'i shkaktojë veprimtaria e tyre joprofessionale.

Mediumet e shtypit

Janë analizuar nga shtatë numra të gazetave ditore (Dnevnik, Utrinski Vesnik, Veçer, Vest, Flaka dhe Fakti), 4 numra të Kapital-it dhe pesë të Lobi-t.

1. Mënyra e përpunimit dhe pajisjes së teksteve të analizuara. Në këtë muaj hapësira e përgjithshme e kontributave të analizuara shënon një rënje si te gazetat ditore (12-16 %) ashtu edhe te ato javore, te cilat si za-

konisht kjo rënie është më e madhe, kështu që te Kaptali kjo është 33 %, kurse te Lobi 47 %. Ndërkohë bie në sy rënia e dukshme e hapësirës së përgjithshme të kontributeve të analizuara në numra absolutë te gazeta ditorre në gjuhën shqipe Flaka, gjë që sipas të gjitha gjasave ndërlidhet me krizën në të cilën ra NGB “Nova Makedonija”, ku del edhe gazeta në fjalë. Edhe te gazeta tjetër e kësaj shtëpie (Veçer) vërehen proceset e njëjta, por ato nuk janë gjithaq të dukshme.

Tabela 1. Hapësira e përgjithshme e kontributeve të analizuara në raport me hapësirën e tekstit, mbititullit/titullit/nëntitullit dhe ilustrimit.

gazeta/revista	Hapësira e përgj. e kontributeve të analizuara në cm ²	% e hapësirës së tekstit	% e hapësirës për mbititull/titull /nëntitull	% hapësira për ilustrim
Dnevnik	30 523	70.24	16.40	13.36
Utrinski Vesnik	37 800	67	16.66	16.34
Veçer	22 985	67.64	21.91	10.45
Vest	23 817	44.52	24.35	31.13
Flaka	15 911	54.64	30.01	15.35
Fakti	30 245	6146	21.95	16.59
Kapital	43 780	46 37	22.17	31.46
Lobi	52 016	71.36	11.3	17.34

Sa i përket raportit ndërmjet pjesës tekstuale të kontributeve dhe pjesës së ndarë për tituj/nëntituj dhe ilustrime, gjendja ndryshon shumë në varësi nga mediumi. Pjesës tekstuale hapësirë më të madhe i ka ndarë Dnevnik-u dhe Lobi (mbi 70 %), më pak Kapital-i dhe Vest-i (rreth 45 %). Në rastet kur pjesa tekstuale “sakrifikohet” në llogari të titujve/nëntitujve dhe ilustrimeve mund të shtrohet pyetja për cilësinë e kontributeve, gjegjësisht

për kapacitetin e gazetës/revistës për t'i plotësuar faqet e caktuara me tekste cilësore. Jobaraspesha e qartë, në këtë kuptim, flet për një gazetë relativisht “të zbrazët”, respektivisht për gazetë që nuk është në gjendje t'i ofrojë opinionit informata më të shumta dhe më cilësore.

2. Struktura tematike e kontributave të analizuar: Në kontributet e mediumeve të shtypit zakonisht dominojnë çështjet nga sfera socio-ekonomike dhe politike. Ndërkohë, sipas preferencës, është e mundur që gazetat të ndahen në dy grupe. Në grupin e parë bëjnë pjesë gazetat/revistar që përparësi u jasin temave nga sfera socio-ekonomike (Dnevnik, Utrinski, Vest, Kapital), kurse në grupin e dytë dominojnë temat nga sfera politike (Lobi, Flaka, Fakti). Në Veçer ky raport është relativisht i barabartë. Është me rëndësi të theksohet se, përveç dy temave të cekura, në disa gazeta si temë e ranguar në vendin e dytë paraqitet ajo që ndërlidhet me rajonet ku ka pasur luftime (Lobi, Fakti), ose tema në lidhje me marrëdhëniet ndërkombëtare (Kapital).

Sa i përket zgjedhjes dhe shkallëzimit të temave të veçanta nëpër mediumet e shkruara si dhe mënyrës së përpunimit të tyre, analiza na jep këtë tablo:

Në **Dnevnik** si temë e ranguar në vendin e parë na paraqitet *gjendja ekonomike* (20.5 %), e më pas, me përqindje mjaft më të vogël, ajo e kriminalitetit (11.2 %), aktivitetet e partive politike (10.6 %), jeta dhe problemet në zonat ku janë zhvilluar luftime (6.2 %) etj. Këto tema nuk janë paralajmëruar në faqen e parë. Sa u përket zhanreve përmes të cilave janë përpunuar temat, dallohet për nga analiza tema e partive politike. Të gjitha temat janë të shoqëruara me ilustrime. Lidhur me burimet e informatave mund të thuhet se te të gjitha mediumet e shkruara është i madh numri i teksteve me burime të përdefinuara. Në Dnevnik ka disa kontribute më të gjata.

Më i gjati është letra drejtuar ministrit të bujqësisë, Sllavko Petrov, nga firma shkupjane “CIP Produkt”, në lidhje me privatizimin e kësaj ndërmarrjeje. I gjatë është edhe kontributi i titulluar “Dhelprat e Brukselit ia hidhëtuan koktejin kreut tonë shtetëror” (botuar në ballinë të gazetës) rrëth skandalit gjatë largimit të misionit të NATO-s për arsyen se gjuhën shqipe e kanë trajtuar si zyrtare dhe Maqedoninë e kanë emëruar IRJM. I tillë është edhe kontributi i titulluar “Vojo Mihajlovski në ikje, Besnik Fetai i pakapshëm” (i botuar edhe ky në faqen e parë), që flet për fillimin e hetimeve rrëth keqpërdorimit të funksionit zyrtar të këtyre funksionarëve të lartë të pushtetit të mëparshëm. Duhet përmendur edhe tekstin autorial në lidhje me Maqedoninë, që mban titullin “Maqedonia duhet ta sigurojë vetë stabilitetin e brendshëm”.

Sipas numrit të kontributeve në **Utrinski Vesnik**, si temë e ranguar në vend të parë është *korrupsioni* (13.8%), pastaj ajo për gjendjen ekonomike (12.3 %), për funksionimin e pushtetit ligjvënës dhe ekzekutiv (11.5 %), aktivitetet e partive politike (9.2 %). Si tema më shpesh të paralajmëruara më shepsh në faqen e parë janë ato rrëth korrrupsionit dhe funksionimit të pushtetit dhe thuajse të gjitha, përveç zhanreve të zakonshme, hasen edhe forma analitike. Ato shpesh janë të shoqëruara me ilustrime, e sa u përket burimeve të informatave jo të qarta dhe të pasakta, ato hasen më së shumti te ato në lidhje me korrrupsionin. Dy kontributet më të gjata nuk e ilustrojnë strukturën tematike dominante të gazetës. Njëri, me titullin “Evropës i duhen kufij të rinj, por edhe shtëpi e re”, dhe mbititullin “BE është pa përgjigje për ndërtimin e shtëpisë së re evropiane në të cilën do të gjejnë vend 25 shtete” dhe shtron çështjen nëse “shtëpia evropiane” është mjaft e madhe për të pranuar anëtarë të rinj. I dyti që mban titullin “Viti 2003 do të jetë vit i ligjit

dhe i reformave” është një intervistë me kryetarin Trajkovski në lidhje me çështjet e politikës së brendshme të Republikës së Maqedonisë.

Në **Veçer**, në të cilin thuajse rëndësi të njëjtë u kushtohet dy lëmenjve dominantë, me frekuencën e vet dallohen tri tema: *funkcionimi i pushtetit ekzekutiv dhe ligjë-nës* (20.7 %), *gjendja ekonomike* (18 %) dhe *aktivitetet e partive politike*. Dy të parat janë të shoqëruara relativisht shpesh me ilustrime. Temë më e paralajmëruar në ballinën e gazetës është funksionimi i pushtetit. Në lidhje me strukturën e zhanrit të kontributeve për t'u shënuar është fakti se te tema e ranguar si e treta ka forma më të ndryshme dhe më cilësore të zhanrit (tekst autorial, koment, deklaratë). Nga sa përmendëm, mund të përfundohet se gazeta e ka theksuar rëndësinë e disa temave përmes trajtimeve të ndryshme, duke mos i dhënë asnijë-rës pozitë të privilegjuar. Këtë muaj, kontribut më i gjatë në Veçer është intervista me kryetarin Trajkovski, që mban titullin “Do të jetë i rëndë viti 2003, por ka gjasa të shkojmë përpara”. Por, për nga gjatësia dallohen edhe dy kontribute. Njëri, i titulluar “VMRO-DPMNE të vazhdojë t'i mbështesë interesat e RM-së”, flet për qëllimet e kryetarit Trajkovski për mbajtjen e një takimi me liderët në lidhje me Marrëveshjen Kornizë, kurse i dyti, i titulluar “Pasqyra e Maqedonisë nuk është e mirë”, i prezanton qëndrimet e raportit të Komisionit Evropian rrëth gjendjes ekonomike në rajon.

Në **Vest**, këtë herë dominojnë çështjet nga sfera socio-ekonomike dhe si të veçanta dallohen dy tema: *gjendja ekonomike* (15.9 %) dhe *aktivitetet e partive politike* (10.3 %).

Është interesante se këtë herë vëmendja, më tepër se muajt e kaluar, ka qenë e orientuar nga çështjet e lëmit të tretë, respektivisht nga ngjarjet në zonat e krizës

(9.3 %). Paralajmërimet në faqen e parë kanë qenë më të shpeshta për aktivitetet e partive politike, e sa i përket përpunimit të temave sipas zhanrit, komenti dhe teksti autorial i vetëm u janë kushtuar partive politike. Numri më i madh i kontributeve në të cilat autori nuk mund të identifikohet janë të lidhura me gjendjen ekonomike, gjë të cilën e kemi konstatuar edhe muajin e shkuar. Sa u përket burimeve të paqarta, ato më së shumti i gjejmë te temat për veprimtaritë shoqërore-politike. **Vest**-i ka tri kontribute më të gjata. I pari, i titulluar “Katër të lënduar në përplasje të armatosur të reketit drejtorial” flet për grevën në firmën e Velesit “Kiro Quçuk”, i dyti, i titulluar “Dinastitë e AMSHA-së”, për nepotizmin në Akademi, respektivisht për kandidatët-djem të akademikëve në AMSHA-së, kurse i treti nën titullin “Zegin-i e okupon Vodnon” flet për denoncimet penale që komshinjtë e Bllagoj Hanxhiskit, pronar i barnatoreve “Zegin” në Shkup, i kanë bërë kundër tij sepse ka zaptuar një pjesë të tokave të tyre.

Në **Flaka**, si edhe muajin e kaluar, shënohet interesim i dukshëm për çështjet e lëmit politik. Si tema më frekuente janë *veprimtaritë shoqërore-politike* (20.3 %), vetë-qeverisja lokale (11.9 %) dhe funksionimi i pushtetit ligj-vënës dhe ekzekutiv (8.5 %). Në përgjithësi, interesimi për temat socio-ekonomike është tri herë e gjysmë më i vogël, kurse, si edhe muajin e kaluar, mund të konstatohet se temat që ndërlidhen me zonat e krizës janë marginalizuar. Analiza e indikatorëve të tjera, përmes të cilëve del në pah rëndësia që gazeta ua kushton temave të caktuara, flet për të dhënrat në vijim: Te dy temat që i zënnë dy vendet e para shënohen edhe forma analitike të zhanrit. Paralajmërimet në ballinën e gazetës ndërlidhen më tepër me temën e parë. Ilustrimin, si element shoqëruesh, e hasim më së tepërmë te tema për funksionimin e

pushtetit, kurse te dy temat e ranguara në vendin e parë është i madh numri i kontributeve në të cilat nuk janë theksuar fare burimet e informatave. Edhe në Flaka ka disa kontribute që dallohen nga gjatësia. I pari (i titulluar “Viti që shkon - në shenjë të stabilizimit të sigurisë në vend”) ka të bëjë me diskutimin vjetor të kryetarit Trajkovski para Kuvendit të RM-së. I dyti, që mban titullin “Shumë pyetje lidhur me një vendim të pritur”) flet për ndryshimin e datës së qytetit të Tetovës nga 19 Nëntori, kur është çliruar ky qytet, në 3 Mars, dita kur është formuar Kuvendi shumëpartiak i qytetit.

Te gazeta e dytë në gjuhën shqipe, **Fakti**, interesimi për *çështjet politike* është edhe më tepër i theksuar (rreth 70 % të të gjitha kontributeve), kurse sfera socio-ekonomike është mjaft e marginalizuar. Temë e veçantë e ranguar në vendin e parë është ajo rreth aktivitetave shoqërore-politike (50.9 %), kurse temë e ranguar në vendin e dytë është ajo që ka të bëjë me jetën dhe problemet në zonat ku ka pasur luftime (14.3 %). Temat e tjera janë nga sfera politike: aktivitetet e partive politike (8.9 %) dhe funksionimi i pushtetit ekzekutiv dhe ligjvënës (8 %). Te të gjitha temat dominante është i madh numri i kontributeve në të cilat nuk përmenden kurrfarë burimesh të informatave, kurse te tema e ranguar si e parë është i madh numri i teksteve në të cilat nuk figuron fare autori. Të gjitha temat dominante shpesh janë paralajmëruar në faqen e parë, kurse veçmas ajo e ranguar si e parë është përpunuar përmes formave të ndryshme të zhanrit, duke përfshirë 9 komente, 4 editoriale, dy letra të lexuesve etj. Sa i përket fotografisë, bie në sy se ajo është shfrytëzuar mjaft te temat dominante, me çka gazeta ka dashur ta theksojë rëndësinë e tyre. Ka disa kontributi të gjata. Njëri është raport lidhur me lirimin e Fadil Feratit nga burgu i Shutkës, nën titullin “S'mund t'i

harroj asnjeherë torturat që i kam përjetuar”, i dyti me titullin “Drejtësia e vonuar mund të kushtojë shtrenjt”, flet për gjinekologun Numan Ibrahimit të cilin gjykata e Shkupit e nxjerr të pafajshëm, kurse i treti, që mban titullin “S’do të lejoj interpretim të gabuar të Marrëveshjes së Ohrit”, paraqet shënimë nga konferenca e shtypit e Trajkovskit lidhur me festat e Vtitit të Ri.

Kapital-i, në mënyrë standarde, u kushton më tepër rëndësi çështjeve nga *sfera socio-ekonomike*, të cilën e përbëjnë 60 % të të gjitha kontributeve të kasaj javoreje. Kësaj sfere i përkasin edhe dy temat e ranguara në dy vendet e para: gjendja ekonomike (23.3 %, përqindje kjo thuajse e njëjtë me atë të muajit të kaluar) dhe aktivitetet socio-ekonomike (17.8 %). Vendin e tretë në këtë ranglistë e ndajnë temat mbi korrupzionin, funksionimin e pushtetit ligjvënës dhe ekzekutiv dhe integrimi i Maqedonisë në strukturat ndërkombëtare (me 6.9 %). Për të ashtuquajturën sferë e parë, që i trajton marrëdhënet e Maqedonisë me komunitetin ndërkombëtar, revista trigon interesim më të madh se mediumet e tjera të shtypit (këtë herë, p.sh., me këtë temë ndërlidhen rrëth 15 % të të gjitha kontributeve). Prej temave dominante korrupzioni është më i paralajmëruar në faqen e parë, kurse si zhanri pothuajse te të gjitha temat janë shfrytëzuar edhe format analitike (komente, intervista, analiza etj.) Prej ilustrimeve, fotografia ka qenë shoqëruar i shpeshtë i këtyre teksteve, por duhet të theksohet edhe fakti se shumë shpesh në këto tekste nuk mund të identifikohet autor, gjegjësisht ata nuk janë nënshkruar (p.sh. 50 % të teksteve për gjendjen ekonomike). Karakteristikë e Kapitalit janë tekstet e gjata, e si më të gjata, dallohen disa. Më i gjatë është ai me titullin “Nëse nuk korrupton do ganier – asgjë nga biznesi” (i dhënë edhe në faqen e parë), që flet për hulumtimin që e ka bërë ekipi i Kapital-it

lidhur me funksionimin e sistemit të korruptionit në doganë (hulumtim ky i shoqëruar me biseda me përfaqësues të shumë firmave importuese-eksportuese, transportues, doganierë, biznesmenë, përfaqësues të institacioneve, njerëz të rëndomtë). Aty është edhe portreti i “Droga”-Portorozh – përfaqësia Shkup dhe i drejtorit të përgjithshëm të saj, Ruzhica Radojeviq (titulli “Organizimi i mirë i punës është çelës i suksesit tonë”). Më pas vjen kontributi me titullin “Suksesi i Alumina-s varet nga reformat e jo nga prona”, intervistë me drejtorin e përgjithshëm të kësaj ndërmarrjeje Mitko Krzhovski lidhur me gjendjen në fabrikë, prodhimin, tregun, kushtet për punë, rrrogat, privatizimin etj. Dhe në fund, intervista me ministrin për punë dhe politikë sociale, Jovan Manasievski (nën titullin “Rreth 70 % e familjeve maqedonase jetojnë nga ndihmat sociale”), që flet për reformat në ndarjen e ndihmave sociale, në sistemin pensional etj.

Në javoren tjeter, **Lobi**, struktura e teksteve parapëlqen *temat politike* (këtë herë rreth 48 %), kurse lëm i ranguar në vendin e dytë është ai rreth ngjarjeve në rajojet e krizës (rreth 24 %).

Si të veçanta dallohen çështjet në vijim: aktivitetet shoqërore-politike (13.8 %), Marrëveshja Kornizë dhe implementimi i saj (10.3 %), problemet në zonat ku kishte përlleshje luftarake (9.2 %) dhe aktivitetet e partive politike (6.9 %). Rëndësia e këtyre temave është “përfocuar” me pralajmërimin e shpeshtë të tyre në faqen e parë si dhe me forma cilësore të zhanrit, të cilat mundësojnë përpunim analistik të tyre. Është për t'u theksuar se tema rreth partive politike është e shoqëruar me strip, kurse të gjitha temat e lartpëmedura janë pajisur shumë shpesh me fotografi e më trallë me ilustrime artistike. Në Lobi ka më shumë kontribute të gjata. Si më të gjata dallohen këto: i pari është një intervistë ekzkluzive me

Ali Ahmetin, kryetar i BDI-së, nën titullin “Ali Ahmeti: Kemi hyrë në koalicion për të marrë përgjegjësi për udhëheqjen e vendit” dhe flet për tema aktuale nga sistemi politik, ekonomik dhe arsimor i RM-së; i dyti (nën titullin “Arti i kompromisit”) është kronikë për aktivitetet rreth aprovimit të Kushtetutës së Maqedonisë në përputhje me Marrëveshjen Kornizë, kontribut ky që vazhdon edhe në numrat e ardhshëm të revistës; i treti (nën titullin “Ndërprerje e mësimit”) flet për helmimin e nxënësve të Kumanovës; i katërti, më i gjatë, nën titullin “Viti 2002 në Lobi” është kronologji (me citate) e ngjarjeve me peshë gjatë vitit që shkoi, të shkëputura nga çdo numër i revistës në fjalë.

3. Struktura e aktorëve në kontributet e analizuar. Kur bëhet fjalë për strukturën e aktorëve, duhet të themi se përsëritet një pjesë e mirë e të dhënave të shfaqura në analizën e kaluar. Pra, dominimi i aktorëve individualë vendës paraqet një konstantë te mediumet e përzgjedhjes sonë. Në mesin e tyre i hasim më shpesh dy kategori: zyrtarët shtetërorë në nivel nacional dhe eksperët/intelektualët (të parët janë aktorë të preferuar përmes të cilëve përpunohen temat në pjesën më të madhe të meidumeve të shtypit). Prej këtij rregulli të pashkruar këtë herë kanë hequr dorë Dnevnik-u, në të cilin është ranguar mjaft lart kategoria “organizata dhe institucione të tjera” dhe Fakti, në të cilin politikanët janë ranguar në vendin e dytë, menjëherë pas zyrtarëve të lartë shtetërorë në nivel nacional. Kapital-i si zakonisht, i preferon më shumë ekspertët sesa zyrtarët shtetërorë. Këtij mediumi i bashkohet edhe Vest-i. Dallimi i dytë që shënohet te gazetat/revistat është fakti se në përpunimin e temave disa prej tyre inkuadrojnë shumë aktorë (p.sh. Utrinski, Dnevnik, Kapital, Lobi, Fakti), kurse disa të tjërë fare pak (Vest, Veçer, Flaka).

Sa i përket mënyrës së paraqitjes së aktorëve, mediumet edhe për këtë çështje kanë praktikë të ndryshme. Por, është për t'u shënuar fakti se në këto dallime ka një konstantë, gjegjësisht çdo medium ka trajtim të zakonshëm të prezantimit të aktorëve. Kështu, për shembull, për Dnevnik-un dhe Utrinski Vesnik-un mund ta përsërisim konstatimin e shprehur edhe në raportet e mëparshme: në të shumtën e rasteve ata flasin për aktorët në kontekst të temës. Kjo mund të ndërlidhet me faktin se te këto dy mediume është më i madh numri i kontributive me tema referente, që do të thotë se ato, me tëpër se mediumet e tjera, e shfrytëzojnë trajtimin interpretativ. Edhe te gazetat/revistat e tjera ky trajtim është i mirënjohur: p.sh. Flaka dhe Lobi e preferojnë parafrazimin, pastaj citimin. Kur bëhet fjalë për zyrtarët e lartë shtetërorë, Vest-i dhe Veçer-i, këtë herë, e shfrytëzojnë citimin dhe kontekstin, kurse Kapital-i më së shumti citon.

Kuptohet, gazetat/revistat, duke i prezantuar aktorët, flasin për personalitetë konkrete, për organizata/institucione duke u dhënë atyre një status të caktuar shoqëror. Në ç'mënyrë e bëjnë këtë mediumet e përzgjedhjes sonë?

Dnevnik – Hapësirë më e madhe është ndarë për Qeverinë e RM-së, kurse më shumë i cituar është Ali Ahmeti.

aktorë më të përfaqësuar	hapësirë e përgjithshme për tekstet e analizuara		hapësirë e përgjithshme për citatet direkte të aktorit	
	në cm ²	%	në cm ²	%
1. Qeveria e RM-së	3677	12.0	24	0.6
2. VMRO-DPMNE	2909	9.5	46	1.6
3. Boris Trajkovski	2666	8.7	54	2.0
4. Ali Ahmeti	2340	7.7	59	2.5
5. BDI	2072	6.8	00	0,0

Shënim: % për kontributet në të cilat aktori është prezant është llogaritur në raport me hapësirën e përgjithshme të teksteve të analizuara, kurse % për citatet direkte, në raport me hapësirën e kontributeve në të cilat aktori është prezant.

Utrinski Vesnik – Qeveria e RM-së është më prezante në tekstet e kësaj gazete, kurse më i cituar është kryetari Boris Trajkovski.

aktorë më të përfaqësuar	hapësirë e përgjithshme për tekstet e analizuara	hapësirë e përgjithshme për citate direkte të aktorit		
	në cm ²	%	në cm ²	%
1. Qeveria e RM-së	12 188	32.2	23	0.2
2. VMRO-DPMNE	9589	25.4	00	0,0
3. Boris Trajkovski	4314	11.4	824	19.1
4. Ali Ahmeti	3625	9.6	151	4.2
5. Ljubço Georgievski	3369	8.9	35	1.0

Veçer – Kryetari i shtetit është më i përfaqësuari, kurse më i cituar është ministri i mbrojtjes, Buçkovski.

aktorë më të përfaqësuar	hapësirë e përgjithshme për tekstet e analizuara	hapësirë e përgjithshme për citatet direkte të aktorit		
	në cm ²	%	në cm ²	%
1. Boris Trajkovski	2861	12.4	153	5.3
2. Ilinka Mitreva	1398	6.1	103	7.4
3. Branko Cërvenkovski	909	3.9	74	8.1
4. Vllado Buçkovski	866	3.8	104	24.9

Vest – Aktor më i përfaqësuar është Vojo Mihajlovski, kurse më i cituar është Boris Trajkovski.

aktorë më të përfaqësuar	hapësirë e përgjithshme për tekstet e analizuara	hapësirë e përgjithshme për citatet direkte të aktorit		
	në cm ²	%	në cm ²	%

1. Vojo Mihailovski	1651	6.9	00	0,0
2. Nikolla Popovski	1234	5.2	00	0,0
3. Boris Trajkovski	1041	4.4	51	4.9

Flaka – Lideri i BDI-së, Ali Ahmeti, është aktori më i përfaqësuar në këtë gazetë, kurse më i cituar është Rexhep Selmani.

aktorë më të përfaqësuar	hapësirë e përgjithshme për tekstet e analizuara		hapësirë e përgjithshme për citatet direkte të aktorit	
	në cm ²	%	në cm ²	%
1. Ali Ahmeti	2057	12.9	131	6.6
2. Boris Trajkovski	1445	9.8	49	3.4
3. Rexhep Selmani	730	4.6	119	16.3
4. Branko Cërvenkovski	716	4.5	92	12.8

Fakti – Hapësirë dominante i është dhënë MPB-së dhe policisë, kurse më i cituar është kryetari Boris Trajkovski.

aktorë më të përfaqësuar	hapësirë e përgjithshme për tekstet e analizuara		hapësirë e përgjithshme për citate direkte të aktorit	
	në cm ²	%	në cm ²	%
1. MPB dhe policia	6041	20.0	27	0.4
2. BDI	5889	19.5	00	0.0
3. Boris Trajkovski	5453	18.0	372	6.8
4. shqiptarët	4755	15.7	00	0,0
5. Ali Ahmeti	4438	14.7	59	1.3

Kapital – Në faqet e kësaj javoreje më prezente është Qeveria e RM-së, kurse më i cituar është ministri i punës dhe politikës sociale.

aktorë më të përfaqësuar	hapësirë e përgjithshme për tekstet e analizuara		hapësirë e përgjithshme për citatet direkte të aktorit	
	në cm ²	%	në cm ²	%
1. Qeveria e RM-së	2720	6.2	10	0.4

2. Jovan Manasievski	1775	4.0	658	37.1
3. Kris Paten	1603	3.7	52	3.2
4. Mihail Petkovski	1272	2.9	194	15.3
5. Sasho Gruevski	1233	2.8	134	10.9

Lobi – Më i përfaqësuar është Ali Ahmeti, kurse më i cituar është Ramiz Abdyli.

aktorë më të përfaqësuar	hapësirë e përgjithshme për tekstet e analizuara		hapësirë e përgjithshme për citatet direkte të aktorit	
	në cm ²	%	në cm ²	%
1. Ali Ahmeti	10 208	19.6	1235	12.1
2. Boris Trajkovski	4 683	9.0	102	2.2
3. Branko Cërvenkovski	2967	5.7	115	3.9
4. Ramiz Abdyli	2637	5.1	483	18.3
5. Agron Buxhaku	2676	5.1	145	5.4

Analiza e të dhënave në lidhje me vlerësimin e aktorëve dominantë na jep të drejtë ta përsërisim konstatimin e raporteve të mëparshme, d.m.th. gazetat/revistat, në vlerësim janë më tepër neutrale. E megjithatë, ndërmjet tyre ka disa dallime. Një pjesë e mediumeve të shtypit (Kapital, Vest dhe Veçer) i përbahen këtij neutraliteti në të gjitha rastet, kurse te të tjerat shënohet shkallë e ndryshme e kritikës. Në këtë kontekst duhet theksuar se largimi nga pozicioni neutral ka kuptimin e vlerësimit negativ. Domethënë, gazetat më lehtë marrin vendim për të klritikuar sesa për të “lavdëruar”. Vlerësimet e rralla pozitive këtë herë janë ndarë në këtë mënyrë: Lobi, Flaka dhe Fakti kanë dhënë nga një vlerësim pozitiv për Boris Trajkovskin, Flaka në një shkrim është shprehur pozitivisht edhe për Rexhep Selmanin, kurse Dnevnik-u për BDI-në.

Në vazhdim do të mundohemi ta ilustrojmë vlerësimin e aktorëve në mënyrë më konkrete, me çka do të

shihen edhe specifikat e mediumeve të ndryshme të shtypit. Si edhe deri tanë, Dnevnik-u dhe Utrinski Vesnik ofrojnë material më të begatshëm për analizë kur bëhet fjalë për vlerësimin e aktorëve në kontributet e tyre.

Në **Dnevnik** edhe këtë herë dominojnë vlerësimet negative. Më tepër është kritikuar pushteti i deritanishëm, para së gjithash për shkak të “paaftësisë dhe korruptimit”. Me këtë aspekt të analizës vërehet fakti se ngjarje politike qendrore në dhjetor ka qenë zbulimi i korruptimit të garniturës së vjetër politike. Ndërkohë, si aktorët kryesorë janë ata kolektivë (“pushteti i vjetër”, koalicioni VMRO-DPMNE dhe PDSH-ja etj.) dhe individualë (bartës të deritanishëm të funksioneve të larta shtetërore, por edhe përfaqësues më të ulët të pushtetit, nëpër komuna, ndërrmarrje publike etj.). Lidhur me faktin se kush i jep vlerësimet vërehet një laramani: Vlerësimet i jepin përfaqësuesit e pushtetit të ri, eksperët/intelektualët të cilët paraqiten rregullisht me sugjerime të veta në gazetë, si edhe politikanët e tjerë, e në masë më të vogël edhe gazetarët.

Sa për VMRO-DPMNE-në, numri më i madh i kritikave vijnë nga personalitetet e tjera publike. Kështu, p.sh., lideri i një partie jashtëparlamentare e cilëson koalicionin që ka sunduar deri më vitin 2002 si totalisht të kriminalizuar duke pohuar se partnerët në të “i kanë ndarë sferat e ndikimit në të gjitha lëmenjtë, po edhe në biznes dhe në kriminalitet”. Shumë autorë flasin për “privatizimin e kriminalizuar”, të realizuar në periudhën e sundimit të këtij koalicioni. Njëri prej kolumnistëve, i ka kualifikuar bartësit e pushtetit të vjetër “të marrë dhe grykës”. Disa prej kritikave të tij janë direkte dhe diskualifikuese: “...si të pëgërat e fundit të një ish ministri për punë të brendshme, i cili i shfrytëzon kanalet e veta të vjetra dhe aktuale për kontrabandë me armë, cigare dhe

narkotikë nga Kroacia dhe Bosnja, porosit njerëz për të bërë likuidime dhe rrëmujë në Maqedoni". Kritikave drejtar pushtetit të deritanishëm u bashkohet edhe Peko-ja i popullarizuar, heroi kryesor i stripit me emër të njëjtë. Sa u përket gazetarëve si autorë, ata janë më të përbajtuar në kualifikimet, por si edhe në mediumet e tjera, në këtë periudhë janë publikuar emrat e funksionarëve ta akuzuar nga pushteti i vjetër, duke mos e respektuar prezumcionin e pafajësisë. Në veçanti, të drejtpërdrejtë në vlerësimet e veta negative janë sidomos përfaqësuesit/funksionarët e pushtetit të ri. Kështu, p.sh. për një nga institucionet kryesore të shtetit do të thuhet: "Dogana maqedonase është e korruptuar, tërësisht e pa-organizuar, në të mbretërojnë kriminaliteti, reketi dhe anarkia". Përefaqësuesit e VMRO-DPMNE-së "e kthejnë grushtin", duke përkujtuar kriminalitetin e LSDM-së "se ka qenë një kriminalitet i rëndë me shuma milionëshe dhe se në atë periudhë është shkatërruar ekonomia e Maqedonisë". Kualifikimet e veta ish pushteti i saktëson duke u shprehur se "...pas kontrabandës së duhanit, qëndronin magnatët e Makedonija Tabak-ut" ose që "kjo bankë (bëhet fjalë për Stopanska Bankën) ka qenë shembull i kriminalitetit më të madh që ndonjëherë është bërë në Maqedoni". Kritikat janë drejtar sidomos për koalicionin me BDI-në, kryetar i së cilës është Ali Ahmeti, si pas tyre "një kriminel, gjakatar, vrasës" ose, në stilin e njëjtë "qëllimi kryesor i këtij konkursi është që në polici-në maqedonase të pranohet numër sa më i madh i UÇK-së kriminale", "qeveria e LSDM-së dhe UÇK-së e zvogëlon me qëllim fuqinë mbrojtëse të Maqedonisë me dobësim konkret të forcës së ARM-së dhe MPB-së". Për përefaqësuesit e VMRO-DPMNE-së, koalicioni i ri zbaton "torturë komunisto-balliste", duke lënë të kuptohej, para së gjithash, burgosjen e një numri të madh aktivis-

tësh dhe funksionarësh të kësaj partie, të cilët janë akuzuar për korruption. Nga ana tjetër koalicioni i ri politik është kritikuar për antishqiptarizëm nga ana e një përfaqësuesi të PPD-së: "...në asnjë nuancë nuk dallohen nga qëndrimi racist dhe neofashist lidhur me marrëdhëniet ndëretnike..." Ndoshta vlerësimi i vetëm pozitiv është dhënë nga një politikan shqiptar dhe ka të bëjë me BDI-në ("forcat progresive të BDI-së").

Utrinski Vesnik – edhe më tej numërohet ndër gazetat që në kontributet e veta jepin më tepër vlerësimë të drejtpërdrejta dhe diskualifikuese për një pjesë të aktorëve. Ndryshe nga Dnevnik-u, në këtë gazetë shumë më shpesh paraqiten si autorë vetë gazetarët. Siç mund të pritej, subjekt themelor i kritikës është VMRO-DPMNE-ja, pra pushteti i vjetër "ajo qasje veshtullore, retrograde dhe qaramane nuk ka kundërpikë adekuate të rëndesës..." "Të arrestuarit janë fundi i perit të mbështjellë... të regjimit që iku nga pushteti më 15 shtator". Ose, "është dashur të lahen shuma prej miliona eurosh me prejardhje spekuluese të partisë që ishte në pushtet". Duke folur për njérin nga funksionarët e lartë të partisë së zënë ngoje, gazetari do të konstatojë: "...duke e kryer detyrën partiake e me qëllim që të jepte një pasqyrë të rrëme të Maqedonisë si një zëndan anadollak në të cilën qëndron VMRO-DPMNE, ai kapërcente probleme serioze psikologjike". Organizata humanitare, që udhëhiqej nga gruaja e ish-kryeministrat, është kualifikuar si "reket-organizatë përmes së cilës pushtetarët lokalë, dëshironin të bëheshin, në saje të donacioneve, të afërt me pushtetin". Gazetarët i hyjnë me shumë "guxim" edhe çështjes së disa bizneseve, sipas tyre, "të ndyta". Ja si e vlerësojnë ata blerësin slloven të NGB "Nova Makedonija": "Mediatori në tërë lojën e fëlliqur dhe i ashtuqujaturi blerës", "...ka përvojë të fortë të bankrotimit të firmave të suk-

sesshme në Slloveni përmes borxhit të krediteve”, “Si mendojnë ta bëjnë legale këtë punë kriminale dhe deri në ç’shkallë mund të humbet profesionaliteti dhe etika?” Nga ana tjetër, sjelljen e Qeverisë së re ndaj tij, po ai blerës e cilëson si “metodë të së drejtës bolshevike-anarkiste dhe dhunim të pronës private”. Gazetarët akuzojnë edhe funksionarë konkretë të pushtetit të vjetër: “E ka keqpërdorur funksionin, aksionet e punëtorëve i ka blerë me forcë dhe shantazh, me çka ka fituar shuma të mëdha të parave...”, “Prej tij janë nisur konvoje maunash me cigare të kontrabanduara. Shumë doganierë janë larguar nga vendi i punës për shkak të sinjalizimit... truprojet e tij kanë marrë instruksione për heshtjen e Llazavit...; “...kanë fituar banesa në Ohër duke i kontribuar privatizimit jolegal... Gjykata e Manastirit ka qenë nën presion të madh të Arnaudovit dhe Gjorçevit...”

VMRO-DPMNE-ja është kritkuar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë edhe nga ana e autorëve të tjerë, por, siç duket, kualifikimet më të ashpra i japin gazetarët. Në një letër të lexuesve kjo parti është vlerësuar kështu: “Të formohet Partia revolucionare në fund të shekullit XX... kjo me të vërtetë është anakronizëm, është fenomen që kërkon shpjegim. Programi i kësaj partie anakrone, praktika e saj politike dhe ekonomike (grabitje e paskrupullt e pronës popullore...) është demaskuar përfundimisht”. Duke aluduar në korruptimin e doganës, një funksionar i saj thotë për këtë institucion: “Në vend që ta denonconin kontrabandën, ata kanë qenë koordinuesit kryesorë të gjithë asaj kontrabande, ua kanë hapur rrugën kaminonëve mbushur buzë më buzë”.

Vlerësimet për pushtetin e ri janë dhënë kryesisht nga politikanët e koalicionit të VMRO-DPMNE-së: “Pushtet komunisto-ballist... ose “qëllimi i tyre ka qenë

shndërrimi i terroristëve në funksionarë shtetërorë... tezë populiste për pushtetin. Qeveria ka shkaktuar kaos të plotë, i ka dhënë grusht të rëndë ekonomisë... të mos merret me gjuajtjen e shtrigave..." Ose: "Për sa ka treguar në 102 ditët e para, qeveria e Cërvenkovskit, s'meriton veçse njësh. Në vend të programit, Cërvenkovski na jep ujë me shoshë duke na treguar "pjesëtarë të vdekur të VMRO-së, madje të eshalloneve më të ulëta".

Autorë të kritikave ndaj BDI-së janë politikanët e opozitës: "...kriminel lufte, terrorist ndërkombëtar dhe armik numër një i shtetit... terrorist ballkanas... ngjarja e tmerrshme që ndodhi më 19 nëntor..." (bëhet fjalë për hyrjen e Ahmetit në Parlament); ose, me stil të ngjashëm: "...gjithmonë do të mbetet gjakatar i popullit maqedonas, kriminel, gjakatar ballkanas dhe vrasës... Kjo paraqet nënçmim për popullin maqedonas, shkelje të gjakut të luftëtarëve të rënë. Edhe një krim po ndodh në Parlament". Diskualifikim të Ahmetit hasim edhe në reportin e Institutit për Paqe të Uashingtonit: "Në mënyrë të tillë perverse prej liderit të guerilës së armatosur u bë simbol i demokracisë dhe i nderit mes shqiptarëve në Maqedoni".

Në disa tekste kritikohet edhe bashkësia ndërkombëtare, "politika perfide dhe arrogante... e cila në emër të demokracisë dhe të të drejtave të njeriut i mohon një populli gjënë më të shenjtë-dinjitetin kombëtar". Lideri i VMRO-DPMNE-së e akuzon bashkësinë ndërkombëtare me pretekstin se nën presionin e saj qeveria e tij nuk ka mundur t'i rishikojë privatizimet e dyshimta.

Në **Veçer**, aktor "qendror" për të cilin jepen vlerësimë negative janë "terroristët shqiptarë". Autorë të këtyre vlerësimëve janë kryesisht politikanët e opozitës, të cilët publikut i sinjalizojnë se ata terroristë tanë janë pjesë e koalicionit pushtetmbajtës: "Krimineli i luftës, gjakatari

ballkanas dhe vrasësi Ali Ahmeti është në parlamentin maqedonas”. Ose “... aksione terroriste të monstrumëve që sot ulen në BDI dhe në PPDSH-PDP”. Në deklaratën e VMRO-DPMNE-së me rastin e shpërthimit të një bombe dhe të vrasjes së një shefi në burgun e Tetovës thuhet: “Jemi të tmerruar nga këto ngjarje që gjoja nuk janë të ndërlidhura, por që të dyjat kanë qëllim të njëjtë: “pastrimi etnik dhe terrori mbi maqedonasit e Tetovës dhe të Manastirit... që duhet të hyjnë në përbërjen e Shqipërisë së Madhe”. Dhe më në fund, fjala e drejtpërdrejtë e një intelektuali, drejtar kryetarit të Kuvendit: “Para se ta zgjidhni terroristin e amnistuar dhe UÇK-istin Hysni Shaqiri për nënkyetar të Kuvendit të RM-së, propozoj që të kërkonit nga të gjithë deputetët... vërtetim mjekësor, i cili... ka shkuar në bandat kaçake terroriste dhe ka komanduar kriminelë profesionistë dhe vrasës që u sollën vdekjen pjesëtarëve të ARM-së dhe MPB-së”. Në **Flaka** sjelljen e këshilltarëve në këshillin komunal të Tetovës gazetari e komenton: “...reagimet janë shumë perfide dhe në esencë bëhet fjalë për nacional-shovenizmin maqedonas”. **Vest** e përcjell parashikimin e VMRO-DPMNE-së se “terroristët shqiptarë përgatitin sulme në Kumanovë, Shkup, Kërçovë dhe Strugë, e më vonë edhe në Manastir, Prilep dhe Veles”.

4. Burimet e informatave: Edhe kësaj radhe, përfundimi i përgjithshëm që mund të nxirret në lidhje me këtë variabël është i njëjtë me atë të raporteve të mëparshme: Te të gjitha gazetat/revistarë përqindja më e madhe e informatave vijnë prej burimeve të sakta, por edhe burimet të paqarta/të pasakta janë praktikë e përhapur te shumica e tyre. Sa i përket gazetarit si burim informatash, prezanca e tij nëpër gazetat/revistarë është më tepër se simbolike (ose fare nuk ekziston si burim). Vëmendje të veçantë meriton numri i madh i kontributeve pa buri-

me të theksuara, me përjashtim të dy gazetave ditore, gjë që, nga prizmi i qëndrimit profesional të mediumit dhe i parimit të gazetarisë së përgjegjshme, është një dukuri brengosëse.

Tabela 2. Burimet e informatave sipas llojit

gazeta/revista	të paqarta/të pasakta		të sakta		gazetari nga vendngjarja		burimet nuk janë theksuar	
	N	%	N	%	N	%	N	%
Dnevnik	42	26.1	121	75.2	-	-	27	16.8
Utrinski vesnik	40	30.8	109	83.8	3	2.3	1	0.8
Veçer	22	19.8	82	73.9	-	-	7	6.3
Vest	22	20.6	73	68.2	2	1.9	10	9.3
Flaka	2	3.4	47	79.7	-	-	11	18.6
Fakti	14	12.5	67	59.8	-	-	31	27.7
Kapital	35	34.7	60	59.4	-	-	29	28.7
Lobi	3	3.4	69	79.3	-	-	16	18.4

Shënim: Përqindja e përgjithshme e të dhënare të arritura është më e madhe se 100 % për arsy se disa kontributet kanë edhe burime të paqarta/të pasakta të informatave.

Kuptohet, mes gazetave/revistave ka dallime të rëndësishme. Specifikat janë këto: Utrinski ka numër më të madh burimesh të sakta dhe është i vetmi që nuk ka tekste pa burime të informatave. Por, ndërkohë, te kjo gazetë hasim numër të madh të burimeve që nuk janë mirë të definuara, praktikë që, pak a shumë, është e zakonshme për këtë medium. Numër më të vogël të burimeve të pasakta/të paqarta kanë Flaka, Lobi, e në këtë kategori mund të futet edhe Fakti, por te këto mediume hasim edhe përqindje të lartë të teksteve në të cilat burimet e informatave nuk janë theksuar fare. Vest-i dhe Veçer-i kanë qëndrim të njëjtë në lidhje me burimet e informatave. Te këto gazeta janë më të pakta rastet e mos-

theksimit të burimeve, por kanë qëndrim relativisht të njëjtë ndaj llojeve të tjera të burimeve.

Duke e hulumtuar relacionin ndërmjet temës dhe llojit të burimeve kemi arritur në konstatimin e njëjtë me të muajit të kaluar. Numrin më të madh të burimeve “të padefinuara” e hasim te temat dominante ose te disa prej tyre. Nga kjo mund të gjykojmë se mediumet edhe kur nuk mund të gjejnë burime “cilësore” të lajmeve promovjnë ngjarje të cilat i vlerësojnë si të rëndësishme për opinionin. Animi nga burimet e pasakta, e disa herë edhe mospërmendja e burimeve, mund të jetë rezultat i detyrimit, i situatës objektive, por mund të jetë edhe burim i manipulimeve. Hulumtimi nuk jep përgjigje ku qëndrojnë arsyet e këtyre veprimeve. Sidoqoftë, shfrytëzimi i shpeshtë i burimeve të cilat nuk mund të identifikohen nuk shkon në favor të infomimit objektiv dhe të plotë, respektivisht nuk shkon në favor të profesionalizmit gazetaresk. Nga ana tjetër, nëse rruga deri te burimet e informatave është një gjë objektivisht e rëndë, gazetat/revistat janë të vëna në pozitë të gjejnë vetë rrugëzgjidhje dhe të improvizojnë.

Në lidhje me **statusin e burimeve** të informatave, gazetat/revistat i shfrytëzojnë më tepër burimet vendëse të informatave, zyrtare dhe alternative. Edhe këtu ekzistonë specifika. Kështu, p.sh., Veçer-i dhe Vest-i mbështeten më pak në burimet ndërkombëtare, Kapital-i i parapëlqen burimet alternative dhe ndërkombëtare etj. Ngjarjet e mbështetura mbi shumë lloje informatash, në parim, janë përpunuar në mënyrë më cilësore dhe përkëtë arsyet themi se shfryrëzimi “i kombinuar” i shumë burimeve mund të kontribuojë për informim më të mirë. Kuptohet, për realizimin e këtij qëndrimi gazetari duhet të japë më tepër mund dhe të tregojë kompetencë më të madhe për përpunimin e temës gjegjëse.

Aspekti i dytë i hulumtuar në lidhje me burimet e informatave ka të bëjë me karakterin e kontributeve dhe me shfrytëzimin e burimeve nga dy a më shumë anë për të ashtuquajturat çështje konfliktuoze.

Tabela 3. Karakteri i kontributit

gazeta/revista	kontribut i karakterit të konfliktit ndëretnik		kontribut i karakterit të interesit politik dhe konfliktuoz		kontributi nuk është i karakterit konfliktuoz	
	N	%	N	%	N	%
Dnevnik	3	1.9	88	54.7	70	43.5
Utrinski vesnik	13	10.0	113	86.9	4	3.1
Veçer	2	1.8	54	48.6	55	49.5
Vest	10	9.3	69	64.5	28	26.2
Flaka	10	16.9	14	23.7	35	59.3
Fakti	29	25.9	7	6.3	76	67.9
Kapital	1	1.0	-	-	100	99.0
Lobi	22	25.3	27	31.0	38	43.7

Sipas këtij variabli, gazetat/revistat mund t'i ndajmë në disa grupe. Nëse e veçojmë Kapital-in në të cilin të gjitha kontributet janë të karakterit jokonflikutoz, një grup mediumesh të shtypit tregon interesim më të madh përmarrëdhëniet ndëretnike të cilat për nga përkufizimi janë konfliktuoze (Fakti, Lobi dhe Flaka). Utrinski është i fokusuar në çështjet politike/të interesit të karakterit konfliktuoz, kurse te mediumet tjera numri më i madh i kontributeve janë ndarë ndërmjet atyre që nuk janë të karakterit konfliktuoz dhe atyre që i përkasin karakterit të konfliktit politik dhe atij të interesit.

Analiza e të dhënave na tregon se mbështetja e mediumeve në burime të njërsës anë është një praktikë mjaft e përhapur. Pa marrë parasysh faktin nëse bëhet fjalë përt tekste të karakterit ndëretnik a politik/të interesit, gaze-

tat/revistat shumë shpesh e informojnë publikun duke shfrytëzuar të dhëna vetëm nga njëra anë e konfliktit. Është e qartë se kjo nuk kontribuon për informimin e plotë dhe objektiv dhe nuk flet për profesionalizëm të lartë në gazetari. Pasojat shoqërore të një informimi të tillë, sidomos në një shoqëri që nuk është e integruar sa duhet, janë tjetër punë.

Tjetri në masmedia¹⁷

Në shoqërinë e kohës sonë, që cilësohet edhe si shoqëri e informacionit (*societe d'information*), mediumet luajnë një rol madhor në zhvillimin e jetës sociale. Ato ndikojnë te individi dhe te grupet e ndryshme shoqërore që të marrin këtë ose atë qëndrim lidhur me një fënumen të caktuar. Midis të tjera sh, ato janë përcaktuese edhe në krijimin e raporteve konstruktive apo të tensio-nuara dhe destruktive ndërmjet qytetarëve të një shoqërie apo banorëve të rruzullit tokësor në përgjithësi. Vrojtimet tregojnë se janë mediumet ato që luajtën rol vendimtar në keqësimin e marrëdhënieve ndërmjet etnive të ndryshme dhe në fillimin e konflikteve në trojet e ish-Jugosllavisë.

Njëri nga gurët e mozaikut medial është edhe pasqyra e tjetrit. Projekti ynë që parasheh monitorimin e gjashtë mjeteve të informimit në RM, ka për qëllim të nxjerrë në pah konceptin real të mediumeve të fokusua-ra lidhur me tjetrin në aspektin etnik, religjioz, gjuhësor dhe gjinor. Tani le të kalojmë në shtrimin e disa të dhë-nave relevante rrëth gazetës *Birlik* dhe rrëth qëndrimit të saj për “tjetrin”.

Birlik është botim në gjuhën turke me një traditë të gjatë (59 vjet). Kjo gazetë shtetërore del tri herë në javë

¹⁷ Raport nga monitorimi i gazetës *Birlik* në periudhën 26 maj-26 qershor 2003.

dhe ka gjithsej 16 faqe. Karakteri i saj është politik, informativ dhe kulturor.

Lexuesit, që nga ballina i bie në sy menjëherë përcaktimi “Gazetë e turqve të Maqedonisë”, që flet për një orientim kryesisht etnocentrik të botimit në fjalë, gjë kjo e provuar edhe nga observimi i 14 numrave të periudhës së përcaktuar për monitorim (26 maj-26 qershori 2003).

Analiza e përbajtjes që ka kapur zhanre të ndryshme gazetareske flet për një qëndrim të veçantë të kësaj gazete *vis-à-vis* ngjarjeve dhe dukurive në RM dhe më gjerë. Logosi gazetaresk sillet para së gjithash rrëth etnikumit, historisë, gjuhës dhe traditës turke (“të dashuruarit në gjuhën turke”, “kultura turke”, “bota turke”, “ushqimet turke”, “adetet turke”, “lektyrat në gjuhën turke”)¹⁸. Pra, epiqendër e shkrimeve është identiteti turk, madje mund të thuhet se Birlik-u është promotor i idesë panturkiste. Shqyrtimi i çështjeve të tjetrit është gjë që mund të gjendet tepër rrallë në agjendën e *Birlik*-ut, vetëm atëherë kur ai (tjetri) preket në kauzën turke. Mund të thuhet lirisht se shumë më tepër tregohet interesim për sukseset e turqve në botë dhe për çështjet aktuale të shtetit turk sesa për ndodhitë në Maqedoni.¹⁹

Gazetarët turq në mënyrë të tërthortë lënë të kuptosh se mundohen të qëndrojnë në distancë të njëjtë si me shqiptarët ashtu edhe me maqedonasit. Te opinioni turk kryesisht mbretëron paragjykimi se pjesëtarët e këtij kombi janë viktima e politikës së “tjetrit”, politikës së dy etnoseve më të mëdha të kësaj shoqërie. Si shembull

¹⁸ *Birlik*, 5 qershori, fq. 11; 10 qershori 2003, fq. 13.

¹⁹ Këtë e provon numri i madh i lajmeve dhe i shkrimeve lidhur me turqit anekënd botës, duke filluar nga Turqia, Azia e Mesme, ShBA-të, Gjermania etj. Si shembull mund të përmendim shkrimet rrëth marshimit të turqve në Berlin, rrëth sukseseve të shkencëtarëve turq në korniza botërore, rrëth problemit të Qipros, inkuadrimit të Turqisë në BE, botimit të kushtetutës së re BE-së në gjuhën turke etj.

mund ta cekim reagimin e nxënësve turq të shkollës fillore “Tefejjyz” pas mospranimit të portofolit të tyre në kuadër të projektit qytetar “Ne populli!” Në këtë kontekst ata shprehen se refuzimin do ta kishin pranuar sikur të vinte nga Vasko, Petko e Iliri (lexo: maqedonasi dhe shqiptari), por assesi s’mund ta kapërdijenë vendimin negativ për ta nga Aktani dhe Vefkiu (nga kompetentët turq). Janë sinjifikative edhe pohimet e dy deputetëve me përkatësi kombëtare turke se bashkësitë më të vogla etnike janë “qytetarë të rendit të dytë”, gjegjësisht se “janë bashkësi etnike të përjashtuara”, madje njëri prej tyre do të shprehet se ndihet si qytetar i rendit të tretë, se turqit duhet të presin edhe njëqind vjet për ta arritur 20 % të popullatës së përgjithshme. Një gazetar pohon se si pasojë e luftës së dy komuniteteve të mëdha, turqit gjithmonë dalin si humbës.²⁰ Ndërsa, në një shkrim tjetër thuhet se në këtë vend praktika flet se çdo gjë është duke u ndarë midis maqedonasve dhe shqiptarëve.²¹ Qëndrimin për marginalizimin e bashkësive të vogla etnike e mbështesin edhe me fjalët e deputetit të Partisë Demokratike të Romëve (“Unë në këtë kuvend dhe në këtë shtet ndihem vetëm si dekor”).²²

Kohë pas kohe hasim edhe në ndjenja pozitive dhe negative ndaj tjetrit. Gazeta e zënë ngoje i çmon urimet që kanë ardhur nga kolegët gazetarë maqedonas për fitoren e Turqisë në Eurosong, por është mjaft e “hidhëruar” me moszgjedhjen e gazetarëve turq dhe shqiptarë për të marrë pjesë në ndeshjen e gazetarëve të sportit të Maqedonisë me kampionin shtetëror në futboll për femra, Lombardini. Fjalia në vijim më së miri e shpreh këtë tablo: “Zgjedhësi Toni Çupovski ka harruar se ekziston

²⁰ *Po aty*, 24 qershor 2003, fq. 2, 3 qershor 2003, fq. 10.

²¹ *Po aty*, 14 qershor 2003, fq. 3.

²² *Po aty*, 21 qershor 2003, fq. 2.

Birlik-u dhe *Flakd'*.²³ Në këtë gazetë do ta gjejmë edhe gjykimin se veten maqedonasit ende e konsiderojnë si pronar dhe padron, kurse tjetrin si qiraxhi.²⁴

Turqit e vendit tonë kanë paragjykime edhe ndaj shqiptarëve. Thonë se Marrëveshjen Kornizë shqiptarët e kanë prerë e qepur sipas aritmetikës së vet. Ata bile edhe shkakun e mosvazhdimit të kontratës së tre punëtorëve të sportit në një klub shqiptar e gjejnë në përkatësinë etnike turke.²⁵

Kur jemi te faktori gjuhë, vërejmë identitetin e ndarë të turqishtes së sotme dhe inferioritetin e versionit të kësaj gjuhe që flitet në vendin tonë: ambasada turke shpall konkurs përbursa të studimeve postdiplomike në Turqi dhe kërkon përkthim të dokumenteve në “turqish-ten e Turqisë”. Gjuha e tjetrit (maqedonishtja), shihet si problem për nxënësit e shkollave të mesme.²⁶ Në faqet e kësaj gazete shihet synimi që turqishtja të jetë gjuhë zyrtare. Në të e hasim edhe sentencën me mesazh linguocentrist: “... që problemeve tona do t'ju përgjigjen turqisht”. Gjuha të cilën Ernest Renani e quan një nga faktorët themelorë të çdo kombi paraqitet edhe si objekt i apologjisë kundrejt shtëpisë televizive shtetërore (MTV) dhe programit në gjuhën shqipe të kësaj shtëpie. Bëhet fjalë për ditën (11 qershor), kur për shkak të transmetimit të drejtpërdrejtë të seancës së parlamentit me përkthim në gjuhën shqipe, u shkurtua programi në gjuhën turke prej dy orë e gjysmë në një orë. Lidhur me këtë rast gazeta përcjell reagimin e ashpër të Partisë së Lëvizjes Turke e cila në kumtesën e saj do të theksojë se res-

²³ *Po aty*, 5 qershor, fq. 15.

²⁴ *Po aty*, 17 qershor 2003, fq. 3.

²⁵ Rasti i trajnerit dhe dy lojtarëve turq në KF Bashkimi të Kumanovës. (*Po aty*, 26 qershor 2003, fq. 15.)

²⁶ Shih: *Po aty*, 3 qershor 2003, fq. 11.

triksioni arbitrar cenon të drejtën për të marrë lajme në gjuhën amtare dhe lëndon krenarinë kombëtare, është shkelje e të drejtave dhe lirive të tjetrit për t'i siguruar të drejtat e veta demokratike.²⁷ Gazeta turke e mbështet ekspansionizmin gjuhësor të turqishtes në një fshat të Shkupit të banuar me shqiptarë: i gëzohet dukurisë së mësimit të turqishtes nga fëmijët shqiptarë (Besimi dhe Agimi) përmes kanaleve satelitore.

Birlik me këmbëngulje mbron vlerat shpirtërore të turqve dhe të muslimanëve të RM-së, denoncon sulmet ndaj trashëgimisë osmano-turke dhe i cilëson ato si barebare. Me indinjatë të thellë ai e përmend shndërrimin e Imaret Xhamisë në kishë, shtron dilema lidhur me kryqin e mileniumit, rrënimin e xhamisë së Plaoshnicës, shkatërrimin e mihrabit të Urës së Gurit, e shfaq padrejtësinë e bërë nga pushteti ndaj xhamisë së Dyqanxhikut, e cila në planin urbanistik të qytetit figuron si park. Lagjen e Çairit e identifikon me elementin fetar (“lagja e Çairit në të cilën shumica janë muslimanë...”). Në këtë gazetë do të hasim edhe një rrëfim në vazhdime lidhur me pelegrinazhin (haxhin) e parë të muslimanëve.²⁸

Gazeta *Birlik* e trajton edhe çështjen e gruas. Kështu, ajo i jep publicitet veprimtarisë së shoqatave të grave turke (MATÜKAT dhe “Derya”), mundësisë që një grua, Kristin Krohn Devold, ministre e mbrojtjes e Norvegjisë, të jetë pasardhëse e Robertsonit në krye të NATO-s. Dy intervistat me semimaturante të shkollave fillore flasin për politikën pozitive ndaj gjinisë më të ndjeshme. Por ndërkohë, përmend edhe fakte të abuzimit të femrës anekënd kontinentit të vjetër, pra të shndërrimit të saj në objekt të tregtisë së seksit. Femra

²⁷ *Po aty*, 14 qershor 2003, fq. 3.

²⁸ *Po aty*, 29 maj 2003, fq. 9.

gjen vend edhe në reklamat që i hasim në faqet e kësaj gazete por jo si figurë kryesore.²⁹

Bashkëjetesa dhe multietniciteti janë koncepte që gaze-a turke i mbështet plotësisht. Në faqet e saj flitet për urën që i bashkon njerëzit, popujt dhe qytetërimet, i jepet hapësirë pjesës teatrore “Përralla të sokakut” në të cilën kanë marrë pjesë nxënës turq, shqiptarë dhe maqedonas, projektit “Të krijojmë siguri”, të udhëhequr nga një shoqatë turke dhe të mbështetur nga asocioacione të grave me përkatësi të ndryshme etnike, qëllimet e të cilit përshkruhen si vijon: theksimi i ngjashmërive, krijimi i raporteve pozitive me tjetrin, eliminimi i paragjykimeve dhe zbatimi i parimeve të tolerancës në kuadër të demokracisë, përmendet rasti i bashkëpunimit në treg ndërmjet një shqiptari dhe një maqedonasi që shesin pjeshka bashkë dhe të cilëve një myshteri u shtron pyetjen: “Mos vallë jeni duke e zbatuar Marrëveshjen e Ohrit?”³⁰

Mund të konstatojmë se kjo gazetë nuk shkon në skajshmëri në trajtimin e tjetrit, asnjëherë nuk përdor fjalë të ashpra për ta përshkruar etnosin tjeter. Hulumtimi ynë flet se *Birlik*-u më shumë merret me veten sesa me tjetrin, i referohet vetë etnosit turk (*self-referential*). Ky medium përveç se bën dallimin “turqit” dhe të tjerët, krijon edhe një paralele të tipit “shqiptarët dhe maqedonasit” dhe “komunitetet më të vogla etnike” (lidhur me të cilën e përmend shifrën 15 % të popullatës së përgjithshme të RM-së). Është interesante se në këtë gazetë në periudhën e ekzaminuar s’kemi hasur asnjë autor me përkatësi tjeter etnike.

²⁹ Tre reklamat e birrës.

³⁰ *Po aty*, 21 qershor 2003, fq. 11, 24 qershor 2003, fq. 2.

KREU I DYTË: Leksione

Shteti

Koncepti “shteti” (ang. *state*, fr. *état*, gjer. *staat*) ka kuptimin e një dukurie historike, ideje filozofike, forme të vazhdueshme dhe të organizuar të udhëheqjes së njerëzve ose konkretisht të një fenomeni bashkëkohor. Shteti është një dukuri shoqërore që luan rol të rëndësishëm në zhvillimin e historisë njerëzore; është një institucion i rëndësishëm shoqëroro-politik dhe paraqet një problem të trajtuar gjërësisht jo vetëm në fushën e sociologjisë, por edhe në shkencat e tjera, juridike, politike etj.³¹ Shteti është koncept aq me peshë në sociologji saqë një sociolog freng thotë se një disiplinë e tërë sociologjike merret me këtë tematikë. Bëhet fjalë për sociologjinë politike, të cilën ai e quan *statologie* (shkencë mbi shtetin).³²

Shteti paraqet organizatën më të madhe në shoqëritë bashkëkohore që i koordinon marrëdhëniet midis njerëzve; shteti merret thuajse me të gjitha gjërat, që nga lindja e deri në vdekje të njerëzve. Gjithë këtë veprimitari e kryen përmes qeverisë dhe administratës.³³ Shteti është një institucion i vetëm shoqëror që përmes mekanizmave të ndryshëm e siguron rendin dhe paqen. Këtë funksion e kryen përmes “së

³¹ Ali Dida, *Fillet e sociologjisë*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSA të Kosovës, Prishtinë, 1977, fq. 276.

³² Sulhi Dönmez, *Toplumbilim*, Beta Basım Yayın Dağıtım A.Ş., Stamboll, 1994, fq. 348.

³³ Dönmez, fq. 350.

drejtës legjitime për shfrytëzimin e forcës fizike” (Max Weber).³⁴ Mund të thuhet se shteti është institucioni i vetëm që e ka monopolin e përdorimit të dhunës.

Duhet theksuar se fjala shtet është mjaft e re, është zhvilluar në mënyrë graduale në term të përgjithshëm për trupin politik midis shekullit XIV dhe fundit të shekullit XVII.³⁵ Historiani frëng Ue Feler pohon se ky nacion ka lindur në shekullin XV dhe paraqet zbulim italian. Për herë të parë atë e ka përdorur politikani, teoriku i shquar italian N. Machiavelli, i cili kreun e parë të veprës së vet të njojur *Princi* e fillon me këto fjalë: “Tutti di stati...” (“Të gjitha shtetet...”). Zhvillimit të këtij nacioni i kanë kontribuar shumë edhe Lock, Montesquieu, Rousseau e të tjerë.³⁶ Termi në fjalë qysh në shtetin romak e ka pasur domethënien *rex publica* (çështje e popullit, çështje publike).

Sipas Magerit rrënjën ky term e ka te fjala *status* që është përdorur për shënimin e gjendjes, fuqisë, pozitës, të ardhurave dhe fisnikërisë së princit (*status regalis*) dhe për llojin ose strukturën e politikës.

Rreth konceptit shteti janë dhënë përkufizime të shumta të cilat shpeshherë janë diametrale nga njëri-tjetri. Le t'i përmendim disa prej tyre. Sipas Aristotelit, shteti është një mendim i përgjithshëm i shfaqur në trajtën e ndarjes së detyrave dhe bashkimit të mundit. Saint Simoni pohon se shteti është institucion i veçantë që i shërben shoqërisë. Lenini pohon se shteti është aparat force i klasës sunduese që shërben për ta mbajtur të nënshtruar klasën e shtypur.³⁷ Për Lester F. Ward-in shteti paraqet interaksion të fuqive të papajtueshme.³⁸

³⁴ Давид Милер, *Блеквелова енциклопедија на политичката мисла*, МИ-АН, Shkup, 2002, fq. 92.

³⁵ Милер, *роат*, fq. 109.

³⁶ Dida, *роат*.

³⁷ Милер, *роат*, fq. 109.

³⁸ Samuel Koenig, *Sosyoloji*, Ütopya Kitabevi Yayımları, përkth. S. Sucu – O. Aykaç, Stamboll, 2000, fq. 100.

Origjina e shtetit dhe teoritë e tij

Të gjesh rrënjet e institucioneve shoqërore është një punë shumë e rëndë. Por njeriu s'heq dorë nga kërkimi i gjenezës së gjërave dhe kështu shfaqen teza, teori të ndryshme lidhur me fenomenet e ndryshme.

Sipas disa sociologëve, shteti, si edhe institucionet tjera, ka lindur nga një organizim i thjeshtë dhe duke kaluar nëpër disa fazë ka arritur një nivel të lartë të zhvillimit. Sipas të dhënave të antropologjisë politike fenomeni i shtetit është paraqitur diku 3000 vjet p.e.r. në Mesopotami.³⁹ Por teoricienët bashkëkohorë, si Morgan, pohojnë se ky institucion, në fakt, ka lindur në periudhën e qytetërimit.

Sociologu dhe politologu anglez Walter Bagehot në veprën e tij *Fizika dhe politika* pohon se pushteti korrespondon me tri periudha: a) Periudha e dokeve dhe zakoneve – në të cilën s'ekziton fare qeverisja ose pushteti. b) Periudha e luftës ndërmjet grupeve, kur një grup ka arriutur ta nënshtrojë tjetrin – fazë e paraqitjes së bërthamës së shtetit. c) Periudha e polemikës, kur si rezultat i përplasjeve dhe kompromisit lind shteti dhe paraqet formën më të lartë të zhvillimit politik.

H. Spenceri në veprën e tij *Parimet e sociologjisë* shtron edhe ai një tezë të zhvillimit të historisë njerëzore, duke filluar me periudhën fisnore, kur grupet nuk kanë qenë të organizuara, kur kanë jetuar në formë të kopeve dhe kur s'ka ekzistuar kurrfarë pushteti. Si periudhë të dytë ai e cek periudhën ushtarake, kur nënshtrohet një pjesë e shoqërisë, kur i hapet rruga organizmit shtetëror si pasojë e tubimit të njerëzve rrëth liderëve të fortë ose mbre-

³⁹ Ali Yaşar Sarıbay, *Siyasal Sosyoloji*, botimi i katërt, Der Yayınları, Stamboll, 1998, fq. 145.

tërve. Si periudhë e tretë, sipas tij, është periudha industriale, kur veprimtaria ekonomike ia zë vendin veprimtarisë militare. Sipas këtyre dy mendimtarëve shteti ka kaluar nëpër një periudhë të evolucionit dhe në fazën e fundit do të pasojë jetësimi i paqes dhe harmonisë.⁴⁰

Sipas *teorisë marksiste* dhe materializmit historik, në periudhën kaluese prej bashkësisë së parë njerëzore joklasore në formacionin e parë klasor janë paraqitur ato kushte ekonomike në të cilat për herë të parë shfaqet shteti. Sipas kësaj teze, kushti kryesor shoqëror-ekonomik që ka shpënë deri te lindja e shteti, është prona private dhe grumbullimi i pasurisë, gjëra këto që e kanë ndarë shoqërinë në klasa shfrytëzuese dhe të shfrytëzuar. Engelsi në bazë të hulumtimeve të veta lidhur me shfaqjen e shteteve evropiane si ai athinas, romak, gjerman etj., ka ardhur në përfundim se shteti është rezultat i ndarjes së shoqërisë joklasore në klasa të kundërtta.⁴¹ Sipas kësaj teorie shteti është një dukuri kalimtare, që është i gjykuar të atrofojë në shoqërinë komuniste, kur do të zhduken klasat.⁴²

Ndër teoritë që e shqyrtojnë problemin e shtetit është edhe ajo e *kontratës shoqërore*, elementet e së cilës i hasim qysh te sofistët në botën antike greke. Kjo teori është zgjetuar, përhapur dhe është bërë dominante mes shekujve XVII-XVIII. Apologjet i kësaj teorie është Thomas Hobbes-i, i cili teorinë e vet mbi shtetin e ka elaboruar në veprën e tij të titulluar *Leviathan*. Sipas tij, zanafillës së shtetit i paraprin periudha e gjendjes natyrore, kur të gjithë njerëzit kanë qenë të barabartë. Ai thotë se shtetin e krijojnë njerëzit, të cilët ia bartin atij një pjesë të të drejtave të tyre natyrore ose të gjitha ato me që-

⁴⁰ Koenig, *po aty*, fq. 96.

⁴¹ Dida, *po aty*, fq. 279.

⁴² Милер, *po aty*, fq. 109-110.

llim që të shpëtojnë prej sundimit të pasioneve, luftës, frikës, skamjes, vëtmisë, barbarisë, mosdijes, egërsisë dhe të jetojnë në perandorinë e qetësisë, sigurisë, pasurisë, dijes, vullnetit të mirë etj. Këtë teori e ka zhvilluar edhe J. J. Rousseau. Sipas tij, shoqëria njerëzore është zhvilluar në vijën: gjendja natyrore (ku mbisundon barazia), gjendja e qytetarisë (në saje të zhvillimit të punës shfaqet mosbarazia) dhe gjendja shoqërore në të cilën njerëzit bëjnë marrëveshje shoqërore me vullnetin e tyre me qëllim të rregullimit të marrëdhënieve të veta në kushtet e pabarazisë. Koncepti themelor i Rousseau-së lidhur me shtetin është kontrata sociale (shih veprën e tij *Mbi konratën shoqërore*). Në shtetin që koncepton nga ky dijetar sundon vullneti i përgjithshëm i shumicës.⁴³

Teoria patriarkale si një ndër më të vjetrat, është përpjekur që origjinën e shtetit ta interpretojë me faktorë shoqërorë. Ajo niset nga pikëpamja se shteti është vetëm formë e zhvillimit të familjes dhe qeverisja me shtetin është dorë e zgjatur e qeverisjes së familjes në bashkësi të gjerë. Sipas Henry Sumner Maine, mbrojtës ky i përbetuar i kësaj teorie, që kishte studiuar shoqërinë antike, shteti ka lindur nga familja, sidomos nga ajo patriarkale, nga zhvillimi i privilegjeve të kryeparit të familjes.⁴⁴ Sipas kësaj teorie, shteti është vetëm një familje e zhvilluar në krye të së cilës gjendet sunduesi - sovrani.

Përfaqësuesit e *biologjizmit* në sociologji e interpretojnë shtetin si qenie të veçantë, si qenie e gjallë, si një superorganizëm. Ekzistimin dhe funksionet e shtetit ata i krahasojnë me qeniet e gjalla. Meqë organet në organizëm veprojnë në mënyrë organike, edhe në shtet duhet të sundojë një harmoni e grupeve të ndryshme shoqërore.

⁴³ Dida, *pë aty*, fq. 281.

⁴⁴ Koenig, *pë aty*, fq. 97.

Teoria idealiste, përfaqësues më i denjë i së cilës është Hegeli, e konsideron shtetin personifikim të arsyses së për gjithshme. Sipas Hegelit, shteti është shkalla më e lartë e zhvillimit të idesë absolute, “ecje e Perëndisë në sipërfaqen e tokës”,⁴⁵ kurse monarkia prusiane formë më e lartë e qeverisjes.⁴⁶ Kjo teori, e interpreton shfaqjen dhe esencën e shtetit duke i përshkruar origjinë hyjnore.

Teoria e fuqisë, e interpreton shtetin vetëm me kush-tin politik, me përdorimin e fuqisë, origjinën e tij nuk e shpjegon me faktorë të brendshëm por me faktorë të jashtëm. Përfaqësuesit e kësaj teorie janë Ibën Haldun-i, Machiavelli, Dühring-u, Kunov-i, Kaucki, Gumpowitz-i dhe Oppenheimer-i. Sipas kësaj teorie “shteti ka lindur mbi bazën e pushtimit të territoreve të ndryshme dhe nënshtrimit të popujve që e kanë humbur atë luftë”.⁴⁷

Tipologja, elementet kryesore dhe funksionet e shtetit

Secila periudhë e historisë së njerëzimit i ka pasur format e veta të shtetit. Në periudhën feudale si qeverisës me shtetin paraqiten feudalët të cilët kanë zotëruar toka të mëdha. Edhe pse shteti ka ekzistuar që në etapat e hershme të shoqërisë njerëzore, trajtësimi i tij konkret është bërë me lindjen e konceptit për shtetin nacional, erë kjo që ka filluar të ndihet që nga shekulli XVI. Fak-

⁴⁵ Po aty, fq. 102.

⁴⁶ Shih: Френсис Фукујама, *Крајот на историјата и последниот човек*, përkth. Драган Јакимовски, Култура, Shkup, 1994, fq. 106.

⁴⁷ Gjergj Rrapi, *Sociologja*, Institut i Filozofisë-Sociologjisë, Prishtinë, 2000, fq. 291.

torë kryesorë që kanë ndikuar në lindjen e shtetit modern janë reformacioni, zbulimet kontinentale, revolucioni tregtar dhe industrial, Revolucioni Amerikan dhe Francez, luftërat e Napoleonit etj.⁴⁸ Në periudhat e mëvonshme kanë lindur shteti kapitalist dhe ai socialist me rendin shoqëror përkatës.

Teoria konfliktuoze e mbështetur në ideologjinë komuniste jep një tipologji aksilogjike ku si kulm i tipave shtetërorë na paraqitet shteti socialist, domethënë ai komunist. Në këtë tipologji ku si bazë merret ndërrimi i klasave sunduese ose karakteri i strukturës ekonomike i sistemit klasor, e hasim shtetin skllavopronar, feudal, borgjez dhe socialist (komunist). Tre tipat e parë të shteteve kjo teori i konsideron eksplotues, kurse këtë të fundit (proletar, socialist) joeksploatues.⁴⁹

Shtetet shkencëtarët i kanë klasifikuar edhe sipas shumë kritereve tjera. Sipas formës së qeverisjes, i kanë ndarë në

- a) monarki, dhe
- b) republika

Sipas regjimit politik, në:

- a) demokraci përfaqësuese
- b) demokraci të drejtpërdrejtë
- c) oligarki dhe
- d) autokraci.

Sipas organizimit të pushtetit, në:

- a) shtete centraliste
- b) shtet decentraliste

Kurse sipas formës së sistemit shtetet ata i kanë ndarë në:

- a) shtete unitare,
- b) shtete federative, dhe

⁴⁸ Koenig, *pø aty*, fq. 103.

⁴⁹ Dida, *pø aty*, fq. 283.

c) shtete konfederative.

Elementet kryesore të shtetit janë territori, popullsia dhe sovraniteti. S'mund të quhet shtet asnjë organizëm që s'e ka njërin prej këtyre elementeve. Ashtu sikundër s'mund të ketë shtet pa hapësirë të caktuar gjeografike, s'mund të quhet shtet as ai që nuk është i përbërë nga një numër relativisht i madh njerëzish. Pretendimet e personave të cilët bëhen temë e lajmeve interesante të mediave duke shpallur vetveten shtet, paraqesin sarkazëm postmodern. S'mund të cilësohen shtete as vendet që shpallin pavarësi pa pasur sovranitet, pra pa mbizotërim të mirëfilltë të organeve shtetërore me hapësirën përkatëse. Një grup mendimtarësh pretendojnë se kusht i katërt për të qenë një shtet me të vërtetë shtet është njojja ndërkombëtare.

Si dje, ashtu edhe sot, detyra kryesore e shtetit është mbrojtja e rendit shoqëror. Në vendet ku ekzistojnë lëkundjet sociale dhe anarkia, qëllimi kryesor i shtetit është përpjekja për implementimin e paqes, rendit dhe stabilitetit. Për t'u realizuar këto qëllime duhet përdorur forcën, e drejtë kjo ekskluzive legitime e shtetit. Në vendet stabile shteti është mjet i kontrollit shoqëror.

Një funksion tjeter i shtetit është pengimi i monopoleve private, sigurimi i hapësirës për një konkurrencë të lirë⁵⁰ dhe të shëndoshë në bazë të parimit të ndërmarrjes ose iniciativës së lirë. Funksion cilësor me peshë të madhe është edhe organizimi i procesit edukativo-arsimor. Megjithëse penjtë kryesorë në këtë fushë është duke i mbajtur në duart e veta shteti, dita ditës shkohet drejt decentralizimit të arsimit dhe forcimit të institucioneve arsimore private. Madje, në shumë vende anekënd botës prestigj më të madh kanë institucionet arsimore private.

⁵⁰ Dönmezer, *po aty*, fq. 351-352.

Përmbyllje

Shteti është fenomen universal, thuajse i kapur pas shoqërisë. Ky fenomen, i quajtur nga disa “servis i elitës sunduese” (Vuçetiq) e nga disa të tjerë “e keqe e domos-doshme” (Novicow, Sumner), para së gjithash është një institucion ose organizatë politike, përfaqësues zyrtar i shoqërisë që i rregullon dhe i kryen punët e caktuara sociale. Ky institucion në të kaluarën ka qenë kreaturë e oligarkive shoqërore ose e individëve. Me formimin e shoqërive qytetare është forcuar prirja që shteti t'u përkasë të gjithë njerëzve që jetojnë në kuadër të një shoqërie. Është forcuar ndjenja e barazisë midis njerëzve dhe kështu ka dalë në skenë shteti liberal-demokratik, të cilin Fukuyama e quan majë të evolucionit të historisë njerëzore në aspekt të rregullimit shoqëror.⁵¹

Në kundërshtim me pretendimet e marksizmit – i cili në teori ishte antietatist, kurse në praktikë u tregua si ultraetatist – shteti po vazhdon të jetojë madje sot e kësaj dite po vazhdon procesi i formimit të shteteve të reja. Në kohën tonë në botë po përhapet tendeca e liberalizmit radikal sipas së cilës zona e aktivitetit të shtetit duhet të zvogëlohet në minimum.

Rolin e vet shteti do ta luante më së miri nëse parqitej sa më pak me fytyrën e përbindëshit hobbesian e më tepër si garantues i të drejtave individuale dhe kolektive të qytetarëve, si pasqyrues i vullnetit të popullit.

⁵¹ Shih: Fukujama, po aty.

Format e qeverisjes me shtetin

a. Sistemi parlamentar⁵²

1. Sistemi parlamentar anglez

Sistemi parlamentar anglez është sistemi më i hulumtuar dhe më i imituar i demokracisë borgjeze, i cili shumë rrallë kuptohet ashtu siç duhet dhe i cili, në formën e vet klasike, në fakt, ekziston vetëm në Britaninë e Madhe.

Konstituimi përfundimtar i këtij sistemi parlamentar ka filluar pas të ashtuquajturit “revolucioni i famshëm pa gjak” i vitit 1688. Parlamenti i kësaj periudhe nuk ka qenë bartës i kurrrfarë sovraniteti demokratik popullor, por armë politike e kufizimit të absolutizmit mbretëror, kompromis ndërmjet borgjezisë në rritje dhe fisnikërisë feudale, e cila edhe vetë kishte filluar të borgjezohet. Në atë kohë, mbreti ende ka qenë bartës sovran i pushtetit ekzekutiv dhe të drejtat e parlamentit shërbenin vetëm për t’ia kufizuar atij deri diku pushtetin. Meqë fuqia ekonomike e borgjezisë ishte në rritje, kuvendet e shtresave gjithnjë e më tepër shndërroheshin në vende të pazarllëqeve ndërmjet monarkut feudal, nga njëra anë dhe shtresave të ndryshme shoqërore dhe përfaqësuesve të bor-

⁵² Shkëputur prej Najdan Pašić, *Uporedni politički sistemi*, Beograd, 1976.

gjezisë, nga ana tjetër. Borgjezia po e përqendronte vazhdimisht pasurinë në duart e veta përmes tregtisë, përmes industrisë manufakturale në zgjerim e sipër, kurse monarku kishte gjithnjë e më tepër nevojë për mbajtjen e një ushtrie të pérhershme për zhvillimin e luftëraive. Mes këtyre dy faktorëve filloi një negocim politik dhe si kristalizim i këtij procesi dolën në pah institucionet e para parlamentare. Kështu, parlamenti lindi si produkt politik i një marrëveshjeje klasore.

Atëbotë, e drejtë themelore e parlamentit, përmes së cilës ai përpinqej ta mbante nën kontroll pushtetin absolut të deriasokohshëm të mbretit, ishte votimi i buxhetit. Monarku, për t'i sigruuar mjetet e nevojshme duhej t'i jepte llogari parlamentit lidhur me harxhimet publike dhe nga ai merrte aprovimin për taksat dhe të dhënat e tjera.

Raportin e dikurshëm ndërmjet mbretit dhe parlamentit e pasqyron në mënyrë ilustrative edhe institucioni tipik britanik i *spikerit*. Deputetët e dhomës së përfaqësuesve, për t'u mbrojtur nga hakmarrja e mbretit, mbanin mbledhje të mbyllura dhe me mbretin kontaktonin vetëm përmes një njeriu, pra përmes “spikerit” të tyre. Gjithë ajo që debatohej në kuadër të parlamentit duhej të mbetej e fshehtë për kurorën, me qëllim që deputetët të mos përndiqeshin nga mbreti për qëndrimet e tyre. Për këtë arsy, në ritualet e kuvendorit, në mënyrë simbolike ende shprehët parulla e vjetër se parlamenti pa spikerin e vet është memec. Procedura e zgjedhjes së spikerit bëhet vetëm përmes gjesteve dhe lëvizjeve, pa thënë asnjë fjalë. Kur deputetët, sipas një marrëveshjeje të mëparshme, tregonin me shenja spikerin e ardhshëm, i gjithë parlamenti, përmes tij, fitonte të drejtën e fjalës.

Sistemi parlamentar anglez ka përjetuar një proces të evoluimit dhe të reformave. Si më të rëndësishme janë

ato të vitit 1832, 1867, 1884 dhe 1918 (kur edhe gratë e kanë fituar barazinë politike). Të rëndësishme janë edhe reformat me të cilat i janë kufizuar të drejtat Dhomës së lordëve, dhomë kjo që sot e ka humbur pjesën më të madhe të domethënies dhe prestigjit që e ka pasur më parë. Kësisoj, në masë të dukshme është rritur vlera e Dhomës së komunave e cila zgjidhet në mënyrë demokratike.

Në fund, të drejtat që i kanë mbetur Dhomës së lordëve janë ngushtuar vetëm në mundësinë që ta ngadalësojë dhe përkohësisht ta prolongojë ndonjë vendim të Dhomës së komunave. Por, krahas kësaj tendencë demokratike, shfaqet pozicioni i *kabinetit* - si trup zgjedhës dhe bartës formal i sovranitetit - kundrejt parlamentit. Në këtë mënyrë u bë ndryshimi në ndarjen reale të pushtetit ndërmjet kuvendit dhe qeverisë në favor të kësaj të dytës.

Mekanizmi kushtetutues i demokracisë parlamentare në Britaninë e Madhe ka tri shtylla kryesore: froni, kabinetin dhe parlamentin. Kurora (mbretërore) dikur ka qenë bartëse e vërtetë e pushtetit ekzekutiv. I gjithë kreu shtetëror është konsideruar emanim i kurorës, dorë e zgjatur e saj. Në tërë udhëheqjen shtetërore ka qenë i përhapur parimi se mbreti nuk mund të bëj diçka të gabuar.

Sot froni mbretëror ka vetëm domethënie simbolike. Gjithçka bëhet në emër të mbretit, respektivisht të mbretëreshës, por pa vendimin e vërtetë të tyre. Lirisht mund të themi se mbretëresha sot është shef i shtetit, por nuk udhëheq me të. Të drejtat e saj sot janë reduktuar në atë që të jetë e konsultuar, të nxisë (të japë zemër) dhe të tërheqë vërejtje. Ajo formalisht e ka të drejtën ta emërojë qeverinë, por dihet se është e domosdoshme mandatin t'ia besojë shumicës parlamentare.

Pozita e dikurshme e monarkisë shihet edhe te një sërë institucionesh që ende ekzistojnë. Mbreti ka qenë bartës ekskluziv i pushtetit. Ai ka pasur trupin këshillues të cilin e ka emëruar vetë, të ashtuquajturin “këshilli privat i mbretit”, i cili përbëhej (edhe sot e këtë ditë përbëhet) prej përafërsisht 300 vetave që janë funksionarë të shqar, ministra, gjykatës të Gjykatës së lartë, përfaqësues të vendeve të Komonveltit, madje edhe funksionarë të rëndësishëm sindikalë. Nga ky këshill privat i mbretit ka lindur gradualisht organi në duart e të cilit sot përqendrohet pushteti real, pra *kabinet*, gjegjësisht qeveria.

Kabinetin, respektivisht qeverinë, e formon lideri i partisë më të fortë të parlamentit. Të gjitha emërimet në kuadër të qeverisë janë kompetencë e tij dhe ai për to vendos duke u këshilluar me parinë e partisë së vet. Kryetari i ardhshëm i qeverisë (kryeministri) i emëron 18 ministrat kryesorë që hyjnë në kabinet si një trup më i ngushtë, e më pastaj i emëron ministrat për të gjitha dikasteret dhe ndihmësministrat (“ministrat e rinj”). Kabinet takohet çdo javë, ndonjëherë edhe më shpesh në rezidencën e përhershme të kryeministrit. Ministrat janë përgjegjës të dyfishtë para parlamentit: si anëtarë të qeverisë dhe si shefa të dikastereve të ndryshme të qeverisë. Qeveria është krejtësisht e nënshtuar para parlamentit, sepse ajo mund të jetojë vetëm përderisa e ka besimin e parlamentit. Çdo disfatë e qeverisë në parlament do të thotë dorëheqje e saj, kurse dorëheqja e saj zakonisht e tërheq shpërndarjen e parlamentit.

Puna e parlamentit është e irregulluar dhe i është përshtatur mekanizmit të ekzistimit të dy partive (partia konservatore dhe laburiste). Me dallim nga shumica e parlamenteve të vendeve evropiane, ku kolltukët formojnë një gjysmërrreth, në parlamentin britanik deputetët e pozitës dhe të opozitës ulen karshi-karshi, kurse në mes

të sallës gjendet spikeri, si gjykatës i drejtë. Opozita në Britani nuk synon që ta prishë rendin: ajo edhe vetë është pjesë e këtij rendi dhe punon në mënyrë që në çdo moment mund ta formojë qeverinë e re. Përveç kabinetit të qeverisë, ekziston edhe faktori që quhet “kabineti në hije”. Opozita qeveritare është e organizuar si qeveria dhe shefi i opozitës, në fakt, luan rolin e kryeministrat në hije.

Për funksionimin e parlamentit britanez është karakteristike se edhe njëra edhe ana tjetër anë e Dhomës së komunave, edhe pala qeveritare edhe ajo opozitare, janë mirë të organizuara. Të dy palët mbajnë mbledhje të veçanta në të cilat e përcaktojnë takтикën e vet parlamentare, ua jepin detyrat deputetëve lidhur me paraqitjet në kuvend, paraprakisht marrin qëndrime rrëth çështjeve për të cilat do të diskutohet, kështu që funksionimi i parlamentit i përngjan një pjese teatrore me regjistri të mirë. Ndryshe nga e kaluara, kur ka ngjarë që qeveria të mbetet në pakicë dhe të jetë e detyruar të tërhoqet, pra të japë dorëheqje ose ta pranojë qëndrimin e parlamentit, sot situata të tilla nuk mund të paramendohen, sepse deputetët janë të detyruar të votojnë për qëndrimin e caktuar të partisë së vet. Kështu që rezultatet e votimeve shpesh mund të parashikohen prej më parë. Deputetët votojnë duke hyrë në një korridor me dy kahje. Ata që votojnë “për” hyjnë në njërin krah të korridorit, kurse ata që votojnë “kundër” propozimit gjegjës shkojnë në krahun tjetër të korridorit. Në vendin ku korridori ndahet në dy krahë qëndrojnë “kamxhikët”, personat që duhet t'i disiplinojnë deputetët e tyre dhe të shohin nëse bashkë-partiakët do t'i përbahen vendimit të partisë.

Sot në Britaninë e Madhe pesha e pushtetit nuk është në vetë parlamentin, por te lideri i partisë udhëheqëse nga radhët e së cilës rekrutohet qeveria. Praktika kushtetuese britanike ka ndikuar shumë në organizimin e sistemit politik në ShBA.

2. Sistemi parlamentar në vendet e tjera

Sisteme parlamentare të ndërtuara sipas modelit britanik sot hasim në shumë vende të botës. Sipas faktit sa kopjet janë të afërta me origjinalin, vendet e regjimit parlamentar mund të ndahen në tri grupe: vendet e Komonveltit (Kanadaja, Australia, Zelanda e Re dhe Republika Jugafrikane), të Evropës Veriore dhe të Skandinavisë si dhe ato evropianoperëndimore.

Në vendet e Komonveltit pozitën e fronit mbretëror e ka guvernatori i përgjithshëm, të cilin formalisht e cakton mbretëresha angleze në bazë të propozimit të qeverisë gjegjëse. Guvernatori i sapoemëruar i pranon funksionet të cilat në mekanizmin e sistemit politik i ka mbretëresha.

Në vendet e Evropës Veriore dhe ato të Skandinavisë si Belgjika, Holanda, Danimarka, Norvegja, Suedia dhe Finlanda regimi parlamentar ka një histori të gjatë dhe ai funksionon relativisht me sukses. Të gjitha këto vende, me përjashtim të Finlandës, janë mbretëri dhe në to froni mbretëror ka pozitën e shefit të shtetit me funksionet që përafërsisht u përgjigjen funksioneve të mbretit në Britaninë e Madhe. Ajo që në këto vende e ndërlikon mënyrën e funksionimit të parlamentarizmit është mungesa e sistemit dypartiak të Britanisë. Në të gjitha këto vende parlamenti është njëdhomësh, me përjashtim të Suedisë, ku ekzistonë dy dhoma, por komisionet e të dyjave janë të përbashkëta, kështu që edhe bashkëpunimi ndërmjet tyre është i ngushtë.

Grupi i tretë të vendeve me sistem parlamentar e përbëjnë ato të Evropës Perëndimore si Franca, Italia, Gjermania etj.

Shefi i shtetit në Francë është kryetari i shtetit. Rol i tij në Republikën e Katërt ka qenë i kufizuar me pozitën

e cila i përgjigjet asaj të fronit mbretëror në Britani. Kur ndodhi kryengritja në Algjeri, qeveria e atëherdhme e Republikës së Katërt të Francës nuk dinte veçse të kapitulonte. Pushteti kaloi te gjeneral De Goli dhe u formua Republika e Pestë Franceze, e cila me institucionet e veta del prej kornizave të sistemeve parlamentare që ekzistojnë në shtetet e tjera të Evropës Perëndimore.

Cilat janë karakteristikat e sistemit të ri politik të Francës? Para së gjithash pushteti ekzekutiv është i përgendruar në duart e kryetarit të republikës. Ky, në fakt, është regjim në të cilin kryetari ka ingeranca të mëdha dhe pozita e tij është forcuar me ndryshimet më të reja kushtetuese pas referendumit të 6 nëntorit të vitit 1962, sipas të cilave kryetari zgjidhet përmes zgjedhjeve të drejpërdrejta. Ky synim thekson faktin se kryetari nuk e merr mandatin nga kuvendi, por nga vetë populli. Me këto ndryshime kryetarit i është dhënë e drejta që ta shformojë kuvendin, që, sipas dëshirës së vet, disa ligje t'i çojë në referendum. Kryetari i republikës është edhe emëruar i ministrave, kryetar i këshillit të ministrave, ai është shef i shtetit dhe qeverisë. Lideri i qeverisë në mënyrë efektive e kryen rolin e vet vetëm në mungesë të kryetarit të shtetit, si bashkëpunëtor më i vjetër dhe më i afërt i tij. Parlamenti është mjaft i degraduar në aspektin e të drejtave dhe ingerencave të veta, sepse qeveria ka fituar të drejtën që të aprovojë akte ligjore përmes rregulloreve dhe dekreteve me fuqi ligjore. Pra, në Francë ekziston një sistem gjysmëparlamentar i cili në disa elemente i afrohet sistemit presidencial.

b. Sistemi presidencial

Ndër sistemet më të rëndësishme politike është edhe sistemi presidencial, tipik për ShBA-të. Falë kontinuitetit të sistemit në fjalë dhe rritjes së ndikimit të ShBA-ve në marrëdhëniet ndërkombëtare, ky sistem, ashtu si ai britanik, merret si model dhe imitohet në anë të ndryshme të botës, sidomos në kontinentin amerikan, por kopjet e këtij sistemi, posaçërisht në shtetet e Amerikës Latine, më tepër se kopje janë karikatura të tij.

ShBA-të, që nga themelimi i tyre, dy shekuj e më parë, jetojnë me po atë kushtetutë, të aprovuar në atë kohë, që konsiderohet kushtetuta më e vjetër bashkëkohore në botë. Kjo kushtetutë ka përjetuar dy kriza, atë të viteve 1860, kur u zhvillua lufta ndërmjet shteteve të Veriut dhe të Jugut, që synonin të ndaheshin dhe krizën e madhe të viteve '30 të shekullit XX. Teksti i parë i kushtetutës amerikane është shkruar më 1787, kurse është aprovuar më 1789 dhe përmban gjithsej 7 nene të cilat e ilustrojnë organizmin federal të këtij shteti, funksionet themelore të organeve federative dhe marrëdhëniet e tyre me shtetet përbërëse të federatës. Kjo kushtetutë është plotësuar kohë pas kohe me amendamente. Dhjetë amendamentet e para janë aprovuar më 1791, kurse i fundit me të cilin kryetarit i është marrë mundësia për t'u kandiduar për mandat të tretë, më 1946. Elasticiteti i kësaj kushtetute është siguruar me të drejtën që i është dhënë Gjykatës së Lartë që t'i komentojë normat kushtetuese. Kështu, për shembull, kjo gjykatë, para Luftës së Dytë Botërore konsideronte se organizimi i shkollimit dhe i insitucioneve të tjera sipas parimit “të barabartë, por të ndarë” - në bazë të të cilit, në shtetet jugore bëhej diskriminim ndërmjet të zinjve dhe të bardhëve - nuk

është në kundërshtim me parimet kushtetuese. Por, pas Luftës (së Dytë Botërore), dispozitat e njëjtë ligjore Gjykata e Lartë i komentoi krejtësisht ndryshe, dhe shprehu idenë se parimi i përmendur bie ndesh me normën kushtetuese për barazinë e qytetarëve para ligjit.

Për sistemin e ShBA-ve është karakteristike se ai ka lindur nga revolta kundër pushtetit të fortë shtetëror, kundër mbretërisë britanike dhe restriksioneve të vëna nga ajo. Për këtë arsy, “etërit themelues” të këtij shteti kanë marrë masa për kufizimin e pushtetit federal, për ngushtimin e tij vetëm në funksionet e pashmangshme për mbajtjen e rendit në këtë vend të madh, për funksionimin pa pengesa të tregtisë, për lëvizjen e kapitalit dhe çështje të ngjashme. Për këtë arsy, ShBA-të janë bërë vendi ku në mënyrë më konsekiente është aplikuar maksima politike e Monteskjesë për ndarjen e pushtetit si garanci e lirisë politike karshi tiranisë shtetërore. Bëhet fjalë për parimin “pushteti e kufizon pushtetin”. Mbi çdo organ është vënë një organ tjetër. Çdo shtet në ShBA (janë 50, e dikur kanë qenë vetëm 13) e ka kushtetutën e vet, me të cilën i rregullon çështjet e tij interne. Shtetet kushtetuta federale i obligon vetëm që të jenë republika.

Një gjë e rëndësishme me të cilën sistemi amerikan dallon nga sistemi parlamentar është edhe pozita dhe funksionet e kryetarit, d.m.th. të organit sipas të cilit është pagëzuar ky sistem. Kryetari i shtetit është shef i shtetit, shef i ekzekutivit (i pushtetit ekzekutiv shtetëror) dhe komandant i forcave ushtarake. Kryetari i shtetit në ShBA zgjidhet përmes votimeve të drejtpërdrejta të të gjithë qytetarëve me të drejtë vote. Kushtetuta parashev që atë ta zgjedhin të ashtuquajturit “zgjedhës”. Në çdo shtet sipas numrit të përfaqësuesve në Kongres, zgjidhen zgjedhësit, kurse numri i përgjithshëm i zgjedhësve nga të gjitha shtetet e zgjedh kryetarin e shtetit. Por, ky

sistem tashmë është kapërcyer, përkatësisht është modifikuar. Kryetari, faktikisht, zgjidhet me votim të drejtpërdrejtë, sepse të gjithë zgjedhësit e shtetit në të cilin kandidati i caktuar ka fituar më shumë vota janë të detyruar të votojnë për atë kandidat, kështu që kur zgjedhësit tubohen puna është e kryer: ata e inaugurojnë vetëm formalisht kryetarin e ri.

Në dallim nga pozita e qeverisë në sistemin parlamentar në të cilin ajo është bartëse e pushtetit ekzekutiv dhe vetëm formalisht i përgjigjet shefit të shtetit, në ShBA, kabineti përbëhet prej njerëzve të cilët kryetari i zgjedh si bashkëpunëtorë dhe u beson dikastere të caktuara. Ministrat janë të varur nga kryetari, i cili mund ta largojë prej postit çdonjërin prej tyre. Ministrat nuk janë anëtarë të Kongresit dhe s'kanë përgjegjësi para këtij institucioni. Numri i ministrive përcaktohet formalisht me vendime të Kongresit dhe ky numër rritet relativisht ngadalë. Në fillim ka pasur vetëm 3 ministri (e mbrojtjes, e punëve të jashtme dhe e financave), kurse sot ka 12, por ky numër nuk e reflekton as për së afërmë rritjen e aparatit shtetëror. Përveç ministrive (departamenteve) ekzitojnë edhe 65 komisione, byro dhe agjencione. Kryetari i shtetit ka edhe këshilltarë personalë (“kabineti i kuzhinës”) dhe kancelarinë e vet ekzekutive që përbëhet nga Byroja për buxhet dhe Këshilli i mbrojtjes kombëtare. Anëtarët e kësaj kancelarie i ndihmojnë kryetarit në kryerjen e detyrave të përditshme.

Në sistemin e ndarjes së pushtetit, si baraspeshë ndaj kryetarit qëndron Kongresi i cili e ka cilësinë e trupit përfaqësues suprem. Kongresi përbëhet prej dy dhomat:

a. *Dhoma e përfaqësuesve*, që ka përafërsisht 430 deputetë, të zgjedhur në dy vjet, nga votuesit me të drejtën e

përgjithshme për votë dhe proporcionalisht me numrin e banorëve, dhe

b. *Senati*, që numëron 100 senatorë, nga dy prej çdo shteti, pa marrë parasysh madhësinë e tyre (shteteve). Senatorët zgjidhen çdo gjashtë vjet dhe një e treta e përbërjes duhet të ripërtëritet çdo dy vjet.

Senati ka kompetencë që ta japë pëlqimin e vet lidhur me emërimin e funksionarëve të lartë shtetërorë, sidomos për emërimin e ambasadorëve si dhe të shefave të dikastereve të ndryshme, të agjencive të pavarura etj. Senati i thirr kandidatët për poste të ndryshme në bisedë paraprake dhe në bazë të kësaj bisede merr vendim nëse janë të përshtatshëm për ta kryer detyrën për të cilën janë propozuar ose jo.

Kongresi ka edhe rol hetues dhe gjyqësor në lidhje me punën e udhëheqjes shtetërore si dhe në të gjitha format e tjera të veprimit publik në ShBA. Për çështjet e interesit të përgjithshëm mund të formohet komision i veçantë hetues. Kongresi e gëzon edhe të drejtën për ngritjen e procedurës kundër funksionarëve më të lartë shtetërorë (si p.sh. kryetari) në rast të tradhtisë, korruptionit dhe kundërvajtjeve të ngjashme.

Shtylla e tretë e sistemit politik amerikan është Gjykata e Lartë, i përbërë prej 8 gjykatësve të përhershëm dhe një kryetari, të cilin e emëron presidenti i ShBA-ve. Gjykatësit e emëruar një herë, janë të pandryshueshëm dhe mbeten në postet e veta deri në fund të jetës ose deri në pensionim.

Në ShBA veprojnë dy parti politike, partia republike, partia demokratike, të cilat nuk e kanë domethënien që ne në Evropë ia japim konceptit parti politike. Ato më tepër janë koalacione të mëdha që luajnë rol të ngjashëm me atë të agjencive për ndërmjetësim. S'ka-

në program qartë të definuar dhe nuk bazohen në shtresa dhe klasa të caktuara shoqërore.

Këtu duhet përmendur edhe rolin e afër 500 grupave të interesit që veprojnë në këtë vend, të cilat e kanë aparatin e vet propagandues dhe agjentët profesionalë, që qëndrojnë në Uashington dhe në qendrat e tjera ku merren vendime politike dhe administrative. Një karakteristikë tjeter e sistemit politik të ShBA-ve është ndikiimi i madh i qarqeve ekonomike, sidomos i kapitalit të madh. Në këtë vend, kapitali ka tradicionalisht ndikim të madh në administratën shtetërore. Sociologu i shquar C. Wright Mills në studimin e tij *Elita sunduese* thekson se në kohën e tij, 30 prej 50 individëve që e përbënë bërtamën e udhëheqjes amerikane ngushtë kanë qenë të lidhur me kompanitë e mëdha amerikane.

Demokracia

“Dinjiteti i njeriut qëndron në mundësinë e tij për të zojedhur”.
Max Frisch⁵³

Një nga konceptet prolematike të modernitetit është edhe demokracia. Edhe për të - njësoj si për kulturën – janë bërë rreth treqind përkufizime. Shprehja demokraci përbëhet nga dy fjalë greke *demos* (populli) dhe *kratos* (forca, fuqia)⁵⁴ dhe ka kuptimin e “të qenët e forcës në duart e popullit”, “administrimi popullor” ose thënë më qartë qeverisje apo udhëheqje e popullit me vetveten, sistem ku i gjithë pushteti i takon popullit (*Omni potestas a populo*) ose, siç shprehet A. Lincoln-i, “qeverisje e popullit, nga populli, për popullin (“Government of the people, by the people, for the people”).⁵⁵ Demokracia e cila ka një histori 2500 vjeçare është formë e qeverisjes së shumicës së qytetarëve me shtetin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

Termi demokraci gjithherë ka treguar një entitet politik, një formë shteti e qeverisjeje dhe ky mbetet kuptimi i parë i termit. Nga ky term kanë dalë edhe sintagmat demokraci shoqërore dhe demokraci ekonomike.⁵⁶

⁵³ Демократија-никако без мене, fq. 5.

⁵⁴ Grolier International Americana Encyclopedia, vell. IV, fq. 381.

⁵⁵ Giovanni Sartori, Ç'është demokracia, Dituria, Tiranë, 1998, fq. 20.

⁵⁶ Sartori, po aty, fq., 8.

a. Zhvillimi historik i demokracisë

Ata që flasin sot për standardet e demokracisë, me vetëdije ose pa të, mendojnë pa përjashtim për standartet e qeverisjes politike në Angli, Francë dhe ShBA. Por, antropologët pohojnë se demokracia është zbatuar nga shumë bashkësi të vjetra përgjatë historisë së njerëzimit. Por, sipas traditës politike perëndimore, demokracia fillon me qytetet-shtete të Greqisë së vjetër (*poliset*). Platon dhe Aristoteli, të cilët janë munduar të krijojnë një teori sistematike mbi politikën, e kanë konsideruar demokracinë si një nga pesë ose gjashtë mënyrat e qeverisjes. Përkufizimin më të mirë të demokracisë e ka bërë Platon në veprën e tij *Republika*. Por koncepti në të cilin bazohet ky përkufizim dallon shumë nga pikëpamja e sotme për këtë koncept.

Në demokracitë antike ka mbizotëruar demokracia e drejtpërdrejtë. Në Greqinë antike, ligjet i bënin të gjithë qytetarët së bashku; s'ka ekzistuar demokracia përfaqësuese. Demokracinë e drejtpërdrejtë e ka bërë të mundshëm numri i vogël i banorëve që nuk i kalonte 10 000. Në këtë demokraci gratë, robërit dhe të varfërit, të ashutuquajturit *laikos*, kanë qenë të përjashtuar nga e drejta e pjesëmarrjes në udhëheqje⁵⁷ dhe për këtë këtë arsyë këtë demokraci, që i lë mënjanë laikosët, është më mirë ta quajmë aristokraci. Robëria s'është konsideruar si diçka e keqe, është konsideruar si e domosdoshme për kryerjen e shërbimeve publike. Sistemi i vjetër grek e ka njuhur barazinë mes qytetarëve, por s'e ka arritur nivelin e njuhjes së barazisë mes njerëzve.

⁵⁷ Mustafa Erkal, Burhan Baloğlu, Filiz Baloğlu, *Ansiklopedik Sosyoloji Sözlüğü*, Der Yayımları, Stamboll, 1997, fq. 82-83.

Të gjithë qytetarët e demokracive antike kanë pasur të drejtën për të marrë pjesë në kuvend dhe për të votuar, madje edhe të marrin detyra të ndryshme në organet ekzekutive dhe gjyqësore. Ndarja e posteve bëhej me zgjedhje ose me short. Sipas Aristotelit, një nga veçoritë e kësaj demokracie ka qenë epërsia e sistemit të shortit. Në këtë sistem të demokracisë s'ka ekzistuar ndarja e pushtetit dhe autoritetet nga të tri nivelet e pushtetit janë përgjigjur para kuvendit popullor.

Moskrijimi i demokracisë përfaqësuese, te grekët e vjetër e ka penguar krijimin e shteteve më të mëdha. Poliset e vogla kanë mundësuar zhvillim të lartë të jetës politike. Të gjithë qytetarët kanë pasur mundësinë të interesohen për së afërmë rrëth ndodhive shoqërore dhe të marrin njohuri të drejtpërdrejta për to. Shembujt e sotëm që i afrohen më së afërmë këtij sistemi janë mënyra e udhëheqjes në New England dhe në disa kantone të vogla të Zvicrës. Demokracia në Greqinë antike është përhapur sidomos në shekullin V p.e.r. Kanë qenë athinasit ata që të parët janë munduar të krijojnë një perandori demokratike. Demokracia athinase pas një periudhe të dekadencës, me ngadhënjimin përfundimtar të Romës kaloi në histori. Në Romë, në fakt, asnjëherë nuk është realizuar një demokraci e tipit athinas. Pavarësisht nga regjimi (së pari republikë, më pas perandori), shteti ka qenë në duart e *Senatus Populusque Romanus* (Senati Romak Popullor). Me themelimin e sistemit të quajtur “senhuiate” u vu në zbatim diferençimi mes qytetarëve të pasur, të mesëm dhe atyre të varfër dhe realisht push-teti iu dha të pasurve.

Në mesjetë u krijuan qytetet tregtare që u përngjanin siteve të vjetra dhe udhëheqësit u detyruan t'i përdornin termat e vjetër demokratikë (populli, kuvendi popullor) dhe mënyra e qeverisjes në këto qytete shpesh emërtohen si “demokracia e popullit”.

het si “demokraci e qytetit”. Autorët mesjetarë dhe të kohës së re, duke u bazuar në Aristotelin, vazhduan ta quanin demokracinë një nga tri mënyrat e qeverisjes, por në këtë kohë demokraci s’kishte vecse në fushën e mendimit. Kjo gjendje vazhdoi deri në revolucionin amerikan dhe francez. Në këtë periudhë edhe pse nuk pati zhvillime demokratike, prapseprapë iu vunë themelit konceptit dhe institucioneve që e përbëjnë karakterin specifik të qeverisjeve demokratike bashkëkohore.

b. Demokracia moderne

Demokracia e kohës sonë lindi në Angli në shekullin XVII (revolucioni i vitit 1688) dhe dalngadalë u bë një model i parapëlqyer nga e gjithë bota. Farid Zakaria, drejtues i revistës amerikane *Foreign Affairs*, të cilën e boton Këshilli për Marrëdhënie Ndërkombëtare, flet për “demokratizimin masovik të botës”.⁵⁸ Sipas një hulumtimi, në vitin 1970 në botë ka pasur 40 vende demokratike, më 1988, 66, kurse sot 117.

Ndryshe nga demokracitë e drejtprëdrejta greke, është demokraci përfaqësuese ose liberale, në të cilën ka tendenca drejt një demokracie ekonomike. Organi themelor i qeverisjes është kuvendi përfaqësues ose parlamenti, i cili konsiderohet si një *demos* në miniaturë.⁵⁹ Në këtë sistem qytetarët i zgjedhin politikanët që premtojnë se do t’i përfaqësojnë interesat e tyre në një forum kombëtar. Në praktikë, politikanët e sistemit demokratik, në

⁵⁸ www.voagov/miscl/croatia

⁵⁹ Gordon Marshall, *Sosyoloji Sözlüğü*, çev. O. Akınhay – D. Kömürcü, Bilim ve Sanat Yayınları, Ankara, 1999, fq. 140.

vend që t'i dëgjojnë problemet e qytetarëve, në përgjithësi janë anëtarë të partive të cilat dalin para popullit me programet e veta. Së këtejmi vërehet se partitë janë shndërruar në qendra të pavarura të pushtetit (fuqisë). Përvoja e shekullit XX tregon se interesat e qytetarëve përfaqësohen më së miri nga partitë e vogla (shembulli i Italisë), por veprimi më efektiv i qeverive është i mundur në vendet ku garojnë dy ose tri parti politike (Britania e Madhe dhe ShBA-të). Ky është një nga paradokset në të cilët kanë vënë theks sociologët dhe politologët. Sot në botë, në veçanti në Lindje të Mesme, Afrikë, Azi dhe në Amerikën Latine, ekzistojnë shumë sisteme njëpartiake që pretendojnë se e përfaqësojnë vullnetin kolektiv të popullit dhe janë demokratike, por në to, në fakt, sundojnë, siç shprehet sociologu A. Bullaç “diktatorët dhe paravan-parlamentet”.⁶⁰

Sipas një mendimi të përhapur demokracia varet nga konkurenca brendapartiake dhe ndërpartiake, përfaqësimi i interesave të ndryshëm, zgjedhjet e drejta dhe të lira, mundësia e zgjedhësve për të bërë zgjedhje ndërmjet kandidatëve dhe politikave të ndryshme, pushteti i vërtetë i parlamentit, ndarja e pushtetit, shfrytëzimi i të drejtave qytetare nga të gjithë qytetarët, mbisundimi i së drejtës.

Paradigmë etike është se të gjithë njerëzit janë krijuar të barabartë dhe se qeveritë ekzistojnë për t'u mundësuar qytetarëve t'i realizojnë të drejtat e tyre themelore.⁶¹ Një nga veçoritë e demokracisë moderne, frys ky i kapitalizmit industrial, është edhe koncepti i kushtetutës.

Demokracitë, sidomos ato perëndimore, kanë tri patrixe kryesore:

⁶⁰ Shih: Ali Bullaç, “Demokracia-temë problematike e botës bashkëkohore”, *Vepra*, dhjetor 1999, fq. 8-11.

⁶¹ *Meydan Larousse*, vëll V, fq. 153.

1. Sigurimi i lirive të individëve dhe mbrojtja e tyre kushtetuese (individualizmi),
2. Sistemi parlamentar (përfaqësues) si institucion për mirëqenien e popullit (delegimi apo përfaqësimi),
dhe
3. E drejta e votës krahas administrimit në pajtim me dëshirën e shumicës (shumica).

Lidhur me kuptimet e veçoritë kryesore të demokracisë ekzistojnë divergjenca të mëdha dhe ky subjekt vazhdon të jetë debativ si në sferën publike ashtu edhe në qarqet akademike.⁶² Ernest Gellneri thotë se “shoqëria civile” është një parullë më e mirë dhe më ndriçuese sesa demokracia.⁶³ Demokracinë Giddingsi e cilëson si një sistem në të cilin pakica drejtuese mund të udhëhiqet më pak nga tekat, mund të jetë më pak arbitrale dhe më e përgjegjëshme, ku elita qeverisëse është më e matur dhe më pak e ashpër.⁶⁴

c. Problemi i demokracisë

Që demokracia nuk është një term aq i qartë flet edhe nevoja që autorë të shquar botërorë ndiejnë nevojën që të shkruajnë vepra të tipit *Edhe një herë mbi teorinë e demokracisë*.⁶⁵ S’do mend se ky nocion bëhet problematik, ngaqë asnjëherë në histori nuk është jetësuar demokracia të cilën na

⁶² Marshall, *po aty*, fq. 141.

⁶³ Ernest Gellner, *Konditat e lirisë – Shoqëria civile dhe rivalitet e saj*, përkth. Mentor Agani, Dukagjini, Pejë, 2002, fq. 293.

⁶⁴ Samuel Koenig, *Sosyoloji*, Ütopya Kitabevi Yayımları, përkth. S. Sucu – O. Aykaç, Stamboll, 2000, fq. 104.

⁶⁵ Shih: Giovanni Sartori, *Edhe një herë mbi teorinë e demokracisë*, Dituria, Tiranë, 1993.

e premtojnë dhe na e interpretojnë ditë për ditë prindërit, mësimdhënësit, filozofët dhe politikanët tanë. Madje edhe në vendet më demokratike, si ShBA-të, demokracia nuk ka përfunduar. Për këtë flet më së miri një shkrim në një ditorë ku thuhet: “U largua shenja: ‘Vetëm për të bardhët’”. Bëhet fjalë për votimin e këshilltarëve të Dallasit për heqjen e mbishkrimit të një fontane të këtij qyteti, ku deri në vitet ’60 të shekullit XX zezakët është dashur të ndahen nga të bardhët dhe të shfrytëzojnë objekte të veçanta, përfshirë këtu shkollat, spitalet, fontanat për pirje të ujit dhe bankat nëpër ndërtesat zyrtare.⁶⁶

Një aspekt tjetër problematik i demokracisë është të kuptuarit e saj si liri absolute duke u nisur nga parimi i lirisë së qytetarit. Ky problem veçanërisht paraqitet në vendet që kanë përjetuar një periudhë të diktaturës së një personi, oligarkie ose të një partie. Demokracia është lojë brenda rregullave të caktuara. Ashtu sikundër në futboll loja luhet brenda terrenit dhe goli i shënuar nga jashtë s'pranohet, madje lojtarit që bën një “akrobacion” të tillë i jepet karton i kuq, edhe në demokraci personat që e përdhosin demokracinë ndëshkohen sipas normave të caktuara paraprakisht. Nuk është demokraci shkatërrimi i pasurive gjithëkombëtare (siç ndodhi në Shqipëri në fillim të viteve ’90 dhe sot në Irak). Keqkuptimi i demokracisë shpie në anarki dhe kaos. Duhet ditur e vërteta se demokracia nuk është një shkop magjik e as mrekulli që e ndryshon gjendjen aty për aty.

S. Huntington pohon se edhe qeveri të zgjedhura në mënyrë demokratike mund të jenë joefektive, të korruptuara, shkurtpamëse dhe diskriminuese. Edhe këto qeveri mund të ndjekin një politikë agresive nacionaliste dhe të aplikojnë masa të dëmshme ekonomike.

⁶⁶ Дневник, 11 mars 2003.

Është çështje e hapur edhe shfrytëzimi i mekanizmave të demokracisë nga persona dhe klika destruktive përmarrjen e pushtetit përmes proceseve demokratike, por me qëllim të realizimit të idealeve të tyre nëpërmjet zbatimit të politikës së dhunës dhe zhdukjes së tjegrit. Njerëz si Hitleri, Sadami, Milosheviqi kanë ardhur në pushtet përmes zgjedhjeve.

Përveç kësaj, me gjithë mendimet, shpresën dhe bindjen e kundërt të laikëve, me ligjin zgjedhor parashihet parevokueshmëria e mandadit të personit të zgjedhur nga populli. Me fjalë të tjera, me ligj jo vetëm që është legalizuar e drejta e deputetit të bëjë ç'të dojë me mandatin, por është penguar çdo rregullim tjetërfare i kësaj çështjeje.⁶⁷

C'të thuhet për demokracinë aritmëtike, apo demokracinë e numrave. Sot, pas një dekadë e ca të demokracisë (?) në vendin tonë debatohet çështja se “ç'fat i pret qytetarët e këtij vendi nëse numri i shqiptarëve, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, del nën 20 %-in e numrit të përgjithshëm të banorëve të këtij shteti?” Një pyetje tjetër nga realiteti ynë: C'mund të ndodhë nëse parlamenti i mbështet idetë ose tezat e publikuara të ish kryeministrat të RM-së për këmbim të territoreve dhe njerëzve?

S'duhet harruar as faktin se demokracia po kontestohej edhe si fenomen universal. P.sh. M. Hyseni, bashkëpunëtor i Institutit për Marrëdhënie Ndërkombëtare në Boston, flet për “perfeksionimin” e mjeteve shfrytëzuese nga ana e fuqive që luftojnë për “transformimin demokratik” të botës, kurse A. Birin për “demokracinë totalitariste”, për botën e padrejtësisë së globalizuar.

⁶⁷ www.angelfire.com

Përfundim

Demokracia, bashkë me të drejtat njerëzore dhe ekonominë e tregut, ngërthen tri standardet kryesore të kulturës politike perëndimore. Disa mendimtarë e shikojnë atë si një sistem ideal që duhet pranuar nga të gjitha shoqëritë, kurse disa të tjerë e sulmojnë pa mëshirë. Politologë, si Robert Dahli, kanë pohuar se pas vrapimit politik dhe participimit politik, demokracitë medoemos polarizohen dhe se nuk mund të flitet për ekzistimin e modelit politik vërtet demokratik, por vetëm për demokracitë e rreme. Winston Churchill-i pohon se “demokracia paraqet formën më të keqe shtetërore...” Ai konstaton gjendjen faktike: Është e qartë se një demokraci perfekte nuk ekziston askund. Me gjithë kritikat, demokracia, megjithatë, paraqet procesin më të suksesshëm drejt zgjidhjes paqësore të konflikteve. Shkencëtarët socialë janë të një mendimi me Abraham Lincoln-in që thotë se “të metat e demokracisë mund të shmanngen vetëm me më shumë demokraci”.⁶⁸

⁶⁸ Koenig, *po aty*, fq. 105.

Teoritë sociale bashkëkohore

**- vështrim rreth funksionalizmit,
interaksionizmit simbolik dhe etnometodologjisë -**

Teoria përbën totalitetin e paraqitjeve, formulimeve (*statements*) ose të prepozitioneve që mes vete janë të lidhura në mënyrë sistematike.⁶⁹ Në kuptimin më të gjerë të fjalës, teoritë sociale mund të përkufizohen si “tërsi të përgjithësimeve në lidhje me jetën sociale”.⁷⁰ Teoritë sociale janë përgjithësime dhe argumentime të nxjerra nga jeta shoqërore, e cila e përgatit sfondin për lindjen dhe zhvillimin e teorive në fjalë.

Teoritë sociale kanë filluar të ndërtohen me Revolucionin Francez që dha mundësinë për lindjen e një shkence të pavarur, të veçantë dhe me ndikim, siç është sociologjia, dhe në periudhën pas kësaj ngjarjeje madhere të historisë moderne që e ndryshoi në mënyrë rrënjësore strukturën sociale të shoqërive perëndimore. S’do mend se teoritë e para sociale, të cilat në literaturën sociologjike njihen si **teori klasike sociale** kanë qenë makroskopike, globale dhe janë marrë me vijën e zhvillimit të historisë njerëzore që nga fillimi e deri në atë kohë. Këto teori bëjnë ndarjen e shoqërive në moderne dhe

⁶⁹ Shih: Margaret M. Poloma, *Çağdaş Sosyoloji Kuramları*, përkth. Hayriye Erbaş, Gündoğan Yayımları, Ankara, 1993, f. 16, 17.

⁷⁰ Graham C. Kinloch, *Sociological Theory- Its Development and major Paradigms*, McGraw-Hill Book Company, New York, 1977, f. 26.

premoderne. Përfaqësuesit më të dalluar të teorive sociale klasike janë: Comt-e, Marks-i, Durkheim-i, Spencer-i, Tönnies-i, Pareto, Weber-i etj.

Teoritë sociale bashkëkohore (*meanstream/contemporary social theories*) kanë lindur me qëllim të pengimit të çrregullimeve të reja, siç ishin Anarkia Botërore e Prodhimit e vitit 1929 dhe Lufta e Dytë Botërore, të cilat edhe më tepër koncentrohen rrëth koncepteve integrim social, vlera, norma, statizëm, rend, konsensus, strukturë, funksion, sistem social, status, rol, strukturë kulturore, diferencim strukturor, baraspeshë dinamike etj.

Me zhvillimin e shpejtë të marrëdhënieve kapitaliste të jetesës, me procesin e burokratizimit dhe të modernizimit, u shënuan ndryshime me peshë edhe në strukturen shoqërore, lindën realitetet e tilla si “vetmia brenda turmës”, “tëhuajësimi”, “anomia”, “devijimi social”... Si pasojë e kësaj, edhe teoritë sociale filluan të koncentrohen rrëth këtyre dukurive të reja, filluan që në plan të parë të dalin marrëdhëniet individ-individ, individ-grup dhe grup-grup. Kështu teoritë sociale nga dimensioni makroskopik zbritën në atë mikroskopik.

Në këtë shkrim do të ndalemi në tre teori të rëndësishme sociale, siç janë funksionalizmi, interaksionizmi simbolik dhe etnometodologja dhe do të bëjmë një vështrim përshkrues të tyre në pikë të shkurtra.

a. Funksionalizmi

Funksionalizmi si një akces sistematik lidhur me jetën shoqërore është paraqitur në dekadat e para të shekullit XX. Kjo teori i ngërthen në vete elementet subs-

tanciale të teorive holistike dhe organiciste, por është trajtuar si e re për arsyet se ajo përmban koncepte të reja të studimit të shoqërive dhe karakteristikave të tyre themelore. Funksionalizmi së pari paraqitet në antropologji në formë të *përgjithësimeve lidhur me komunitetet e vogla fisnore*, të bazuara në hulumtime të terrenit të realizuara në shoqëritë primitive të ishujve të largët të Oqeanit Paqësor. Në periudhën e Luftës së Dytë Botërore kjo teori futet edhe në sociologji si përpjekje për të ndërtuar modele teorike për shoqëritë si sisteme, të cilat më tutje do të vihen në shërbim të hulumtimeve empirike të shoqërive të ndërlikuara bashkëkohore.

Hapi i parë në këtë drejtim është bërë në vitin 1906, me qëndrimin e Radcliff-Brown-it në ishujt Andamane. Pastaj vijon qëndrimi i Malinowski-t në Melanezi, më 1914. Në sferën e sociologjisë, shkëndija e parë në këtë plan është vepra e Talcott Parsons-it *Struktura e aksionit shoqëror* (1937).

Në spektrin funksionalist shoqëria kuptohet si **sistemi i institucioneve dhe i shembujve kulturorë**. Institucionet janë shembuj rregullues të aksionit shoqëror, të bazuar në nevojat e mbijetesës. Kultura është aparat i përgjithshëm lëndor, mendor dhe shpirtëror lidhur në mënyrë instrumentale me institucionet. *Shoqëria është sistem i pjesëve institucionale dhe kulturore që funksionojnë të lidhura në mënyrë të ndërsjellë, prej të cilave çdonjëra e jep kontributin e vet për mbijetimin e sistemit në tërësi.*

Koncept themelor në sociologjinë funksionaliste është “sistemi shoqëror”, i cili është ngushtë i lidhur me ekuilibrium (drejt peshimin). Ekuilibri është baraspeshë dinamike që realizohet në saje të lidhshmërisë së komponentëve strukturorë të sistemit dhe proceseve që e mbajnë këtë strukturë. Sistemi në fjalë, me kalimin e kohës, ndryshon, kështu që në përbërjen e tij mbijetojnë pjesët

që tregohen si të suksesshme, kurse mënjanohen ato që tanimë nuk janë të tilla.

Sipas përfaqësuesve të funksionalizmit:

- Shoqëria mund të mbijetojë vetëm si sistem, respektivisht si tërësi e pjesëve të lidhura dhe të harmonizuar në mënyrë reciproke.

- Rendi shoqëror mbijeton për shkak të dëshirës së njerëzve të marrin pjesë në të.

- Tek njerëzit, dëshirat kolektive i kapërcejnë ato individuale.

- Çdo pjesë e sistemit kryen funksion pozitiv.

- Çdo sistem shoqëror, me t'u formuar, zhvillon mekanizma për mbijetesën individuale. Prej tyre më të rëndësishme janë kontrolli shoqëror dhe socializimi.⁷¹

1. Talcott Parsons (1902-1979)

Parsons-i është një nga figurat më markante të sociologjisë në 20-30 vjetët pas Luftës së Dytë Botërore. Teoria sociale e Parsons-it, që pagëzohet si funksionalizëm struktural ose normativ, trajtohet në përgjithësi si fryt i shoqërisë bashkëkohore dhe të pasur amerikane.

Vepra e tij më e hershme ka qenë përkthimi i librit të Max Weber-it *Etika protestante dhe shpirti i kapitalizmit*, e cila ka ndikuar shumë në depërtimin e pikëpamjeve ueberiane në ShBA. Duke bërë sintezë mes pikëpamjeve të themeluesve kryesorë të sociologjisë, sociologu i shquar ka zhvilluar një teori përgjithësuese. Ai ka synuar bashkimin e individualizmit ueberian dhe kolektivizmit durkheimian. Pika kyç në pikëpamjen e Parsons-it është njësimi i ideve, vlerave dhe normave me veprimet individu-

⁷¹ Марија Ташева, *Социолошки теории*, Универзитет “Св. Кирил и Методиј”, Shkup, 1999, fq. 424-425.

ale që përputhen me normat dhe vlerat që hasen brenda-përbrenda sistemit shoqëror.

Sipas tij, detyrë parësore për përkufizimin e sistemit shoqëror është zhvillimi i tërësisë së koncepteve abstrakte dhe përgjithësuese.

Tri aspektet themelore të mendimit të Parsons-it janë:

- a) Nacioni i kushteve të domosdoshme të shoqërisë.
- b) Koncepti i rendit shoqëror që shoqëritë i prezanton si sisteme sociale të ndërlidhura dhe “të vetëmbështetura”, që veprojnë në një “rreth të jashtëm”.
- c) Teoria e përgjithshme e “sistemeve të aksionit”, që është zhvilluar nga vepra e Robert Vales-it.

Duhet theksuar se veprat e Parsons-it kanë qenë Bibl e vërtetë për brezin e sociologëve funksionalistë.⁷²

2. Robert Merton (1910 -)

Merton-i është nxënësi i parë i Parsons-it dhe ndjekës i strategjisë së funksionalizmit strukturor. Teoria e tij është shumë më radikale se e Parsons-it. Ai ka dhënë një koncept për sistemin me lidhje më të dobëta të komponentëve të tij, me dozë më të madhe të dinamizmit dhe disrupcione (përçarje) permanente.

Merton-i e ka zhvilluar teorinë e “vêllimit të mesëm” përmes së cilës ka synuar të ndërtojë urë ndërmjet teorisë abstrakte të Parsons-it dhe shqyrtimit empirik që është tipik për sociologjinë moderne amerikane. Vepra më e njojur e Merton-it është *Teoria sociale dhe struktura sociale* (1949), e cila përmban ese me peshë si “Funksionet manifeste dhe latente” dhe “Struktura sociale dhe anomia”. Kontributin e tij më të madh Merton-i e ka

⁷² David Jary & Julia Jary, *Unwin Hyman Dictionary of Sociology, second edition*, HarperCollins Publishers, Glasgow, 1995, fq. 474-475.

dhënë në drejtim të studimit të burokracisë, në sferën e sociologjisë së shkencës, sociologjisë së mjeteve të komunikimit masiv, teorisë së roleve, analizave të deprivimeve relative dhe grupeve të referencës. Teza e tij e doktoratës, e titulluar *Shkenca, teknologja dhe shoqëria në Anglinë e shekullit XVII* (1938) bazohet në qëndrimet e Weber-it treth relacionit të protestantizmit dhe kapitalizmit. Sipas hipotezës së autorit, zhvillimi i aktivitetit shkencor në shekullin XVII ka qenë ngushtë i lidhur me forcat sociale, përfshirë këtu edhe religionin puritan.⁷³

b. Interaksionizmi simbolik

Interaksionizmi simbolik, si degë amerikane e sociologjisë, paraqet pjesë përbërëse të mikrosociologjisë e cila në qendër të fokusit të vet e ka individin dhe relacionet e tij me individët e tjere⁷⁴ dhe shkurt emërtohet edhe vetëm si *interaksionizëm*. Nga aspekti i interaksionizmit, rregullimi shoqëror është rezultat i veprimeve interpretative të aktorëve në situata të interaksionit.⁷⁵ Kjo teori është zhvilluar nga një grup filozofësh amerikanë, përfshirë këtu edhe John Dewey-n, William I. Thomas-in dhe George Herbert Mead-in. Kjo pikëpamje disa herë emërtohet si fenomenologjike për arsyen e thekson rëndësinë e qëndrimeve dhe interpretimeve të aktorëve lidhur me realitetin shoqëror. Manis dhe Metzer pohojnë

⁷³ David Jary & Julia Jary, *op. cit.*, fq. 408-409.

⁷⁴ TALLIEBA, *op. cit.*, fq. 359.

⁷⁵ Haralambos, *Sociologija*, Zagreb, 1989, fq. 525.

se interaksionizmi simbolik merret me aspektet e brendshme apo fenomenologjike të sjelljes së njeriut.⁷⁶

Tradita e interaksionizmit simbolik i nxjerr në plan të parë aspektet e neglizhuara të sjelljeve njerëzore, pra aspektin subjektiv dhe interpretativ. Individ i interaksionizmit simbolik më tepér se një produkt i përcaktuar nga struktura ose gjendja objektive është një njësi pjesërisht e pavarur.⁷⁷ Pikëpamja interaksioniste, në vend që ta trajtojë veprimin si reaksiون të drejtpërdrejtë ndaj motivuesit shoqëror, vë theks mbi domosdoshmérinë e përkufizimit dhe interpretimit subjektiv të motivuesit objektiv.

Lidhur me këtë teori është me rëndësi të veçohet kontributi i Mead-it, Blumer-it dhe Davist-it.

1. G. Herbert Mead (1863-1931)

Sipas botëkuptimit meadian, mendimi, përvoja dhe sjellja njerëzore janë shprehimisht shoqërore. Natyra e tyre është rezultat i faktit se qeniet njerëzore veprojnë në mënyrë të ndërsjellë në saje të simboleve, prej të cilave, më të rëndësishmet, i gjejmë në gjuhë. Simboli nuk paraqet thjesht vetëm një objekt ose ngjarje: në një mënyrë ai i përcakton ato dhe të drejton të reagosh ndaj tyre. Kështu, p.sh., simboli “karrike” nuk është vetëm një tërësi sendesh të cilat i përkufizon si të ngjashme, por implikon edhe veprim, gjegjësisht veprimin e uljes. Simboli sigurojnë mjete me anë të të cilave njeriu mund të jetë në interaksion të kuptimitë me natyrën dhe rrëthin shoqëror. Sipas Mead-it pa simbole nuk mund të ekzistonë as ndërveprimi ndërmjet njerëzve e as shoqëria njerëzore. Interaksioni simbolik është i rëndësishëm sepse

⁷⁶ Haralambos, *op. cit.*, fq. 516.

⁷⁷ Poloma, *op. cit.*, fq. 222.

njeriu nuk ka instikte të cilat do të udhëhiqin në sjelljen e tij. Ai nuk është i programuar gjenetikisht të reagojë në raste të ndryshme. Për pasojë, për të mbijetuar, ai duhet të ndërtojë botën e domethënieve dhe të jetojë në të. P.sh. për t'i plotësuar nevojat e tij për ushqim ai duhet ta bëjë kategorizimin duke u nisur nga rrithi natyror: gjëra që mund të hahen dhe gjëra që s'mund të hahen. Në saje të simboleve i jepet kuptim botës natyrore dhe kështu mundësohet interaksioni i njeriut me të (botën).

Jeta shoqërore mund të zhvillohet vetëm nëse pjesëtarët e shoqërisë kanë simbole kryesisht të përbashkëta.

Interaksiioni njerëzor mund të kuptohet si proces permanent i interpretimit në të cilin çdonjëri e merr rolin e tjetrit. Pra, njeriu, në procesin e marrjes së rolit, e zhvillon konceptin për “unin” vetjak. Mead-i pohon se koncepti “uni vetjak” mund të zhvillohet vetëm nëse individi “arrin të dalë nga vetja në mënyrë që të bëhet objekt i vvetvetes”.⁷⁸ Veten njeriu duhet ta shikojë nga prizmi i “tjetrit të përgjithësuar”, ashtu si e shohin të tjerët. Sipas Mead-it “sjellja zhvillohet sipas qëndrimeve të të tjerëve dhe sipas asaj që ata e presin prej tij”. Ashtu si Aristoteli, sociologu në fjalë do të thotë se individi mund të bëhet qenie njerëzore vetëm në kontekstin shoqëror. Pa komunikim në saje të simboleve të cilat janë me domethënien të përbashkëta, proceset e veprimit të përbashkët janë të pamundura. Njeriu, pra, jeton në **botën e simboleve** të cilat i japin kuptim jetës dhe përfaqësojnë bazën e interaksionit ndërnjerëzor.

⁷⁸ Haralambos, *op. cit.*, fq. 518.

2. Herbert Blumer (1900-1987)

Blumer-i, sociolog ky i shquar që ka punuar në Universitetin e Chicago-s, në artikullin e botuar më 1937, një vepër të redaktuar nga W. Shmidt, *Man and Society*, në të cilin bën vlerësimin e natyrës së psikologjisë sociale, e ka shpikur sintagmën *interaksionizmi simbolik* dhe me plot kuptimin e fjalës është themelues i kësaj tradite. Blumer-i nuk e pëlqen analizimin e fenomeneve në të cilat sociologu nuk është dëshmitar dhe i shikon me urrejtje teoritë abstrakte. Ai ka shfaqur interesim për masmedian, moden, sjelljet kolektive, relacionet punëdhënës-punëmarrës, për marrëdhëniet ndërmjet racave dhe për jetëshkrimet.⁷⁹

Teorinë e vet e bazon Blumer-i në disa parime të përgjithshme, të cilat janë pranuar edhe nga përfaqësues të tjerë të interaksionizmit simbolik. Bëhet fjalë për parimet në vijim:

- Qeniet njerëzore, ndryshe nga gjallesat më të ulëta, kanë kapacitete për të menduar.
- Kapaciteti i të menduarit është formësuar përmes interaksionit shoqëror.
- Domethëniet e simboleve njerëzit i mësojnë në-përmjet ndërveprimit shoqëror.
- Njerëzve domethëniet e simboleve u mundësojnë të realizojnë aksion dhe interaksion njerëzor *sui generis*.
- Njerëzit, në bazë të interpretimit të situatës, janë të aftë t'i modifikojnë ose t'i zëvendësojnë domethëniet dhe simbolet të cilat i përdorin në aksionin dhe interaksionin e tyre.
- Aksioni dhe interaksioni e mundësojnë formimin e grupeve dhe të shoqërive.

⁷⁹ Marshall, *op. cit.*, fq. 77-78.

c. Etnometodologjia

Etnometodologjia është një pikëpamje sociologjike që është paraqitur aty kah mesi i viteve '60 të shek. XX, pas rrënimit të konsensusit të quajtur ortodoks.⁸⁰ Konceptin etnometodologji, si rezultat i “projektit të jurisë” (1968)⁸¹, i pari e ka përdorur sociologu amerikan Harold Garfinkel, i cili është autor i veprës *Studime në etnometodologji* (1967). Ky dijetar pohon se shprehja “etno” në këtë apo në atë mënyrë rrëfen për njohuritë lidhur me ndjenjat kolektive të shoqërisë në të cilën jeton njeriu. Ai i ka analizuar deri në hollësi metodat të cilave njerëzit u referohen për t'i sqaruar veprimtaritë e tyre të jetës së përditshme. Në hulumtimin e tij lidhur me jurinë Garfinkel i ka dëgjuar fshehurazi regjistrimet e një jurie, ka biseduar me anëtarët e jurisë dhe është munduar t'i përgjigjet pyetjes në vijim: Ç'i bën këta njerëz anëtarë të trupit të jurisë? Ai dhe një shok i tij i hulumtimit synonin të kuptonin nga e dinte juria se si duhej të sillej juria në kryerjen e këtij funksioni. Nga hulumtimi erdhën në përfundim se juria për t'ia shpjeguar vetes dhe të tjerëve veprimet e veta, shfrytëzonte metoda të ndryshme. Sipas Garfinkel-it, anëtarët e jurisë përpinqeshin që ta bënin të kuptimitë zbatimin e veprimit të këtij trupi dhe në këtë drejtim merreshin me “shprehje të mjaftueshme”, “përshkrimë të mjaftueshme” dhe “argumente të mjaftueshme”.

Botimi i veprës së lartpërmendur për dhjetë vjet me radhë shkaktoi polemika të zjarrta në katedrat e sociologjisë. Sot etnometodologjia është një lëm me të cilin me-

⁸⁰ Gordon Marshall, *Sosyoloji Sozliğii* (A Dictionary of Sociology), Bilim ve Sanat Yayınları, Ankara, 1999, fq. 216.

⁸¹ Adil Çiftçi, *Toplumbilimi Yazılıarı*, Anadolu Yayınları, Izmir, 1999, fq. 55.

tren pak sociologë, në radhët e të cilëve e hasim edhe A. Giddens-in.

“Etnometodologët nuk pranoncohen ose e hudhin poshtë bindjen se ekziston rendi shoqëror i vërtetë dhe objektiv. Në vend të kësaj, ata nisen nga premisa se jeta e anëtarëve të shoqërisë u duket e rregulluar. Kështu, në sytë e anëtarëve të shoqërisë, veprimet e tyre të përditshme janë të rregullta dhe sistematike, por ky rend nuk është doemos rezultat i natyrës së brendshme ose i kualiteteve inherente të botës shoqërore. Me fjalë të tjera, ai në fakt ndoshta edhe nuk ekziston. Në bazë të mënyrës se si anëtarët e vërejnë dhe e komentojnë realitetin shoqëror, më parë mund të thuhet se ai duket se ekziston. Për këtë arsyе rendi shoqëror bëhet shpikje adekuate, fantazmë e rendit të cilën e kanë ndërtuar anëtarët e shoqërisë.”⁸² Kjo fantazmë lejon që bota shoqërore të përshtkruhet dhe të shpjegohet dhe kështu pjesëtarëve të vet t'u bëhet e njohur, e zbërthyer, e kuptueshme dhe “e interpretueshme”.

Don H. Zimmerman

Zimmerman-i e ka studiuar sjelljen në Byronë amrikane për ndihmë sociale (Bureau of Public Assistance). Punëtorëve socialë zyrtarët e recepcionit, ua kanë ndarë klientët që kërkonin ndihmë. Nëse kanë punuar katër punëtorë socialë, çdonjërit prej tyre i caktohej nga një klient. Katër klientët e ardhshëm ndaheshin sipas parimit të njëjtë. Mirëpo, kohë pas kohe, rregulli thyhej. P.sh. njëri nga katër punëtorët socialë ndodhte të kishte ndonjë rast të rëndë dhe biseda mund të zgjatej më tepër

⁸² Haralambos, *op. cit.*, fq. 525.

sesa në rastet normale. Në një situatë të tillë, klientin e ardhshëm recepcionisti ia jepte punëtorit tjetër social.

Thyerjen e rregullit recepcionistët e arsyetonin dhe e interpretonin me vetë rregullat. Nga këndvështrimi i tyre, ata duke e thyer rregullin i janë nënshtuar rregullit. Ky paradoks mund të shpjegohet me faktin se si e shikojnë recepcionistët qëllimin e rregullave. Sipas gjykimit të tyre, rregullat kanë për qëllim t'i gëzojnë klientët me shtyrje sa më të vogla, kështu që deri në fund të ditës së punës të gjithë të janë të pranuar. Duke u nisur nga kjo, mund të thuhet se thyerja e rregullave për ta arritur këtë qëllim kërkon t'u nënshtrohesh rregullave. Kështu, pra, recepcionistët janë arsyetuar para vetes dhe të tjerëve dhe e kanë interpretuar sjelljen e tyre në mënyrën e përmendur. Zimmerman-i argumenton se rregullat të cilat shfrytëzohen nga anëtarët për ta përshkruar dhe për ta shpjeguar sjelljen e tyre, duket sikur vënë rend në mëdisin shoqëror për pjesëmarrësit, dhe mu kjo përshtypje dhe mashtrim janë gjëra deri te të cilat na shpien rregullat dhe që studiohen nga etnometodologët.⁸³

Hulumtimet e Zimmerman-it i vënë në pah disa prej preokupimeve kryesore të etnometodologjisë. Ato shërbejnë si shembull për metodën dokumentare dhe e ilustrojnë natyrën reflektive të sjelljeve me të cilat anëtarët e ndërtojnë fantazmën e rendit.

Përbyllje

Teoritë sociale që janë trajtuar këtu në fakt janë hapatë rëndësishëm të zhvillimit të sociologjisë si shkencë, janë fenomenologji e mirëfilltë e shoqërisë bashkëkohore dhe përpjekje për ta interpretuar shoqërinë si botë e jetës së

⁸³ Haralambos, *op.cit.*, fq. 529.

njeriut përmes dijes shkencore. Diskursi i përdorur nga këto teori është ai i vënies shenjë barazimi mes shoqërisë dhe sistemit social, që tregon se synimi i vazhdueshëm i shoqërive është jetësimi i baraspeshës dhe integrimit në saje të vlerave të përbashkëta, ai i theksimit të raporteve mes mendimit, aksionit dhe ndërveprimit (*thinking, action and interaction*), ai i pohimit se njerëzit botën shoqërore e përfytyrojnë “ashtu siç e ndërtojnë ata vetë”, se njerëzit janë të detyruar që veprimet e veta t'i bëjnë të kuptimta për të tjerët. Njohja me këto teori është mjaft e rëndësishme në drejtim të përbrendësimit të shkencës së sociologjisë si “arkitekturë sociale” dhe të zhvillimit të imagjinatës dhe të perceptimit socio-logjik si parakushte për t'i interpretuar drejt faktet sociale.

KREU I TRETË

Shtojca

Bazat ideore të sociologjisë politike, fusha dhë përfshirja⁸⁴

Studimet sistematike lidhur me dukurinë e quajtur *politikë* kanë një të kaluar njëzetepesëshekullore. Në kuadër të kësaj periudhe politika është hulumtuar nga prizma dhe disiplina të ndryshme, por dy shekujt e fundit këto disiplina vazhdimisht e kanë thelluar ndarjen e punës dhe si përfundim në shekullin XX është lindur një disiplinë tepër e sofistikuar.

Ndryshimet shoqërore që ndodhën ndërmjet shekullit XVIII dhe XX dhe problemet që u shfaqën në këtë fazë të historisë njerëzore kanë ndikuar edhe mbi botëkuptimin dominant të studimeve shoqërore. Para së gjithash është kuptuar pamjaftueshmëria e *filozofisë sociale* e cila realitetit shoqëror, që në varësi nga ndryshimi shoqëror është shumëdimensional dhe kompleks, i përvishet nga pikëpamja se si “duhet të jetë”. Kjo kthesë paraqet pikënisjen e zhvillimit të botëkuptimit shkencor që fenomenet do t'i sqarojë ashtu “siç janë”. Kështu, filloi të pranohet pikëpamja e pavarur e shkencave shoqërore dhe ligjet sociale të cilat deri në shekullin XVIII nuk kishin qenë të pranuar, madje në mënyrë permanente filloi

⁸⁴ Shkëputur nga Ali Yaşar Sarıbay, *Siyasal Sosyoloji*, Der Yayınları, botimi i katërt, Stamboll, 1998, fq. 5-18, 47-66. Autori i kësaj vepre është anëtar i trupit mësimor të Universitetit “Uludağ”, Bursa, Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative, dega e Administratës Publike

të shtohet numri i veprave që e pasqyronin këtë botë-kuptim të ri.

Në fakt, edhe në shekullin XVIII dukuritë sociale vazhduan të vlerësoheshin nga një spektër filozofik, organizatat shoqërore dhe marrëdhëniet njerëzore të trajtoheshin jo siç janë por si duhet të jenë. Por, mu në këtë shekull u arrit te ideja se dukuritë shoqërore me karakterin e tyre specifik varen nga ligjet natyrore që u përngajnë atyre të botës fizike. Ndërkohë, nevoja për hulumtimin e organizatave shoqërore ekzistente dhe nevoja për fiksimin e parimeve dhe normave të një rregullimi shoqëror ideal i shtyri filozofët socialë që të orientoheshin nga shkenca shoqërore.⁸⁵ Sepse pa e kuptuar natyrën komplekse që ndryshimet sociale ia japid realitetit shoqëror s'është lehtë të përcaktohet rregullimi (rendi) ideal që synohet.

Kështu, nga njëra anë u zhvilluan studimet e bazuar në vrojtime (p.sh. vepra e Montesquieu-së *Spirit i ligjeve*, 1874), nga ana tjetër përpunimi i pikëpamjes për “ligjet shoqërore” (në këtë drejtim është i rëndësishëm kontributi i A. Comte-t), madje u shfaqën përpjekjet për formimin e një teorie të përgjithshme të shkencave shoqërore (p.sh. hulumtimet e K. Marks-it).⁸⁶

Këto zhvillime të shekullit XVIII lindën dy tendencia të ndryshme në shkencën shoqërore: ajo përgjithësuese, sipas së cilës shkencat shoqërore janë një tërësi, ligjet natyrore nga të cilat varen fenomenet shoqërore vlejnë për të gjitha dukuritë dhe detyra për zbulimin dhe nxjerrjen në pah të këtyre ligjeve është detyrë e një shkence të vetme shoqërore. Përfaqësuesi kryesor i këtij qëndrimi është Auguste Comte. Sociologjinë ai e sheh si një shkencë shoqërore të përgjithshme, duke e theksuar

⁸⁵ M. Duverger, *Sosyal Bilimlere Giriş*, përkth. Ü. Oskay, 1973, fq. 9, 14.

⁸⁶ Po aty.

aspektin pozitiv të kësaj fushe shkencore së cilës ia ngarkon detyrën e *bulumtimit të ligjeve të zhvillimit historik*.⁸⁷

Pra, ashtu si para lindjes së botëkuptimit për *shkencat shoqërore* që hulumtimet lidhur me realitetin social janë përqendruar nën ombrellën e filozofisë,⁸⁸ pas shfaqjes së këtij koncepti të gjitha fenomenet shoqërore janë studiuar brendapërbrenda ombrellës së sociologjisë. Ky ishte qëllimi i Comte-t, i cili në këtë përpjekje të tij nuk është shkëputur tërësisht nga filozofia sociale; Këtë mendimtar Aron e përkufizon si “një sociolog në mes të filozofëve dhe si një filozof në mesin e sociologëve”.⁸⁹

Duhet theksuar se Comte nuk është i vetmi në këto frekuencia. Ky përkufizim mund të jepet edhe për pararendësit e tij (Saint Simon, Proudhon) si dhe për pasardhësit e tij (Marks, Durkheim). Madje mund të thuhet se dëshira për ta studuar në të njëjtën kohë atë që është dhe atë që duhet te jetë, në studimet e shkencave sociale ka qenë mjaft e përhapur deri në fillimin e shekullit XX.

Shekulli XX është simbol i tendencës përgjithësuese të shekullit XVIII dhe XIX ashtu dhe i fillimit të ndarjes së punës dhe profesionalizimit në sferën e shkencave shoqërore. Mendimi që ishte dominant në tendencën moniste të shkencave shoqërore, u zëvendësua me studimin e thellë të pjesëve përbërëse të tërësisë. Një gjë e tillë mund të arrihet vetëm në saje të disiplinave të profesionalizuara të shkencave shoqërore që korrespondojnë me çdo pjesë të realitetit social (p.sh. feja, kultura, politika etj.)

⁸⁷ R. Aron, *Main Currents in Sociological Thought*, I, Nju-Jork, 1968, fq. 102.

⁸⁸ Kjo vlen jo vetëm për shkencat shoqërore, por edhe për ato natyrore dhe pozitive. Pra, të gjitha disiplinat tuboheshin nën ombrellën e filozofisë. Është me rëndësi të theksohet se shkencat ekzakte para atyre shoqërore shpëtuan nga kjo hije. Lidhur me këtë temë shih C. Yıldırım, *Bilim Felsefesi*, Stamboll, 1972, fq. 25.

⁸⁹ Aron, *po aty.*, fq. 114.

Sociologjia e politikës është një disiplinë që ka lindur si rezultat i një pikëpamjeje të tillë. Ç'është e vërteta, mendimtarët e mëdhenj që e shënojnë historinë e mendimit politik, si Aristoteli, Machiavelli dhe Montesquieu kanë trahur çështje që janë pjesë integrale të sociologjisë së sotme të politikës. Në shekullin XIX, sociologjisë së politikës Saint Simon-i, Marks-i dhe Weber-i i kanë dhënë vepra të cilësisë themelore të kësaj discipline. Por, për shkak të arsyeve të përmendura më parë është më e qëlluar që sociologjia e politikës të konsiderohet fryt mendor i shekullit XX. Deri në këtë kohë, kjo disiplinë është përballur me rrezikun e shkrirjes në kuadër të filozofisë sociale/politike ose të sociologjisë së përgjithshme, por në shekullin XX ka filluar që ta fitojë identitetin e vet të vërtetë nën ombrellën e shkencës politike bashkëkohore.

Tani le ta ndjekim më për së afërmi këtë proces në korniza të fazave të ndryshme dhe të faktorëve që u ka dhënë atyre drejtim.

a. Bazat ideore të sociologjisë politike: Evropa

Duhet ditur se për lindjen e sociologjisë së politikës nuk ka ndikuar vetëm ndryshimi i mënyrës së kapjes së problemit (*problemstellung*) të dukurive shoqërore, pra kallimi nga trajtimi filozofik në atë sociologjik, por edhe shumë faktorë të tjera. Në këtë kontekst, përveç pyetjes se cilat janë kushtet natyrore dhe mekanizmat për jetësimin e rendit më të mirë shoqëror/politik, mund të përmenden analizat në lidhje me vazhdimësinë dhe ndryshi-

min e këtij rendi.⁹⁰ Por, në mendimin politik të Evropës, sociologjia e politikës është një disiplinë e ndërtuar mbi konceptualizimin e ndarjes *shteti-shoqëria*. *Problemstellung*-u sociologjik ka luajtur një rol të rëndësishëm në përfundimin e shëndoshë të këtij ndërtimi.

Ndarja shteti-shoqëria, është aktualizuar pas lindjes së idesë për shtetin modern. Bashkë me këtë ndryshim temë preokupuese e mendimit politik është çështja nëse shteti e trajtëson shoqërinë ose shoqëria e trajtëson shtetin.⁹¹ Ky debat që ka lindur nga çështja - ç'është ndarja e sferës shoqërore dhe sferës politike, i ndau dysh themeluesit e sociologjisë së politikës. Nga një anë, në krye me Marks-in, u tubuan ata që e përcmonin veçantinë dhe peshën e politikës dhe të institacioneve dhe proceseve të saj. Në anën tjeter u pozicionuan ata që pohonin se fuشا politike është mbizotëruese, kurse ajo shoqërore është e rëndësisë sekondare, qëndrim ky i Pareto-s, Mosca-s dhe deri diku i Schumpeter-it.⁹²

Ky polarizim lidhur me dallimin e sferës politike prej asaj shoqërore ka qenë shprehje e përplajses ideologjike ndërmjet atyre që e mbështetnin shtetin (Hegel, von Stein) dhe atyre që ishin pro shoqërisë (Saint Simon, Proudhon dhe Marks). Të parët pohojnë se shoqëria duhet të jetë nën dominimin e shtetit, kurse të dytët thonë se shteti duhet të kufizohet, të kontrollohet ose të eliminohet tërësisht nga shoqëria.⁹³

⁹⁰ S. N. Eisenstadt, "General Introduction: The Scope and Development of Political Sociology", *Political Sociology: A Reader*, ed. Eisenstadt, Nju-Jork, 1971, fq. 5.

⁹¹ W. G. Runciman, *Social Science and Political Theory*, Kembrixh, 1969, botimi i dytë, fq. 25.

⁹² Eisenstadt, *po aty*, fq. 6.

⁹³ S. M. Lipset, "Political Sociology", *Sociology Today*, vell. I, ed. K. Merton dhe të tjerët, Nju-Jork, 1959, fq. 82.

Në mesin e përfaqësuesve të qëndrimit të dytë vend të veçantë, si për nga veçantia dhe përfshirja e tezave, ashtu edhe për nga kontributi që i ka dhënë sociologjisë së politikës, zë Karl Marks-i, i cili, në fakt, nuk ka shkruar drejtpërdrejt në lidhje me subjektin e politikës. Në analizat që i ka bërë, ka konkluduar se *politika është një dukuri hixe e formësuar nga konflikti i interesit ekonomik dhe lufta e klasave*. Kështu, ai e thekson bazën shoqërore të politikës. Sipas Marks-it, politika është mjeti kryesor për sigurimin e presionit, pranimit dhe bindjes në raportin personi udhëheqës - masat e udhëhequra, një mjet i bazuar në forcë që e përcakton të qenët sundues apo i nënshtruar. E megjithatë, Marks-i pretendon se sundimi nuk është pjesë natyrore e marrëdhënieve ndërnjerëzore, se ai është veçori e shoqërive klasore të cilat janë fryt i karakteristikave specifike dhe konkrete të mënyrave të prodhimit në këto shoqëri.⁹⁴ Në këtë kontekst, shtetin ai e sheh si ndërtim të ngritur mbi synimin e vazhdimit të hegemonisë së klasave shoqërore sunduese. Sipas këtij mendimi shteti është trajtësuar nga shoqëria.

C’ë do që si te Marks-i ashtu edhe te të tjerët, polemika nëse “shteti i jep formë shoqërisë ose shoqëria shtetit”, siç cek edhe Lipset-i, meqë shteti dhe shoqëria janë trajtuar si dy organë të pavarura, është bazuar në një pyetje të gabuar.⁹⁵ Në kundërshtim me këtë, polemika e zënë ngoje e cila bën identifikimin e politikës me shtetin, ka dhënë një kontribut pozitiv për t’iu shmangur mangësisë së konceptit të shkencës tradicionale të politikës. Në saje të këtij kontributi ka filluar të pranohet qëndrimi se shteti është vetëm një nga institucionet e shumta politike dhe se këto të fundit paraqesin vetëm një grup të institucioneve shoqërore, gjë kjo që ka qenë determinante për

⁹⁴ R. Miliband, *Marxism and Politics*, Londër, 1977, fq. 17-18.

⁹⁵ Lipset, *po aty*, fq. 72.

t'i dhënë peshë sociologjisë së politikës si një disiplinë e re. Sepse, prej asaj kohe e këndeje detyrën e shpjegimit të marrëdhënieve ndërmjet institucioneve të ndryshme shoqërore e ka marrë përsipër sociologja e përgjithshme, kurse detyra e shpjegimit të raporteve mes institucioneve politike dhe të tjerave i është lënë sociologjisë së politikës.⁹⁶ Në këtë mënyrë, sociologja e politikës është bërë një degë profesionale e sociologjisë së përgjithshme dhe përfaqësuese e një botëkuptimi shumë të ndryshëm nga ai i shkencës tradicionale të politikës. Në kontekst të këtyre zhvillimeve, politika, pa marrë parasysh nëse mbisundon shtetin ose jo, ka marrë në të gjitha shoqëritë një karakter universal të identifikimit me pushtetin ekzistent.

Është me rëndësi të përmendet edhe kontributi i Weber-it në të kuptuarit e politikës si një dukuri universale. Ky kontribut pasqyrohet në të kundërtën e asaj që ka bërë sociologja e përgjithshme, në suksesin e trajtimit të pushtetit në “rrafshin politik”. Përkufizimi se “çdo grup sundues që në kornizat e kufijve të caktuar hapësinor, synimet e veta i realizon përmes një organizimi administrativ dhe që ka aftësinë t'i referohet forcës fizike quhet grup politik”, e ka sinkretizuar politikën me shtetin dhe pikëpamjen politike e ka shkëputur nga perspektiva klasike institucionale dhe juridike.⁹⁷

Përderisa në Evropë sociologja e politikës, nën ndikimin e Marks-it dhe Weber-it⁹⁸, në vitet '30 të shekullit XX e ka arritur identitetin e vet specifik,⁹⁹ ajo në Amerikë nën influencën e shfaqjes së dukurisë së “shpërmguljes së trurit” nga “kontinenti i vjetër”, ariti një vijë të veçantë të zhvillimit.

⁹⁶ Po aty, fq. 83.

⁹⁷ N. Vergin, *Siyaset Sosyolojisi*, Stamboll, pa vit botimi, fq. 15.

⁹⁸ M. Janowitz, “Political Sociology”, *International Encyclopedia of Social Sciences*, vëll. XI-XII, 1972, fq. 299.

⁹⁹ R. Bendix – S. M. Lipset, “The Field of Political Sociology”, *Political Sociology: Selected Essays*, ed. L. A. Coser, Nju-Jork, 1965, fq. 9-10.

b. Bazat ideore të sociologjisë së politikës: ShBA-të

Depërtimi i teorisë sociale evropiane në ShBA në vitet '30 të shekullit XX ka mundësuar zgjerimin e horizontit të ngushtë të sociologjisë amerikane¹⁰⁰ dhe i ka dhënë një dimension të ri shkencës politike të këtij neniqielli.¹⁰¹ Në vitet 1920-1930 në politikologjinë amerikane u shfaq një tendencë e re: një grup i politikologëve nga Universiteti i Çikagos, në krye me C. Merriam, e kundërshtuan politikologjinë klasike, në aspektin metodologjik e shtynë në plan të dytë shikimin juridik dhe historik, filluan që t'i analizojnë të dhënat me ndihmën e disiplinave si sociologjia, psikologjia, antropologjia dhe ekonomia. Më pas kjo frysma ndikoi edhe te shkencëtarët e tjerë dhe për rrjedhojë lindi shkolla e quajtur *biheviorizëm*. H. Lasswell, V. O. Key Jr., D. Truman, H. Simon, G. Almond dhe G. Catlin, duke shfrytëzuar një trajtim interdisiplinar, filluan t'i mbështesin studimet e veta në njojuritë dhe të dhënat e dukshme. Këtë zhvillim R. Dahl e përshkruan kështu: “Në aspektin historik trajtimi biheviorist në kuadër të politikologjisë është një lëvizje e protestës. Shumë politikologë amerikanë nuk ishin të kënaqur nga korniza tradicionale, në veçanti nga spektri historik, filozofik dhe përshkrues. Në këtë kontekst, trajtimi biheviorist u shfaq si një skicë që nga njësitë politike u orientua nga ekzaminimi i individëve: doli në skenë si përpjekje për t'i kuptuar aspektet e dukshme të jetës politike në saje të metodave dhe teorive të ndryshme”.¹⁰²

¹⁰⁰ R. Bendix, “Introduction”, *State and Society: A Reader in Comparative Political Sociology*, ed. R. Bendix dhe të tjera, Berkli, 1973, fq. 121.

¹⁰¹ R. A. Dahl, “The Behavioral Approach in Political Science”, *Contemporary Political Thought*, ed. J. A. Gould – V. V. Thursby, Nju-Jork, ?, fq. 121.

¹⁰² Po aty, fq. 124.

Kështu, lindi një gamë e studimeve lidhur me zgjedhësin, votimin, pjesëmarrjen politike, formimin e opiniionit publik, partitë politike, grupet e interesit, mekanizmat e vendimmarrjes etj.

Shkencëtarët e shpërngulur evropianë, të cilët zunë pozita të çmuara në departamentet amerikane të sociologjisë dhe të politikologjisë, vinin theks të veçantë në të kuptuarit e politikës mbi rëndësinë që ka referimi i teoreve sociologjike dhe psikologjike, potenconin vlerën Marks-it, Durkheim-it, Pareto-s, Mosca-s, Weber-it, Michels-it etj. Këto përpjekje kanë ndikuar në paraqitjen e fillimeve të biheviorizmit në politikologjinë amerikane (vitet '30) dhe në përhapjen e tij të mëvonshme (vitet '50). Nga ana tjetër, një grup tjetër dijetarësh shprehën një qëndrim kritik ndaj biheviorizmit. Atë ky grup dijetarësh (F. Neumann, S. Neumann, P. Lazarsfeld, H. Speier, H. Gerth, R. Bendix) biheviorozmin e shihë si shumë të ngushtë¹⁰³ dhe kërkonte që për analizimin e politikës të shfrytëzohet më tepër sociologjia. Kështu filloi të shfaqet dhe të zhvillohet sociologjia politike në Amerikë dhe grapi i përmendur i sociologëve filluan me shpejtësi dhe me kompetencë të futen në fushën e politikologeve.¹⁰⁴

Përveç kësaj, për zhvillimin e sociologjisë së politikës në ShBA kanë ndikuar edhe disa faktorë institucionalë. P.sh. "Shoqata Ndërkombëtare Sociologjike" (International Sociological Association) filloi të formojë "komitete hulumtuese (Research Committees) dhe në sa-

¹⁰³ Biheviorizmi nuk është kritikuar vetëm nga ky grup, por edhe nga politikologët amerikanë, në krye me D. Easton-in, i cili zhvillimin e teorisë politikologjike e lidh me "revolucionin biheviorist". Biheviorizmin Easton-i e sheh si të mangët për shkak të hiperfaktualizmit (*hyper factualism*). Shih: Ş. Tekeli, *David Easton'un Siyaset Teorisine Katkısı Üzerine Bir İnceleme*, Stamboll, 1976, fq. 28, 72-78.

¹⁰⁴ Dahl, *pë aty*, fq. 121.

je të përpjekjes së SHNS-së (ISA) lindi “Komiteti për sociologji të politikës”. Në fakt propozimi i parë për themelin e një komiteti të këtillë u dha nga një grup shkencëtarësh (S. Eisenstadt, M. Janowitz, S. M. Lipset, S. Rokkan) në Kongresin IV Botëror të Sociologjisë më 1959 në qytetin italian Stresa, por komiteti e filloj veprimtarinë e vet më 1960. Më 1963 në Tampere u organizua konferenca e parë ndërkombëtare mbi “Sociologjinë Politike Komparative”, që u pasua nga e dyta e mbajtur më 1965 në Kembrixh. Më 1968 u mbajt konferenca e tretë e cila është e rëndësishme për shkak të caktimit të temave specifike të hulumtimit në fushën e sociologjisë së politikës. Në këtë konferencë u formuan pesë grupe të ndryshme të punës dhe u përcaktuan këto tema që u shqyrtuan nga grupet në fjalë:

1. Sjellja komparative zgjedhore;
2. Politika studentore komparative;
3. Procesi komparativ i formimit të kombit;
4. Forcat e armatosura dhe shoqëria, dhe
5. Hulumtime komparative të bashkësive.¹⁰⁵

S'do mend se këto aktivitete institucionale i kanë nxitur marrëdhëniet në fushën e shkencës dhe hulumtimet krahasimtare. Nga ana tjeter, ato kanë luajtur rol të rëndësishëm edhe në pranimin e sociologjisë politike në nivel ndërkombëtar. Një dobi tjeter qëndron në caktimin e kufirit të sociologjisë politike me politikologjinë, në fiksimin gradual të përbërjes së disiplinës së parë dhe në pamjen e sotme që ka marrë ajo.

¹⁰⁵ Lidhur me këtë çështje shih: S. Rokkan, “International Cooperation in Political Sociology”, *Mass Politics: Studies in Political Sociology*, ed. E. Allardt - S. Rokkan, Nju-Jork, 1970.

c. Përfshirja e sociologjisë politike dhe kufiri i saj me politikologjinë

Problematika (politika) së cilës i referohen sociologjia e politikës dhe politikologjia e bën të paqartë kufirin midis këtyre dy shkencave, kurse objektin e bën thuajse të njëjtë.

Shkaku kryesor i kësaj gjendjeje, përveç të qenët të sociologjisë politike degë e sociologjisë, është edhe fakti se ajo është element përbërës i politikologjisë bashkëkohore.¹⁰⁶ S. Rokkan-i thotë se sociologjia e politikës është një disiplinë meleze pa identitet të qartë. Sipas tij, kjo është një dobësi nga e cila burojnë forca dhe risia.¹⁰⁷

Le të theksojmë se paqartësia e kufirit ndërmjet këtyre dy disiplinave shkencore dhe ngashmëria e subjektit të cilin e hulumtojnë nuk na shpien në përfundimin se s'ka kurrfarë dallimi mes tyre. Nëse u referohemi shkrimeve të autoriteteve në sferën e sociologjisë politike edhe të politikologjisë do t'i vërejmë qartë pikat e dallimit.

Për shembull S. M. Lipset, në një artikull të shkruar në vitin 1959 politikologjinë e përkufizon si një “disiplinë shtetërore” dhe shton: “Politikologjia merret me funksionet pozitive dhe të qarta të institucioneve politike, kurse sociologjia politike është një disiplinë radikale që merret me konfliktin dhe ndryshimet shoqërore. Kjo e

¹⁰⁶ Politikologjinë e sotme Greer e sheh si një shkencë të përgjithshme sociale që zbatohet në dimensionin politik-udhëheqës të shoqërisë. I mendimit të njëjtë është edhe Braungart. Shih: Greer, “Sociology and Political Science”, *Politics and Social Sciences*, ed. S. M. Lipset, Nju-Jork, 1969, fq. 62; R. G. Braungart, “Political Sociology: History and Scope”, *Handbook of Political Behavior*, vell. V, S. Long, Nju-Jork, 1981, fq. 3.

¹⁰⁷ Rokkan, *po aty*, fq. 19. Të njëjtën gjë e thotë edhe Bendix. Shih: Bendix dhe të tjera, *po aty*, fq. 10.

fundit i trajton dhe i thekson më gjerë funksionet e fshehta, të patraktshme, dimensionet jofunksionale të politikës. Për këtë arsy, politikologja synon efektivitetin e administratës publike dhe të organizatave menaxhuese, kurse sociologjia politike merret me burokracinë, në vëçanti me presionin dhe detyrimin që ekziston në natyrën e burokracisë”.¹⁰⁸

Më vonë, R. Bendix dhe S. M. Lipset, në një studim të përbashkët, i kanë përcaktuar kështu pikat kufitare të këtyre disiplinave: “Sociologjia politike, ashtu si politikologjia merret me ndarjen dhe zbatimin e pushtetit në shoqëri. Por, sociologjia e politikës, për dallim nga politikologjia, nuk merret me aspektet institucionale të ndarjes dhe aplikimit të pushtetit, por ato i merr si të dhëna. Kjo disiplinë e ka si pikënisje shoqërinë dhe e hulumton çështjen se si shoqëria ndikon mbi shtetin, kurse politikologjia, duke u nisur nga shteti e sqaron çështjen e ndikimit të shtetit mbi shoqërinë”.¹⁰⁹

Sociologjinë politike L. Coser e sheh si një degë të sociologjisë dhe si një disiplinë e cila sa me shkaqet dhe pasojat shoqërore të ndarjes së pushtetit, merret edhe me konfliktet sociale dhe politike që shkaktojnë ndryshime në ndarjen e pushtetit. Sipas tij, përderisa politikologjia koncentrohet mbi fushën politike, sociologjia politike e ka si subjekt të vetin të trajtimit të kuptuarit e procesit politik dhe shpjegimin e relacionit ndërmjet strukturës shoqërore dhe politikës. Vështruar nga ky kënd, mund të themi se sferë kryesore interesimi e sociologut të politikës janë raportet ndërmjet shtresimit shoqëror dhe sjelljes politike dhe ndërmjet ndarjeve etnike dhe procesit politik.¹¹⁰

¹⁰⁸ Lipset, *po aty*, fq. 83.

¹⁰⁹ Bendix-Lipset, *po aty*, fq. 26.

¹¹⁰ L. A. Coser, “Introduction”, *Political Sociology: Selected Essays*, fq. 1-3.

Hamilton dhe Wright pohojnë se sociologët e politikës dhe politikologët janë dy grupe të veçanta që e studojnë sistemin politik nën dritën e kornizave të ndryshme teorike. Ata, më tutje shtojnë: “Sociologët e politikës ndalen mbi ndarjet në shoqëri, e fokusojnë çështjen e ndikimit të këtyre ndarjeve mbi strukturën politike dhe të influencimit të tyre nga struktura politike. Politikologët i hodhën pas shpinës ndarjet dhe merren më tepër me “lojën politike (*game of politics*). Shkurt, përderisa të parët fokusohen mbi konfliktin social dhe mbi mjetet që e gjenerojnë dhe zgjidhin atë, të dytët e hulumtojnë stabilitetin, vlerat dhe qëndrimet që e sigurojnë atë”.¹¹¹

Disa dijetarë të shkencave shoqërore pohojnë se kufiri midis këtyre dy disiplinave mund të përcaktohet si pas përkufizimit të fenomenit të studiuar si ndryshor (variabël) i pavarur ose i varur. Pra, për sociologun, ndryshor i varur është struktura politike, kurse për politikologun përbërja shoqërore. Në përgjithësi, sociologja i trajton si ndryshorë shpjegues gjendjet shoqërore-strukturore, kurse politikologja gjendjet politike-strukturore. Në këtë kontekst, kur flasim për sociologjinë politike, para së gjithash nënkuftojmë faktin se epiqendra e kornizës sonë konceptuale, e afritimit dhe mënyrës së hulumtimit është sociologjike.¹¹² Siç shprehet M. Duverger, “politikologja e parapëlqen një qëndrim të gjerë shkençor me të cilin ngjarjet politike trajtohen si nga prizmi i institucioneve juridike, i historisë, gjeografisë njerëzore, ekonomisë, demografisë etj. ashtu edhe nga ai drejtpër-

¹¹¹ R. F.Q. Hamilton – J. Wright, *New Directions in Political Sociology*, Indianapolis, 1975, fq. 5.

¹¹² Shih: C. Sartori, “From Sociology of Politics to Political Sociology”, *Politics and Social Sciences*, fq. 65-67 A. Effart, “Power to the Paradigms: An Editorial Introduction”, *Perspectives in Political Sociology*, ed. A. Effart, Nju-Jork, pa vit botimi, fq. 7.

drejt sociologjik, kurse sociologja e politikës, përkundrazi, e parapëlqen sidomos qëndrimin e fundit".¹¹³

Një sqarim sistematik ka bërë edhe R.G. Braungart-i. Sociologjinë politike ai e cilëson si përpjekje për ta kuptuar dhe shpjeguar shoqërinë politike, si një disiplinë që e studion raportin ndërmjet shoqërisë dhe politikës. Sipas tij, tri temat analitike që bëjnë pjesë në sferën e interesimit të sociologjisë politike janë:

1. Rrënjet shoqërore të politikës.
2. Perbërja e politikës dhe procesi politik, dhe
3. Ndikimet e politikës mbi shoqërinë dhe kulturen.¹¹⁴

Duke u nisur prej këtu, përfshirjen konceptuale të sociologjisë politike Braungart-i mundohet ta shpjegojë duke e modelizuar nga këndi i shkaqeve që e gjenerojnë ndërveprimin shoqëror dhe politik.

Modeli i parë bazohet në sistemin e thjeshtë të ndërveprimit (*simple exchange system*) ndërmjet shoqërisë dhe politikës dhe formulohet kështu:

S (shoqëria) -----> P (politika)

Modeli i dytë i merr për bazë ndërveprimet dyndryshorëshe (*bivariate causal arrangements*).

(S--->P), (P --->P), (P--->S)

Modeli i tretë bazohet në lidhje shumëndryshorëshe seriale (*sequential multivariate relationship*).

(S---> P---> S)

Këto tri modele Mendimtari i përmendur i pagëzon sipas pikave kyç të temave në të cilat fokusohen. Sipas kësaj, modeli i parë korrespondon me "rrënjet shoqërore të politikës", modeli i dytë me "perbërjen politike të po-

¹¹³ M. Duverger, *Siyaset Sosyolojisi*, përkth. §. Tekeli, Stamboll, 1982, botimi i dytë, fq. 5.

¹¹⁴ Braungart, *po aty*, fq. 3.

litikës”, kurse modeli i tretë me “ndikimin e politikës mbi shoqërinë”.¹¹⁵

a. Rrënjet shoqërore të politikës (S--->P): Sipas Braungart-it, kjo pikëpamje e cila ende është më e popullarizuara në sferën e sociologjisë politike e hulumton ndikimin e strukturës shoqërore mbi organizimin dhe ndarjen e pushtetit. Fushat e ekzaminimit janë këto: “Pushteti i komunitetit”, “Ndikimi i strukturës shoqërore mbi politikën” (Bazat shoqërore të pjesëmarrjes politike; Dimensionet shoqërore dhe psikologjike të veprimit politik), “Burimet e ndryshimit shoqëror dhe politik”.¹¹⁶

b. Përbërja e politikës (P --->P): Është një pikëpamje lidhur me burimet politike. E trajton ndikimin e fuqisë ligjdhënëse, ekzekutive dhe gjyqësore ndaj strukturës së pushtetit, formimit dhe ndarjes së tij. Fushë hulumtimi i këtij trajtimi janë “elita dhe sistemet politike”, “zhvillimi politik” dhe “tipet e sistemit politik”.¹¹⁷

c. Ndikimi i politikës ndaj shoqërisë (P--->S): Kjo pikëpamje, që ka fituar dalngadalë famë si te sociologët ashtu edhe te politikanët, përqendrohet në aspektet e ndikimit të politikës mbi shoqërinë. Fushat në të cilat aplikohet më së shpeshti kjo pikëpamje janë “ekonomia politike”, “vlerësimet rrëth opinionit-politikës” dhe “analiza politike”.¹¹⁸

Braungart-i edhe pse si bazë i merr këto tri pikëpamje, në thelb ia mban anën modelit qarkullues. Sipas tij “në paradigmën e sociologjisë politike bazë janë proceset politike të faktorëve shoqërore dhe ndikimi i tyre

¹¹⁵ Braungart, *po aty*, fq. 25-60.

¹¹⁶ *Po aty*, fq. 36-40.

¹¹⁷ *Po aty*, fq. 40-47.

¹¹⁸ *Po aty*, fq. 47-55.

ndaj politikës dhe shoqërisë.¹¹⁹ Këtë mund ta formulojmë kështu: (S---> P---> S)

Duket qartë se evaluimi i sociologjisë politike nga ana e Braungart-it, i kalon kornizat e shumë dijetarëve të përmendur më parë me përjashtim të G. Sartori-t. Ai nuk flet vetëm për një ndikim në drejtimin shoqëria-politika, por edhe për politikën e politikës (*the politics of politics*) si dhe për ndikimin e politikës mbi shoqërinë. Këtë çështje e ka trajtuar edhe G. Sartori në një artikull të tij të vitit 1969. Në vend për sociologjinë e politikës (*sociology of politics*) Sartori flet për një paradigmë të re, për sociologjinë politike (*political sociology*) dhe shton se ajo është një disiplinë që i bashkon pikat e fushës sociologjike dhe asaj politikologjike. Por, duke përkujtuar se para-digma e re simbolizon një qëllim drejt së ardhmes nga prizmi i bashkëpunimit interdisiplinar, ky mendimtar, shton: “Përpjekja e sotme e quajtur sociologji politike nuk është gjë tjetër pos sociologjisë së politikës e cila ka kuptimin e mohimit të politikologjisë. Nëse merremi me sukseset interdisiplinare, duhet ta fshijmë qëndrimin se sociologjia politike është nëndegë e sociologjisë dhe duhet ta veçojmë sociologjinë politike nga sociologjia e politikës”.¹²⁰

Siq shihet, nga këndi i trajtimit dhe përfshirjes, sociologjia e politikës dallohet nga politikologjia në shumë pika të rëndësishme dhe e ndryshon identitetin e vet në kuadër të bashkëpunimit mes shkencave shoqërore. Edhe pse nuk ka zënë vend mirë, këtë identitet të ri e përfaqëson sociologjia politike. Siq pohon edhe Sartori, “nëse sociologjia e politikës i trajton arsyet jopolitike

¹¹⁹ Po aty, fq. 68.

¹²⁰ Sartori, *po aty*, fq. 67-69. Në këtë temë mund të konsultohet edhe artikulli në vijim: A. Y. Sarıbay, “Siyaset(in) Sosyolojisi, Siyaset(in) Bilimi, Siyasal Sosyoloji”, *İktisat ve Sosyal Bilimler*, vël. II (1981), fq. 2.

(sociale) të këtyre sjelljeve politike, sociologjia politike është e detyruar t'i përfshijë shkaqet politike të sjelljeve. Atëherë, sociologjia politike e vërtetë do të jetë një disiplinë që përsëri në formë të ndryshorit e trajton çdo pjesë të faktorit interdisiplinar dhe i studion në hollësi modelet e zgjeruara dhe kufijtë interdisiplinarë”.¹²¹

¹²¹ Sartori, *po aty*, fq. 92.

Kultura politike

a. Koncepti “kultura politike” në literaturën e politikës

Ata që bëjnë analiza duke e vënë në vatër konceptin e kulturës politike kanë një qëllim të vetëm përcaktimin e tipit kulturor që kontribuon në funksionimin e sistemit politik. Lidhur me kulturën politike jepen përkufizime të ndryshme. Me të, për shembull, kur përmendet kultura politike ndonjëherë nënkuptohen traditat politike të një kombi ose veçoritë që u japidin kuptim institacioneve publike. Përveç kësaj, në kuadër të sintagmës së përmendur bëjnë pjesë edhe rregullat jozyrtare që e shënojnë jetën politike, qëllimet të cilat i zë ngoje ideologjia politike mbisunduese. Kulturës politike i atribuohen shumë cilësi duke filluar nga paragjykimet politike, metodat politike, shpirti politik e deri te ajo që është legale apo jolegale.

G.M. Patrick pohon se ekzistojnë katër koncepte lidhur me kulturën politike:

1. Konceptimi *objektiv* autor iu të cilit është D. Easton.
2. Konceptimi *psikologjike apo subjektive* të G. Almond-it, B. Powel-it dhe S. Verba-s.
3. Konceptimi *heuristik* i L.W. Pye-s.

4. Konceptimi i gjithanshëm i R.R. Fagen-it dhe i R.C. Tucker-it.¹²²

Konceptimi objektiv i kulturës politike bazohet në marrëdhëniet e kulturës politike me sistemin politik. Në këtë rast me objektivitet nënkuptojmë tërësinë, që është e pavarur nga individët, që i tejkalon, por që në të njëjtën kohë i bashkon ata. Sipas Easton-it çdo shoqëri i ka totemët dhe tabutë e veta politike-kulturore të cilët konsiderohen se kanë synime të shenjta dhe janë të paprekshëm. Të njëjtit janë të padiskutueshëm dhe ndaj tyre duhet treguar respekt të veçantë. Në këtë kontekst, mund të thuhet se kultura politike paraqet një tërësi të mendimeve, ndjenjave, sjelljeve, bindjeve, ideve, normave dhe vlerave. Të hyrat dhe performancat e sistemit politik, - meqë anëtarët e shoqërisë sistemin e perceptojnë si një forcë autoritare dhe detyruese, - janë nën ndikimin e kulturës politike. Pra, objektivisht, performancat e një sistemi të caktuar janë, objektivisht ngushtë të lidhura me adaptimin e kulturës politike gjegjëse.¹²³

Konceptimi psikologjik apo subjektiv i kulturës politike paraqet antipodin e atij objektiv. Domethënë, nuk është koncept i pavarur nga individët, një koncept që i kapërcen ata, përkundrazi, është një koncept kulturor që bazohet në individin ose subjektin. P.sh. G. Almond, B. Powell dhe S. Verba në studimet e tyre individuale dhe kolektive e cilësojnë kulturën politike si tërësi të qëndrimeve dhe prirjeve të pjesëtarëve të një sistemi politik ndaj politikës. Pra, kur flasim për kulturën politike, nën-

¹²² G. M. Patrick, "Political Culture", *Social Science Concepts: A Systematic Analysis*, ed. G. Sartori, Beverli Hills, 1984, fq. 271-280.

¹²³ D. Easton, *A Systems Analysis of Political Life*, Nju-Jork, 1965.

kuptojmë njohjet, ndjenjat dhe gjykimet e pjesëtarëve të një sistemi politik.¹²⁴

Konceptimi heuristik bazohet në të dukshmen. Sipas këtij konceptimi përgjigjen lidhur me pyetjen se ç'është në të vërtetë kultura politike mund ta gjejmë vetëm duke hulumtuar. Ky është qëndrim i Pye-s. Sipas tij, kultura politike ngërthen në vete traditat e një shoqërie, shpirtin e institucioneve publike, lidhjen e të qenët qytetar, arsyetimin kolektiv, metodën dhe kodet e liderëve. Pye-ja nuk e mohon rëndësinë dhe vlerën e prirjeve psikologjike në të cilat ngul këmbë konceptimi subjektiv. Ai pohon se shoqëria është fryt i historisë kolektive dhe e historive individuale të njerëzve.¹²⁵ Me hulumtimet që i ka bërë mbi disa shoqëri si ajo kinezë dhe burmase Pye-ja na ka treguar se si mund të zbulohet në mënyrë konkrete kultura politike.¹²⁶

Me kulturë politike konceptimi i gjithanshëm, nënkupton tërësinë e cilësive që e bëjnë këtë koncept. Si R. R. Fagen¹²⁷ ashtu edhe R. C. Tucker¹²⁸ e kanë përkufizuar kulturën politike si tërësi të lidhjes së sjelljeve të individëve dhe përbërjeve të tyre kognitive dhe të faktorëve efektivë psikologjikë që ndikojnë në drejtimin e sjelljeve

¹²⁴ G. Almond, *Comparative Politics: A Developmental Approach*, Boston, 1966; G. Almond-B. Powell, Jr (eds), *Comparative Politics Today: A World View*, Boston, 1980.

¹²⁵ L. W. Pye, "Introduction: Political Culture and Political Development", *Political Culture and Political Development*, eds: L. W. Pye - S. Werba, Princeton, 1965.

¹²⁶ Shih: L. W. Pye, *Politics, Personality and Nation Building: Burma's Search for Identity*, Nju Hevën, 1962; *The Spirit of Chinese Politics*, Kembrixhi, 1968.

¹²⁷ R. P. Fagen, *The Transformation of Political Culture in Cuba*, Stenford, 1969.

¹²⁸ R. C. Tucker, "Culture, Political Culture, Communism", kumtesë e lexuar në konferencën nën titull *Political Culture and Communist Studies*, 21 nëntor 1971.

të tyre. Ky është konceptualizimi më i gjerë i kulturës politike.¹²⁹

Prej katër kategorive të shtjelluara, në politikologji përdoret më tepër kategoria subjektive apo psikologjike. Edhe ky punim, në të cilin në vijim do të trajtohet edhe konceptualizimi i kulturës politike si sistem i simboleve, bart në vete gjurmë të konceptimit psikologjik dhe në saje të tij përbën një tërësi.

b. Kultura politike si një sistem simbolesh

1. Themeli psikologjik

Sic cekëm më parë, kulturën politike konceptimi psikologjik e bazon në subjektin. Duke u nisur nga kjo themi se tërësinë e qëndrimeve, bindjeve dhe ndjenjave të pjesëtarëve të një kombi lidhur me politikën e quajmë kulturë politike. Duhet pasur parasysh se në formimin e historisë së një etnosi rol të rëndësishëm luajnë kultura shoqërore, ekonomike dhe ajo politike. Qëndrimet e trajtësuara nga përvojat e së kaluarës kanë ndikim me peshë në veprimet politike të së ardhmes. Individët mund të veprojnë duke mësuar dhe të mësojnë duke vepruar.¹³⁰

Në sferën e formimit të qëndrimit të individit ndaj objekteve politike ndikojnë tre faktorë:¹³¹ ai njohës (*cognitive*), ndiesor (*affective*) dhe vlerësues (*evaluative*).

¹²⁹ Patrick, *pø aty*, fq. 266.

¹³⁰ G. A. Almond-B. Powell, Jr, *Comparative Politics: System Process and Policy*, Boston, 1978, botimi i dytë, fq. 25.

¹³¹ *Pø aty*, fq. 26.

Individ mund të ketë ca njohuri për personat kryesorë të sistemit politik dhe çështjet e ndryshme të këtij lëmi. Këto njohuri janë pjesë plotësuese e adaptimit të individit ndaj sistemit gjegjës.

Përveç kësaj, njeriu nën ndikimin e familjes dhe të shokëve, mund që ta refuzojë emocionalisht sistemin, mund që të mos i përbahet asaj që atij i imponohet përmes autoriteteteve. Ai mund ta vlerësojë sistemin nga këndi i moralit. Pikëpamjet e tij lidhur me demokracinë mund ta shpien deri te përfundimi se sistemi nuk u përgjigjet kërkeseve të tija politike.

Në procesin e marrjes së qëndrimit ndaj sistemit, për të cilin ai njeriu duhet të zotërojë njohuri, ndikojnë tre faktorët e sipërpërmendur (njohës, ndiesor dhe vlerësues), të cilët janë ngushtë të lidhur ndërmjet. Njohuritë të cilat personi i ka për sistemin mund të jenë të drejtuara nga ndjenjat, por ndodh edhe e kundërtë, ndjenjat të jenë të determinuara nga njohuritë.¹³² Një gjë duhet pranuar: janë të domosdoshme njohuritë minimale mbi të cilat do të bazohen gjykimet apo ndjenjat tonë. Rëndësia e diturisë e përcakton edhe tipin e kulturës politike. S’do mend se çështja mund të vështrohet edhe nga ana e kundërt. Tipi i kulturës politike mund të përcaktojë rëndësinë e diturisë, mund ta orientojë lidhjen e saj me faktorët ndiesorë dhe vlerësues.

Konceptimi psikologjik parasqeh tre tipa kulturorë:

1. Tipin rajonal,
2. Tipin pasiv, dhe
3. Tipin pjesëmarrës.¹³³

Në *kulturën politike rajonale*, personi ka shumë pak ose fare s’ka njohuri për sistemin politik jashtë fshatit dhe fisit. Në këtë tip të kulturës njeriu nuk di gjë për

¹³² Po aty.

¹³³ Po aty, fq. 35.

ndikimin e tij të mundshëm ndaj sistemit politik e as për detyrat që i ka ndaj tij. Pra aspekti njohës, ndiesor dhe vlerësues i aktorit politik lidhur me sistemin politik janë afër zeros.¹³⁴

Në shoqëritë ekonomikisht të zhvilluara në të cilat niveli i shkrim-leximit është shumë i lartë dhe ku mjetet e komunikimit masiv kanë ndikim të madh, është rëndë të gjendet tipi rajonal i kulturës politike. Ky tip, pra, është veçori e shoqërive tradicionale dhe kalimtare.

Në *tipin pasiv*, personi e percepton ndikimin ekzistues ose të mundshëm të sistemit politik në jetën e tij dhe veten e sheh si pjesë të këtij sistemi. Por, roli i tij në jetën politike është pasiv dhe orientohet nga qeveria. Edhe pse ka preferenca politike, qëndrime pozitive apo negative ndaj udhëheqësisë, edhe pse ka koncept për regjimin dhe pushtetin, ai nuk është pjesëmarrës politik.

Në *kulturën politike participuese* individi është i vetëdijshëm për procesin politik dhe ka vullnet të marrë pjesë në politikë. Ç'është më e rëndësishmja - në këtë tip të kulturës individi ka aftësi t'i shfrytëzojë mundësitë e pjesëmarrjes, zotëron ndjenja të aktivitetit.

Sic shihet, pa marrë parasysh tipin e kulturës politike, gjithherë në plan të parë janë qëndrimet, bindjet dhe vlerësimet e individëve. Kjo është një mangësi e rëndësishme e konceptimit psikologjik, sepse kultura është ngushtë e lidhur me ekzistencën e kolektivitetit. Me fjalë të tjera, individët kanë qëndrime, bindje dhe vlerësime, por jo edhe kulturë. Kultura bazohet në cilësitetë e kolektiviteteve si kombi, krahina, klasa, etniteti, organizata formale, partia e kështu me radhë.¹³⁵

¹³⁴ S. P. Huntington – J. I. Dominguez, *Siyasal Gelişme*, përkth. E. Özbudun, Ankara, 1986, fq. 20.

¹³⁵ D. J. Elkins - R. E. B. Simeon, "A Cause in Search of Effect on What Does Political Culture Explain?", *Comparative Politics*, 11/2 (1969), fq. 129.

Përfaqësues kolektivë të jetës grupore ose bashkësinore janë simbolet, të cilat veprojnë si forcë integruese; ato i lidhin njerëzit në një tërësi dhe krijojnë solidaritetin, parakusht ky i kolektivitetit.¹³⁶ Për më tepër, simbolet e orientojnë aktorin, i ndihmojnë atij në *kuptimësimin* e botës së paqartë politike.¹³⁷

Kulturën politike mund ta kuptojmë më së miri duke e analizuar në mënyrë sistematike, gjë kjo që ka kuptimin e vështrimit të kulturës politike si sistem të simboleve politike.¹³⁸

Si përfundim mund të themi se kulturën politike s'mund ta kuptojmë e as mund të flasim për të pa i njo-hur simbolet si përfaqësues kolektivë.

2. Kulmi simbolik

Simbolet si përfytyrime mendore ua sigurojnë njerëzve mjetet e kuptimësimit, i përcaktojnë rrugët e shprehjes së kuptimeve të veçanta që i ka bashkësi.

Ato kanë tri qëllime kryesore:¹³⁹

1. *Ekonomia mendore*: Rezymimi, veprimi i indeksimit të diturive dhe të ngjarjeve të përjetuara. P.sh. politika ekonomike e zbatuar në ShBA në kohën e kryetarit Ronald Reagan është shprehur përmes një sintagme të vetime “Reagan economics”.

2. *Plotësimi i nevojës së komunikimit*: P.sh. emblema në jakën e maturantëve të një shkolle, në jakën e tifozëve të

¹³⁶ R. E. Klatch, “Of Meanings and Masters: Political Symbolism and Symbolic Action”, *Polity*, 21/1 (1988), fq. 139.

¹³⁷ *Po aty*, fq. 140.

¹³⁸ L. Dittmer, “Political Culture and Political Symbolism”, *World Politics*, 29/4 (1977), fq. 566.

¹³⁹ C. D. Elder-R. W. Cobb, *The Political Uses of Symbols*, Nju-Jork, 1983, fq. 31-32.

një klub futbollistik mund të jetë mjet i komunikimit më të lehtë ndërmjet dy vetave që s’ë njojin fare njëri-tjetrin.

3. Përaktimi dhe verifikimi i identiteteve shoqërore-politike: Në këtë kategori mund t’i fusim himnin kombëtar, ceremonialin para flamurit, përkujtimin e ditëvdekjes së liderit kombëtar, kremitimin e ditës së formimit të shtetit etj.

Simbolet njerëzit i nxjerrin nga ambienti i jetës së përditshme, i bashkojnë me kolektivitetin dhe e riafirmojnë besimin ndaj bashkësisë politike.¹⁴⁰ Duke e bërë këtë e organizojnë realitetin kompleks të jetës shoqërore dhe e luajnë rolin e hartave kognitive, të cilat aktorëve të jetës politike u shërbijnë si busullë dhe e kuptimësojnë botën politike.¹⁴¹ Ndarjet dhe cilësimet “konservator”, “liberal”, “i majtë” dhe “i djathhtë” mund të quhen etiketa të cilat e lehtësojnë këtë kuptimësim. Si shembull konkret në lidhje me rolin e këtyre etiketave mund ta marrim Turqinë.

Sherif Mardin-i në një artikull të tij¹⁴² pohon se në Turqi që moti si formë më serioze e radikalizmit është antifetarizmi. Sipas tij, askush që dëshiron reforma të gjera shoqërore duke u mbështetur në fe nuk konsiderohet i majtë, kurse çdo antifetar që e mbron pronën private dhe nismën e lirë konsiderohet i majtë.

Shembulli i përmendur, na flet jo vetëm për faktin se simbolet (në këtë rast të qenët antifetar ose jo) na mundësojnë kuptimësimin e njerëzve me të cilët komunikojmë, por flet edhe për raportet e simboleve me ideologjitetë dhe sistemet besimore. Në këtë drejtim është me rëndësi në ç’kushte simbolet shndërrohen në ideologji ose në sisteme të besimit. Në vazhdim do të mundohemi t’i përgjigjemi kësaj pyetjeje.

¹⁴⁰ Klatch, *po aty*.

¹⁴¹ C. Geertz, “Thick Description: Toward an Interpretative Theory of Culture”, *The Interpretation of Cultures*, Nju-Jork, 1973.

¹⁴² Ş. Mardin, “Siyasal Sözlüğümüzün Özellikleri: 1. Faşizm”, *Siyasal ve Sosyal Bilimler*, Stamboll, 1990, fq. 142.

Raportet mes kulturës politike, ideologjisë dhe bindjes politike

Më sipër kemi cekur se orientimi drejt simboleve ka dimensionin e vet emocional dhe njoħeſ. Dimensioni i parë nënkuption drejtimin dhe shpeshtesinë e ndjenjave të aktorit lidhur me simbolin, kurse i dyti domethenien të cilën e nxit objekti te vetë aktori.

Simboleve aktori mund t'u japë dy kuptime kognitive:¹⁴³

1. Të pavarur (substantiv) dhe
2. Asociativ.

Kuptimi i pavarur bazohet në bindjet dhe vlerësimet e aktorit, të cilat janë rezultat i socializimit dhe përvojave jetike rrreth botës së jashtme dhe mënyrës së funksionimit të saj. *Kuptimi asociativ*, paraqet kuptim që del nga vetëkonceptimi i aktorit dhe nga grapi ose bashkësia me të cilën ai e identifikon vetveten. Me shprehjen vetëkonceptim nënkuptojmë përgjigjen e pyetjes “kush jam unë”. Kuptimi asociativ mund të cilësohet si shprehje e pozitave që janë rezultat i raportit të aktorit me aktorët e tjerë dhe grupet e ndryshme, të cilin ai e shfrytëzon si pikë reference.

Nëse animi i aktorit ndaj një simboli bart veçori njoħeſe, mund të thuhet se lidhshmëria me simbolin ka ka-

¹⁴³ Elder-Cobb, *po aty*, fq. 42.

rakter ideologjik.¹⁴⁴ Kështu, ideologjinë mund ta konsiderojmë si një nënkategori të shfaqjes dhe përcjelljes së ndërtimeve simbolike kolektive.¹⁴⁵

Roli i ideologjisë në përcaktimin e detyrave morale¹⁴⁶ e themelon edhe relacionin me sistemin e bindjeve. Në këtë kontekst, me sintagmën sistem bindjesh nënkuptojmë tërësinë e ideve dhe qëndrimeve të cilat janë të lidhura ndërmjet tyre në aspekt të funksionit.¹⁴⁷

Me frazën sistemi i bindjeve politike duhet nënkuptuar tërësinë e bindjeve lidhur me politikën. Sistemet e bindjeve politike ua tregojnë aktorëve rrugën lidhur me atë se cili sistem politik është i moralshëm ose i drejtë. Për shembull, sistemi i bindjeve hyn në punë edhe në vlerësimin e veprave të sunduesit, gjë kjo që është bazë për respektimin ose mosrespektimin e tij.¹⁴⁸

Atëherë mund të themi se sistemi i bindjeve paraqet një kriter të legjitimitetit në sferën e kryerjes së detyrave morale ndaj komunitetit politik; mund të shtojmë, po kështu, se sistemi i përmendur bën pjesë në kuadër të ideologjisë.

Sistemi i bindjeve ka dy dimensione: atë njohës dhe ndiesor. Dimensioni i parë mund të shpjegohet si i mbyllur, domethënë ai nuk u nënshtrohet argumenteve dhe polemikave, ose i hapur, gjegjësisht i pranon argumentet dhe polemikat. Dimensioni ndiesor mund të jetë i cilësisë së fortë osë të dobët. S'ka dyshim se mes këtyre dy dimensioneve ekziston një lidhshmëri e fortë e cila e determinon edhe tipin e sistemit të bindjeve politike. G.

¹⁴⁴ Po aty, fq. 59.

¹⁴⁵ R. Wuthnow, "Comparative Ideology", *International Journal of Comparative Sociology*, 22/3-4 (1981), fq. 121.

¹⁴⁶ Po aty, fq. 123.

¹⁴⁷ P. E. Converse, "The Nature of Belief Systems in Mass Publics", *Ideology and Discontent*, ed. D. Apter, Nju-Jork, 1964, fq. 207.

¹⁴⁸ E. Kalaycıoğlu, *Çağdaş Siyasal Bilim*, Stamboll, 1984, fq. 191.

Sartori, duke u bazuar te R. Dahl-i, ka gjetur te dy dimensionet e përmendura dhe raportet ndërmjet veçorive të këtyre dimensioneve katër elemente të bindjes politike.

Illustrimi 1. Elementet e bindjes politike



Adaptuar nga G. Sartori, "Politics, Ideology and Belief Systems", *American Political Science Review*, 63 (1969), f. 404.

Në këtë ilustrim shohim se sistemi i bindjeve politike, në të cilin dimensioni kognitiv është i mbyllur, kurse ai ndiesor i fortë, korrespondon me *tipin e fiksuar*, kurse ai me dimensionin njohës të hapur dhe atë ndiesor të fortë korrespondon me *tipin e shëndoshë*. Te tipi i fiksuar elementi i bindjes politike është i ashpër, dogmatik, bart karakteristika që nuk e përfillin argumentin dhe polemikën. Tipi jofleksibil tregon respekt të ulët ndaj argumentit dhe polemikës. Tipi i shëndoshë është i hapur ndaj dyshes së përmendur, pra parimisht ka mundësi të ndryshojë. Tipi fleksibil duke qenë i dobët, është i hapur ndaj provave dhe polemikës dhe mund të ndryshojë.¹⁴⁹


Elementet kognitive të cilat i ka aktori ndihmojnë krijimin e harmonisë mes qëndrimeve dhe shpresave politike, e pengojnë rënien në kontradiktë dhe zotërimin e qëndrueshmërisë logjike. Por, nëse aktori ka dy sisteme të bindjeve, është e mundur të lindin kontradikta logjike. Sepse, s'mund të thuhet se gjithmonë ekziston harmoni mes gjendjes subjektive dhe objektive logjike.¹⁵⁰

¹⁴⁹ G. Sartori, "Politics, Ideology and Belief Systems", *American Political Science Review*, 63 (1969), fq. 404-405.

¹⁵⁰ Kalaycioğlu, *po aty*, fq. 187.

Në këtë rast, aktori lëkundet mes qëndrimit *ideologjik* dhe atij *pragmatik*. Për ta kuptuar këtë duhet shikuar natyrën e raporteve mes sistemit të bindjeve të aktorit dhe elementeve kognitive dhe emocionale. Këtë gjendje, duke u bazuar te Sartori, mund ta shpjegojmë kështu:

Ilustrimi 2. Lidhja mes qëndrimeve ideologjike dhe pragmatike të aktorit



Adaptuar nga artikulli i njëjtë i Sartori-t, f. 405.

Sic shihet nga ky ilustrim, aktori i cili në kuadër të sistemit të bindjeve politike, i orientuar drejt një simboli, me njohje të mbyllur, por ndjenja të forta, quhet tip ideologjik. T'i biem drejt: në këtë rast sistemi i bindjeve të aktorit është shndërruar në ideologji. Në kundërshtim me këtë, aktori që ka njohje të hapur, por ndjenja të dobëta, quhet tip pragmatik.


Meqë qëndrueshmëria logjike e sistemit të bindjeve përcaktohet nga elita, aktorët që hyjnë në ndërveprim politik mund t'i ndajmë në dy kategori të përgjithshme: elita dhe masa. Midis këtyre dy kategorive ekzistojnë dallime të mëdha me pasoja të dukshme.

Kultura politike e élites dhe e masës

Dallimin midis kulturës politike të élites dhe të masave të gjera e përcakton niveli i njohurive. Elita ka njohuri më të gjera dhe më të thella sesa masa. Kjo veçori tregon ndikimin e vet në njërin nga dimensionet më të rëndësishme të kulturës politike, pra në sistemin e bindjeve. Lidhjet funksionale dhe reciproke ndërmjet elementeve që e formojnë sistemin e bindjeve janë të qarta, kurse sistemi i bindjeve të masës nuk e ka këtë cilësi. Me fjalë të tjera, me uljen e pozitës së aktorit, bie edhe tërësia përbajtësore e sistemit të bindjeve të tij, bëhet e paqartë lidhja ndërmjet elementeve të mendimit të tij. Si përfundim zvogëlohet edhe kapaciteti njohës i aktorit dhe ngushtohet botëkuptimi i tij. Kështu, në vend të sistemit të gjerë të bindjeve që bashkon shumë njohuri të hollësishme, dalin në shesh sisteme të bindjeve të vëllimit të vogël.¹⁵¹ Sartori pohon se sistemi i bindjeve (dhe kultura politike) të élites është më i pasur, kurse ai i masës më i varfër.

¹⁵¹ Po aty, fq. 189. Krahaso me P. Converse, *repra e njëjtë*, fq. 213-217.

Ilustrimi 3. Dallimi ndërmjet sistemave të bindjes së elitës dhe masës



Adaptuar nga Sartori, *artikulli i njëjtë*, f. 408.

Dallimi ndërmjet elitës dhe masës, para së gjithash është rezultat i nivelit të edukatës-arsimit. Shtresa e elitës përbëhet nga persona që kanë marrë arsim të nivelit më të lartë. Mbi këtë veçori, ata kanë aftësinë e të menduarit abstrakt dhe të arritjes deri te gjykimet logjike. Këta individë i drejtojnë simbolet (manipulojnë me to) dhe masës ia imponojnë interpretimet e veta. L. Dittmer këtë veprimtari të elitës e quan kornizim (*framing*).¹⁵² Kornizimi ka kuptimin e tjetërsimit të ambientit të jashtëm dhe të brendshëm të simboleve dhe shumimit të tyre. Elita ka mundësi për kornizim të jashtëm dhe të brendshëm të simboleve dhe për t'ia përcjellë ato masës. Kornizimi i jashtëm bëhet duke shfrytëzuar ceremoni dhe rituale të shenjta të cilat e mbrojnë gjuhën nga të qenët shprehje e përfitimeve të jetës së përditshme. Kështu simboli kalon në një strukturë krejtësisht të ndryshme, bëhet më efektiv, më i fortë dhe më i madh. Kornizimi intern bëhet duke shfrytëzuar në të njëjtën kohë një thesar të çmuar të fjaloneve dhe gjestet fizike. Kështu simboleve u jepet një forcë shtesë dhe një shenjtëri.

¹⁵² Dittmer, *po aty*, fq. 575.

Elita, duke e institucionalizuar kornizimin, e siguron kontrollin mbi masën ose e përforcon kontrollin ekzistes. Këtu ritualizimi anon nga abstraktimi i sistemit simbolik prej ndodhive të jashtme dhe “e burgos” kulturën politike brendapërbrenda bashkësisë së ithtarëve. Kështu sigurohet kontrolli dhe realizohet sistemi shoqëropolitik.¹⁵³

Duhet theksuar se është gabim të thuhet se faktori i vetëm që e përcakton rolin e elitës është edukata. Avantazh të ngjashëm me edukatën mund të arrijë edhe një aktor që ka interesim për politikë, që i ndjek ngjarjet politike dhe që kryen vazhdimisht veprime politike, që ka një sistem të fortë të bindjes dhe që është i pavarur nga niveli arsimor.¹⁵⁴

S’ka dyshim se edhe në mesin e pjesëtarëve të shtressës së elitës ekzistojnë dallime të shumta në aspekt të ideologjisë, sistemit besimor dhe të bindjeve, kulturës politike etj. Ashtu sikur mund të hasim pjesëtarë të elitës, ngushtë të lidhur me ideologjinë, o që janë më pak të varur nga ideologja, mund të hasim edhe të tillë që janë pragmatistë.¹⁵⁵

Sh. Mardin pohon se në shoqërinë osmane ka ekzistuar nga njëra anë, elita me gjuhë të stolisur dhe vlera të veçanta, nga ana tjetër populli i periferisë me një gjuhë dhe kulturë specifike.¹⁵⁶ Disa hulumtime të bëra lidhur me kulturën politike të kësaj shoqërie kanë arritur si përfundim se në atë kohë ka mbisunduar raporti “ne-ata” dhe “miku-armiku”, gjë kjo që solidaritetin brendagrupor dhe kritikën për ata që janë jashtë grupit e ka bërë

¹⁵³ Po aty.

¹⁵⁴ Kalaycıoğlu, po aty, fq. 190.

¹⁵⁵ Sartori, po aty, fq. 408.

¹⁵⁶ Mardin, *Türk Modernleşmesi: Makaleler*, Stamboll, 1991, fq. 186.

temë më të ndjeshme.¹⁵⁷ Sipas autorit në fjalë, element ndihmës, që e ka forcuar kontrollin e elitës mbi masat, ka qenë nënshtimi i popullatës ndaj mendimit politik islam.¹⁵⁸

Kornizimi simbolik i jashtëm, që ka shërbyer për sigurimin e përshtatjes së përgjithshme të shoqërisë, na del para si *secessionizëm*. Ky shabllon ka kryer funksionin e një mjeti të zgjedhur për të fajësuar një grup shoqëror tjetrin.¹⁵⁹ Si kornizim simbolik i brendshëm, të cilin elita e ka përdorur për ta sigruar harmoninë e përgjithshme të bashkësisë ka qenë shteti. Politika, pushteti, madje çdo aspekt i jetës shoqërore është përqendruar rrëth simbolit të shtetit. Fatin e vet elita e ka identifikuar me besnikëri me atë të shtetit¹⁶⁰ dhe këtë besnikëri ka kërkuar ta kenë edhe masat ndaj shetit “të lartë” dhe “të fortë”.

Nga ana tjetër, disa hulumtime empirike kanë vërtetuar se në kulturën politike turke cilësia e elitës e ka përjetuar procesin e rënies pas kalimit në procesin shumë-partiak.¹⁶¹

Gjuha, si një lloj i posaçëm i simboleve, meqë e përfaqëson realitetin të cilin nuk mund ta përfaqësojnë simbolet e tjera, ka një rol të rëndësishëm në kulturën politike.

¹⁵⁷ FQ. W. Frey, *The Turkish Political Elite*, Kembrixh, 1965.

¹⁵⁸ Mardin, *pō aty*, fq. 188-189.

¹⁵⁹ *Pō aty*, fq. 192.

¹⁶⁰ FQ. W. Frey, “Patterns of Elite Politics in Turkey”, *Political Elite in the Middle East*, ed. G. Lenczowski, Uashington, 1975, fq. 45.

¹⁶¹ Shih: İ. Turan, “Türkiye’de Siyasal Kültürü Oluşumu”, *Türk Siyasal Hayatın Gelişimi*, ed. E. Kalaycıoğlu - A. Y. Sarıbay, Stamboll, 1986; E. Kalaycıoğlu, “Political Culture and Regime Stability: The Case of Turkey”, *Ekonomi ve İdari Bilimler Dergisi*, 2/3 (1988).

Kultura politike dhe gjuha

Gjuha është simboli kryesor i njeriut.¹⁶² Të gjitha sistemet e tjera të simboleve mund të interpretohen vetëm përmes gjuhës. Një gjë që s'e gjen shprehjen e vet në gjuhë s'mund të ketë kurrfarë kuptimi.¹⁶³ Gjuha e përfaqëson një pjesë të realitetit ose përdoret në referimin ndaj tij. Të vërtetën ne e kapim në saje të simboleve; përmes simboleve e fokusojmë atë që e shohim, atë që na duket interesante dhe atë që duam ta interpretojmë. Duke e pasur parasysh këtë themi se gjuha na e mundëson ndërveprimin shoqëror dhe homogjenizimin me kulturën.

Shprehjet simbolike, të cilave njerëzit u bashkohen në saje të gjuhës, janë mjet i shoqërizimit dhe e krijojnë lidhjen shoqërore ndërmjet aktorit dhe bashkësisë.¹⁶⁴ Në krijimin e kësaj lidhjeje gjuha nuk është një mjet i thjeshtë, ajo ia jep trajtën kësaj lidhjeje, është pjesë përbërëse e saj.

Simbolet kanë kuptim vetëm nëse përshkruhen me fjalë. Veprimet simbolike dhe të gjitha objektet ne i për-

¹⁶² E. Cassirer, *İnsan Üstüne Bir Deneme*, përkth. N. Arat, Stamboll, 1980, fq. 107-130; S. K. Langer, *Philosophy in New Key*, botimi i tretë, Kembrixh, 1971, fq. 103-141.

¹⁶³ O. Hertzler, *A Sociology of Language*, 1965, cituar nga J. M. Charon, *Symbolic Interactionism*, Englewood Cliffs, 1989, botimi i tretë, fq. 44-45.

¹⁶⁴ K. Pekonen, "Symbols and Politics as Culture in the Modern Situation: The Problem and Prospects of the 'New'", *Contemporary Political Culture*, ed. J. R. Gibbins, Londër, 1989, fq. 132.,

shkruajmë përmes fjalëve. Pra, fjalët, si element i shpjetimit, i bëjnë të mundshme të gjitha simbolet.¹⁶⁵ Kultura në përgjithësi dhe ajo politike në veçanti është shprehje me fjalë ose në mënyrë interpretative e së pérjetuarës.¹⁶⁶

Është me rëndësi të theksohet se ekziston edhe shpjegimi abstrakt i një gjendjeje që realizohet përmes shenjave (*signs*).

Shenjat janë, në thelb, abstrakte që shërbejnë për indeksimin ve kuptimeve subjektive. Ja një shembull: dihet se arma është prodhuar për gjuajtjen e kafshëve, por në përgjithësi është e mundur që ajo të shndërrohet në shenjë të agresivitetit dhe dhunës.¹⁶⁷ Në këtë rast, funksioni i pushkës na del para si një asocim i tërthortë, që mund të cilësohet edhe si simbol. Nëse shenja ka kuptim asociativ mund të shndërrohet në simbol. Në rastin e dytë, shenja është në lidhje të tërthortë me realitetin e përbashkët dhe ka karakter simbolik.¹⁶⁸ P.sh. drita e kuqe e trafikut është një shenjë, e cila, megjithëse shpreh një gjendje associative, nuk ka kuptim asociativ. Kurse flamuri i kuq është simbol sepse kujton shumë gjëra, për disa është shenjë e gëzimit, për disa të tjerë pjesë e realitetit dëshpërues.¹⁶⁹

Shndërrimi i shenjave në simbole shkakton shndërrimin e gjuhës të cilën e përdorim. P.sh. “e kuqja” është një fjalë që e bart cilësinë e shenjës dhe përbën një element *të gjuhës objektive*. Por, “flamuri i kuq” është një simbol që të kujton revolucionin, kurse “molla e kuqe” idealin turanist të Zija Gokalpit dhe janë elemente të metagjuhës (mbigjuhës).

¹⁶⁵ J. M. Charon, *pø aty*, fq. 44.

¹⁶⁶ Pekonen, *pø aty*, fq. 128.

¹⁶⁷ P. Berger - T. Luckmann, *The Social Construction of Reality*, Harmondsuort, 1981, fq. 50.

¹⁶⁸ Mardin, *pø aty*, fq. 89-90.

¹⁶⁹ *Pø aty*.

Ilustrimi 4. Raporti simboli – shenja - gjuha

mbigjuha	simboli	asocimi
	shenja	
gjuha e objekteve	asocuesi	e asocuar

Adaptuar nga L. Dittmer, "Political Culture and Political Symbolism", *World Politics*, 29/4 (1977), f. 566.

Dukuria e mbigjuhës të cilën e krijojnë simbolet e farkon në mendjen tonë idenë se gjuha nuk është vetëm mjet komunikimi, porse ajo mund të jetë edhe mjet kontrolli.

Kemi cekur se funksioni kryesor i simboleve është t'i sigurojë njeriut mjetet e kuptimësimit, gjë kjo që pasqyrohet në gjuhë. Domethënë, gjëja që nuk e gjen shprehjen e vet në gjuhë është e pamundur të ketë kuptim. Gjuha është sistem i kategorive dhe rregullave lidhur me botën, të bazuara në parime dhe hipoteza.¹⁷⁰ Në këtë kontekst, gjuha nuk është pasqyrë e realitetit objektiv. Këtë realitet ajo e krijon duke i organizuar perceptimet e kuptimta të abstraktuara nga bota komplekse dhe e çuditshme.¹⁷¹ Atëherë, mund të themi se gjuha është seri e simboleve që e përshkruan botën e perceptuar nga unë. Kur e përdor një gjuhë, kur formoj një mbigjuhë të përbërë nga simbolet, nuk dëshiroj që njerëzit vetëm të më kuptojnë, por edhe të më respektojnë dhe çmojnë.¹⁷² Gjuha që e përdor shfaqet edhe si mjet për të siguruar kontroll mbi njerëzit e tjerë.¹⁷³

¹⁷⁰ G. Kress – R. Hodge, *Language as Ideology*, Londër, 1979, fq. 5.

¹⁷¹ M. Edelman, *Politics as Symbolic Action*, Nju-Jork, 1971, fq. 66.

¹⁷² J. B. Thompson, *Studies in Theory of Ideology*, Kembrixh, 1984, fq. 47 duke iu referuar P. Bourdieu-së.

¹⁷³ Analizë të hollësishme lidhur me rolin e kontrollit të cilin e luan gjuha në marrëdhëniet shoqërore, në veçanti nga këndi i klasave shoqërore, ka bërë B. Bernstein. Shih veprën e tij *Class, Codes and Control*, vell. I, Londër, 1971.

Krijimi gjuhësor i realitetit nuk është gjë e rastësishme, por proces i krijimit të kuptimeve që përputhen me veprimin politik, kufizim gjuhësor i realitetit. Kuptimësimi del në shesh kur është i lidhur me kërkesat emocionale të aktorëve.¹⁷⁴ Me fjalë të tjera, simbolet kanë kuptim në masë të përfaqësimit të ndjenjave të individit. Mund të themi se thelbi i kulturës politike janë ndjenjat e aktorëve ndaj politikës.¹⁷⁵

Mënyrë e rëndësishme për të kuptuar se ç'ndien ndonjë aktor – pa marrë parasysh nëse është nga elita ose nga masa - në lidhje me politikën, është gjuhë që e flet ai, element ky kryesor në të cilin reflektohet kultura politike.

¹⁷⁴ Edelman, *po aty*, fq. 66.

¹⁷⁵ Dittmer, *po aty*, fq. 568.

Bibliografia

APPIGNANESI, R. & GARRAT, Ch., *Herkes İçin Postmodernizm*, pa datë dhe pa vend botimi.

BEQJA, Hamit *Tranzicioni demokratik dhe psikologja e shqiptarëve të sotëm*, Mësonjtorja e parë, Tiranë, 2000.

BULLAÇ, Ali, "Demokracia-temë problematike e botës bashkëkohore", *Vepra*, dhjetor 1999.

ÇIFTÇİ, Adil, *Toplumbilimi Yazılıarı*, Anadolu Yayınları, Izmir, 1999.

DIDA, Ali, *Fillet e sociologjisë*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSA të Kosovës, Prishtinë, 1977.

Дневник, 11 mars 2003.

DÖNMEZER, Sulhi, *Toplumbilim*, Beta Basım Yayın Dağıtım A.Ş., Stamboll, 1994.

ERKAL, Mustafa, BALOĞLU, Burhan, BALOĞLU, Filiz, *Ansiklopedik Sosyoloji Sözlüğü*, Der Yayınları, Stamboll, 1997.

FUKUJAMA, Frencis, *Krajot na istorijata i posledniot ~ovek*, përkth. Dragan Jakimovski, Kultura, Shkup, 1994.

GELLNER, Ernest, *Konditat e lirisë – Shoqëria civile dhe rivalitet e saj*, përkth. Mentor Agani, Dukagjini, Pejë, 2002.

Grolier International Americana Encyclopedia.

HARALAMBOS, Michael, *Sociologija*, Zagreb, 1989.

HOTI, Ukshin, *Filosofia politike e çështjes shqiptare*, Rozafa, Tiranë, 1995.

JARY, David & Julia, *Unwin Hyman Dictionary of Sociology*, second edition, HarperCollins Publishers, Glasgow, 1995.

KINLOCH, Graham C., *Sociological Theory- Its Development and major Paradigms*, McGraw-Hill Book Company, New York, 1977.

KOENIG, Samuel, *Sosyoloji*, Ütopya Kitabevi Yayınları, përkth. S. Sucu – O. Aykaç, Stamboll, 2000.

MARSHALL, Gordon, *Sosyoloji Sözlüğü*, çev. O. Akınhay – D. Kömürcü, Bilim ve Sanat Yayınları, Ankara, 1999.

Meydan Larousse.

MILER, David, *Blekvelova enciklopedija na politi~kata misla*, MI-AN, Shkup, 2002.

OZEL, Ismet, *Shkrime të padobishme*, përkth. Ali Pajaziti, Logos-A, Shkup, 2002.

PAŠIĆ, Najdan, *Uporedni politički sistemi*, Beograd, 1976.

POLOMA, Margareth M., *Çağdaş Sosyoloji Kuramları* (*Contemporary Sociological Theory*), Gündoğan Yayınları, Ankara, 1993.

Raport nga monitorimi i mediave në RM për periudhën 15-28 shkurt 2002.

RRAPI, Gjergj, *Sociologja*, Institut i Filozofisë-Sociologjisë, Prishtinë, 2000.

SARIBAY, Ali Yaşar, *Siyasal Sosyoloji*, botimi i katërt, Der Yayınları, Stamboll, 1998.

SARTORI, Giovanni, *Ç'është demokracia*, Dituria, Tiranë, 1998.

SARTORI, Giovanni, *Edhe një herë mbi teorinë e demokracisë*, Dituria, Tiranë, 1993.

ТАСЕВА, Марија, *Социолошки теории*, Универзитет "Св. Кирил и Методиј", Скопје, 1999.

ВУЈАКЛИЈА, Милан, *Лексикон страних речи i izraza*, Просвета, Београд, 1954.

www.angelfire.com

www.voagov/miscl/croatia

Indeksi

A

- A. Comte, 183
A. Giddens, 177
A1, 69, 71-4, 76, 78, 82,
84, 88, 89, 90, 91, 92
abstraktimet, 216
Adolf Hitler, 65
Ali Bullaç, 162
anarkia intelektuale, 40
antikomunizmi, 49
argumenti, 209
Armagedoni, 59
arti i kompromisit, 114
arti demostenian, 12

B

- bajraktarizmi, 52
bashkëjetesa, 55, 58
bashkëpunimi bilateral,
74, 75, 94
Baudrillard, 63
BDI-ja, 17, 83, 88
Bertrand Russel, 58
Borgjezia, 147

Bosnja e Hercegovina
61

bota turke, 130
Britania e Madhe, 146,
148, 150, 151

C

C. Wright Mills, 64, 157
cezaropapizmi, 29
Cogito ergo sum, 42

Ç

çështjet socio-
ekonomike, 69, 75,
79, 81, 90

D

demokracia moderne,
161
demokracia, 30, 46, 50,
159, 161, 164, 165,
203
demokratura, 57
demos, 158, 161
depersonalizimi, 47
Divide et impera, 39

E

- edukata fetare, 54
elita, 13, 57, 145, 157,
163, 196, 210-4, 218
elita sunduese, 157
elita urtare, 13
emancipimi shpirtëror,
47
erklären, 40
Ernest Gellner, 56, 163
Ernest Renan, 132
Etika protestante, 170
etnokracia, 31
etnometodologja, 176
etnosi, 134

F

- filozofët socialë, 183
FMN, 28
Foreign Affairs, 161
funksionalizmi, 168

G

- G. Sartori, 197, 200, 209
George Herbert Mead,
172
George Washington, 12
globi intellectualis, 13
Gordon Marshall, 63,
161, 176
grupe sociale, 12
grupe të interesit, 12
grupi shoqëror, 214

Gj

- gjakmarrja, 53
gjuha, 215, 217
gjuha objektive, 216

H

- Habermas, 62
Harta Kushtetuese, 27
Harvard, 22
hemoragjia e trurit, 54
Herbert Spencer, 13
homo albanicus, 38
homo ecco, 23
homo sapiens, 23

I

- Ibën Haldun, 142
ideali turanist, 216
idealizmi, 23, 33
ideologja, 143, 206,
207, 208, 210, 213
imperativi kategorik, 51
instiktet destruktive, 49
interaksionizmi, 172
interaksionizmi
simbolik, 173, 175

J

- jugosllavizmi, 27

K

- kabineti në hije, 150
kaosi, 123, 164
kinemaja, 64
Komonvelti, 149, 151

konceptimi heuristik,
199, 201
konflikti, 59, 105, 187
Konica, 50
konservatorizmi, 34
kornizimi, 212, 214
korrupsiuni, 28
Kosova, 25, 27, 30
krenaria kombëtare, 133
kriminaliteti, 76, 77, 90,
107, 120
kuazidemokracia, 57
kulmi simbolik, 205
kultura politike, 199,
200-2, 211, 215, 218
kultura autoritare, 13

L

laikos, 159
Leviathan, 140
ligji hyjnor, 57
Lobi, 11, 16, 25, 33, 37,
42, 46, 55, 63, 69,
105-7, 113-5, 118,
125, 127
Locke, 138
loja politike, 194
LSDM, 85, 120
Lufta e Dytë Botërore,
153, 169, 170

M

Machiavelli, 138
Maqedonia, 56, 58, 61,
77-8, 120, 123, 130
mare nostrum, 13
marrëveshja klasore,
147
Marrëveshja Kornizë,
19, 31, 69, 76, 97
Max Weber, 35, 170
mbreti, 147, 148, 149,
151
mediumet, 60, 63, 71,
105
mesjeta, 33
Michael Kinsley, 20
mileniumi, 133
milet, 29
minoritetet etnike, 28
modeli i integrimit, 26
modeli i krizës, 26
Montesquieu, 138
multietniciteti, 57, 134

N

Naimi, 21
Napoleoni, 143
NATO, 97, 108, 133
negocimi politik, 147
nihilizmi, 50

O

Oppenheimer, 142

P

- pajtimi rajonal, 27
parlamenti, 74, 82, 95
PDSH, 18, 76, 97
përcaktimi pozitiv, 29
personaliteti i lirë, 47
piramida shoqërore, 57
Platoni, 159
Problemstellung, 186
profesionalizmi
 gazetaresk, 71
Prologomena, 44
psikologjia e shqiptarëve,
 46, 219
psikologjia sociale, 47,
 175
pushteti ekzekutiv, 74-9,
 81, 94-5, 97, 109,
 111, 146, 148, 154-5

R

- radio, 63, 65, 92, 93, 94,
 98, 102, 104
reformat, 69, 75, 77,
 113, 148
Revolucioni Amerikan,
 143
rex publica, 138
ritualizimi, 213
Robert Dahl, 166
romantizmi, 56
Rousseau, 138, 141

S

- Saint Simon, 138
secesionizmi, 214
selbverstandis, 58
senati, 156, 160
simboli, 173, 207, 210,
 212, 215, 217
sistemi parlamentar,
 146, 147, 151, 163
societe d'information, 129
sociologjia e politikës,
 185-93, 195, 197
sociologjia, 142, 191,
 220
statologie, 137
status regalis, 138
strukturat ndërkombetar,
 75, 90, 95, 101, 103,
 112
studimet sistematike,
 182
supraidentitet, 40

SH

- ShBA, 59, 130, 153,
 154, 162, 164, 189
shoqëria multietnike, 40
shprehjet simbolike, 215
Shqipëria, 50
shtetet federative, 143
shtetet konfederative, 144
shtetet unitare, 143

T

- Talcott Parsons, 169-70
teknologjia, 64
teoria e fuqisë, 142
teoria idealiste, 142
teoria patriarkale, 141
teoritë sociale
 bashkëkohore, 167
terra incognita, 61
tranzicioni demokratik,
 46, 219
totalitarizmi, 46

TH

- Th. S. Szasz, 14
Thomas Hobbes, 140

U

- UÇK, 88, 120

V

- Vepra, 162, 170-1, 219
verstehen, 40
VMRO-DPMNE, 84,
 88, 96, 120, 122-4
Vox populi, 20

Z

- Zija Gokalp, 216
Zoti, 14, 20

W

- Walter Bagehot, 139

Dr. Ali Pajaziti
IN VERITAS /traktat sociologjik/

Boton: Logos-A

Biblioteka: Lexo

Për botuesin: Adnan Ismaili

Kryeredaktor: Husamedin Abazi

Redaktor biblioteke: Dr. Ali Pajaziti

Recensentë: Dr. Reshat QAHILI,

Dr. Metush SULEJMANI

Redaktor gjuhësor: Rexhep Zllatku

Redaktor artistik: Edi Agagjshi

Redaktor teknik: Naser Fera

Faqosës: Afrim Gashi

Mbikëqyrës i shtypit: Imer Gogufi

Përgatitja kompjuterike: Focus Pro - Shkup

Shtypi: Focus - Prishtinë

Copyright©Logos-A, 2005

Shënim i CIP katalogut i këtij libri gjendet

në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare

ISBN: 9989-58-160-6

www.logos-a.com.mk





ISBN 998958160-6

A standard one-dimensional barcode is positioned below the ISBN number. The barcode is black and white, with vertical bars of varying widths.

9 789989 581601